Xhafer Durmishi

# SKENDER

VEPRA

13



# ARGATËT AGRESIV

Shënim: Ky libër, në maj 2013, kur është publikuar për herë të parë e ka pasur titullin *Operacioni Barbarossa.*

## CILI ËSHTË SHARTI I PARË I TURQNISË?

Gjatë qëndrimit tim në Adapazar tek Sabri Novosella, ai (Sabriu) ishte i interesuar edhe për përgatitjet e mia teorike në fushën e materializmit dialektik dhe historik dhe sidomos për atë se a posedoj ndonjë aftësi sado elementare për t'i kapur problemet në gjithë kompleksitetin e tyre teorik. Për këtë arsye ai m'i shtroi dy pyetje jashtëzakonisht komplekse në pikëpamje teorike, të cilat ishin:

Shënim: Ky libër, në maj 2013, kur është publikuar për herë të parë e ka pasur titullin Operacioni Barbarossa

| | |
|---|---|
| Sabri Novosella: | Cili është sharti i parë i turqnisë? |
| Xhafer Durmishi: | Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni! |
| Sabri Novosella: | Cili është sharti i parë i shkinisë? |
| Xhafer Durmishi: | Proletarë të të gjitha vendeve, socializmin luftojeni me socializëm! |

Sabriu dyshoi në baza solide dhe më pyeti se a kam knue në Sarajevë, pasi ai si rrobaqepës i njohur dhe *menaxher kitaristash* kishte lidhje aq të ngushta sa më tha se gjatë një periudhe, *Bijelo Dugmen* e ka sjellë në maje të gishtit. Pra më duket se ai fitoi një përshtypje se jam i knueshëm (për moshën), përderisa i analizonte përgjigjet e mia në tërë kompleksitetin e vet. Për këtë ai shkroi më vonë: *"Xhafer Durmishi u bë më marksist se vetë Marksi, më Lenin se Lenini e më Stalin se Stalini."*


1. Lutje për ndihmë
2. SI U NJOHA ME JUSUF E BARDHOSH GËRVALLËN DHE KADRI ZEKËN
3. FTESË
4. Adem Gashi: DYNDALLA E MENDIMEVE
5. Sadri Ramabaja: Dëshmitari dhe krijuesi i historisë, Sadri Ramabaja
6. Prend Buzhala: PROMOVIM – IBRAHIM KELMENDI: "ATENTATET"
7. Shemsi Reçica: Zonja e zotërinj
8. Rasim Selmanaj: LIBRI " ATENTATET" I IBRAHIM KELMENDIT
9. Avni Dehari "Atentatet" - sjell kujtimin për vrasjen tragjike të 17 janarit '82
10. SAIME ISUFI: SECILIN PERSONAZH E KE PARAQITUR TË TILLË SIÇ PATA MUNDËSI T΄I NJIHJA EDHE VETË
11. Salih Kabashi: PER ROMANIN ATENTATET
12. Ibrahim Kelmendi: E NJOH VRASËSIN E JUSUF GËRVALLËS
13. Hysen Gërvalla: E KA PRAPA KËTË FAMILJE
14. Ramiz Kelmendi: Më ke gëzuar
15. Ibrahim Kelmendi, autori i romanit "Atentatet" u pergjigjet lexuesve!
16. Bedri Islami: Vonesa e mbarë
17. Mustafë Xhemaili: Atentatet e zbuluara
18. Ibrahim Kelmendi e Salih Kabashi: BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN E HIDHUR TË KOSOVËS TË TREMBË PËRHERË
19. Daut Demaku: ROMANI "ATENTATET" ËSHTË SHEMBULL I PASTËR KU E SHOHIM ME SY RILINDJEN E HERONJVE TË KOMBIT
20. KUSH I KA DENUAR HERONJTË DHE DESHMORËT...!?
21. Shaban Sinani: Sahati i Sinanit
22. Fatos Aliu: Zhvendosja e binarëve të lëvizjes kombëtare
23. TI E DI, SE PATA SHKRUAR ROMAN DHE JO LIBËR HISTORIK E DOKUMENTAR DHE AS MEMOARE
24. Përshëndetje (Xhafer Durmishi)
25. Nuk do te ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant


## 1. LUTJE PËR NDIHMË

Datum: Fri, 15 Dec 2006 16:09:38 +0100 (CET)
Betreff: Kelmendi: Lutje për ndihmë

Të dashur shokë, miqë dhe dashamirë të librit,

po ua nisë, të bashkangjitur në attachment, lutjen që po e shpërndaj përmes interneti, për romanin ATENTATET, që dëshiroj ta botoj me rastin e 25-vjetorit të atentateve ndaj Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës e Bardhosh Gërvallës, tashmë personalitete historike.

Edhe me këtë rast Ju falënderoj për gatishmërinë Tuaj për të më ndihmuar. Meqë adresarin tim të mail-adresave nuk po e seleksionoj, dëshiroj të kërkoj falje ndaj atyre që ndjehen të bezdisur nga kjo lutje imja.

Miqësisht
Ibrahim Kelmendi

PS. Të interesuarit për të më ndihmuar, dëshiroj t'i lus që këtë lutje timën
tua shpërndaj shokëve e miqve të Tyre.

Shumë të dashur shokë e miq,
Të nderuar lexues të librit,
Ju informoj se kam përfunduar se shkruari romanin, të cilin e kam titulluar "Atentatet". Përmbajta kryesore e ti është jeta dhe veprimtaria në ekzil e shkrimtarit, publicistit, gazetarit e këngëtarit Jusuf Gërvalla, gazetarit Kadri Zeka dhe punëtorit social Bardhosh Gërvalla, si dhe atentatet ndaj Tyre në Gjermani, më 17 Janar 1982. Kam sjellë të dhëna, që opinioni shqiptar akoma nuk i di.
Romanin do ta vlerësoja të zhanrit historik dhe politik.
Këtë roman dëshiroj ta kem të botuar me rastin e 25-Vjetorit të rënies se këtyre personaliteteve, tashmë historike. Ndonjë shtëpi botuese, që të jetë në gjendje financiare ta botoj me shpenzime të veta, nuk kam gjetur deri tani.
Prandaj po ndjehem i detyruar, të Ju lutem për ndihmë financiare, që ta realizoj botimin e këtij romani deri më 17 Janar 2007.
Që përpara ju falënderoj për mirëkuptimin dhe për ndihmën Tuaj.
Kërkoj falje nga ata që ndjehen të bezdisur nga kjo lutje imja.
Vëllezërisht e miqësisht
Ibrahim Kelmendi (telefoni im: 00377 44 151959)

Gjirollagaria ime bankare: 1501030000582464, Reiffeisen Bank Kosovo, Prishtina, Kosova
Njoftim: Deri tani kanë shpreh gatishmëri që të angazhohen për të mbledhur ndihma për mua te shokët e miqtë e tyre:

| | | |
|---|---|---|
| Norvegji: | Nufri Lekaj | tel.: 0047 90038098 |
| Belgjikë: | Muharrem Berisha, | tel.: 0032 475470452 |
| Zvicër: | Blerim Muriçi | tel.: 0041 797032928 |

Në ndërkohë po pres të shfaqin gatishmëri edhe shokë e miq të tjerë.
Emrat e të gjithëve, që do më ndihmojnë, dua t'i bëjë publik në libër, me përjashtim të atyre që nuk e dëshirojnë.

## 2. Njohja me Jusuf e Bardhosh Gërvallën dhe me Kadri Zekën

Intervistë me veprimtarin dhe publicistin Ibrahim Kelmendi
Intervistë e botuar në gazetën "EPOKA E RE"
Adem Gashi
Prishtinë, 7 janar 2007– Këtyre ditëve e netëve të dimrit surrogat, më rastisi ta takoja njeriun, për të cilin kisha dëgjuar të flitej qëkur, por e kisha njohur më vonë, në verën e vitit 1990, në një qytet të Zvicrës. Ibrahim Kelmendi më vinte kështu me dy portrete: me atë që ia bënin të tjerët (një figurë që lëvizte ndërmjet Trockit dhe Bakuninit/anarkistit) dhe me pamjen e vet të natyrshme (të njeriut që ishte i gatshëm të të ofronte shërbim pa u hamendur, sidomos për punët që lidheshin me kauzën e atdheut e të lirisë), por që asnjëherë nuk e shfaqte autoportretin, nuk e shpalonte CV-në e vet, siç po thuhet tashti. S'i kam shpëtuar as vetë tundimit dhe dilemës: Është modesti e këtij njeriu,

apo zonat e errëta janë terrene që e joshin për mistifikim!? Sidoqoftë, në të gjitha variantet, portreti i tij, në profil, shfaqet me një vurratë.

***Jemi goxha burra tashti dhe besoj nuk ma merr për keq. Ç'është kjo shenja në faqe?***

**Kelmendi**: Këtë e kam dhuratë nga Zoti, do thoshin besimtarët, që janë të prirur ta ngarkojnë Atë padrejtësisht. Saktësisht duhet ta kem nga gjallëria dhe kureshtja. Në moshën fëmijërore prej shtatëmbëdhjetë muajsh, duhet t'më ketë bërë përshtypje oxhaku i madh i familjes sonë të madhe, gjegjësisht zjarri i madh në atë oxhak dhe kazani gjithashtu i madh, i mbushur me fi dhe i varur për të zier rrobat që do i lante Nëna. Në atë zjarr tërheqës jam futur dhe jam bërë grill, gjegjësisht hell. Ka qenë dhjetori i dimrit të rëndë të vitit 1956. Babën atë ditë e kishin lidhur për kumbulle në oborrin e stacionit të policisë në Kliçinë. Pas dyzetë e një viteve, kur Adrian Krasniqi, vëllai im, Qerimi, bashkë me bashkëluftëtarë, e sulmuan këtë stacion famëkeq, m'u bë sikur e sulmuan për të marrë hak për Babën tim, për shumë baballarë dhe për mua, pasi ditën e djegies sime, duhet të më ketë munguar Baba, që të më dërgonte menjëherë në spital.

***Mos doni të më thoni se edhe adoleshenca juaj i nënshtrohet trysnisë së pushtetit të pushtuesit?***

**Kelmendi**: Me tepri, do thosha. Baba shpesh rrëfente për angazhimet e tij kundër pushtuesit dhe vuajtjet e tij po nga pushtuesit, pas ripushtimit të Kosovës. Rrëfimin e fillonte nga i pari i tij në Vuthaj të Gucisë, kur pushtuesit malazez e kishin ther, bashkë me 300 burra të përzgjedhur të fshatit. Barbare në atë rrëfim ishte, se 300 burrat i kanë lidhur dorë për dorë, i kanë detyruar t'i hapin varret e tyre, i kanë ther me singia, i kanë hedhur në varre, i kanë mbuluar me dhe pa ju dalë shpirti. Në vitet e 50-ta e 60-ta përndiqej djali i axhës, Imeri, i vetmi në rrethinën tonë që studionte historinë. Në fëmijëri atë e kisha si idol. Që në klasën e parë të shkollës së mesme të mësuesisë në Pejë, si 14-vjeçar, më rastisi të ballafaqohem me peripeci, për shkak të rolit tim spontan në demonstratën e 28 nëntorit të '68-tës, që u nis në oborrin e kësaj shkolle. Më 1972 më rastisë të më arrestojnë në Rahovec, duke qenë në vitin e 4-tërt të Gjimnazit të atyshëm.

***Ditët studentore doemos jua hapin terrenin për njohje të reja me shokë, miq e bashkëmendimtarë. Kë kujtoni nga ajo kohë? Cilët kishit idole, frymëzues shpirtëror që donit t'u shëmbëllenit?***

**Kelmendi**: Tri vite isha studentë në Prishtinë, dega e fizikës. Qysh në vitin e parë u gjeta në rreth të mirë të shokëve, meqë isha ilegal (banues jo legjitim) në dhomën nr. 5, të konviktit nr. 1, ku legalisht banonin vëllai Zeneli dhe kolegu i tij, Tahir Reci, absolventë të juridikut. Ata i kishim si kujdestarë të rreptë për ngritjen tonë intelektuale. Edhe Fetah Kajtazi ishte cimer, ilegal si unë. Kishim shumë shokë dhe vazhdimisht diskutonim, si të organizohemi dhe çfarë mund të bënim. Jusuf Bruçaj na "indoktrinonte" pa pra, por vdiq nga rrjedhojat e burgut. Atëherë bënim gjëra të vogla, për të cilat në vitin 1976 m'u desh të arratisem. Veprimtaria e fshehtë e Grupit Revolucionar, veprimet e të cilit patën jehonë, na dhanë forcë morale dhe na provokuan që edhe rrethi ynë i shokëve të angazhohej, deri sa të gjenim kontakt me atë Grup, por nuk e gjetëm.

***Kur ndodh angazhimi juaj politik i një shkalle më të ndërgjegjshme? Ku dhe si aderoni fillimisht? Ç' kuptim ka dalja juaj jashtë vendit?***

**Kelmendi**: Në Gjermani në vitin 1977 regjistrova gjermanistikën dhe filozofinë, në Ruhr-Universitet në Bochum. Sapo gjeta veten, fillova të botoj ndonjë trakt të thjeshtë, që ua shpërndaja emigrantëve tanë, që mezi dinin t'i lexonin. Pastaj avancova në botim të një pamfletit, që e pata titulluar: "Rron or rron, dhe nuk vdes shqiptari" dhe në botim të një si gazete, me emër "Bashkimi", Organ i Frontit të Kuq Popullor. Këtë e themeluam në vitin 1978. Ishte faza e revolucionaritetit adoloshent, në kuptimin ideo-politik e organizativ. Por, vështirësia ishte se nuk kisha shokë, me të cilët do organizonim veprimtarinë botuese, emigrantët tanë ekonomikë ishin gjysmanalfabetë dhe njëherësh frikësoheshin për t'u angazhuar.

***Si dhe sa e njihje në atë kohë veprimtarinë atdhetare ilegale?***

**Kelmendi**: Fillimisht fare pak, asgjë konkrete, pothuajse vetëm nga disa bisedime me përmbajtje të një patriotizmi romantik. Djali i axhës, Imeri, i cili përndiqej e survejohej si i dyshuar për veprimtari ilegale, nuk na fliste konkretisht. Te ne, në kullën tonë të famshme, vinin personalitete, si Ramadan Shala, Murteza Nura, Nezir Gashi dhe të tjerë. Prania e tyre në odën e miqve na bënte krenarë. Më pastaj, gjatë studimeve në Prishtinë, diskutonim shumë për organizimet e fshehta, por nuk i kontaktonim dot. Do thoja, në atë kohë gati sa nuk ndjehej nevoja për veprimtari të fshehtë patriotike, meqë shumë veprimtari mund të ushtroheshin hapur. Kishte ndodhur një ndërgjegjësim i gjerë patriotik dhe strukturat e pushtetit të KSA të Kosovës mbyllnin njërin sy, bëheshin sikur nuk po vërenin. Pra, Kosova po frymonte më lirshëm. Por, në këtë kohë po formohej një borgjezi e kuqe, titiste, që kishte mundësi të bënte më shumë për zhvillim të përshpejtuar të Kosovës, por humbiste kohën me pasurim të pamerituar vetanak, humbiste kohën në kafehane, pas degjenerimit etj. Sapo u arratisa, m'u dha mundësia të informohem më shumë.

### Njohja me Jusuf e Bardhosh Gërvallën dhe me Kadri Zekën

***Duke njohur shumësinë e profilimeve politike të veprimtarëve atdhetarë, mund të na jepni një sinopsis të atyre rrymimeve?***

**Kelmendi**: Përgjithësisht, organizimet e fshehta në Kosovë ishin të majta, komuniste e revolucionare, meqë ndikoheshin nga propaganda e fuqishme e Tiranës dhe të angazhuarit vinin kryesisht nga shtresat e varfra. Ndonjë organizim i djathtë në vitet e 60-ta e 70-ta nuk duhet të ketë ekzistuar, për sa kam qenë unë i informuar. Në Perëndim, në dy vitet e para, dëgjoja për ca organizime nacionaliste, i kërkoja ato në Bruksel e gjetiu, por kur vija në kontakt, dëshpërohesha, pasi ato organizime nuk kishin përmbajtje kombëtare dhe aty e tutje i quaja pseudonacionaliste. Ishin ca organizime formale, të vogla, pa peshë e ndikim, që vetëm përflisnin, se si do ta çlironin Shqipërinë nga diktatura komuniste, ndërsa trojet e pushtuara, Kosovën me vise, nuk e përmendnin fare. Këto organizime i udhëhiqnin kryesisht njerëz që dikur i kishin shërbyer UDB-së, pasi ishin arratisur nga Republika e Shqipërisë në RSFJ-në, gjithashtu komuniste. Ata nuk i kishte penguar terrori komunist i serbomadhit Aleksandër Rankoviç mbi shqiptarët e pushtuar, meqë e kishin pasur atë si një lloj punëdhënësi. Të njëjtin zhgënjim përjetova në vitin 1978, kur njoha më për së afërmi Besëlidhjen Kombëtare Shqiptare, të cilën e udhëhiqte Emin Fazlia, alias Emil Kastrioti. Edhe kjo pseudo-organizatë, në dukje nacionaliste, 7-8 anëtarë të të cilës ishin nga Kosova, preokupim kryesor kishte çlirimin e Shqipërisë nga diktatura komuniste e Enver Hoxhës dhe jo çlirimin e Kosovës nga pushtimi jugosllav. Kjo njohje nuk më përvetësoj që t'ju bashkëngjitem atyre, prandaj u ndjeva i detyruar të themelojmë,

bashkë me ca bashkatdhetarë, organizatën Fronti i Kuq Popullor. Përkrahjen fillestare e gjeta te bashkatdhetarët në Düsseldorf me rrethinë dhe nga emigracioni i vjetër nacionalist në Bruksel, rreth veteranëve të famshëm Gjelë e Hysen Gjelil Kalishta, që veten e dinin për ballistë. Për të na u kundërvënë, pas nesh Riza Salihu sajon Grupin Komunist "Zëri i Kosovës", në Stuttgart. Në fund të vitit 1979 në Gjermani arratiset Jusuf Gërvalla. Në të njëjtën ditë informohem nga vëllai i tij, Bardhoshi, me të cilin isha njohur dhe ishim bërë miq që në vitin 1978. Ardhjen e Jusufit e përjetuam si ndihmesë të madhe morale dhe intelektuale. Po në këtë kohë, në Zvicër gjendeshin Kadri Zeka dhe Hydajet Hyseni, kuadro drejtues të OMLK-së, por angazhimi dhe ndikimi i tyre nuk shihej gjëkundi, pasi ishin futur në ilegalitet, shtatë pashë nën tokë. Meqë Jusufi i përkiste Lëvizjes Nacional-Çlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ), vendosëm që veprimtarinë e organizuar të Frontit ta ngrimë, siç po thuhet, deri sa të ndodhte bashkimi.

***Pas ngjarjeve të të tetëdhjetave (e kam fjalën për demonstratat e 1981- së), cili ishte roli i veprimtarëve shqiptarë në Perëndim? Format e organizimit dhe shtypi?***

**Kelmendi**: Angazhimi ynë më i suksesshëm, në janar të vitit 1981, ishte përgatitja e gazetës "Bashkimi", futja dhe shpërndarja e tij e fshehtë në Kosovë dhe më pastaj shpërndarja në Perëndim. Në kryeartikull, me titull "Bashkimi bënë fuqinë", të shkruar nga Jusufi dhe unë, kishim përpiluar platformën ideopolitike të kohës dhe kishim shtjelluar formën e organizimit në Kosovë e në emigracion. Platforma ideopolitike dhe forma e organizimit, të trajtuar në këtë kryeartikull, kishin karakter pluralist.
Protesta sociale e studentëve më 11 mars 1981, demonstrata politike më 25 mars, ku u lansua për herë të parë kërkesa për Statut të Republikës, dhe revolta popullore e 1 e 2 prillit na befasuan, meqë ne kishim bërë parashikime të përgjithësuara, se shpërthimet sociale e nacionale do të ndodhnin, por nuk i kishim parashikuar aq të shpejta. Menjëherë, Jusufi, Kadriu dhe unë, morëm vendim për të bërë demonstrata çdo fundjavë në metropolet kryesore të Zvicrës dhe të Evropës Perëndimore, të cilat kishin ndikim të kufizuar jashtë, por moralizonin popullin në Kosovë. Kjo 3-she, edhe pse u përkisnim organizatave të veçanta, pothuajse gjatë gjithë vitit 1981 e organizonte veprimtarinë, sikur t'i përkisnim një organizate të vetme. Fillimisht Jusufi, bashkë me Kadriun (prill-shtator), u angazhuan edhe në redaktimin dhe botimin e Organit të OMLK-së, "Liria", meqë gazetën "Bashkimi" dhe revistën "Lajmëtari i lirisë" i kishim "ngrirë", duke pritur bashkimin. Gjatë muajit korrik-gusht, fillimisht Jusufi, Kadriu dhe unë, pastaj edhe bashkëveprimtarë të tjerë, diskutuam platformën e bashkimit, duke u bazuar në tezat e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Ato i kishte përpiluar OMLK-ja në maj të '81-shit në Kosovë, por bashkimi në Kosovë u pengua nga burgosjet e shumta. Prandaj u ndjemë të thirrur që bisedimet t'i vazhdojmë ne dhe të realizojmë bashkimin. Në parim u dakorduam për platformë dhe për formë të organizimit. Jusufi shprehu dëshirën, që bashkimin ta shpallte veterani Sabri Novosella, të cilin ai e dinte si njërin nga udhëheqësit e Organizatës se tij, LNÇKVSHJ. Në tetor 1981, në takimin e Stambollit, Sabri Novosella bllokon përkohësisht bashkimin, për të cilin ishim marrë vesh qysh në gusht. Si rrjedhojë, Jusufi dhe Kadriu ndërprejnë bashkëpunimin deri më 2 janar 1982, me përjashtim të pjesëmarrjes se përbashkët në festën e 28 Nëntorit, ku bashkërisht ishin në podium të atij manifestimi të madh. Gjatë këtyre dy muajve Jusufi nis botimin e gazetës "Zëri i Kosovës", si organ të LNÇKVSHJ, kurse Kadriu përgatit një numër të "Lirisë". Më 2 janar 1982, në dasmën e Kadri Zekës dhe Saime Jusufit, gjendet mirëkuptimi i pezulluar në mes të Jusufit e Kadriut. Më 16 janar, me ftesë të Jusufit, takohemi për të bërë bashkimin. Në agun e 17 Janarit 1982, vendosim bashkimin e tri organizatave tona. Në

mbrëmjen e kësaj dite të kobshme, UDB-ja ekzekuton Jusufin, Kadriun e Bardhoshin dhe plagos rëndë vendimin tonë për bashkim.

**(Pjesa e dytë e intervistës)**

Intervistë me veprimtarin dhe publicistin Ibrahim Kelmendi (2)
Me Thaçin konfrontohem për të mirë të Kosovës dhe të PDK-së
-Në PDK asnjëherë nuk kam qenë anëtar
-Hidhërohem ndaj disa bashkëveprimtarëve dhe miqve të dikurshëm, që bëjnë vila e pallate...
Adem Gashi

Prishtinë, 8 janar 2007- Me Hashim Thaçin jemi bashkëveprimtarë e miq të vjetër. Miqësinë dhe respektin vazhdoj ta ruaj për të, pavarësisht kritikave të herë pas hershme. Besoj edhe ai ruan për mua miqësi e respekt reciprok. Jo vetëm një herë jemi "konfrontuar" në media dhe kam ndërmend të "konfrontohem" sa herë që do ta gjykoj se "konfrontimi" im është në të mirë të Kosovës, të zhvillimit të demokracisë në PDK dhe në të mirë të vetë Hashim Thaçit. Kështu është shprehur në pjesën e dytë të intervistës për "Epokën e re", veprimtari dhe publicisti Kelemendi.

Një çerek shekulli heshta, me mendim se heshtja ime është konstruktive...

***Me Bardhosh Gërvallën njiheshit më herët, po me Jusufin, Kadri Zekën?***

**Kelmendi**: Në këtë pyetje duhet të jem përgjigjur paraprakisht. Konkretisht, me Bardhoshin jam njohur e miqësuar në vitin 1978, me Jusufin sapo ka arritur në Gjermani, në fund të vitit 1979, kurse me Kadriun në fund të marsit të vitit 1981.

***Itinerari gjeografik i veprimtarisë sate shtrihet gjithandej Evropës e kontinenteve të tjera. Jam kurioz të di në ç'gjendje ishte mërgata jonë në kontinentin e largët, në Amerikë? Kam parasysh gjithnjë traditën e ndritur të Nolit e të Konicës.***

**Kelmendi**: Pas atentateve na u imponuan "përfaqësuesit" e LNÇKVSHJ-së (Sabri Novosella), PKSHMLJ-së (Avdullah Prapashtica) dhe OMLK-së (Xhafer Shatri). Ata nuk deshën të dinë për bashkimin e 17 Janarit, por bën një "bashkim" të tyre, për t'u përçarë në mes tyre, pa u tharë ngjyra e firmave nën marrëveshje. Nga qershori deri në dhjetor 1982 shkova në Amerikë për të shtrirë ndikimin e Lëvizjes sonë atje, dhe për t'u arratisur nga zullumi që më bënin "trashëgimtarët" politikë të Jusufit e Kadriut, të cilët uzurpuan (ç)udhëheqjen e Lëvizjes sonë.

Në aspektin e organizimit patriotik e politik komuniteti shqiptar në Amerikë ishte për faqe të zezë. Vatrën e Nolit e kishte pushtuar UDB-ja, kryesisht përmes krerëve të Legalitetit. Disa vatranë, nga pakënaqësia, në Boston ishin organizuar në shoqatën dhe rreth gazetës "Liria". Mërgata politike ishte e copëtuar në shumë partiza e organizata, të cilat pos zhurmës në rrethe të ngushta, kishin numër të vogël të anëtarëve e simpatizantëve. Ndikimi i tyre ishte simbolik. Edhe ato zhurmonin për çlirimin e Shqipërisë nga diktatura komuniste e Enver Hoxhës, kurse Kosova e pushtuar ju interesonte vetëm sa për të vjel ndonjë ndihmë financiare nga shqiptarët e trojeve të pushtuara. Kjo mërgatë në vitin 1981 shante e fyente studentët dhe rininë e Kosovës, me etiketime e përfolje, si "kuçaloshët e Enverit" e ngjashëm. Sa për të bërë një formalitet, në prill 1981, kjo mërgatë organizoi një protestë para Selisë se OKB-së në Nju Jork, por nuk morën pjesë as 300 veta, të ardhur edhe nga Detroidi, Çikago e qytete të tjerë, në

kohën kur vetëm në Nju Jork duheshin të ishin rreth 50 mijë shqiptarë. Emigracioni i ri nga Kosova, nga Maqedonia, nga Mali i Zi, që ishte i interesuar të angazhohej për statut të Republikës për Kosovën, pengohej e kërcënohej nga emigracioni i vjetër pseudonacionalist, i cili, pothuajse tërësisht, kontrollohej nga UDB-ja.

***Këtyre ditëve në faqet e shtypit është dukur një kërkesë për mbështetje rreth botimit të një romani tuaj. Me pak rreshta përvijohet tematika që jo rrallë ka trazuar shpirtrat e shqiptarëve. Është fjala për atentatin ndaj vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës. Unë njoh disa fusha të vokacionit tuaj si komentin, vështrimin, shkrimin dokumentar (kam lexuar edhe librin tuaj për ngjarjet e 97-së në Shqipëri). Përse këtë herë zgjodhët pikërisht gjininë e romanit? Mendoni se zbardhja do të jetë më e thellë dhe më totale?***

**Kelmendi**: Një çerek shekulli heshta, me mendim se heshtja ime është konstruktive, në interes të veprimtarisë sonë çlirimtare. Individëve dashamirës, por më shumë individëve naivë, ju interesonin emrat e dorasëve. Disa syresh shpërdoronin vëllezërit Avdyl e Hysen Gërvalla, për të më terrorizuar, duke shfaqur banalisht naivitetin e tyre, sikur vetëm ata, si vëllezër, po interesoheshin për të zbuluar vrasësit. Atyre nuk ju mjaftonte prononcimi i Jusufit, me plumba vdekjeprurës në trup, se “atentatin politik na e ka bërë UDB-ja”, të tillëve nuk ju mjaftojë as porosia (amaneti) i tij: “Nëse dorasit janë shqiptarë, mos u zbulofshin kurrë!”. Kërkonin gjithsesi emrat e dorasëve, jo vetëm nga kureshtja.

Zgjodha zhanrin e romanit historik e politik për të kompletuar sa më shumë tabloidin e veprimtarisë, jetës dhe të atentateve, sidomos ato që nuk dukeshin. Njëherit, zgjodha romanin, për të paraqitur edhe figurën e kryedorasit të mundshëm, për të cilin unë vazhdoj të jem i bindur se e ka bërë këtë krim të rëndë.

Në PDK asnjëherë nuk kam qenë anëtar

***Janë bërë disa libra për UÇK-në. Dihen raportet dhe roli i LPK-së. Pastaj lufta në Kosovë, në Luginë të Preshevës, në Maqedoni. Ku ishte Ibrahim Kelmendi?***

**Kelmendi**: Aty ku mendonte se ishte i nevojshëm dhe ku e ngarkonin me detyrë, pa bërë zhurmë e vetëreklamim, siç bënin disa zhurmë për t’u afirmuar, që bënin sherr e pengonin luftërat.

***Pastaj erdhën partitë e reja, partitë e ish-luftëtarëve. Njëherë u dukët në PDK. Më vonë u botua një shkrim juaji tepër kritik për teorinë e Moratoriumit të liderit të PDK-së, Hashim Thaçi. Ishte mospajtim konceptual apo frymë e demokracisë së brendshme?***

**Kelmendi**: Në Kuvendin e fundit të LPK-së, të mbajtur në Prizren në vitin 1999, u prononcova: “Fillimisht nuk do angazhohem në asnjë parti politike, pasi më duhet kohë për t'u integruar në Kosovë, pas gati 25 viteve në ekzil. Nëse ka qenë i mbarë kontributi im deri tani, ka qenë i mjaftueshëm, nëse ka qenë i mbrapshtë, ka qenë i tepërt...”.Në PDK asnjëherë nuk kam qenë anëtar. Në mbledhjen themeluese dhe në Kongresin e Parë kam marrë pjesë si qytetar i lirë. Më ka interesuar vëzhgimi i drejtpërdrejtë, nëse po themelonin parti vërtetë demokratike. Gjithashtu isha i interesuar të jap ndonjë sugjerim profesional, nëse do më kërkohej, ose do ta jepja vetë, nëse e gjykoja të arsyeshëm. U ndjeva i zhgënjyer, sidomos nga mënyra e imponimit dhe e autoritarizmit të Hashim Thaçit. Me Hashim Thaçin jemi bashkëveprimtarë e miq të vjetër. Miqësinë dhe respektin vazhdoj ta ruaj për të, pavarësisht kritikave të herë pas hershme. Besoj edhe ai ruan për

mua miqësi e respekt reciprok. Jo vetëm një herë jemi "konfrontuar" në media dhe kam ndërmend të "konfrontohem" sa herë që do ta gjykoj se "konfrontimi" im është në të mirë të Kosovës, të zhvillimit të demokracisë në PDK dhe në të mirë të vetë Hashim Thaçit. Nuk besoj se kjo do prish miqësinë tonë, pasi kemi jetuar mjaft gjatë në Perëndim, për të mësuar diç nga kultura e atjeshme demokratike. Jam i prirur të kritikojë e kundërshtoj miqtë, që ata të bëhen më të mirë. Ata që i konsideroj se janë destruktivë dhe që i vlerësoj të jenë në "grixhën" e Beogradit e në "grixhat" e shërbimeve të huaja, kryesisht i le të qetë, për të mos thënë i injorojë.

***Po tani? Tani? Unë njoh tash e gjashtëmbëdhjetë vjet Ibrahim Kelmendin. E di se është martuar me të hyrë të nëntëdhjetave me Mimoza Cikën, që tashti punon si gazetare e redaktore në radion Deutsche Ëelle (dojçe vele) në Këln, e di që ka një djalë, e di që duket sa në Gjermani, sa në Prishtinë, sa në Tetovë, sa në Tiranë, ndoshta rastësisht (!) edhe në Vuthaj. Po, çfarë nuk di? Ku është ai tani dhe ç'bën?***

**Kelmendi**: Për momentin jam këtu dhe vazhdoj të jem Ibrahim Kelmendi. Gjendem gjithandej, kudo më duket e nevojshme dhe ku ndjej kënaqësi të gjendem. Po përpiqem të kompletoj e të sistemoj shënimet për të kaluarën. Jam marrë intensivisht me grumbullim të bashkëbisedimeve (kam të incizuara rreth 300 orë) me shumë veprimtarë të emigracionit, të të gjitha rrymave e organizimeve, duke përgatitur të paktën nga një libër për çdo shtet. Profesionalistet më kanë këshilluar se botimi i tyre duhet të shtyhet për më vonë, sepse tani është çekuilibruar sistemi i vlerave. Pra, kam të gatshme një mori botimesh dhe do t'i botoj kur do të gjykoj se e kanë kohën.

Hidhërohem ndaj disa bashkëveprimtarëve dhe miqve të dikurshëm, që bëjnë vila e pallate...

***Zërat e skajshëm që më vijnë ma bëjnë portretin tënd të ngjashëm me personazhin Durmish Dur Aliu të Kadaresë, që, herë shfaqet e herë humbet. Kanë ardhur këta zëra tek ti ndonjëherë dhe ç'mbresa keni pasur? Si i gjykoni, më në fund?***

**Kelmendi**: Nuk më kujtohet fare ky personazh. Kam gjykuar se veprimtarisë tonë politike dhe çlirimtare i duhet edhe njeriu i "padukshëm", në operativë, siç thuhet në gjuhën profesionale. Këtë rol të rëndësishëm nuk mund ta ushtrojnë ata që vazhdimisht dëshirojnë të duken, të imponohen e të vetëreklamohen, nuk mund ta ushtrojnë as ata, që edhe kur pjerdhin, mendojnë se kanë bërë bombë atomike. Këtë rol nuk mund ta luajnë as ata që përpiqen të përvetësojnë meritat e të tjerëve, meqë dinë se vetë janë të pa merita. Mua tani po më brengos, se disa të pamerituar i janë imponuar skenës politike e partiake në Kosovë, kurse nuk po më brengos pse unë kam ngelur në "hije". Vazhdoj të jap kontributin tim, pa pritur që të paguhem, të dekorohem e të bëhem personalitet mediatik. Hidhërohem ndaj disa bashkëveprimtarëve dhe miqve të dikurshëm, që bëjnë vila e pallate, shpenzojnë barbarisht mjetet e pamerituara, por nuk hidhërohem pse atyre nuk ju intereson për Ibrahim Kelmendin, që ende nuk ka banesë e të ardhura të rregullta për jetesë, por po varet nga ndihma e individëve vullnetmirë dhe shpirtmirë. Për këtë gjendje sociale nuk ndjehem i penduar, por krenar, meqë kam përballuar tundimin e parasë (edhe kur kam kaluar miliona DM nëpër dorë) dhe të tjera tundime, që sprovojnë ndershmërinë e burrit, siç thuhej nga pleqtë. E çmoj si jo njerëzore, për të mos thënë armiqësore, kur mësoj se disa individ shpërdorojnë mundësitë, që të përvetësojnë ato që nuk i meritojnë, në këtë fazë kaq vendimtare, e cila kërkon vetëpërmbajtje e sakrifica, kërkon kontribut konstruktiv. Në kohë të përshtatshme, këta keqbërës mbase do jenë personazh të ndonjë

romani, siç i kam paraqitur disa në romanin "Atentatet", për t'i përjetësuar si të tillë. Keqbërësit e sotëm po i "survejojë" përmes syrit të popullit. Jam i vetëdijshëm, se keqbërësit nuk do skuqen e marrohen, edhe kur do përjetësohen në romane, si shpërdorues tenderësh edhe të ilaçeve, si shpërdorues të besimit politik e partiak, si autoritar absolutist në parti, në poste ekzekutive e gjetiu. Nuk do skuqen as pseudo trimat, që populli i quan trima pas beteje, nëse do t'i përjetësojë si të tillë, nëse po i keqtrajtojnë bashkëqytetarët tanë joshqiptarë, për interesa të tyre personale ose si mercenarë të Beogradit, nëse i keqtrajtojnë për teka e frustrime të tyre, jo vetëm për të kompromentuar Kosovën, por edhe duke rënë në nivel të bishave... Kur shumë keqbërës e kriminelë mendojnë se unë jam zhdukur, dhe prandaj mund të livadhisin lirshëm, pikërisht në këtë kohë unë mbledh e përpunojë investigimin që ua bënë syri i popullit. Kur të gjejë mënyrën e momentin e përshtatshëm, do t'i përjetësojë në letra, si të tillë. Shpresoj se edhe krijues të tjerë do kenë kurajë, që të trajtojnë këtë tematikë, sado që ndjehen të kërcënuar e të pafuqishëm. Shfrytëzoj rastin që të uroj lexuesit e gazetës për Vitin e Ri 2007. U dëshiroj shëndet e suksese, u dëshiroj edhe më shumë ndërgjegjësim qytetar e demokratik, për të penguar në secilin hap keqbërësit e kriminelët. Uroj që bashkëqytetarëve t'u rikthehet kultura e punës, e urtisë, e bamirësisë.

***Tok me falënderimin për bashkëbisedimin, Ju dhe familjes suaj u deshiroj shëndet!***

**Kelmendi**: Edhe unë ju falënderoj dhe ju uroj ato që i dëshironi vetës suaj.

## 3. FTESË

Sot përurimi i romanit ATENTATET
**Ftesë**

Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës organizon përurimin e romanit "Atentatet" të autorit Ibrahim Kelmendi.

Koha: Sot, e hënë, më 5 shkurt 2007, ora 17.00
Vendi: Hotel "Victoria" Prishtinë
Mirëardhshi.
Ibrahim Kelmendi
(Mob.tel: +377 44 151959)

Radio Televizioni i Kosovës, RTK: "*Sot përurohet libri " Atentatet"*
*Sot, në orën 17 në Hotel "Viktoria", në Prishtinë, bëhet përurimi i librit "Atentatet" të autorit Ibrahim Kelmendi. Libri "Atentatet" është ndër të parët në fushën e trilerit shqiptar. Libri, për herë të parë, flet më haptas për enigmën 25 vjeçare të vrasjes së Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës."*

# 4. DYNDALLA E MENDIMEVE

Shkruan:Adem Gashi

(Ekskursion paranoik nëpër librin “Atentatet” të Ibrahim Kelmendit)

Referenca për U. Uitmenin “Uollt, ti ke mjaft brenda vetes, përse nuk e zbraz?”...

1. Derisa lexoja dorëshkrimin “Atentatet” (ndonja 600 faqe tekst) nga pozicioni i lexuesit të parë e ndieja trysninë e lodhjes e të trishtimit, të përhumbjes e të kotësisë, të mllefit e të ngazëllimit, të vajit e të ekzaltimit. Autori kishte hedhur furtunshëm mbresat, kujtimet e përvojën e tij disa vjeçare në një radhor tekstual, pas një çerekshekulli. E pranova torturën i joshur nga tri a katër elemente që i konsiderova vlera. E para: duke qenë vetë njëri nga aktorët e këtyre ngjarjeve, merr kurajën të shkruajë pa shtihamë e krekosje: Ky është varianti im i rrëfimit dhe i së vërtetës! – thotë ai. Mistifikimi i vetëm: autori narrator vetëpersonifikohet me kryepersonazhin në veten e tretë – Miranin; E dyta: duke e bartur peshën e tragjedisë për rreth çerekshekulli, autori krijon largesën e nevojshme me aktndodhjen, pa lënë shteg ndikimi në kohën tonë nga përndezja e pasioneve, po aq sa edhe nga marrëzia e harresës; E treta: tejkalimi i vetvetes dhe i rrethanave kontekstuale duke e shpërfaqur dramën-dilemë për foshnjërinë dhe adoleshencën politike, kur njeriu brenda ditës gdhihej atdhetar e ngrysej tradhtar, ngrysej politikan e gdhihej demagog, kur trasta e kredos politike të veprimtarëve ngjante me strajcën e magjupës përzier me teorira ideologjish të skajshme politike. Nuk thashë kot në fillim ekskursion paranoid, sepse pranë mendimeve-perla të një filozofi të lashtësisë shfaqeshin broçkullat e ndonjë mistreci komunist, pranë urtisë popullore sloganet e zvjerdhura të moralit të shpëlarë, pranë dijes së orakullit fodullëku i të parit të mëhallës. Megjithatë, megjithatë... gjithë kësaj shtjelle nuk i mungonte vullneti dhe aspirata për liri.

2. Për tragjedinë shqiptare të 17 janarit të vitit 1982, kur u vranë Jusufi, Kadriu e Bardhi, unë kam lexuar tri vepra që i përkasin lëmit të letërsisë. “Baladë për vdekjen e J. G.”, tregim i Ismail Kadaresë; “Jusufi”, novelë e Zejnullah Rrahmanit dhe “Atentatet”, roman i Ibrahim Kelmendit. Tregimi i të parit ndërtohet sipas skemës së rrëfimit policor, novela e të dytit sipas predikimit mitik, biblik e simbolik, romani i të tretit sipas modelit-përvojë të Atë Zef Pllumbit “Rrno për me kallxue”. Ibrahim Kelmendin e kam takuar së pari në verën e vitit 1990, në Zvicër. Ai ka rrojtur që të rrëfejë (në fund të fundit letërsia s’është tjetër veçse një rrëfim a një vetërrëfim). Së fundi e pashë sot paradite, në mos edhe para pak çasteve këtu në këtë sallë. E kam ditur dhuntinë e tij për shkrime të tjera, po kurrë për letërsi. “Atentatet” është një roman ku brenda shtatë kaptinave përvijohet jeta dhe veprimtaria e shqiptarëve në emigracion, në dekadën e shtatë, të tetë dhe të nëntë të shekullit të kaluar. Pavarësisht nga titulli atentatet romani më së paku e trajton aktin kulmor të shkrepjes së plumbave. Krismat vijnë vetëm si jehonë e kumtit të përzishëm, si jehonë mandate. E po vepra letrare nuk është kronikë a lajm gazete. Ajo sjell atmosferën, gjendjen psikologjike e shpirtërore, vrasjen, vetëvrasjen, grackën, lëkundjen, tundimin e ndërgjegjes së njerëzve. Aty është farka ku nga shkëndijat e vogla plasin zjarret e mëdha të dramave, të tragjedive, po edhe të fitoreve të mëdha.

Në planin e gjuhës e të stilit autori nuk del më tej mëhallës së amatorive. Veçoj me këtë rast dialogun. S’di pse m’i kujton romanet e Remarkut. Kelmendi shumë më saktë e jep tablonë përmes bashkëbisedimit sesa përmes përshkrimit. Vetjet e romanit, po të flisja sipas teorisë së dramës, i përkasin personave autentikë të emigracionit, duke u shfaqur me siglat e emrave e të mbiemrave. Kelmendi është nga të rrallët autorë që ka pasur kurajën t’i shpalojë edhe marrëzitë e çoroditjet, shfytyrimin e çnatyrimin e bëmave të njerëzve, pa e kursyer as veten. Kur ta lexojmë me këtë dioptri kritike historinë tonë

dhe sidomos historinë tonë politike them se kemi maturuar në planin e ideve politike e shoqërore.

3. S'ka shumë kohë që lexova një intervistë të Gabos së madh, Garsia Markezit. Kur e pyetën si ndodhi që gjatë gjithë vitit 2005 as shkroi dhe as botoi gjë, ai u përgjigj: Besoj se ju të gjithë e dini se unë, së paku më përvojën që kam, kurdo mund të ulem e të shkruaj një roman. Madje një roman shumë të mirë. Po nuk e bëj dot nga konsiderata që kam për lexuesin tim. Ai lehtë do ta hetonte se në romanin tim mungon shpirti im, qenia ime. Në dy veprat e para që zura ngoje për këtë vullkan ngjarje, në tregimin e Kadaresë dhe në novelën e Rrahmanit shkëlqen mjeshtëria shkrimore, zanati i shkrimtarit. Në romanin e Kelmendit është derdhur furtunshëm shpirti i i autorit, bashkëveprimtarit të heronjve. Zgjidhni dhe merrni! (www.pashtriku.org)

## 5. DËSHMITARI DHE KRIJUESI I HISTORISË
### ROJE E VETËDIJES KOMBËTARE DHE E SË VËRTETËS

Shkruan: Sadri Ramabaja:

(Dy fjalë për romanin ATENTATET, autor Ibrahim Kelmendi, botues Fokusi, Prishtinë 2007)

Në këtë fjalë rasti për romanin e veçantë ATENTATET, të autorit poashtu për shumëçka të veçantë, Ibrahim Kelmendi, duke pas parasysh se të tjerët mund të ndalen dhe ta kundrojnë atë nga aspekti thjesht letrar, dua të nënvizojë pikërëndesat dhe ndërlidhjet që reflekton poetika e romanit në bashkëjetesën e natyrshme të artit me politikën.

Në letërsinë shqipe bashkjetesa e artit me politikën ka pas që në zanafillën e saj edhe mision historik: zgjimin e vetëdijes kombëtare dhe krijimn e shtetit shqiptar. Ndërkaq si vazhdim i kësaj tradite pozitive në letërsinë shqipe, autori i romanit ATENTATET, i ka vënë vetës për detyrë parasëgjithash mbrojtjen e së vërtetës dhe vetëm të vërtetës. Krahas kësaj përmes përmbysjes së hierarkisë së ideolatrisë utopiste, ai prajshëm, por pa atë modestinë që e karakterizon në jetë, ndjek hullinë e Brehtit të madh, duke u shndrruar plotësisht në një shkrimtar të angazhuar në kuptimin e mirëfilltë dhe më pozitiv të mundëshëm të kësaj fjale.

Heronjtë kryesor të romanit triller ATENTATET: Mirani, prapa të cilit, e qartë, është vet autori, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla, do të hyjnë kështu në galerinë e personazheve - roje të vetëdijes kombëtare.

Ndërkaq kryeheroi i biografisë së romanizuar – Mirani, mund të shikohet si model i bashkëjetesës dhe përplotësimit reciprok të narratorit si personazh letrar dhe autorit të romanit i njohur parasëgjithash si veprimtar politik.

Përzgjedhja e këtij zhanri të letërsisë për t' ju qasur epokës së ilegales shqiptare, duke pasur përherë si motiv qenësor intencën kombëtare të veprimtarëve të saj, i ka dhuruar letërsisë sonë një model të veçantë të heroit- Miranin – që si busull orjentuese në jetën e tij, si personalitet i kompletuar, ka intencën kombëtare, njerëzoren dhe të vërtetën. Intenca kombëtare me kalimin e kohës i bëhet pikë referuese, standart për të gjykuar për çdo hap në jetë edhe në kohën kur ai fillon studimet në Filozofi dhe gjermanistikë, zgjidhet si student aktiv në Kryesi të organizatës së Studentëve të Universitetit të Bohumit, kur fillon botimin e Bashkimit, shtron platformën politike të Frontit të Kuq, kur bashk me Jusuf Gërvallën dhe Kadri Zekën diskutojnë rreth Tezave e Frontit, që më vonë do të shndrrohen në Platformë politike të Lëvizjes për Republikën e Kosovës etj. Ai për asnjë qast, si intelektual i kompletuar nuk lejon që të shndrrohet

në farë idealisti utopist. Shi për këtë me kohë mendon diferencueshëm, nuk e identifikon socializmin teorik me pseudosocializmin e shteteve pseudosocialiste, gjegjësisht me sistemin diktatorial monist.

Duke pas parasysh rrethanat në të cilat vepronin Mirani, Jusufi, Kadriu, Bardhi etj., duke njohur brumin përmes të cilit mëton ta bëjë bukën – armatën e emigracionit tonë gjysmëanalfabet etj. puna e tyrej prej titani del edhe më në pah, meqë ata i kishin shtruar vetes detyrën fisnike prej revolucionari dhe edukatori: të ndikojë te këta njerëz dhe në krejt procesin historik duke ndikuar në vetëdijsimin e tyre, që do të rezultojë me luftën për çlirimin e pjesëve të pushtuara të atdheut.

Këtë punë Mirani e bënë me përkushtim, me këmbënguljen tipike të revolucionarëve dhe si busullë ditore ka interesin kombëtar.

Ndërkaq ai nuk lodhej fort se çfarë mendonte për të dhe bashkëpunëtorët e tij "ajka" e reaksionit të ashtuquajtur djathtist që nuk e kishin për turp të krenohen edhe për aktet makabre siç ishte rasti i Muharrem Bajraktarit në vrasjen e Bajram Currit. Kjo shtresë e llumit historik me atë të ashtuquajturin patriotizëm të tyre arkaik, ishin shndrruar në mumje neveriitëse edhe për fëmijët e tyre, shumica e të cilëve tashmë nuk flisnin shqip.siç do të shpreht në një rast një bijë e Malësisë së Gjakovës, studjuese e shkencave politike, që e takon krejt rastësisht në relacionin Bruksel-Nju Jork.

Romanin ATENTATET kam prirje ta shikoj si një vepër letrare që ka një mison tjetër jashtëletrar – të dëshmojë për të vërtetën rreth atentatit fizik dhe atentateve tjerë politik etj. që iu bë Jusufit, Kadriut e Bardhit më 17 janar 1982 dhe Lëvizjes si tërësi deri në qershor të vitit 1999.

"UDB-ja, shprehet në një rast Mirani, personazhi kryesor i romanit, nuk e ka pasur për synim vetëm vetëm mënjanimin fizik të Jusufit, Kadriut e Bardhit, sepse atë mund ta bënte edhe më heret. Ajo ka përgaditur terrenin që, pas atentateve fizike ndaj shokëve, të bëjë atentate të njëpasnjëshme ndaj lëvizjes sonë patriotike".

Duke qenë pjesë e kësaj Lëvizje dhe mik i autorit për më se 20 vjet rresht, pra edhe njohës i shpirtit të tij krijues, mund të shpreh bindjen këtu dhe në këtë rast se romani që do ta pasojë këtë, si temë bosht do ta ketë të ashtuquajturën alternativë politike të ngritur në Kosovëë në vitet e 90-ta dhe pjesë të tëra të saj që shërbyen si mekanizëm i UDB-së për shpërlarjen e trurit të një populli të tërë, duke e bindur atë për pamundësinë për t`përballuar luftën me Serbinë. Nëse autori nuk do taë arrijë ta bëjë këtë për një arsye apo tjetër, sigurisht romani ATENTATET, do të shërbejë si model i mirë për ndonjë autorë tjetër nga kjo lagje e kriptoelitës sonë që tashmë po del në shesh.
Po të mos ndodhte atentati i 17 janarit 1982 dhe atentatet politike që pasuan brenda Lëvizjes dhe më pas edhe brenda UÇK-së, sigurisht se Kosova dhe shqiptarët në tërësi sot do të ishin subjekt dhe faktor i dinjitetshëm i familjes së popujve në Evropë, pa qenë të shtrënguar të përgaditen të jetojnë edhe më të ndarë dhe me tutorë mbi kokë.

Romani ATENTATET natyrshëm më ngjet se do të jetë si një ledh mbrojtës përball demistifikuesve të strategjisë kombëtare në letrat shqipe dhe gjetkë. Autori i tij, meqë i takon kripto elitës kombëtare tërësisht të pakontrollueshme, që përmbysi shumë plane të superstrukturave elitare intelektuale dhe ushtarake, duke krijuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës që do ti hapte rrugë çlirimit të Kosovës nga zgjedha serbe... natyrshëm, duke u identifikuar plotësisht me Miranin si narrator, para lexuesit të gjerë na prezantohet jo vetëm si dëshmitar i historisë, po edhe si krijues i saj. (www.pashtriku.org)

# 6. PROMOVIM – IBRAHIM KELMENDI: “ATENTATET”

Shkruan: Prend Buzhala:

(Roman, botues FOCUS, Prishtinë 2007)

Kur merr fund leximi i romanit “Atentatet” të Ibrahim Kelmendit, tek iu bëhet homazh përjetësisë së tri personaliteteve historike, vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla e Kadri Zeka, në trevjetorin e rënies, lexuesi e ndien se nuk është në gjendje të dalë nga gjeratoret e misterit të krimit politik; të dalë nga humnerat e enigmave dhe të intrigave të rretheve nga më të ndryshmet, qofshin ato politike, të organizatave e lëvizjeve atdhetare, familjare a të interesave nga më meskinet; nga skenarë të fshehtë shtetërorë a të shërbimeve sekrete ndërshtetërore e ndërkombëtare që thuren pafundësisht; nga ngritje, hapje e përmbysje çështjesh e faktesh të ditura e të paditura; nga të provuarit e një morie përjetimesh që të tronditin; nga zbulime të vrullshme, nga pak të rrëmbyeshme e dehëse. I del parasysh panorama e gjerë epike e romanit, në të cilin parakalojnë personazhe të mërgatës shqiptare të të gjitha ngjyrave, me huqet e karaktereve që kanë, parakalojnë revolucionarë, politikanë kafenesh, pseudonacionalistë të shitur për një femër serbe, mashtrues e qelepirxhinj të ndryshëm, bixhozxhinj të shitur si politikanë e atdhetarë, janë njerëz të thjeshtë të emigracionit ekonomik, ende të shtypur nga mendësia e skllavit, vijnë ambasadorë, diplomatë, komunistë e pseudo-ideologji të të gjitha tarafeve, spiunë, intelektualë, gazetarë, nëpunës policie, parakalojnë ngjarje, qytete e shtete të Evropës perëndimore. Parakalojnë demonstratat shqiptare për Kosovën Republikë nëpër qytetet gjermane e zvicerane, në Bruksel e SHBA, janë ecejeaket e pafund të atdhetarëve për drejtësi kombëtare nëpër zyra shtetesh, kancelarish ndërkombëtare a media botërore.

Kurse receptuesi i veprës, mandej, ka nevojë për një këndellje: e këtë mundësi ia krijon vetë autori me ndërthurjet e pleksjet e strukturës kompozicionale që e lë të hapur. Bartës i rrëfimit është Mirani, ndryshe një personazh ideografik i veprës (sikundër e ka përkufizuar këtë formalizim të ligjërimit që më 1879 logjicienti Gottlob Frege). Së këndejmi, autori ka arritur t`i bëjë një Artin e Jetës dhe Artin e Fjalës, t`i shquajë pistat, të përafërta e të përkundërta, të Idealistit dhe Revolucionarit, të Krijuesit dhe kronikanit letrar kundruall psedudove të shumtë, qofshin ata të stolisur me emra të bukur, si atdhetarë, revolucionarë, idealistë apo me emra të preferuar të kohës, si marksistë-leninistë, komunistë etj etj. I quajtur tashmë roman-thriler, vepra “Atentatet” e Ibrahim Kelmendit, megjithatë, ka shumë përbërës: veprimtaria e organizuar atdhetare dhe përpjekjet për bashkim të mërgatës politike shqiptare të Kosovës gjatë atyre viteve, si dhe rrethanat, si shprehet autori, para e pas atentatit ndaj tre personaliteteve tashmë historike, Jusuf Gërtvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës; një rrëfim autobiografik i pikëzuar përgjatë gjithë veprës, ashtu sikundër e afishon këtë edhe autori “fragmente të jetës dhe veprimtarisë në ekzil gjatë viteve 1979 – 1982”, një relatë dashurie, takimesh, bashkëpunimi e debatesh me Renatën, studente gjermane. Sado që modeli diskurziv i kësaj vepre i përket autofikcionit a romanit autobiografik, tek lexohet si roman personal, a si publicistikë intime letrare, megjithatë, në kontekstin e përtashëm sociokulturor e historik, ai përpiqet ta mbajë distancën objektive me realitetin e viteve ’80. Vetë epizmi romanor e përcakton këtë distancë me kohët e me njerëzit, ashtu sikundër e përcakton edhe motivacioni i personazheve me karakterologjinë e tyre.

Zhvillimin fabular të ngjarjeve shkrimtari e “defabulizon” përmes shtatë kapitujve: në kapitullin e parë romani hapet me festën e krishtlindjes, me panoramën epike të lëvizjeve atdhetare jashtë me bartësit e tyre dhe me arratisjen e Jusufit nga

Kosova e pushtuar; në të dytin jepen pjesë autobiografike të personazhit të Miranit, nëpërmes trajtës së esesë e të kronikës letrare, në të tretin çmaskimi e shpërbërja e grupit pseudoatdhetar të personazhit të Rezilit, një dorë e zgjatur e shërbimit sekret jugosllav; në të katërtin jepet gjendja politike e mërgatës dhe ajo në Kosovë në prag të shpërthimit të demonstratave, si dhe përplasjet dramatike të mërgatës politike për t'u bashkuar; në pestin ndodh arrestimi tragjik i njërit ndër personazhet kryesore të veprës, Vasilit, jehona e demonstratave shqiptare në Kosovë, organizimi i tyre në mërgim, hartimi i tezave për bashkim politik; në të gjashtin kulmi arrin me vrasjen e tre personaliteteve në çastin kur po arrihej ideali i atdhetarizmit shqiptar për bashkim të organizatave të tyre politike dhe në të shtatin gjendja pas këtyre atentateve. Vepra është konceptuar sipas strukturës së romanit kriminalistik: meqenëse lexuesi di për vrasjen e tri figurave të shquara atdhetare, po ashtu ky receptues i letrave shqipe di se vrasja është e mbështjellë me një mister, kurse këtu, personazhi i veprës, Mirani, më shumë gjendet në rolin e zbërthimit të kësaj enigme, i cili bën punë të palodhur jo vetëm në çmaskimin e personave të infiltruar të armikut në radhët e mërgatës atdhetare, po edhe në çmaskimin e pseudove e të karaktereve të dyshimtë e joqëllimimirë, jorevolucionarë, që kishin ardhur aty jo për qëllime çlirimtare, po për qëllime të tjera. Autori përqendrohet në përshkrimin e aktorëve e të atyre rrethanave, të mbështjella ende me mjegulla të pleksura e me kundërthënie, me pohime hamendëse, për të ringjallë interesime për intriga të shoshitura e të bëra sipas një skenari politik. Shumë ndër këta aktantë që ende janë gjallë, autori i përmend e i pikëzon me emrat e mbiemrat e tyre të vërtetë. E, mbi të gjitha, aty përcillen mesazhe atdhetarie e humanizmi. Në poetikën e ndërthurjes shumështresore, autori na detyron që në tryezën e leximit të na vijnë nocionet teorike-letrare post/moderne si eseja biokritike, hibridizimi i zhanreve, biografia letrare, autobiografia, memoari, biografia e romanizuar, trajta letrare e kronikës, bioletra, epistola etj etj e që po i përkufizojmë me nocionin bioproza. Sa do që "Atentatet" është dëshmi dokumentare për dramën shqiptare të këtyre anëve në shtegtimet e lirisë, që nga viti 1979 e deri më 1982, për vëllezërit Gërvalla e Kadri Zekën; sa do që lënda e pasur dokumentare e librit është paraqitje dokumentare e fatit të njerëzve; sa do që autori është rrëfimtar i jetës së përditshme; sa do që ai gërsheton elemente të reportazhit e të romanit, të letrës e të kronikës publicistike me strukturën tekstore të udhëpërshkrimit dhe, më në fund, rrëfimin në veten e tretë me dialogun sokratik-platonian – kudo është i pranishëm Rrëfimtari Autorial që unifikohet me Unë-in e personazheve tjerë autentikë: si modalitet i veçantë i së vërtetës. Është jeta ajo që e ka përgatitur shkrimin e veprës, do të thoshim: krijimin e rrëfimit. Mandej lexohen linjat narrative art-jetë, fikcion-realitet.

"Atentatet", në radhë të parë do lexuar si vepër letrare, si roman, meqë të tillë e ka përkufizuar edhe vetë autori. Kjo do të thotë se edhe ky roman kuintesencë estetike të veten e ka imagjinatën letrare, fikcionin autorial. Është thënë shpesh se s' ka letërsi pa imagjinatë letrare, e cila thuret e endëzohet mbi të vërtetat e një kohe, mbi veçoritë thelbësore të jetës, mbi tiparet individuale të personave të veçantë, mbi universin e paanë të jetës, të kohës, të historisë e të ambienteve. Romani t'i jep ato mundësi që nuk t'i jep, bie fjala, një libër dokumentar, i mbështetur e i thurur mbi dëshminë, mbi faktin dhe mbi të vërtetën. Dhe sa e sa herë lexuesit e kanë shtruar pyetjen: a na e mëson të vërtetën imagjinata letrare? Bioproza e Ibrahim Kelmendit përbën një thurje shumështresore dhe të ndjeshme, përbën një modalitet të veçantë të së vërtetës; sado që, në pamje të parë, të lë përshtypjen e një rrëfimi të thjeshtë. Aq sa të duket se po lexon një bioroman, po aq futesh në shtigjet e romanit kriminalistik. Ndryshe, shumështresimi romanor hap shtigje të shumta pajtimi a mospajtimi po edhe mundësi të shumta për lexim.
Prishtinë 5 shkurt 2007 (www.pashtriku.org)

# 7. ZONJA DHE ZOTËRINJ

Shemsi Reçica: (Fjala në përurimin e romanit ATENTATET, më 5 shkurt 2007, në hotel VICTORIA në Prishtinë)

Zonja e zotërinj,

Në qoftë se më lejohet të shprehem në mënyrën dhe stilin që është shprehur autori Ibrahim Kelmendi në librin më të ri të tij, ATENTATET, dhe në qoftë se lejohet që në përurime librash të thuhet diçka e veçantë ose edhe e kundërt me vijën e përgjithshme që është praktikuar të ndiqet në raste të tilla, atëherë mund të them se lexuesit shqiptarë kanë në duar një libër problematik, në të cilin flitet për ngjarje e personalitete, gjithashtu problematike.

Gjykuar sipas përmbajtjes së librit dhe sipas dialogëve e debateve të ashpra ndërmjet personazheve të librit ATENATET, njëri prej të cilëve është, pa dyshim, Ibrahim Kelmendi, edhe për vetë autorin e librit mund të thuhet se është problematik.

Sa di unë, ATENTATET është libri i dytë i Ibrahim Kelmendi. Edhe libri i parë i tij, SHQIPËRIA JASHTË "VERIUT" DHE "JUGUT", mund të quhet libër problematik, ashtu siç mund të quhen problematike edhe ngjarjet që trajtohen në atë libër.

Për ngjarjet dhe për personalitetet që trajtohen në të dy librat e Ibrahim Kelmendit kanë shkruar shumë autorë, por pothuajse të gjithë, me ndonjë përjashtim të rrallë, këto ngjarje ata i kanë parë nga jashtë dhe nga larg. Për dallim prej tyre, Ibrahim Kelmendi këto ngjarje i ka parë nga afër dhe nga brenda. Pikërisht këtu qëndron e veçanta e përbashkët dhe njëra nga vlerat e mëdha të këtyre librave të autorit Ibrahim Kelmendi.

U takon letrarëve dhe historianëve të thonë nëse libri ATENTATET është roman, libër kujtimesh apo diçka tjetër. Pavarësisht nga kjo, unë mund të them se në këtë libër ka premise të qarta, në bazë të cilave lexuesit dhe studiuesit mund të arrijnë në përfundime interesante:

E para: siç del nga vetë libri, Mërgata shqiptare e para vitit '81 dhe e pas atij viti, edhe pse e madhe në numër, ishte analfabete ose gjysmanalfabete.

E dyta: siç del nga vetë personazhet kryesore të librit ATENTATET, me ndonjë përjashtim të rrallë, gjysmanalfabetë ishin edhe personalitetet që përpiqeshin ta organizonin Mërgatën shqiptare.

E treta: Organizatat shqiptare në Perëndim ishin të mbyllura hermetikisht dhe të izoluar nga njëra-tjetra dhe nga vendorët. Ato, në emër të konspiracionit, i fshihnin nga njëra-tjetra dobësitë, paaftësitë dhe mossuksesin e tyre. Ato, siç del nga personazhet e librit, e survijonin, e minonin dhe e denonconin njëra-tjetrën.

E katërta: përkundër konspiracionit të thellë, organizatat shqiptare në Perëndim mbikëqyreshin nga Sigurimi i shtetit shqiptar dhe nga Shërbimi i Sigurimit Shtetëror serb dhe jugosllav. Siç del nga personazhet kryesore të librit ATENTATET, pothuajse secili nga personalitetet që qëndronin në krye të organizimit të Mërgatës shqiptare, dyshonte në të tjerët dhe i akuzonte ata se po punonin për dikë tjetër.

Dhe e pesta: paradoksi më i madh qëndron në faktin se organizatat shqiptare vepronin në Perëndim, pra në botën e kapitalit dhe të pronës private dhe, me ndonjë përjashtim, vetëquheshin komuniste-marksiste-leniniste!

Në fund, zonja e zotërinj, me lejoni të them, se në kohën kur organizatat shqiptare po vepronin në Perëndim, Kosova e kishte Universitetin, e kishte Akademinë e Shkencave dhe të Arteve. Pra, në Kosovë ishte formuar në elitë profesionale, intelektuale,

shkencore dhe politike, por ajo, me ndonjë përjashtim të rrallë, nuk po denjonte t'i printe organizimit të shqiptarëve. Kështu ka ndodhur gjatë '81-shit, kështu ka ndodhur gjatë Luftës se fundit në Kosovë, por edhe pas saj. Mbase pikërisht këtu qëndron arsyeja e vonesës së shqiptarëve. (www.pashtriku.org)

## 8. LIBRI " ATENTATET" I IBRAHIM KELMENDIT

Shkruan:Rasim Selmanaj

Botimi i gazetës FOCUS, ma ka ushqyer, pashmangshëm "mallin e stampes" – siç do të thoshte Buzuku mendjendritur. Prirë nga kjo ndjenjë, kam publikuar një dyzinë librash të zhanreve të ndryshme letrare. Midis këtij korpusi, ja edhe kjo e sotmja, "Atentatet" e Ibrahim Kelmendit.

Raportet e mia me këtë libër dhe me këtë autor, nuk janë raporte të rëndomta të botuesit me autorin, dhe as të interesit. Është jehona e ngjarjes së madhe të para-çerekshekullit që vjen në jehonën e kohës duke më ndjekur gjithandej, vijave që formojnë biografinë time: në shkollë, në punë, në luftë, në burg, në liri e në paqe. Në këtë përthyerje vijash, jeta ime ndahet përgjysmë: para atentatit dhe pas atentatit. Çuditërisht, në këtë të dytën, zë fill misteri si një lum nëntokësor që herë shfaqet, e herë humbet, duke lënë sheshit vetëm ca shenja e kode si pika orientimi brenda një hapësire të pacaktuar.

Deri tashti, për këtë tragjedi janë dhënë qindra lajme e kumtesa me variante e nënvariante, me siglën sekret, top-sekret, rezervat etj. Mendja më thoshte dhe më thotë se çdo kumtesë "zyrtare" shtetërore është më çoroditëse se rrëfimi më i trilluar i krijuesit, sado e mëvetësishme dhe subjektive qoftë ajo.

Shpalimin e këtij libri doja ta bëja mu në përvjetorin e rënies së heronjve, më 17 janar, në Deçan, por qenë defektet e makinave të shtypshkronjave, mungesa e dritave, korrentit që e bënë vonesën. Tani jemi këtu, sonte. Defektet e makinave i kuptojmë dhe i lëmë me një anë! Por nuk i kuptojmë dhe nuk i lëmë siç nuk na lënë të qetë defektet e ndërgjegjes sonë. Ndaj, që ato të mos ndodhin, që ato të mos përsëriten, që mbretëria e territ të mos kthehet në mendjet tona, po i japim dorë fillimit të shpalimit të enigmës.

Kurdo qoftë është më i pranueshëm një sherr që duket, sesa një lajkë erëkëndshme, e padukshme. Për aq sa është në dorën time, unë do të vazhdoj t'i shpalos "sherret" edhe me botime të tjera.

Prishtinë, 5 mars 2007 (www.pashtriku.org)

## 9. "ATENTATET" - SJELL KUJTIMIN PËR VRASJEN TRAGJIKE TË 17 JANARIT '82

Shkruan: Avni Dehari

"Nëse dorasit janë shqiptarë, mos u zbulofshin kurrë!" – amaneti i Jusuf Gërvallës me të cilin i shpallet luftë përçarjes dhe vëllavrasjes.

Me rastin e 25 vjetorit të rënies së tre dëshmorëve Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla shtëpia botuese "Focus" në Prishtinës e botoi romanin "Atentatet" të autorit Ibrahim Kelmendi.

Romani trajton për temë veprimtarinë patriotike të Jusufit, Kadriut, Bardhoshit, Ibrahim Kelmendit dhe bashkëveprimtarëve të tyre në mërgim, kryesisht në Gjermani dhe në Zvicër. Gama e veprimtarisë së tyre me theks çlirimtar shtrihet edhe në disa shtete të Evropës dhe të kontinenteve të tjera. Tema që shtjellohet në këtë roman, ka

për bazë synimin dhe përpjekjet çlirimtare të popullit tonë të pushtuar nën Jugosllavi, i cili në mars dhe prill të vitit 1981 u ngrit në demonstrata gjithëpopullore për liri dhe barazi me popujt e tjerë në këtë shtet.

Romani “Atentatet” është shkruar nga një autor, i cili një kohë të gjatë ka vepruar me tre dëshmorët, të cilët të përndjekur për shkak të veprimtarisë patriotike në Kosovë, detyrohen të gjejnë strehim, Kadriu në Zvicër, ndërsa Jusufi e Bardhoshi në Gjermani, ku do të kryhet atentati në natën e kobshme të natës së 17 janarit të vitit 1982. Si bashkëveprimtar i tyre Ibrahim Kelmendi ka sjellë brumë të mjaftueshëm për t'u njohur me përpjekjet dhe veprimtarinë organizative për çlirimin e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi.

Jusufi, Kadriu e Bardhoshi, bashkë me kryeprotagonistin, autorin, që në roman mban emrin Mirani, janë veprimtarë të rinj. Ata janë të pajisur me dëshirën më sublime, përkushtimin për punë dhe gatishmërinë për sakrificë deri në vetëflijim. Edhe pse kishin thithur njohuri teorike nga librat e shumtë për luftërat çlirimtare dhe revolucionet që kishin lexuar e që po lexonin, atyre u mungonin përvoja dhe shumë njohuri të artit të luftës. Të vetëdijshëm për këto mangësi ata do t'i vënë vetes për obligim që me njohuri të tilla teorike e praktike të pajisen krahas ushtrimit të veprimtarisë organizative me mërgimtarët.

Të katër bashkëveprimtarët janë më se të vetëdijshëm se bashkimi i organizatave OMLK, LNÇKVSHJ dhe Froniti i Kuq Popullor që përfaqësoheshin me organet “Liria”, “Lajmëtari i lirisë”dhe “Bashkimi” ishte më se i domosdoshëm. Ata do t'i hyjnë punës së palodhshme për bashkimin e këtyre organizatave në organizatën Lëvizja/ Fronti për Republikën e Kosovës, e cila do ta marrë përsipër organizimin e veprimtarisë patriotike në mërgim dhe në trojet tona nën Jugosllavi. Gjatë realizimit të këtij qëllimi tepër fisnik ata do të hasin në vështirësi të ndryshme dhe të shumta. Numri i vogël i përkrahësve nga radhët e mërgimtarëve ekonomikë, që në roman përfaqësohen në mënyrë tipike nga Hysni G. ¬ Vasili, Maksi, Rexhep Halimi, Hakani e ndonjë tjetër, edhe pse të përkushtuar deri në sakrificë, do të jetë mbështetje e pamjaftueshme për t'u bërë ballë sfidave të shumta. Kundër tyre ishin angazhuar pseudopatriotët, naivët, demagogët, udbashët dhe bashkëpunëtorët e tyre, të cilët duke u futur nëpër klube dhe organizimet politike manipulonin me mërgimtarët tanë ekonomikë që, si pasojë e robërisë, kishin nivel shumë të ulët arsimor. Me mashtrime, kërcënime, frikësime, shantazhime, me marrjen e pasaportave, torturave fizike dhe me burgosje (kur mërgimtarët ktheheshin në atdhe), ata i përçanin këta hallexhinj dhe ushtronin presion mbi ta që jo vetëm të distancoheshin nga veprimtaria patriotike që zhvillohej në vend dhe në mërgim, por edhe ta dënonin e ta luftonin atë.

Shumica e personazheve në këtë roman ose janë bashkëpunëtorë të autori dhe dëshmorëve ose kundërshtarë të tyre. Një pjesë e emrave të tyre janë të vërtetë, ndërsa të tjerët edhe pse të sajuar shumë lehtë mund të identifikohen me bartësit e tyre. Në figurën e Jusuf Gërvallës gërshetohen tiparet e një atdhetari me edukatë tradicionale kombëtare dhe të një intelektuali me një diapazon të gjerë kulturor që vihet me tërë qenien për çlirimin dhe bashkimin kombëtar. Amaneti i tij “Të mos jua dëgjojë kush vajin, sepse e kemi krenari të flijohemi për Kosovën!” – që në çastet e fundit ia thotë bashkëshortes, janë fjalët më të spikatura që flasin për përkushtimin e vetëdijshëm të tre dëshmorëve deri në flijim. Kadri Zeka, që po ashtu është personazh kryesor në këtë roman, krejt kapitalin e tij patriotik dhe të gjitha aftësitë dhe njohuritë revolucionare i shkrin po për këtë ideal. Në roman shquhet edhe figura e Nënëmadhes ¬ Ajshes, nënës së vëllezërve Gërvalla, e cila pas atentatit nuk pranon t'i shihte djemtë e vetë të vrarë, para se t'i fliste Kadriut, të cilin e quan djalë. Ajo do t'i bëhet nënë edhe Miranit, të cilin nuk e ndan nga Kadriu, Jusufi, e Bardhi. I tillë është edhe Babai i Kadri Zekës, i cili duke e pasur parasysh se në

mesin e atyre që vinin për ngushëllime, kishte bashkëpunëtorë të UDB¬së, ndër të tjera thoshte: "Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllime dy ditët e para sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha, do ta kisha vrarë vetë djalin tim dhe do t'ia kisha lënë fajin UDB¬së." Me përshkrime të gjalla na paraqiten Drita ¬ bashkëshortja e Jusufit, Saranda ¬ bashkëshortja e Kadriut, fëmijët e Jusufit që një dhomë në shtëpinë e tyre e quanin dhoma e xhaxhit Miran. "Shyqyr që na shpëtove ti, xhaxhi Miran!" – janë fjalët e vajzës së Jusufit, Dardanës së vogël, që shprehin afërsinë dhe besimin për njeriun që e çmonin si anëtar të familjes dhe luftëtar të çështjes kombëtare.

Mirani ¬ Ibrahim Kelmendi, njeri praktik, që për veprimtarinë e mëtejme mbështetet fort në Jusufin e Kadriun, mallkon veten që nuk kishte qëlluar të vritej në natën e kobshme të 17 janarit. Bashkë me brengën e madhe në shpirt, ai, tani, pa shokët e idealit, duhej të luftonte kundër UDB-së e cila në bashkëpunim me Rezilët, Qerosët e Xhahilët dhe shërbimet e fshehta gjermane dhe të shteteve të tjera, sabotuan, minuan e kryen atentatin. Dorasit duke i vrarë tre bashkëluftëtarët e tij bënë atentat shpirtëror edhe mbi Miranin, mbi familjen Gërvalla, mbi familjen Zeka, mbi shumë bashkëveprimtarë të tjerë dhe mbi tërë Lëvizjen, e cila do ta marrë të mbarën falë përkushtimit dhe sakrificës së pasuesve të mirëfilltët që do ta ndjekin shembullin e të rënëve më 17 janar në Gjermani.

(Botuar në gazetën javore "Focus", më 2 mars 2007)

## 10. SAIME ISUFI: "SECILIN PERSONAZH E KE PARAQITUR TË TILLË SIÇ PATA MUNDËSI T'I NJIHJA EDHE VETË"

Letra e Saime Isufit personazhe e romanit "Atentatet" -dërguar autorit të librit Ibrahim Kelmendi

Saime Jusufi (personazhe e romanit / bashkëshortja e Kadri Zekës)

"I nderuar Ibrahim, Ka kohë (vite) që nuk jemi parë, por ja që bota është e vogël dhe për të gjallët krijohen mundësi kontakti. Në këtë rast kontakti elektronik. Këtë e bëj, pas leximit të veprës tënde historike "Atentatet", për të cilën të përgëzoj nga zemra! Edhe njëherë urime!

Me të dalë nga shtypi e lexova me një frymë. Pasi jam njëra ndër protagonistet e asaj ngjarjeje makabre që bëri UDB-a me vrasjen e tre bijve (udhëheqësve të denjë) të Kosovës dhe në disa rrethana kam qenë edhe pjesëmarrëse direkte në ato ndodhi para dhe pas vrasjes, nuk u durova pa të shkruar, për të përgëzuar.

Të them të drejtën, u ktheva prapa 25 vjet, duke kujtuar e përmalluar dhe plot emocione atë kohë sa të bujshme, aq edhe të dhimbshme, ku ti me spikamë ke paraqitur çdo personazh. Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë.

Kjo më bën të besoj se edhe ata të cilët nuk pata mundësi t'i njihja, i ke paraqitur tamam ashtu siç ishin në realitet, të lidhur me UDB-në jugosllave, për të shkatërruar lëvizjen..." (Mail-letër, 5 mars 2007, www.pashtriku.org)

## 11. PER ROMANIN ATENTATET

Shkruan:Sali Kabashi

Do të doja të prezantoja librin e ri të një pjesëtari të njohur të Mërgatës shqiptare të Evropës. Ibrahim Kelmendi nuk është kushdokushi. Ai është për rreth 30 vite

aktiv në gjirin e asaj që të shumtën e kohës është quajtur Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës, e cila, siç dihet sot, njihet me emrin LPK dhe është e pranishme me një deputet edhe në Parlamentin e Kosovës. Këtu nuk do të shkruaj për këtë, por për librin Atentatet dhe për autorin e tij, pasiqë në rastin konkret ata as nuk mund të ndahen nga njëri-tjetri. Ibrahim Kelmendi edhe më parë e ka sprovuar pendën e tij në publikime e libra të tjerë. Por, kësaj radhe ai ka dalë me një libër, që në fakt është një evokim kujtimesh nga gjiri i Lëvizjes atdhetare më të përfolur e më të kontestuar, njëherit edhe më të lëvduar e më të glorifikuar. Në ballë të saj, mu në majat e saj, bile edhe ndër themeluesit e Lëvizjes, të gjithë e kanë ditur se qëndronte vetë Ibrahim Kelmendi. Lidhur me të janë thënë e stërthënë gjera tepër fantastike. Ka pas aq shumë përgojime, sa mua personalisht më brengoste dhe njëherit më mahniste këmbëngulja e tij për të heshtur. Ai heshtte pothuajse për gjithë bjeshkët e thashethemnajave. Nuk ka shumë muaj qyshse në një komunikim përmes postës elektronike i kisha shkruar se ai duhej, më në fund, të shkruante versionin e tij lidhur me atentatin e UDB-së mbi Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën e Bardhosh Gërvallën. E kam ruajtur atë komunikim relativisht të shkurtër dhe nuk e kam vështirë të kujtoj se ai ende kishte mëdyshjet e tij që do ta bënte librin, do ta linte për një kohë tjetër apo do ta braktiste fare një ide të tillë. Kjo ishte përshtypja ime e asaj kohe dhe mbështetej në një gati indiferencë e tij lidhur me një libër eventual. Por një gjë e kisha të sigurt: Ibrahim Kelmendi ishte njëri ndër njohësit më të mëdhenj të realiteteve të mërgatës shqiptare. Për mendimin tim ai ishte një profesionist në politikë. Student gjerman dhe për pasojë një njohës i shkëlqyeshëm i gjuhës gjermane, një orator shembullor, një njeri i hazërxhevapeve, siç thonë, Ibrahim Kelmendi më pati fascinuar mua dhe një mikun tim, shkrimtar i shquar slloven, kur të ftuar nga një asociacion për të drejta të njeriut nga Munihu (München), patëm shkuar që të shpalosnim dosjen shqiptaro-sllovene të Kosovës se vitit 1989. Miku im, më një nuhatje fantastike, më pat thënë e më vonë edhe e pat shkruar në shtypin slloven, se lider i ardhshëm i Kosovës se re paskomuniste do të ishte Ibrahim Kelmendi. Peter Bozhiç quhej shkrimtari slloven dhe si fëmijë kishte kaluar nëpër kampet naziste në Gjermani.

Nejse, kjo është ajo që më ka mbetur në kujtesë nga ajo kohë. Tashti kemi librin Atentatet. Kemi edhe autorin e tij, për të cilin thashë se e konsideroja një njeri me profesion politikani. Tash Ibrahim Kelmendi nuk është askund në politikë. Apo ai vazhdon ta bëjë politikën në mënyrën e tij tejet origjinale. Edhe libri i tij është origjinal në shumë pikëpamje. Origjinal si zhanër. Ai e quan roman, mbase për të shpëtuar nga grackat e akuzave që pas botimit të librit atij mund t'ia bëjnë njerëz që janë përmendur me emra të gjymtuar, me emra të shpifur, me emra të vërtetë. Mirani është personazhi kryesor i librit dhe nuk është vështirë të merret vesh se ai personifikon vetë autorin. Ç'deshi Ibrahim Kelmendi që të shfaqet me këtë libër vetëm tashti? Ishte një shqetësim i tij intelektual, apo një kthim kusuri të gjithë atyre që e kishin sharë e akuzuar derisa ai kryesisht heshtte? Mund të jetë dhe mund të jetë tjetra, por mund të jenë edhe të dyja bashkë. Sido që të jetë, pasi e lexova librin, edhe unë kam nxjerrë konkluzionet e mia:

E para, libri i tij e pasuron atë që ne e quajmë literaturë e Diasporës shqiptare, e cila dita ditës po bëhet më e begatshme dhe pasuruese e letërsisë dhe publicistikës sonë kombëtare.

E dyta, libri Atentatet do të çojë shumë pluhur dhe do të nxisë edhe të tjerë veprimtarë në Diasporën tonë që të shkruajnë memoaret e tyre. Bile kjo do ta inkurajojë më shumë edhe vetë Kelmendin që të shkruaj edhe libra të tjerë. Sepse, nëse përpara është thënë se fjala nxjerrë fjalën, tash mund të thuhet, sidomos në rast si ky, se libri nxjerr librin, tëndin apo të tjetrit që do ta kundërshtojë librin tënd.

E treta, libri Atentatet, në të vërtetë është një kundërgoditje e fuqishme për gjithë ato që unë i quajta fabrikues të atyre bjeshkëve të mëdha të shpifjeve e të thashethemeve.

E katërta, përmes romanit të tij politik dhe memoaristik, Ibrahim Kelmendi ka sfiduar edhe ata që ende janë të fuqishëm dhe që janë gjallë, por që kanë qenë, për faqen e zezë të tyre, shërbëtorë të UDB-së famëkeqe, e cila ka veshur në të zeza shumë motra e nëna. Po të zhvishej nga ai petk i hollë i literaturës së mirëfilltë, anarkisti Ibrahim, siç e kanë quajtur të tjerët dhe që, siç duket, i pëlqen ta quajnë, përmes kësaj vepre u ka hapur shtegun zbulimit të shtisëve e dorasëve mbi vëllezërit Gërvalla dhe të Kadri Zekës. Libri ka sfiduar rëndë spekulantë të ndryshëm që akuzonin pa fije turpi njerëz të pafaj për gjoja vrasjen e tre heronjve të Kosovës. Po të kishim të ndërtuara struktura drejtësie, siç ka në vende evropiane, prokurorët, qysh në ditën e daljes së librit në treg, do t'i priste një punë e ngutshme.

Dhe e pesta, libri edhepse voluminoz, lexohet me një frymë. Libri ka ritmin e tij që të rrëmben dhe të bën të jesh ngjitur me te deri në faqet e fundit, kur në kopertinë qëndrojnë vlerësimet e Prend Buzhalës e të Adem Gashit. Ky i fundit në parafjalën e tij ka lënë të shkruar: “Ky shkrim s'është gjë tjetër veçse një akt dëshmimi i autorit, blatuar hyjneshës se tij, të vetmes dhe të tërëkohshmes.” Prend Buzhala, ndërkaq, flet për Rrëfimtarin autorial dhe për librin që lexohet si dorëshkrim letrar.

Vetë autori e ka parë të udhës që në fund të sqarojë (citoj): “Ngjarjet e romanit janë fragmente të jetës dhe veprimtarisë në ekzil, gjatë viteve 1979-1982, të personaliteteve tashmë historike, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla dhe të bashkëveprimtarëve e të kundërshtarëve të tyre. Ato janë pasqyruar ashtu siç i kam përjetuar dhe siç i kam mbajtur mend, pa pretendime për të qenë të vërteta historike. Mendimet dhe vlerësimet janë të kohës kur kanë ndodhur ngjarjet.”

Krejt në fund edhe ky element i rëndësishëm për raste të këtilla: Libri është botuar nga Focus, është botuar gjatë janarit dhe fillimshkurtit nga shtypshkronja Blini në Gjakovë. Kopertinën e ka punuar Ngadhnim Memhmeti në Shkup, ndërsa për faqosje autori nuk ka paguar asgjë, sepse e ka bërë vetë. As shtypi nuk i ka kushtuar gjë, sepse brendësinë e ka financuar Focusi, kurse kopertinën Ngadhnjim Mehmeti. Deri në dalje të librit autori është ndihmuar me mbi 3.000 euro nga individë të ndryshëm. Pra, mund të kenë ardhur ende në adresën e tij, sepse ai aty ka të shënuar edhe dy konto bankare. Është shënuar se libri është botuar në 3.000 ekzemplarë dhe është paralajmëruar se do të ketë edhe një ribotim. Nga kjo pikë Ibrahim Kelmendi del krejtësisht dhe plotësisht i suksesshëm, sepse në epokën paskomuniste librat nuk botohen më në tirazhe kaq monumentale. Ndërsa polemikat për librin, pa ftohur mirë ai nga rotativat, kanë filluar me bujë. Ne diasporikët, kësodore, do të fusim bashkëkombësit tanë në Atdhe që t'i flugën leximit dhe t'i shkëpusim nga limonadat serike latino-amerikane.

(Revista REPUBLIKA, nr. 3, 2007)

## 12. E NJOH VRASËSIN E JUSUF GËRVALLËS

Flet veprimtari Ibrahim Kelmendi “Pa doreza” për gazetën Express

Ai që vrau Jusuf Gërvallën jeton në Kosovë, në një fshat të komunës së Suharekës. Është shqiptar dhe e ka emrin Rezil, thotë Ibrahim Kelmendi në intervistën ekskluzive për gazetën Express.

Intervistoi: Nebih Maxhuni

Prishtinë, më 11 e 12 mars 2007

Prishtinë,10 mars 2007— Ibrahim Kelmendi. Për gjeneratën e re ky emër s'thotë asgjë. Ndoshta as që e dinë se çfarë ka bërë ky njeri për jetën e tyre. I harruar për shumë kohë në jetën e diasporës, numërohet se ka qenë idealisti i parë i së majtës shqiptare jashtë Kosovës dhe Shqipërisë. Është ndër të paktë shqiptarë të diasporës që ka pas guxim të vishet me xhins dhe në një mënyrë a tjetër ka jetuar me jetën e studentëve gjermanë. Për dallim nga të tjerët ai ka mundur të socializohet në jetën gjermane dhe në jetën e tij ka nxitur polemika dhe debate pikërisht për shkak se nuk ka jetuar vetëm jetën e refugjatit ose të punëtorit të krahut në Gjermani.

Ka qenë njeriu i parë që ka thyer heshtjen prej kohësh për meritokracinë e diasporës dhe ka botuar të dhëna interesante duke anashkaluar distancën historike dhe duke përshkruar gjëra të rrezikshme për procesin i cili ende s'ka përfunduar.

Si mik i afërt i Jusuf Gërvallës, ai mori guximin ta përshkruajë tërë realitetin e asaj kohe, duke mos kursyer persona dhe personazhe. Libri i tij i titulluar "Atentatet", përfaqëson një rrezik në vete për të vërtetën e asaj kohe.

Libri në një mënyrë përfaqëson edhe karakterin e hapur dhe shumë të përfolur të Ibrahim Kelmendit, i cili, si shumë herë ka dalë jashtë kornizave të "qytetarit" të diasporës. Shpeshherë, i ngarkuar me teza konspirative gjatë jetës së tij, ai ikën nga ajo hapësirë në librin e tij dhe ballafaqon fakte dhe emra pa hezituar fare se mund të krijojë situata të pakëndshme në jetën kosovare edhe ashtu të rëndë dhe konspirative.

Thotë që e njeh atentatorin e Jusuf Gërvallës, i cili jeton në një fshat të komunës së Suharekës. I bën shenja dhe ia heq elozhet politike dhe meritën folklorike edhe miteve në diasporë, siç thotë ai, të ngritura artificialisht.

Ndryshe, nga tjerët, e sheh figurën e Enver Hadrit dhe Vehbi Ibrahimit, duke i përshkruar ata si njerëz me merita të dyshimta.

Libri ,"Atentatet", duhet të jetë vetëm një pjesë e së vërtetës të cilën Ibrahim Kelmendi, ish udhëheqës i Fondit "Vendlindja thërret" dhe njeriu që ka propozuar që LPK-ja të ketë fundin e saj historik në vitin 1999 në kongresin e rregullt në Prizren, sepse e vërteta tjetër duhet të shpaloset pas intervistës që i ka dhënë gazetës Express.

Ai flet atë që rrallë kush guxon ta thotë.

**Express**: *Pyetja e cila është shumë dilematike për secilin që ju njeh, për shembull gjeneratat e vjetrat, jo të rejat. Pse libri "Atentatet"? Ke thënë që libri do të bëhet krejt në një kohë më të qetë. Pse tani ky libër? Është ky dëshpërim i juaji me të kaluarën dhe të tashmen?*

**Ibrahim Kelmendi**: E para, romanin nuk e kam publikuar deri tani, sepse kam menduar që duhet një distancë kohore, që unë si autor të mund të reflektoj për atë që është bërë në mërgatë, e dyta, kam menduar se publikimi i mëhershëm do të dëmtonte luftën, veprimtarinë çlirimtare, gjegjësisht nuk do i bënte mirë asaj veprimtarie. Tani kam gjykuar që një çerek shekulli është distancë e mjaftueshme dhe mund të thuhen të vërtetat, pa dëmtuar luftën dhe pa qenë i penguar nga subjektivizmi.

**Express**: *Pse ky dekonspirim pas 25 vitesh edhe pse ju jeni njeri nga ata që i keni ditur këto gjëra, i keni njohur situatat, e keni njohur diasporën dhe njerëzit atje...?*

**Ibrahim Kelmendi**: Mosdekonspirimi i deritanishëm i atyre që kanë ndodhur është varur edhe nga ndikimi i amanetit apo porosisë se Jusuf Gervallës, i cili ka thënë: "Nëse dorasi është shqiptar, mos u zbuloftë kurrë!" Ne secili kemi një konstrukt social, i cili na bën të

respektojmë amanetin, gjegjësisht porosinë e fundit. Pastaj, po të thuheshin në kohë këto të vërteta, do kishim përplasje të mëdha, do na shkonte koha duke u marrë me qërim hesapesh në mes nesh.

**Express**: *E përmendet mitin. Heshtja për një kohë kaq të gjatë ka krijuar mite të diasporës. Njëri nga ato mite keni qenë edhe ju. Ju keni qenë i gjithëfuqishëm, por realisht jeni njeri i rëndomtë. Është krijuar miti për Jusuf Gërvallën. Po e lexove librin tuaj, do shihet se të gjithë ata njerëz kanë bërë jetë normale dhe kanë bërë një veprimtari patriotike prej distancës. Si e shikon ju këtë çështje tash?*

**Ibrahim Kelmendi**: Se vërtetë kemi qenë njerëz të rëndomtë. Mua më pengon kur njerëzit mitizohen dhe u zmadhohen angazhimet e tyre. Në botë të qytetëruar angazhimi patriotik e çlirimtar do të shihej si punë normale. Pse, ta zëmë, ka nevoje të lavdërohet një bujk që ka punuar në arën e tij, pasi ka bërë një punë normale. Njësoj e vlerësoj edhe angazhimin patriotik. Prandaj zmadhimet, këto krekosje të njerëzve, nuk janë të shëndetshme. Një angazhim për të fituar sa më shumë liri nuk ka përse të zmadhohet e lavdërohet deri në mitizim. Unë e gjykojë angazhimin tonë si angazhim tepër të përgjegjshëm e qytetar. Dhe prandaj dëshira ime ka qenë dhe është, që të demitizohen këto veprimtari çlirimtare, të shihen realisht se i kanë bërë njerëz vullnetmirë, të cilat, të them, rastësisht kanë qëlluar aty, por ka mundur të jenë edhe të tjerë, prandaj nuk ka nevojë të madhërohen figurat, por duhet të vlerësohet njerëzisht, në hapësirë, kohë e rrethana përkatëse.

**Express**: *Para se të hyjmë në emra konkret. Zakonisht në Ballkan ndodh që elementi i tradhtisë dhe patriotizmit është prezent. Të dyja këto elemente i keni brenda librit. Realisht, si korrespodonin këto elemente ballkanike ose kush është më shumë tradhtar e kush patriot, apo kush ka qenë i infiltruar në lëvizjen e madhe për Pavarësi? Pse i keni prekur këto elemente kaq të ndjeshme kur e dini mentalitetin?*

**Ibrahim Kelmendi**: Janë kategorizime që behën në këtë hapësirë, d.m.th. që shkojnë në ekstreme: tradhtar apo patriot. Unë e peshoj veprimtarinë e të ashtuquajturit tradhtar dhe gjithashtu edhe të patriotit. Patriot është secili njeri për nga natyra, sepse e donë vendin ku ka lind. Ata që e quajnë patriotizmin virtyt të jashtëzakonshëm, për mua janë budallenj. Tjetra, edhe angazhimet e tradhtarëve jam i predispozuar t`i shoh në mënyrë të diferencuar, sidomos në rrethana të rënda të pushtimit. Për aq sa kanë lejuar mundësitë dhe rrethanat e kohës, është formësuar gjeturia e vet qytetarëve. Në Kosovën e pushtuar, në hapësira të ndryshme kohore, ka pasur një farë autonomie përkatëse administrative e vetëqeverisëse. Në atë kuadër të autonomisë është dashur të angazhohen e të punojnë njerëzit edhe në struktura policore, duke përfshirë edhe UDB-në. Për shembull, sipas vlerësimit tim, për mua ka qenë pothuajse i barabartë të qenit mësues me të qenit udbash, gjegjësisht nëpunës sigurimi, sepse kanë qenë struktura e hallka të të njëjtit zinxhir, gjegjësisht të të njëjtit sistem, kanë vepruar sipas ligjeve të miratuara nga i njëjti Kuvend i Kosovës ose nga kuvendi federativ. Mësuesi e ka pasur për detyrë të indoktrinojë, UBD-shi të kontrollojë nëse ka zënë vend indoktrinomi i mësimdhënësit. Përjashto rastet, kur UDB-ashi dhe të ngjashmit kanë kapërcyer kompetencat ligjore, që nuk kanë lejuar ndjekje kolektive, tortura e zhdukje fizike, nuk kanë lejuar as atentatet, si në rastin e 17 janarit të viti 1982. Dhe këto raste duhet ndëshkuar, siç ka ndodhur e po ndodhin në ish shtetet tjera moniste.

**Express**: *Derisa në një moment ju e depolitizoni personalitetin për patriotizmin që ka pasur obligim, në njëfarë mënyrë mitizoni rolin UDB-së si të gjithëfuqishme, si gjithkund infiltruese. Pse i keni dhënë rolin aq të madh, që sipas librit tuaj, nuk ka qenë aq me peshe sa e mitizoni ju, apo është çështje e frikës?*

**Ibrahim Kelmendi**: Ka mundësi të jetë edhe rrjedhojë e frikës, pasi frika është ndjesi e pakontrollueshme. Ka mundësi që unë nuk e kam përshkruar tamam, sa ajo ka qenë e pranishme. Dihet se UDB-ja ka qenë njëra ndër sigurimet më të fuqishme, të cilës në ndonjë rast ia kanë pasur zili edhe CIA, KGB, etj. E di që këtë strukturë, qysh nga viti 1948, e kanë ndihmuar edhe ekspertë të CIA dhe Perëndimi i ka dhënë edhe ndihma të mëdha financiare dhe kadrovike dhe është ndihmuar që të jetë njëra ndër sigurimet më të forta në Evropë. Si e tillë ajo është përpjekur të kontrollonte gjithçka, jo vetëm në Kosovë, por të na kontrollojë e të na pengojë edhe në Perëndim. Prandaj disa prej personazheve që i kam përshkruar, të cilët kanë luajtur rol të madh, mendoj se veprimet e sjelljet nuk duhet t’i kenë pasur si rrjedhojë vetëm të budallëkut të tyre, ose vetëm për të kënaqur egomaninë e tyre, por ashtu duhet të jenë instruktuar e instrumentalizuar për të vepruar nga ky shërbim. Ta zëmë, kemi pas gazetarë dhe letrar të shkëlqyer, për të cilin sa i përket aftësisë profesionale, kam pas dhe kam një respekt të madh. Ai duhet të ketë qenë i kamufluar si korrespodent i “Rilindjes”, por ka qenë i angazhuar për t’i shërbyer atij sigurimi...

**Express**: *Prej nga ju këto informata se këta njerëz duhet të kenë qenë të tillë?*

**Ibrahim Kelmendi**: E para e punës, ai, si korrespodent i “Rilindjes”, nuk kishte nevojë të involvohen në përplasjet tona me konsullatën jugosllave në Dyseldorf dhe në atë përplasje ai ndonjëherë të ishte më brutal se vet konsulli. Do mjaftonte që ai, me një korrespodencë për gazetë të tij, të përshkruante çka po ndodhte dhe ai të mos inkuadrohej në ato përplasje që kishte Klubi shqiptar në Dyzeldorf me konsullatën dhe institucionet tjera të atëhershme shtetërore. Ato insistonin që ta fusnin nën tutelë Klubin e shqiptarëve aty, dhe ky, i kamufluar si gazetar, angazhohej pro konsullatës. Duke vrojtuar veprimtari të tillë, vija në përfundim se ai duhej të ishte në shërbim të UDB-së...

**Express**: *Ju këta njerëz i quani me detyrë të ngarkuar, vërtet kanë qenë të tillë?*

**Ibrahim Kelmendi**: Një kategori e tillë duhet të ketë qenë, siç e vlerësoja unë atëherë. I njëjti, p.sh., kur e arrestuan Vasilin në Kosovë, e sjellin nga Gjermania për ta marrë në pyetje gjatë hetimeve...

**Express**: *Kush është Vasili, ngase lexuesit tanë nuk e dinë?*

**Ibrahim Kelmendi**: Vasili është njëri nga personazhet e romanit. Ai ka pasur një urdhër për të bërë atentat ndaj Jusuf Gervallës, por trimërisht ka refuzuar ta zbatojë. Për këtë ai duhej të ndëshkohej nga UDB-ja. Prandaj kur Vasilin e arrestuan në Kosovë, gazetarin në fjalë e sjellin nga Gjermania për ta marrë në pyetje gjatë procesit hetues, meqë duhet të jetë vlerësuar si njohës më i mirë i veprimtarisë sonë në Perëndim. Kështu i kisha atëherë informatat dhe prandaj i krijoja vlerësimet, pasi na duhej të krijonim sistem të vetëmbrojtjes.

**Express**: *Si e sheh Ibrahim Kelmendin patriot të diasporës, si të duket ai prej kësaj distance historike?*

**Ibrahim Kelmendi:** Si një veprimtar i natyrshëm, autentik, i cili për shkak se ka shkuar i ri dhe është ndikuar shumë nga jeta studentore gjermane, ndonjëherë është keqkuptuar edhe nga bashkëveprimtarët si i padisiplinuar, si jo serioz, si anarshist, si me xhins të grisur e flokë të gjatë...

**Express**: *Të ndalemi te kjo, ngase në libër ju nuk e përshkruani personalitetin tuaj, por ata që ju njohin, ju kanë vlerësuar se keni pas në dukje një bindje ideologjike të majtë, por të dallueshme prej marksistëve dhe leninistëve të kohës, të dallueshme edhe prej Jusuf Gervallës dhe Enver Hadrit. Nga kjo distancë kush ka pasur të drejtë?*

**Ibrahim Kelmendi**: Se pari do të thoja se asnjëri nuk kishim kushedi se çfarë bindje ideologjike, pasi na mungonte përgatitja teorike, po të kemi parasysh përgatitjen përkatëse teorike filozofike. Për aq sa ishim të ideologjizuar, secili kishim të drejt, sepse ideologjitë nuk mund të shabllonizohen dhe të gjykohen, siç po ndodh tani. Me rëndësi duhet të ketë qenë, se edhe pse kishim bindje të ndryshme, nuk armiqësoheshim për shkak të tyre, por bashkëvepronim. Kjo mbase tregon se kishim tolerancë e mirëkuptim pluralist dhe këtë e kishim në programet e statutet tona politike, në shkrimet tona. Bindjet tona ido-politike kanë osciluar dhe kanë evoluuar. Ne më shumë na ka interesuar kontributi për çlirim kombëtar dhe jo drejtësia ideologjike, d.m.th. na interesonte të gjejmë mënyrën më efikase, që të ndikojmë sa më shumë te njerëzit, që t'i afrojmë ata duke i ndërgjegjësuar për veprimtari të angazhuar patriotike e çlirimtare.

**Express**: *A ka krijuar diferenca ideologjia për çështjen kombëtare gjatë asaj kohe, meqë ju duhet të keni qenë më liberal se të tjerët, të cilët ishin më konservativ, për të mos thënë se kanë qenë enveristë?*

**Ibrahim Kelmendi**: Në organizimet ku kam vepruar unë, përcaktimi programor ka qenë: pavarësisht bindjeve ideologjike e politike, secili që është i interesuar të angazhohet për Kosovën Republikë, gjegjësisht ta çliroj Kosovës, ka të drejt të anëtarësohet. Pastaj, brenda për brenda organizimeve tona, kur kishim demokraci më të avancuar, kishim edhe luftë idesh, sepse është e natyrshme që secili të angazhohet që të përfitoj simpatizantët e vet. Kjo ka ardhur në shprehje tek ne nga mbarimi i vitit 1984, kur filluam të organizojmë mbledhje me më shumë veta, deri edhe te kuvende, në të cilat filluam të kishim garë për vota dhe votime të fshehta. Rëndom ka pasur goxha përplasje gjatë diskutimeve, ndonjëherë kanë qenë edhe brutale, por pothuajse gjithë herë kemi bërë kompromise, sepse në fund të fundit ne po angazhoheshim ta çlirojmë Kosovën dhe jo të ia përcaktojmë asaj sistemin politik.

**Express**: *Pse ju keni pasur një respekt të madh për Jusuf Gërvallën, të cilit në njëfarë mënyre i kushtohet libri juaj? Ke një rezervë për veprimtarinë e Enver Hadrit dhe grupacioneve të Belgjikës. Cili është dallimi i këtyre grupacioneve?*

**Ibrahim Kelmendi:** Respekt kam pasur për Jusufin nga se në fillim jam gjetur në një situatë shumë të vështirë. Atëherë kam qenë shumë i ri për të pasur formim të avancuar politik. Kam pas një si kompleks që nuk po dija të artikuloja me shkrim ato që kam dëshiruar t'i shpreh. Ardhja e Jusufit më ndihmoj shumë, pasi ai ma zvogëloi atë kompleks. Pastaj kam pas një kulturë, që kur me rastiste të bashkëveproja me dike që e çmoja më të aftë se vetën, ia lëshoja vendin, kaloja në plan të dytë, që do të thotë se ua liroja vendin atyre që ishin më të përgatitur. Pra, edhe te gëzimi i madh dhe lirimi nga

kompleksi, se aty e tutje nuk do më tallin për ato që do shkruaja, pasi do m'i redaktonte Jusufi, e ka bazën respekti e dashuria e madhe për Jusufin. Por kryesore ka qenë cilësia e tij si njeri, modestia dhe kultura e tij. Ai ka ditë të të afroj si shok e bashkëveprimtar, në kohën kur njerëzit të kategorizonin, gjegjësisht të largonin, nëse kishe nivel të ulët intelektual e profesional.

Po kaq shumë e kam respektuar dhe dashur edhe Kadri Zekën, me të cilin fatkeqësisht jam njohur tek në mars të vitit 1981 dhe kam kaluar shumë më pak kohë, se sa me Jusufin.

Pyetet edhe për Enver Hadrin dhe grupimet në Belgjikë. Unë te ai njeri nuk kisha gjetur pothuajse asgjë. Duhet ta kem takuar qysh gjatë vitit 1978 dhe të mos kem bashkëpunuar. Ai në dukje nuk kishte koncept politik, ka qenë shumë konfuz, kemi pas shumë debate, ndonjëherë edhe përplasje e armiqësime. Në paraqitje ishte antikomunist, kurse kisha informata se po bashkëpunonte me Partinë Komuniste të Belgjikës. Kisha përshtypjen që ai po informonte dike, që do të thotë se, kisha dyshime që ai po informon njëherazi Sigurimin shqiptar por edhe UDB-në. Në vitet e fundit patëm bashkëpunim. Kurse gjatë varrimit Lëvizja u angazhua për varrim dinjitoz, pasi ai nuk kishte miq e bashkëveprimtarë rreth vetës, që do mund ta bënin këtë. Në mbledhjen komomorative i pata kërkuar falje publike për padrejtësitë që mund t'i kishte bërë Lëvizja dhe unë.

Grupimet e organizuara në Belgjikë, në fillim të viteve të 80-ta, nuk kanë qenë të fuqishme. Grupimet e djathta nacionaliste pothuajse kishin pushuar se qenuri, kurse grupimet e reja, të djathta dhe të majta, përbëheshin vetëm nga dy-tre individë, me dallim prej grupimit pro Lëvizjes, i cili dominonte. Vetëm kur ndodhi pluralizmi i simuluar e i shpifur në Kosovë në fillim të viteve të 90-ta, kishte një rritje organizative LDK-ja, me të cilën herë bashkëpunonim e herë jo.

**(Vazhdimi i dytë ...)**

## UNË DO TA ZBARDHI RASTIN GËRVALLA

Ibrahim Kelmendi në romanin e tij "Atentatet" dëshmon se vrasësi është Rezili. Për këtë ai thotë se ka fakte të mjaftueshme. Nuk frikësohet për vete sepse beson se ka ndërgjegjen e pastër.

Lexoni vazhdimin e dytë në Express të intervistës me Ibrahim Kelmendin.

**Express**: Ju e keni margjinalizuar rolin e emigracionit në Bruksel, por i jepni vend rolit të emigracionit në Zvicër. Boshti i veprimtarisë ka qenë i vendosur në Zvicër dhe Gjermani. Ju i jepni peshën Jusufit derisa vritet, por më vonë, edhe pas vrasjes, nxitet ose ngritët mitin për Jusufin dhe ajo ka një inercion. Na trego këto dy boshte edhe lëvizjet tua Zvicër - Gjermani, shihet që keni një njohuri të dukshme duke eliminuar Belgjikën si emigracion?

**Ibrahim Kelmendi**: Fillimi i kësaj lëvizjeje, për të cilën po flasim, ka ndodhur në Gjermani, ndërsa më vonë epiqendra është zhvendosur në Zvicër, për faktin se në Gjermani kishin ardhur shumë emigrantë gjysmë-analfabetë, do me thënë ishin vështirë të "përpunueshëm", ndërsa në Zvicër shumica kishin një shkollë të mesme. Në këto dy shtete emigracioni ka qenë më i madh në atë kohë. Në Belgjikë nuk kishte emigracion aq të madh. Atje ishin dy grupime të mëdha, emigrantë politikë nga Shqipëria dhe emigrantë ekonomik shqiptarë nga Turqia. Të dy grupimet ishin kryesisht të paarsimuara.

**Express**: *Pse ishte Jusuf Gërvalla cak i UDB-së, dhe pse ai ishte i rrezikshëm për te?*

**Ibrahim Kelmendi**: Unë them që UDB-ja duhet të ketë gjykuar se u arratis një kuadër më intelektual se këta të tjerët që ishin deri atëherë dhe prandaj do ketë influencë më të madhe. Emigrantët e paarsimuar në atë kohë kanë pasur një kult ndaj intelektualit, sepse ka pas një deficit të madh në Kosovë. Këta emigrantë që kishin shkuar atje për të punuar, kanë marrë atë gjendje sociale me veti, d.m.th. edhe kultin për intelektualin dhe atë gjendje e kanë konservuar. Menjëherë u përhap lajmi se është arratis një intelektual i zoti. Prandaj UDB-ja priste se ai do të ketë një ndikim të madh. Për këtë arsye ajo qysh në fillim u mundua t'i presë hovin. Kështu, që në start Rezili, personazhi që unë e argumentoj si doras, akoma pa arritur Jusufi, filloi të përhapë propagandë se Jusufin e ka dërguar UDB-ja për të na përçarë dhe se jemi të rrezikuar nga ai. Kjo po ndodhte akoma pa hy në tokë gjermane Jusufi. Kjo ishte metoda më e efektive për t`i frikësuar njerëzit. Rezili në mënyrë aktive u mor me këtë propagandë. Pothuajse 24 orë rrinte në stacione treni në Shtutgard, ju drejtohej shqiptarëve kur i njihte e nuk i njihte, mjaftonte kur i shihte se po blenin gazetën "Rilindja". I gostiste me kafe dhe mandej u thoshte se UDB- ja ka çuar një UDB-ash. Unë gjykoj nga ky kënd, se UDB-ja ka marrë masa të menjëhershme që Jusufin ta pengonte që të mos kishte ndikim qysh në startim të veprimtarisë se tij në ekzil. UDB-ja mori ofensivë që ta diskreditojë Jusufin.

**Express**: *A ka pasur sukses Rezili, personazhi juaj, që ta diskreditojë Jusufin sidomos te një masë që ka qenë krejtësisht analfabete?*

**Ibrahim Kelmendi**: Te njerëzit që i kemi pas afër vetës, si të anëtarësuar, si simpatizantë, nuk ka pasur fare influencë. Ai pat krijuar influencë të kufizuar te një grupim i vet, sepse sapo u hetua që në Gjermaninë Qendrore filluam një angazhim konkret patriotik, si kundërpeshë ai në Shtutgart formoi një grup që fillimisht e quajti Grupi komunist "Zëri i Kosovës".

**Express**: *Pse personazhi juaj do të jetë vrasës dhe pse shqiptari duhet të jetë vrasës i Jusuf Gervallës e jo për shembull njerëz të specializuar të UDB-së? Në libër duket e mjegulluar kjo.*

**Ibrahim Kelmendi**: Sepse edhe unë po të kisha qenë oficer i UDB-së njësoj do të kisha vepruar, do kisha zgjedh një shqiptar si doras. Kjo për faktin se nëse do e zbulonin gjermanët, atëherë do përhapej dezinformatë: "Shqiptarët vriten në mes veti për probleme të tyre të brendshme". Ky duhet të ketë qenë motivi apo qëllimi kryesor i UDB-së, pse ka urdhëruar shqiptarë për të bërë atentatin.

**Express**: *Ju e njihni Rezilin, ai është gjallë, jeton në Kosovë. Jeni frikësuar ndonjëherë se nuk e thoni të vërtetën, se dorasi nuk është ai, edhe pse në libër detajisht e përshkruani personazhin si vrasës dhe jepni arsyen pse është doras?*

**Ibrahim Kelmendi**: Unë në këtë drejtim e kam ndërgjegjen e qetë. Thënë të drejtën, dëshiroja që Rezili të ketë një alibi, të mos ketë qenë atentatori, vrasësi, por krye-hetuesi, të cilin fillimisht e kam orientuar drejt Rezilit si atentator i mundshëm, katërçipërisht më ka bind se Rezili nuk ka alibi. Ai dy herë ka qenë i arrestuar për këtë qëllim. Atëherë unë kisha informata të bollshme që të dyshoj në Rezilin, meqë kishte dhënë një urdhër për t'u bërë atentati ndaj Jusufit. Ngase i kishte dështuar, do e ketë vendosur ta bënte vetë, sepse

për dështim të parë UDB-ja mund t'i ketë kërkuar llogari. Prandaj, kur krye-hetuesi më ka bind se ai nuk ka alibi, atëherë u bëra kategorik, se dorasi duhet të jetë Rezili.

**Express**: *Dorasi ka dhënë një alibi se ka qenë te motra..., por ju e demaskoni këtë?*

**Ibrahim Kelmendi**: Unë e kam bërë këtë duke u thirr në bashkëbisedimet që kam pasur me krye-hetuesin, sepse ai thotë që motra ka qenë shumë mirë e përgatitur, e ka mbuluar shumë mirë Rezilin, por nipat e tij, me të cilët ka biseduar krye-hetuesi, kanë treguar se daja i tyre s`ka qenë natën e krimit të motra, bile ata i kanë treguar se nuk kishte qenë gati për dy vjet aty. Fatkeqësia e tij (krye hetuesit), siç është shpreh vetë krye-hetuesi, është se ligji në Gjermani e ndalon që të miturit të jenë dëshmitarë në gjyq.

**Express**: *Ju e dini se kush është vrasësi. Ai është Rezili. Meqë ju e keni pasur mik Jusufin, pse nuk e denonconi rastin, kur të miturit e motrës së tij tash janë rritur, ata mund të flasin në gjyq? Rezili jeton në Kosovë në një rajon të caktuar. Cili është obligimi moral i mikut të Jusufit, i cili është gjallë?*

**Ibrahim Kelmendi**: Obligimi im moral është që të testoj opinionin, kam drejtë unë apo nuk kam të drejtë të shkeli mbi amanetin e Jusufit për të bërë pastaj denoncim konkret ndaj Rezilit. Pastaj obligim moral tashmë duhet ta kenë edhe lexuesit, që e kanë lexuar romanin "Atentatet"...

**Express**: *Kemi të bëjmë me vrasje, porosia është çështje morale.*

**Ibrahim Kelmendi**: Unë kam dilema, prandaj po marrë mendime nga njerëzit, se çfarë përshtypjeje u ka bërë romani. Edhe të tjetër kanë mundësi të bëjnë denoncimin. Janë me qindra që e dinë emrin e vërtetë të Rezilit, pasi e dinë se ai ka qenë kryetar i grupit komunist "Zëri i Kosovës". Ata nuk janë të lidhur emocionalisht me Jusufin, siç jam unë që ndjehem i obliguar të respektojë një porosi të tillë. Pra, ata i kanë mundësitë më të hapura. Nëse ata s'e bëjnë, unë do i pres diskutimet dhe nëse më thuhet, se është më me rëndësi denoncim i dorasit, sesa porosia e Jusufit, atëherë do ta bëj këtë.

**Express**: *Me qenë se po i lëmë lexuesit që ta lexojnë librin, nuk po ndalemi te rasti Gërvalla, se si është vrarë. Ti e prek një element jashtëzakonisht interesant në libër ose më mirë të themi ke prek edhe një personazh tjetër, Emil Kastriotin. Një personazh tejet konfuz, por një personazh i qartësuar nga ti dhe i paqartë në veprimtarinë e tij. Pse duket Emil Kastrioti i tillë?*

**Ibrahim Kelmendi**: Unë e kam njohur atë edhe personalisht. Kam biseduar shpesh me të, sepse me secilin veprimtar në migracion unë s'kam pas kurrë një lloj paragjykimi të rri e të bisedoj me të, që të shikoj a kemi diçka të përbashkët që na lidh. Edhe në saje të atyre takimeve, më është imponuar të krijoj një lloj intuite që të mundem t'i vlerësojë dhe t'i kategorizoj njerëzit, janë apo nuk janë për bashkëpunim. Kështu unë, qysh herët, Emilin e kam kategorizuar në atë skedarin tim, se nuk është për bashkëpunim, se është destruktiv, bile se është i dyshimtë. Por me Emilin dhe të tillët, nuk kam dëshiruar të hyj në konflikt, sepse gjykoja se do harxhoja kot energji time dhe të organizatës ku bëja pjesë.

**Express**: *Në libër i sheh ata si njerëz të rrezikshëm, megjithatë?*

**Ibrahim Kelmendi**: Po, sigurisht, bile si shumë të rrezikshëm dhe unë kam menduar që duhet t`i lëmë rehat, nuk duhet të merremi me ta. Nëse merrem me ta, atëherë procesi shkon duke eskaluar dhe ndoshta do shkonim deri te vrasja.

Unë kam pas një përcaktim: vrasje në Perëndim nuk guxon të ndodhë, një për shkak të kultit që kam prej malësorit, se mysafiri nuk guxon të shpërdorë mirëpritjen e nikoqirit, do me thanë, në shtëpi të huaj nuk bëhet sherr. Kështu që, meqë në Perëndim na kanë strehuar, na e kanë lejuar veprimtarinë patriotike dhe na kanë ofruar shans për një jetë më të mirë, atëherë unë kam qenë i përcaktuar që të kanalizojmë mërgatën tonë kundër vrasjeve, qoftë mes ne shqiptarëve, qoftë me të tjerët. Prandaj unë u kam ikur këtyre sherrxhinjve, që kanë qenë shumë të rrezikshëm, dhe kurrë nuk jam marr me ta. Kur ata janë marrë me mua, unë i kam duruar, kam heshtë dhe i kam injoruar. Vetëm një përplasje skandaloze e kam pas me Emilin, më pat bërë një sherr të madh, por e kam duruar, nuk jam hakmarrë.

**Express**: *Në librin tënd, realisht një personazh krejt minor, është hero i një pjese të Kosovës. Ai është rivarrosur me nderime, i është ngritur kulti i personalitetit. Unë i kam lexuar reagimet e Ibrahim Kelmendit për një personazh të tillë, i cili gjatë jetës në diasporë ka qenë kontrovers dhe i dyshimtë. Ju e dini për cilin e kam fjalën, besoj?*

**Ibrahim Kelmendi**: Bëhet fjalë ndoshta për Vehbi Ibrahimin. Ate, nga njohja ime e drejtpërdrejtë dhe nga njohja përmes bashkëveprimtarëve në Bruksel, të cilët e kanë njohur më mirë se unë, e kam kategorizuar në atë skedarin tim si element kriminel, që merret me kontrabandë, me prostitucion me gjithçka, por veç patriotizëm e moral nuk i ka. Në fakt shtirej se ishte veprimtar e trim patriot, po i kishte vetëm si mjet për punë. Kështu gjykoja unë atëherë dhe kështu vazhdoj të mendoj, deri sa të më ofrohen prova kokëforta për të kundërtën.

**Express**: *Po pse këto dallime kaq të mëdha. Realisht krijohet miti për një njeri i cili në diasporë ka pas krejt tjetër punë?*

**Ibrahim Kelmendi**: Sepse këtu është lehtë të spekulosh. Unë di kopukë, që janë marrë me droga, kontrabandë, imoraltet, hajni, spiunim, që vinë në Kosovë, paguajnë gazetar fukara, financiarisht dhe profesionalisht, që punojnë në televizion ose në gazeta dhe ua bëjnë me porosi reportazhet për t'i bërë hero. Pastaj ato shkrime i manipulojnë njerëzit, meqë nuk janë të informuar. Akoma kemi njerëz të shkretë, që kanë njëfarë kulti të vjetër, se ato që pasqyron televizioni ose gazeta, duhet me qenë e vërtetë. Pastaj të tillët fillojnë të madhërojnë edhe keqbërës, fillojnë t'u thurin këngë...

**Express**: *Por, edhe miku i juaj, Haqif Mulliqi e ka madhëruar Enver Hadrin.*

**Ibrahim Kelmendi**: Nuk e di. Ai e paska bërë një punë në mungesë të informatave, ose mund ta ketë ndjerë si obligim moral, sepse, ndoshta, në kohën e fundit Enver Hadri ka fituar një lloj ndërgjegjësimi patriotik dhe një siguri, se mund t'ia kthen shpinën padronit. Dhe ky lloj guximi atij i kushtoi me jetë. Ne e kemi diskutuar një rast, kur ai doli të propagandonte dhe të mbledhë lekë në emër të asaj që ka merita për rezolutën e parë për Kosovën, që pat aprovuar Parlamenti Evropian. Meqë unë isha në dijeni për procesin e rezolutës që në nismë, atëherë e këshillova: "Enver je duke e rrezikuar vetën. Ti ke dëgjuar si krejt bota në lajme për rezolutën. Tjetër meritë për te nuk ke. Mos i dil zot, sepse jo të gjithë nacionalistët serbë në Evropë i ka UDB-ja e Beogradit nën kontroll dhe dikush prej tyre mendon që ti vërtet e ke atë meritë që po mundohesh ta përvetësosh.

Ndonjëri prej tyre mund të hakmerret ndaj teje, prandaj rri rehat dhe mos ia sjellë vetës ujkun në torishtë, në mënyrë kaq naive. Edhe këtë punën e mbledhjes se të hollave te bashkatdhetarët, gjoja në emër të shpenzimeve që ke bërë për të korruptuar parlamentarë për të miratuar rezolutën, do të lutesha ta ndërpresësh, mos i bezdis se nuk i meriton". Kanë qenë të paktën edhe 10 veta prezent, në klubin shqiptar "Idriz Seferi" në Bruksel, kur e kemi debatuar këtë çështje. Tash edhe Haqifi ka ndjerë obligim moral të shkruaj, por edhe unë kam ndjerë obligim moral që t`ia organizojmë varrimin, sepse nuk ka pas kush t'ia organizojë. Njerëzit e Lëvizjes i kam këshilluar që të merren me organizim sa më dinjitoz të varrimit të tij, sepse, megjithatë, m'është duk një gjest shumë i mirë e i guximshëm, që Enveri ka provuar të dalë nga shërbimi, sepse ka menduar që ishte dobësuar UDB-ja. Unë nuk druhem t`i them gjërat e përparme të tij, po kuptohet, siç i kam vlerësuar në Kohë dhe do gëzohesha, sikur të kisha prova që të bindesha se ai ka qenë gjithë jetën patriot.

## 13. E KA PRAPA KËTË FAMILJE

**Gazeta Express**: "Ibrahim Kelmendi, autor i librit "Atentati", i cili ka tentuar të zbulojë vrasësin e Jusuf Gërvallës përmes këtij libri, sipas familjes Gërvalla, është njeriu i parë i cili ka drejtuar gisht në një njëri të dyshuar për vrasjen e Bardhosh dhe Jusuf Gërvalles dhe për këtë ka prapa këtë familje...

...Hysen Gërvalla, vëllai i Jusufit, pas publikimit të intervistës së Ibrahim Kelmendit, të botuar në gazetën Express, ka treguar se e admiron këtë njëri për guximin se i ka hyrë një pune shumë të madhe.

...Për këtë, tash për tash, Gërvalla nuk dyshon në Kelmendin për shkak se ky ka marrë guximin t`i hyjë hetimit dhe zbardhjes së rastit të vrasjes së vëllezërve të tij...

"Pasi Ibrahim Kelmendi ka thënë se ka obligim moral për zbardhjen e rastit të vrasjes së Jusuf Gërvallës, atëherë unë nuk dyshoj në të, edhe pse është përfolur shumë për të", ka thënë Gërvalla....

...Të dyshuar për vrasjen e Jusufit, janë një mori personash, që të gjithë shqiptarë, shpjegon ai. Por, nuk dëshiron që me askënd të kacafytet pa ardhur momenti i duhur për të vepruar.

Nuk janë të interesuar si familje ta akuzojnë askënd për vrasjen e Jusuf dhe Bardhosh Gërvalles derisa nuk e kanë në dorë të sigurt njeriun, i cili e ka vrarë Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën...

...Libri i Kelmendit, sipas Gërvallës, është një libër i mirë, edhe pse nuk e ka lexuar në tërësi.

Hysen Gërvalla, vëllai i Bardhosh dhe Jusuf Gërvalles, në emër të familjes Gërvalla nuk dëshiron që t'ia drejtojë gishtin askujt për vrasjen e vëllezërve të tyre. Por, thotë se nuk do të lërë pa hulumtuar dhe çuar deri në fund çështjen e vrasjes së dy vëllezërve të tij. Për këtë pret kohën e duhur." (Gazeta Express, 13 mars 2007)

## 14. Më ke gëzuar

Fragmente nga letra elektronike e Ramiz Kelmendit (14 mars 2007):
(…) Librin e kam marre bashke me "Fokusin", sapo ka dale. Edhe e kam lexuar. (…) Si pune e pare, mund te te them se me ke habitur - jo pak! - me stilin, ta quaj romanesk, te librit.D.m.th., me ke gezuar, ta kam pelqyer.

E dyta, libri lexohet me nje fryme, edhe pse, perkunder natyres sate, si te njoh une, d.m.th. qe nuk nguron fare t'i thuash te bardhes e bardhe dhe te zezez e seze,

kesaj here me ka munguar kjo kurajo jotja duke u fshehur pas emrave te trilluar (me ndonje perjashtim). (…) Libri ka nevoje per nje lekture me te mire. (…)
(www.pashtriku.org)

## 15. Z. Ibrahim Kelmendi, autori i romanit "Atentatet" u pergjigjet lexuesve!

*http://www.kosova.de/index/forum/index.html*
Forum Index » » Tema të vjetra / Alte Themen » » Z. Ibrahim Kelmendi, autori i romanit "Atentatet" u pergjigjet lexuesve!

| Tema: | Z. Ibrahim Kelmendi, autori i romanit "Atentatet" u pergjigjet lexuesve! |
|---|---|
| **Marinsi**<br><br>**Anëtar që nga:** 21.02.2007<br>**Afishime:** 3 | **Afishuar me:** 22.03.2007 14:16<br><br>Te nderuar lexues te ketij forumi<br>Autori i romanit "Atentatet", Z. Ibrahim Kelmendi, ka shfaqe gatishmerine t'u pergjigjet te gjitha pyetje te lexuesve te ketij forumi, lidhur me romanin "Atentatet". U lutem qe mundesisht pyetjet te jene te kjarta dhe pa fyerje. Z. Ibrahim Kelmendi eshte regjistruar ne forum me nofken "i.Kelmendi.<br>Kerkoj nga kujdestaret e ketij forumi qe ta vezhgojne kete teme dhe mos te lejojne fyerje te cilat debatin do ta zhvendosin ne nje kahje krejt tjeter!<br><br>profile \| edit quote |
| **grepi**<br><br>**Anëtar që nga:** 24.11.2004<br>**Afishime:** 3916<br>**Vendbanimi:** çabrat | **Afishuar me:** 22.03.2007 14:39<br><br>Librin "Atentati" te Ibrahim Kelmendi e lexova ne faqen www.pashtriku.org deri rreth faqes 370 sa me kujtohet por kisha pyetur z. Kelmendi se për qfar arsye se sqaron se ku jetoj me vone pas vrasjes se Vllezerve Gervalla dhe Kadri Zeka ky far "Rezili" ?? posaqerisht ku ka jetuar "Rezili" nga vitet 1982 dhe deri ne mbarim te Luftes se "Ushtris çlirimtare të Kosovës".<br>përshendes z. kelmendi për Librin dhe Kurajon qe ka marre ti jape fillin e zgjidhjes se rastit qe ne Historin e Ilegales esht njender rastetet me Enigm.<br>te fala<br>grepi, dora vetë<br><br>profile mail www \| edit quote |
| **qeku11**<br><br>**Anëtar që nga:** 05.03.2006<br>**Afishime:** 40 | **Afishuar me:** 22.03.2007 14:43<br><br>pershendetje z. Kelmendi,<br>Sa te ka kushtuar botimi i kesaj libre?<br><br>profile \| edit quote |
| **Mok**<br><br>**Anëtar që nga:** 21.10.2005<br>**Afishime:** 78 | **Afishuar me:** 22.03.2007 14:58<br><br>Zoti kelmendi , a mendoni se keni me fituar diqka nga ky liber dhe sa keni planifikuar me fitu.<br>Azem zogaj qe shet libra Para Grandit ne Prishtine me pat lan nje fjale kur e pyeta se si po shkon pazari? |

Ai mu pergjigj keshtu:
Shyqyr zotit qe eshte kan Shaban Pluzha trim e luftar, Azem Bejta e Adem Jashari e Shum te tjere Trima se keta dhe kan Luftuar siq duhet e ma ne fund kan ra per LIRI, Ata kan Ra e tash shkrimtaret kush ma i pari turr e me shkrua Libra e Romana sa te duash , Fito ai e Fito Une qe po i shes. Kjo ishte puna e disa " Romansierve "
<font class=editedby>[ Ky afishim u ndryshua nga: Mok më 2007-03-22 15:00 ]</font>
[ Ky afishim u ndryshua nga: Mok më 2007-03-22 15:01 ]

profile | edit | quote

***DIELLI***

**Anëtar që nga:** 26.04.2004
**Afishime:** 93
**Vendbanimi:** buze kufirit

**Afishuar me:** 22.03.2007 17:40

Zoti Kelmendi,
pse ju nuk ndoqet rrugen e Jusufit dhe te Kadri Zekes dhe mbasi qe ju e dinit se kush ishte vrasesi perse nuk u ndermorr nje ofensive nga ana e juaj apo nga ana e Levizjes suaj, per te marre hak, pasi qe Jusufi dhe Kadriu konsideroheshin si shoke tuaj, te bindjes suaj politike te asaj kohe.
Adrian Krasniqi dhe nipi i juaj Qerimi do te kishin pasur mundesi te udhehiqnin ndonje aksion si ai i llojit te fshatit kliqine te pejes per te rivanzhuar vrasnje e Jusufit dhe Kadriut !

profile | edit | quote

**Hyena**

**Anëtar që nga:** 20.02.2007
**Afishime:** 78

**Afishuar me:** 22.03.2007 19:54

Zoti Kelmendi pershendetje nga Hyena.
Kame deshir ta di se ne librin tuaj a e keni pershkru edhe perioden e luftes seUQK-se.
Gjate muajit korrik vitit 98 ju ishit ne Tropoj por spatum fatin me u taku. Ne ate kohe eshte tentu te behet nji atentat ndaj Lum Hagjis dhe ne ate periode u vrane shum shqipatar nga Kosova ne rrethana ende te pa njohura.
Jam i bindur se per kto gjera jeni ne dijeni pasi ju ishit ne ate kohe ne Shqiprin e Veriut-Bajram Curri...

Hyena ju pershendet.

profile | edit | quote

**caka**

**Anëtar që nga:** 05.03.2005
**Afishime:** 759
**Vendbanimi:** germany_k

**Afishuar me:** 22.03.2007 19:54

> Quote:
>
> grepi afishoj me 2007-03-22 14:39 :
> Librin "Atentati" te Ibrahim Kelmendi e lexova ne faqen http://www.pashtriku.org deri rreth faqes 370 sa me kujtohet por kisha pyetur z. Kelmendi se për qfar arsye se sqaron se ku jetoj me vone pas vrasjes se Vllezerve Gervalla dhe Kadri Zeka ky far "Rezili" ??
> posaqerisht ku ka jetuar "Rezili" nga vitet 1982 dhe deri ne mbarim te Luftes se "Ushtris çlirimtare të Kosovës".
> përshendes z. kelmendi për Librin dhe Kurajon qe ka marre ti jape fillin e zgjidhjes se rastit qe ne Historin e Ilegales esht njender rastetet me Enigm.
> te fala
> grepi, dora vetë

--------------------------------------------------------------
tatjeta grepi,
une shikova ne web www.pashtriku.org rreth ketij libri ne fjale por nuk e hasa gjekundi me perjashtim rreth pershtypjeve rreth librit.
me ndihmo içik, te lutem
ti thua se ke arrit deri tek faqja 370 ,apo?
ku gjendet libri i plote ne kete website?
faleminer

profile | edit quote

**grepi**

**Anëtar që nga:** 24.11.2004
**Afishime:** 3916
**Vendbanimi:** çabrat

**Afishuar me:** 22.03.2007 20:01

Quote:

caka afishoj me 2007-03-22 19:54 :

Quote:

grepi afishoj me 2007-03-22 14:39 :
Librin "Atentati" te Ibrahim Kelmendi e lexova ne faqen http://www.pashtriku.org deri rreth faqes 370 sa me kujtohet por kisha pyetur z. Kelmendi se për qfar arsye se sqaron se ku jetoj me vone pas vrasjes se Vllezerve Gervalla dhe Kadri Zeka ky far "Rezili" ?? posaqerisht ku ka jetuar "Rezili" nga vitet 1982 dhe deri ne mbarim te Luftes se "Ushtris çlirimtare të Kosovës".
përshendes z. kelmendi për Librin dhe Kurajon qe ka marre ti jape fillin e zgjidhjes se rastit qe ne Historin e Ilegales esht njender rastetet me Enigm.
te fala
grepi, dora vetë

--------------------------------------------------------------
tatjeta grepi,
une shikova ne web http://www.pashtriku.org rreth ketij libri ne fjale por nuk e hasa gjekundi me perjashtim rreth pershtypjeve rreth librit.
me ndihmo içik, te lutem
ti thua se ke arrit deri tek faqja 370 ,apo?
ku gjendet libri i plote ne kete website?
faleminer

z. Caka
hape faqen pashtriku dhe kliko mbi Librin "Atentat" nga e Djathta ku jane ne Foto duke bere Promovimin e Librit:
pastaj shko me radh nga faqja e Pare e deri ne 470 ........... e tutje duhet te jete.
grepi, dora vetë

profile mail www | edit quote

**caka**

**Anëtar që nga:** 05.03.2005
**Afishime:** 759
**Vendbanimi:** germany_k

**Afishuar me:** 22.03.2007 20:10

ok grepi
faleminer, mu aty paskam harru te klikoj.
edhe 1 here flm
e me te mira

profile | edit quote

**tarasi**

**Anëtar që nga:** 06.01.2006
**Afishime:** 1806

**Afishuar me:** 22.03.2007 20:36

Quote:

> *DIELLI* afishoj me 2007-03-22 17:40 :
> Zoti Kelmendi,
> pse ju nuk ndoqet rrugen e Jusufit dhe te Kadri Zekes dhe mbasi qe ju e dinit se kush ishte vrasesi perse nuk u ndermorr nje ofensive nga ana e juaj apo nga ana e Levizjes suaj, per te marre hak, pasi qe Jusufi dhe Kadriu konsideroheshin si shoke tuaj, te bindjes suaj politike te asaj kohe.
> Adrian Krasniqi dhe nipi i juaj Qerimi do te kishin pasur mundesi te udhehiqnin ndonje aksion si ai i llojit te fshatit kliqine te pejes per te rivanzhuar vrasnje e Jusufit dhe Kadriut !

Qerimi( Dema) nuk është nipi i z. kelmendi por është vëlai i tij, prej nënë e prej babe!

profile | edit quote

**D**

**Anëtar që nga:** 27.04.2002
**Afishime:** 1253

**Afishuar me:** 22.03.2007 20:47

Përshëndes hapsin e kësaj teme, kam lexuar libriun, shkrimet dhe intervistat e autorit.
Për mua nuk kanë qenë enigma dhe të panjohura shumica e pohimeve të autorit I.K.
Në temën ku është intervista e I.K. unë kam dhënë mendimin tim se pohimi se Rezili është dorasi, për mua është pohim subjektiv, pohim i njeriut që nuk mund të dal nga rrethi vicioz i dyshimeve dhe përfoljeve për armiqët e brendshëm !
Nuk i besoj kësaj teorie e as të atyre që thon se Ibrahim Kelmendi i ka shty Riza Salihun dhe Hysen Gegën !!
ndërsa për pyetje dhe përgjegjje !!! nuk është vendi në Forumin "Politikë dhe aktualitete të tjera politike / Politik und politische Aktualitäten Këtu mund të diskutohet"
Megjithatë bravo Kosova Info Serverit që provokon situata të tilla !!

profile aim | edit quote

**grepi**

**Anëtar që nga:** 24.11.2004
**Afishime:** 3916
**Vendbanimi:** çabrat

**Afishuar me:** 22.03.2007 21:15

Ketu esht tema "Diskutime Politke" keshtu qe Vrasja e Vllezerve Gervalla dhe Kadri Zekes ka qen Vrasje Politike andaj esht për tu diskutuar taman ketu por dhe Autorin e Librit Ibrahim Kelmendi e Falenderoj qe ka shpreh Vullnetin dhe do gjen kohen ti përgjigjet qdo pytje dhe qdo njerit kur ketu dihet se te gjith diskutuesit jane anonim!!
grepi, dora vetë

profile mail www edit quote

**Marinsi**

**Anëtar që nga:** 21.02.2007
**Afishime:** 3

**Afishuar me:** 22.03.2007 21:15

Per shkakun se Z. Ibrahim Kelmendi, momentalisht pati disa paqartesi rreth hyrjes ne forum, per shkak se nuk e ka preferuar asnjehere nje diskutim te tille me nofka, une do ti afishoje pergjegjiet e tij. Ne pyetjet tjera, besoj se do t'u pergjigjet z. Kelmendi drejtpersedrejti.
Marinsi
Anëtar që nga: 21.02.2007
Afishime: 1
Afishuar me: 22.03.2007 14:16
Te nderuar lexues te ketij forumi
Autori i romanit "Atentatet", Z. Ibrahim Kelmendi, ka shfaqe gatishmerine t'u pergjigjet te gjitha pyetje te lexuesve te ketij forumi, lidhur me romanin "Atentatet". U lutem qe mundesisht pyetjet te jene te kjarta dhe pa fyerje. Z. Ibrahim Kelmendi eshte regjistruar ne forum me nofken "i.Kelmendi.
Kerkoj nga kujdestaret e ketij forumi qe ta vezhgojne kete teme dhe mos te lejojne fyerje te cilat debatin do ta zhvendosin ne nje kahje krejt tjeter!
Përgjigjet Ibrahim Kelmendi: Ju falendëroj për përkujdesin; Fyrjet e sharjet nuk më hidhërojnë, pasi e di që shajnë e fyejnë ata që janë të sharë e të fyer.
grepi
Anëtar që nga: 24.11.2004
Afishime: 3237
Vendbanimi: çabrat
Afishuar me: 22.03.2007 14:39
Librin "Atentati" te Ibrahim Kelmendi e lexova ne faqen http://www.pashtriku.org deri rreth faqes 370 sa me kujtohet por kisha pyetur z. Kelmendi se për qfar arsye se sqaron se ku jetoj me vone pas vrasjes se Vllezerve Gervalla dhe Kadri Zeka ky far "Rezili" ?? posaqerisht ku ka jetuar "Rezili" nga vitet 1982 dhe deri ne mbarim te Luftes se "Ushtris çlirimtare të Kosovës".
përshendes z. kelmendi për Librin dhe Kurajon qe ka marre ti jape fillin e zgjidhjes se rastit qe ne Historin e Ilegales esht njender rastetet me Enigm.

Përgjigjet Ibrahim Kelmendi:
Rezili ka vazhduar të jetoj në Shtutgart e rrethinë, ndoshta edhe diku tjetër. Nuk ia kam përcjellë lëvizjet dhe jetën e tij. As tani nuk e dij se ku jeton ai.
te fala
grepi, dora vetë

qeku11
Anëtar që nga: 05.03.2006
Afishime: 24
Afishuar me: 22.03.2007 14:43

pershendetje z. Kelmendi,
Sa te ka kushtuar botimi i kesaj libre?

Përgjigjet Ibrahim Kelmendi:
Libri mua më ka kushtuar vetëm energji. Shpënzimet e shtypit (3000 copë x 1,20 euro ) i ka paguar shtëpia botuese FOCUS. Mua më kanë mbajtur miqtë gjatë kohës që kam shkruar dhe ia kam botuar në faqe të fundit të romanit emrat e atyre që më kanë ndihmuar dhe shumën se sa më kanë dhënë.

Mok
Anëtar që nga: 21.10.2005

Afishime: 63
Afishuar me: 22.03.2007 14:58
Zoti kelmendi , a mendoni se keni me fituar diqka nga ky liber dhe sa keni planifikuar me fitu.

Përgjigjet Ibrahim Kelmendi: Me botimtë pare nuk kam fituar asgjë, pos respektit. Shtëpia botuese i ka shtypur 3.000 ekzemplarë, I ka shitur brënda dy javësh 2.200 copë nga 2,99 euro (bashk me gazetën FOCUS), mua në fund m'i ka dhënë 400 ekzemplarë (prej tyre 300 copë ua kam shpërndarë miqve. Tani i kam edhe 100 copë dhe kush është i interesuar, mund të porosit. Në Perëndim romani e ka çmimin 4,99 euro, ndërsa në Kosovë e kishte 2,99 euro.
Azem zogaj qe shet libra Para Grandit ne Prishtine me pat lan nje fjale kur e pyeta se si po shkon pazari?
Ai mu pergjigj keshtu:
Shyqyr zotit qe eshte kan Shaban Pluzha trim e luftar, Azem Bejta e Adem Jashari e Shum te tjere Trima se keta dhe kan Luftuar siq duhet e ma ne fund kan ra per LIRI, Ata kan Ra e tash shkrimtaret kush ma i pari turr e me shkrua Libra e Romana sa te duash , Fito ai e Fito Une qe po i shes. Kjo ishte puna e disa " Romansierve "

Përgjigjet Ibrahim Kelmendi: Z. Azem Zogaj ia kam dhënë 50 copë me çmim 2 euro libri. Atë e kam lutur të mos I shet më shtrejtë se 3 euro copën. Edhe 40 copa ua kam dhënë dy shitësve të hotel Grandi, me çmim gjithashtu 2 euro librin. Ndoshta po më kuptoni, se nuk e kam shkruar për të fituar me te, edhe pse nuk është e turpshme të jetosh nga shitja e librit.

<font class=editedby>[ Ky afishim u ndryshua nga: Mok më 2007-03-22 15:00 ]</font>

[ Ky afishim u ndryshua nga: Mok më 2007-03-22 15:01 ]

*DIELLI*
Anëtar që nga: 26.04.2004
Afishime: 91
Vendbanimi: buze kufirit
Afishuar me: 22.03.2007 17:40

Zoti Kelmendi,
pse ju nuk ndoqet rrugen e Jusufit dhe te Kadri Zekes dhe mbasi qe ju e dinit se kush ishte vrasesi perse nuk u ndermorr nje ofensive nga ana e juaj apo nga ana e Levizjes suaj, per te marre hak, pasi qe Jusufi dhe Kadriu konsideroheshin si shoke tuaj, te bindjes suaj politike te asaj kohe.
Adrian Krasniqi dhe nipi i juaj Qerimi do te kishin pasur mundesi te udhehiqnin ndonje aksion si ai i llojit te fshatit kliqine te pejes per te rivanzhuar vrasnje e Jusufit dhe Kadriut !

Përgjigjet Ibrahim Kelmendi:
Gjykuam se duhet të merremi e avancim të çështjes kombëtare dhe jo me hakmarrje. Në fakt, UDB-ja provonte që të na fuste në luftë hakmarrëse, pasi dëshironte të na kompromentonte në Perëndim. Hakmarrja më efektive kundër dorasëve dhe urdhërdhënësve është çlirimi i Kosovës, i cili do vonohej, sikur shqiptarët të vriteshin në mes tyre, për llogari të pushtuesit.
Sigurisht që kam qenë kundër vetë-gjyqësisë. Vrasësit i kanë hetuar dhe po i hetojnë strukturat përkatëse gjermane.
Qerim Kelmendin e kam vëlla dhe ai nuk lejon të shpërdorohet nga askush për qëllime hakmarrëse. Nuk ka pas dhe nuk nevojë të komprementoj nderin dhe përcaktimin e ushtarit dhe drjetuesit të UÇK-së.
[ Ky afishim u ndryshua nga: Marinsi më 2007-03-22 21:45 ]

profile | edit quote

**piloti**

**Anëtar që nga:** 22.02.2002
**Afishime:** 1439
**Vendbanimi:** Gjermani

**Afishuar me:** 22.03.2007 21:40

Z.Marinsi
Me falni por kjo menyr e pyetjeve dhe pergjegjeve po meduket vertet një kaos apo pështjellim , nuk po dihet as pyetja e ass pergjegja , te lutem organizo pak me mirë , shkruaj me kjart , ndoshta edhe moderatoret mund te ndihmoin ketu, me nderime
piloti

profile | edit quote

**kreksi**

**Anëtar që nga:** 28.02.2005
**Afishime:** 471
**Vendbanimi:** Francë

**Afishuar me:** 22.03.2007 21:44

Pershendetje Ibrahim Kelmendi,
Posa fillova te lexojë faqen e parë te librit tuaje dhe menjehere u kyça ne ngjarje. keni dhene nje pershkrim te bukur qe ne hyrje me nje stil te pakopjushem ne literaturen shqiptare.
Por besoje se ndoshta edhe ju ka shkuar mendja edhe juve per nje vazhdim, pjesen e dytë, çlirimin e kosovës...
Apo më shkurtimisht, nje ngjajshmeri si tek " I teti në bronz" pse jo ?
Vetëm një gabim gjeta, por qe ky është aqë i vogël qe as qe vrehet nga te gjithe, e sidomos per lexuesin tonë e nese vjen tek ribotimi i dytë, e kjo do vie me siguri, ju kisha lutur qe ti thuani pergjegjesit te shtypshkronjës apo botuesi ështe dashur te permisoje kete gabim te vocërr....qe pikë-çuditësja të vëhet vetem edhe një shkallë me tejë, e jo menjehere aty pas germes, si pershembull; çohuni ! = vehet keshtu e jo, çohuni!....
Pra ketu nuk ështe faji i juaj por i shtypshkronjes, ama per botimin e dytë mos e lesho nje gabim të tillë ju lutem....
Nejse, kendej ne ka franca perfeksionimin e kemi si ligj....mos ma shif per te madhe, megjithese edhe njihemi.
Posa te perfundoje romanin tuje me siguri se do te komentoje kete veper sipas mbrresave, si dikur qe benim referate...
Edhe njehere ju pergezoje per kete veper dhe guximin qe keni ndermarrur qe t'ia hapni trurin tujë botes shqiptare, e kjo nuke eshte aspake e lehtë, duhet me te vertete të jesh i ¨matur per nje vendim të tille e qe vetem me njerzit e tille mund te shkohet perpara.
Urime !
Ju pershendes perzemersishtë
kreksi

profile | edit quote

**gjarperi**

**Anëtar që nga:** 27.11.2005
**Afishime:** 526

**Afishuar me:** 23.03.2007 11:28

Te pershendes zotri Ibrahim Kelmendi dhe te uroj per librin, nje liber i cili do te hap rrugen e nje te vertete per vrasjene e Jusufit, Kadris dhe Bardhoshit, por do ti hape rrugen edhe shume librave tjera, te atyre qe pajtohen dhe qe nuk pajtohen me konstatimin tand lidhur me kete atentat, dhe njeherit te pergezoj qe e ke bare te mundshem kontaktin ne mes keti forumi per pytjet dhe zugjerimet eventuale lidhur me librin, por duhet qe te jeni te fort, te perballini me te gjitha pytjet me vend dhe pa vend qe do ti parashtrojn afishuesit. une sa per fillim do te kisha pytur se a ka mundesi te blej librin ne suedi, sepse po me duket larg deri sa te shkoj ne Kosove gjate pushimit.
Pershendetje i Nderuar
Ibrahim Kelmendi

profile | edit | quote

**Ministri**

**Anëtar që nga:** 20.09.2005
**Afishime:** 264

**Afishuar me:** 23.03.2007 11:49

Cka ju ka lidhe me mergaten KROATE?????????????? Dhe per cfar financoheshi nga kjo Mergate?

profile | edit | quote

**kreksi**

**Anëtar që nga:** 28.02.2005
**Afishime:** 471
**Vendbanimi:** Francë

**Afishuar me:** 23.03.2007 11:53

Edhe nje kerkese e kam nga moderatoret.
Per hire te librit, kjo tem eshte dashur te bartet tek arti dhe literatura, me duket si me e drejte nese deshirojmi te behemi me te kulturuar dhe me te civilizuar edhepse ky roman eshte i zhanrit politikë...
[ Ky afishim u ndryshua nga: kreksi më 2007-03-23 11:55 ]

profile | edit | quote

**Qosi**

**Anëtar që nga:** 22.02.2007
**Afishime:** 29

**Afishuar me:** 23.03.2007 12:08

I nderuari z.Kelmendi ne ate kohe kure u be atentat ne vllezrit Gervalla ae dini ju se kush ishin nga shqiptaret qe ne ate kohe mbanin poste te larta ne ambasaden e ish Jugosllavis.
Jame i sigurt se ju e dini nese jo mund te ju tregoj e njeri nga ta ishte i perfshir direkt apo indirekt ne likuidimin e vllezerve Gervall.Qosi ju pershendet dhe ju deshiron sukse.

profile | edit | quote

**cercizi**

**Anëtar që nga:** 23.02.2004
**Afishime:** 237
**Vendbanimi:** rrez lumenjeve!

**Afishuar me:** 23.03.2007 13:15

Quote:

> Qosi afishoj me 2007-03-23 12:08 :
> I nderuari z.Kelmendi ne ate kohe kure u be atentat ne vllezrit Gervalla ae dini ju se kush ishin nga shqiptaret qe ne ate kohe mbanin poste te larta ne ambasaden e ish Jugosllavis.
> Jame i sigurt se ju e dini nese jo mund te ju tregoj e njeri nga ta ishte i perfshir direkt apo indirekt ne likuidimin e vllezerve Gervall.Qosi ju pershendet dhe ju deshiron sukse.

_
Qosi,futja drejt kush asht kon Ymer kllokoqi(edhe pse F.T e livdon) edhe kush apo t´kujtohet mos e harro buxhovin_

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 15:29

Përgjigje pseudonimit D:
Nuk kam arsye të jem subjetiv kur kam ngritur dyshimin e bazuar ndaj Rezilit. Në roman sqarohet edhe përcaktimi i krye-hetuesi gjerman, pavarësisht se ligji gjerman ia pamundësonte ta dëshmonte bindjen e tij. Procesi gjyqësor kundër Rezilit ka qenë maratonik dhe ai aty paraqiste ateste mjekësore, se është i sëmurë psiqik. Në atë proces gjyqësor në Gjermani kam qenë si dëshmitar kundër Rezilit.
Insinuatën që ngitni, për të barazuar dyshimin tim me dyshimin e

tjerëve, e beni sa për të bërë barazime të kota. Këtë dyshim të dytë e sajuat Ju dhe nuk e kishte sajuar askush deri tani.
Mirë që po diskutohet edhe këtu, por sikur të dekonsipronit veten, do kishte më shumë peshë. Megjithatë, ju falënderoj që keni shfaqur edhe këso mendimesh.

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 15:38

Pseudonimi "Ministri" pyet për lidhjet e mia me emigracionin kroat. Që ta marrë përgjigjen e plotë, nëse është i interesuar dhe nëse ka kohë, do duhej ta lexonte romanin. E kam quajtur me interes që të bashkpunoj me atë emigracion të nderuar. Financim personal nga ai nuk kam pasur asnjëherë.

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 15:47

"Qosi" pyet nëse di kush ka punuar atëherë në Ambasadën jugosllave. Përgjigje: Në atë kohë sekretar i parë (krye-udbash) në ambasadë ka qenë Z. Shefqet Hashani, për mendimin tim një person që respektonte ligjet përkatëse. Më vonë e arrestuan dhe e denuan më shumë vite burg. Duhet të ketë pas edhe të tjerë UDB-ashë në konsullatat jugosllave, pasi të tilla kishte shumë në Gjermani, por nuk i di. Në konsullatën e Stuttgart duhet të ketë qenë Bashkim Hisari, por nuk e dij çfarë funksioni ka ushtruar.

profile | edit quote

**Nositi**
**Administrator**



**Anëtar që nga:** 14.01.2004
**Afishime:** 1683
**Vendbanimi:** Anës liqenit

**Afishuar me:** 23.03.2007 15:48

**Pershendetje i nderuar z.Ibrahim Kelmendi,**

*Ne emer te Stafi te Kosova.de iu deshirojme mireseardhje ne Forumin tone te diskutimeve dhe njeheresh iu falenderojme per gatishmerine tuaj qe te perballeni drejperdrejt me interesimet e bashkediskutuesve ne kete teme tejet te ndjeshme!*
*Kete gatishmeri tuajen e konsiderojme edhe si nje privilegj per Kosova.de, qe shkon ne favor te zhvillimit sa me te drejtperdrejt te debatit brenda komunitetit tone virtual!*
*Po ashtu shpresoj se edhe te gjithe forumistet qe inkuadrohen ne kete teme me pyetjet e tyre do t`iu jene mirenjohes, maksimalisht te pergjegjshem dhe do te kene konsiderate kundruall rastit te rralle qe iu keni ofruar si autor i librit "Atentatet"!*
*Te pergezoj per librin dhe uroj te kaloni çaste te kendshme ne Kosova.de!*
*me shume respekt,*
*Nositi*
[ Ky afishim u ndryshua nga: Nositi më 2007-03-23 15:49 ]

profile mail | edit quote

**grepi**

**Anëtar që nga:** 24.11.2004
**Afishime:** 3916
**Vendbanimi:** çabrat

**Afishuar me:** 23.03.2007 16:07

z. Kelmendi
po ju përshendes për ardhjen ne Forumin Kosova de dhe pjesmarrjen e juaj direkte ne kete teme!
Pyetjen qe kam bere me heret me duket se Përgjigjia e juaj esht nje qike e manget pasi mendoj se thot shume te dihet si ka vepruar me tutje "Rezili"

dhe ku ka jetuar !!
une pajtohem deri duku me përgjigjen e juaj se su ka interesuar me tutje se ku jeton ky njeri dhe me qfar merret, por spo me knaq ky veprim i juaji apo dhe përgjigjia e juaj!!
pastaj do te kisha pyetur edhe për Naten e Vrasjes se Vllezerve Gervalla dhe Kadri Zekes!
a mendon se UDB- te ka falur pa te vrar ne ate Kohe vetem qe te lere ne Mjegull kete "Vrasje" apo skan gjetur rast me te mire dhe kan vrar vetem Vllezrit Gervall dhe Kadriun kurse ty te kan lene qe ne te ardhmen te veprohet po qe nevoja!!
Faleminderit z. Kelmendi
grepi, dora vetë

profile mail www | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 16:08

Të nderuar anëtarë të Forumit,
jam duke i mirëpritur pyetjet, mendimet dhe vlerësimet Tuaja (mund të zbrazen edhe ata që dëshirojnë të shajnë e fyejnë, pasi ua lehtëson stresin dhe urrejtjen, duke bërë një hap të madh drejt qytetrimit).
Mos ngurroni, asnjë pyetje nuk është e keqe dhe provokative. Secila në vete përmban sqarime, që janë të mirëseardhura.
Do përpiqem të ju përgjigjem të gjithave/
Nëse ndonjëri/ndonjëra dëshiron komunikim më të zgjeruar rreth romanit ATENTATET, mund të më shkruajnë edhe në mail-adresën time: ibrahim_kelmendi@yahoo. de
Shëndet dhe suksese në punë të mbara të gjithëve, sidomos Stafit të administratorëve, që na kanë mundësuar këtë komunikim.
Mbarësi në jetë e respekt
Ibrahim Kelmendi

profile | edit quote

**prishtinasi-pp**

**Anëtar që nga:** 20.07.2005
**Afishime:** 2222
**Vendbanimi:** Ne LUX me DARDANET .

**Afishuar me:** 23.03.2007 16:14

1 Pytje
Ti thua se i ke pas shok edhe keni punuar per 1 Ideal bashk me Jusufin e tjeret ateher po te Pys
Pse nuk ke marre Hak kur e ke dit se Cili esht Vrasi i Tyre , qe me ju tregu krejt atyne tjereve qe qishtu i pret Pushka te gjithe qe Tradhtojn Kombin apo Shpirti i Emel Babes

profile www add aim | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 16:46

I. Kelmendi / Përgjigje:
"Cercizi" dhe "Qosi" po përqëndrohen te shqiptarët që kanë qenë të punësuar në përfaqësit "diplpmatike" të ish-RSFJ-së.
Atë farë Ymerin nuk e mbaj mend.
Z. Jusuf Buxhovi ka qenë zyrtarisht korrespondent i gazetës "Rilindja".
Në vitet 1978-1982 kanë ndodhur ca konfrontime në me të Klubit famëmadh "Emin Duraku" në Dyzeldorf dhe Z. Buxhovi. Më vonë Z. Hysen Gega e ka bërë publika, se Z. Buxhovi e ka marrë në pyetje në burgun e Prizrenit.
Po shpresoj se ndërgjegjja e tij intelektuale do e nxis që Z. Buxhovi, përndryshe një shkrimtar i zellshëm, njëherit edhe një analist i mirë i politikës ndërkombëtare, do flet për të kaluarën e tij, sidomos për rrolin e tij si nismetar i parë për të themeluar LDK-në...

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 17:00

I dashur "prishtinasi-pp",

E para: është dashur të pritën hetimet e organeve përkatëse në Gjermani, se kush janë atentatoret.
E dyta: Kam qenë kundër hakmarrjeve dhe vrasjeve, pasi në Perëndim do na etiketonin si terroristë dhe kjo do na pengonte që të vinim deri të Lufta Çlirimtare dhe përkrahja nga Perëndimi.
E treta: Përse do duhej ta përvetësoja rastin, sikur do duhej pikërisht unë të merrja hak; kjo do ishte shkurtpamësi politike dhe vetë-gjyqësi primitive, e cila duhet me çdo kusht e terësisht të menjanohet nga kodi ynë i mirësjelljes dhe i qytetrimit.
E katërta: Shpirtin njeriut mund t'ia marrë vetëm Zoti. Kurse denimin për krim të bërë e shqipton vetëm gjykata kopetente.
E pesta: Rruga që patëm zgjedh - themelimi dhe përgatitja e Forcës Çlirimtare, UÇK-së, ka qenë hakmarrja më e mirë politike kundër padronëve të Rezilit: UDB-së serbe.
E kam thënë edhe njëherë: Mua më dhimbset edhe Rezili, nëse nuk ka mundur të përballoj komandimin e UDB-së.
I. Kelmendi

profile | edit | quote

**Grasha_1**

**Anëtar që nga:** 14.01.2006
**Afishime:** 3734
**Vendbanimi:** Gjermani

**Afishuar me:** 23.03.2007 17:42

Zoteri edhe une e kam nje pyetje.
Nese ai far Rezili eshte gjalle.!!!!
A frigohesh qe vjen te dera e jote, edhe ta shkrep nje rafall 9 copa fishek ne goje.
Kjo ishte pyetja ime.

profile | edit | quote

**Qosi**

**Anëtar që nga:** 22.02.2007
**Afishime:** 29

**Afishuar me:** 23.03.2007 17:49

I nderuari z.Kelmendi ju falenderoj ne pergjigjejen tuaj sa i perkete z.Hashanit per te gjithnji kame patur respekt.
Kurse ju e permendet edhe Ymerin pra ky ishte Ymer Abazoviqi ish UDB-sh ne kohen kure u likuiduan herojte-vllezrit Gervalla.
Ky person erdhi ne Gjermani dhe qendroi afer kater vite nese jam i sigurt me dekretin e UDB-se dhe KOS-it te asaje kohe ky ishte puntor i sigurimit shtetror ne Prishtin dhe me vone kryeshef i policis rrugore te Kosoves.
Ky ishte me pune ne ate kohe ne ambasaden e Jugosllavis ne Shtutgard Por ne te njejten kohe ne konsullaten e shtutgartit ishte edhe nji nga komuna e Klines pra ky ishte M.Rraci nuke e di sa keni qene te njoftuar per kete person.
Sa i perkete z.Rracit kete e njof si njeri shume te mire edhe pse per punen dhe veprimin e tina ne konsullaten e ish Jugosllavis nuke kame shum te dhena, pasi ju e botuat kete liber me duhet te kontaktoj pa tjeter me kete persone.
Librin tuaj e kame ble para Hotel Grandit pra dihet te Azem Zogaj ish udheheqes ne qendren e studenteve ne Prishtine. Tani biznismen i shite blerjes se librave dhe jame duke e lexuar shume me vemendje te perqendruar.
Ju pergezoj per kete liber dhe ju deshiroj shendet dhe sukses:Qosi me

mjekerr te zeze.

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 17:51

I nderuar "Grasha_1",
kur kam filluar të merrem me veprimtari të organizuar çlirimtare, e kisha parasysh edhe këtë. Atëherë pata guxuar të ngritem kundër Beogradit pushtues, edhe pse dihet se çfarë mekanizmash kriminel ka pas dhe si i ka përdor. Por nuk jam frikësuar.
Fatmirësisht / fatkeqësisht, e kam mbijetuar Luftën Çlirimtare dhe kemi dal të fituar. Këtë copë të jetës e kisha dhuratë dhe prandaj nuk behem merak nëse Rezili ose ndokush tjetër interesohet...
Tung

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 17:57

I nderuar "Qosi".
Z. Rraci ka qenë nepunës në konsullatën e RSFJ-së në Dyzeldorf.
Për një Ymer kam dëgjuar, por ai duhet të ketë qenë në konsullatë të RSFJ-së në Hamburg. Ai e ka pasur mbiemrin Kuçi. I njëjti ka qenë edhe shef i komunikacionit në PR.
Tung

profile | edit quote

**Qosi**

**Anëtar që nga:** 22.02.2007
**Afishime:** 29

**Afishuar me:** 23.03.2007 18:06

Quote:

cercizi afishoj me 2007-03-23 13:15 :

Quote:

Qosi afishoj me 2007-03-23 12:08 :
I nderuari z.Kelmendi ne ate kohe kure u be atentat ne vllezrit Gervalla ae dini ju se kush ishin nga shqiptaret qe ne ate kohe mbanin poste te larta ne ambasaden e ish Jugosllavis.
Jame i sigurt se ju e dini nese jo mund te ju tregoj e njeri nga ta ishte i perfshir direkt apo indirekt ne likuidimin e vllezerve Gervall.Qosi ju pershendet dhe ju deshiron sukse.

---

Qosi,futja drejt kush asht kon Ymer kllokoqi(edhe pse F.T e livdon) edhe kush apo t´kujtohet mos e harro buxhovin_

////////////////////////////////////////////////////////////

Z.Qerqizi mose po mendon per Ibush Kllokoqin ky e ka la hanin qysh moti po ende na kane mete disa Kllokoqa e besa po na sillen shlirshum neper

Kosov, e disa gjenden jashte ne diaspor.
Ibush Kllokoqi eshte likuidu nga marimangat e zeza si dhe Selim Broshi e disa tjer mose ti kujtoj ma mire.Qerqiz ju pershendes Qosi me mjekerr aty ktu te zbardhur.

profile | edit quote

**Qosi**

**Anëtar që nga:** 22.02.2007
**Afishime:** 29

**Afishuar me:** 23.03.2007 18:25

Quote:

I_Kelmendi afishoj me 2007-03-23 17:57 :
I nderuar "Qosi".
Z. Rraci ka qenë nepunës në konsullatën e RSFJ-së në Dyzeldorf.
Për një Ymer kam dëgjuar, por ai duhet të ketë qenë në konsullatë të RSFJ-së në Hamburg. Ai e ka pasur mbiemrin Kuçi.
I njëjti ka qenë edhe shef i komunikacionit në PR.
Tung

/////////////////////////////////////////////////////////////////////

Zoti Kelmendi edhe ju e keni ngatrru njejte si z.Qerqizi Ymer Kuqi ska qene me pune ne asnji konzullat ne Gjermani ai nji kohe ishte polic i thjesht pastaj ube polic rrugor e dikur diplomoi ne fak.juridik dhe i fitoj qinat dhe ube shef i policis rrugore ne Prishtin.
Magjun Rraci e vertet se paska qene ne Dyselldorf. Krejt tjeter eshte Ymer Abazoviqi.
Ymer Kuqi, Ibrahim Kuqi,Gjavit Kuqi kta ishin antar te afert te nji familje te trete kane qene polic te rrugve-ivetmi qe u avansu dhe kaloj ne sherbimin e UDB-se esht Gjavit Kuqi ky ka maltretu ne mnyra ma qnjerzore shum shqiptar gjat viteve 89,90.
Kta jane nga nji fshat afer Deqanit fshati eshte i njohur per te gjithe.
Ju pershendes dhe kalofshi mire.
Mire u ndegjifshim z Kelmendi kalofshi mire -ne ju njofim mire dhe kemi respekt.
Qosi po fillon punen e ju kalofshi mire te gjith.

profile | edit quote

**D**

**Anëtar që nga:** 27.04.2002
**Afishime:** 1253

**Afishuar me:** 23.03.2007 19:07

Quote:
I_Kelmendi afishoj me 2007-03-23 15:29 : Përgjigje pseudonimit D: Nuk kam arsye të jem subjetiv kur kam ngritur dyshimin e bazuar ndaj Rezilit. Në roman sqarohet edhe përcaktimi i kryehetuesi gjerman, pavarësisht se ligji gjerman ia pamundësonte ta dëshmonte bindjen e tij. Procesi gjyqësor kundër Rezilit ka qenë maratonik dhe ai aty paraqiste ateste mjekësore, se është i sëmurë psiqik. Në atë proces gjyqësor në Gjermani kam qenë si dëshmitar kundër Rezilit. Insinuatën që ngitni, për të barazuar dyshimin tim me dyshimin e tjerëve, e beni sa për të bërë barazime të kota. Këtë dyshim të dytë e sajuat Ju dhe nuk e kishte sajuar askush deri tani. Mirë që po diskutohet edhe këtu, por sikur të dekonsipronit veten, do kishte më shumë peshë. Megjithatë, ju falënderoj që keni shfaqur edhe këso mendimesh.
======================

Z. I. Kelmendi
Sikur harroni se edhe mshefja e krimit është vepër penale !! Ju me vetëdije apo pa vetëdije e penalizoni veten tuaj !!
Ju keni pas shanc kur është burgos Riza Salihu të depononi dëshmin tuaj

- jo tash pas 25- vjetësh !! (po të ishte ashtu si thua se ke qenë dëshmitar në procesin kundër Rezilit - Rezili do të dënohej dhe publiku gjerman dhe shqiptar do ta dinte dëshmin tuaj) atastet për smudje psiqike nuk e lirojn njeriun nga përgjegjsia penale, nëse ka fakte se ka bërë krimin - jo vetëm në Gjermani po askund në botë.
Publiku shqiptar nuk ka ditur për dëshmin tuaj !! nuk di pse nuk ka pas mundsi ta dij ??!!
çdo ligj në botë e dënon edhe mshefjen dhe mos denoncimin e krimit !!
Sa për dekonsipirim apo konspirim tim, shumica e dijn kush shkruan me pseudonimin "D" - edhe mundet ai Torbeshi që po ta reklamon librin me të tregue kush është "D"-ja.
është në natyrën e Forumit të shkruhet me nofka-pseudonime.

profile aim edit quote

**tarasi**

**Afishuar me:** 23.03.2007 19:20

**Anëtar që nga:** 06.01.2006
**Afishime:** 1806

Zoti Kelmendi
Të flasësh për librin në një forum të tillë është e vështirë ngaqë shpeshë herë ka vështirësi së lexuari ndër rreshta dhe nga kjo krijohen mos-marrëveshje.
Kur autori bë një libër, ai libri pra, për të bëhet si të jetë fëmija i tij. Në faktë ai edhe është i tillë ngaqë autori është ai që i ka dhënë jetë, frymë dhe shpirtë.
Për vlerat artistike të librit kisha për të thënë mjaftë sidomos për ndërtimin e saj, përmbajtjen dhe formen, gjuhën e përdorur ( më tha i thashë), idenë pastaj rreth subjektit, Ekspozicionit të veprës, zhvillimin e veprimit; sikurse për atë se ku e vënë si Kulminacion të zhvillimeve së bashku me zgjidhjen e veprimit që ju se bëni dot.
Por, ti kritikosh një Prindi fëmijën nuk është mirë ngaqë ai nuk ndjehet mirë pastaj.
Sikur ju ta kishit konceptuar librin si Historiko - Dokumentar do të kishte vlerë shumë të madhe. Kur beni një roman duhet ta keni parasysh që; " zhvilloni ngjarjen me emertime të personazheve që me asgjë nuk ju përshtaten karaktereve reale të kohës që do të thotë; gjithësecili mundë ta gjejë veten e tij aty mbrenda.
Në librin tuajë nuk e gjenë veten gjithësecili përpos ata ( nuk është vështirë që të identifikohet se cilët janë) të cilët i ke apostrofuar...
Tashti, nëse ju do të ishit dakordë, jam i gatshëm për një debat në të gjitha temat e mundëshme ani pse edhe komunikimi i tillë nuk po më duket fare si i sinçertë.
Jo nga ana e juaj por nga ana e jonë ngaqë ne jemi vetëm nofka.
Nëse je për debat më thoni por për një debat online dhe jo shtrim të Pyeetjeve dhe temave sot dhe pritë përgjigjen gjerë sa të bëhet vjelja e rrushit në Vjeshtë!
Titulli nuk i shkonë fare veprës!
Nëse Ju jeni për debat të hapur jam edhe unë; nëse e preferoni nëpërmjet postës elektronike do ta bëjmë edhe këtë gjë.
Mospajtimet janë njerzore apo jo zoti Kelmendi?
p.s.
Se deshë harrova: boll i " praptë je"!

[ Ky afishim u ndryshua nga: tarasi më 2007-03-23 19:23 ]

profile edit quote

**I_Kelmendi**

**Afishuar me:** 23.03.2007 19:46

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

I nderuar "D",
unë nuk e kam fshehur krimin, por kam deshmuar në gjykimin e Rezilit në Gjermani, ndaj të cilit janë bërë dy gjykime dhe po vazhdon të jetë nën hetime. Edhe ata që është dashur ta dinë, i kam informuar me kohë.

Më vjen keq që nuk keni qenë edhe Ju në mesin e atyre që është dashur ta dinë.
Shëndet e suksese!

profile | edit | quote

**global_info**

**Anëtar që nga:** 21.06.2006
**Afishime:** 37
**Vendbanimi:** Aty ku kam LINDUR

**Afishuar me:** 23.03.2007 19:48

Autorin e kam` pas idoll edhe para botimit te romanit "atentatet" tani edhe me shume kame rrespekt per te. E kame takuar vetem dy-her` gjate jetes time! njeher n`Tirane, pastaj n`Prishtine.
Une nuk dua te shtoj gje tjeter, pos te them se; me nxjerrjen e romanit "atentatet" per shqipetaret je bere nje "DAN BROWN" shqipetarë !
Pritni, ju lutem, Zoti Kelmendi, te falat e mia me nderime.

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 19:50

Edhe një herë për D-në:
Nuk kam ndonjë interesim të posaqem të di identitetin Tuaj dhe nuk do pyes njeri për Ju. Po dëshiruar vetë, tregoni se cili jeni, meqë bashkëbisedimi duket me serioz. Po kuptohet, vetëm nëse nihemi, përndryshe nuk më duhet fare identiti Juaj.
Tung

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 20:08

Shumë i nderuar "tarasi",
ju falënderoj për vlerësimet. Thënë të drejtën, unë nuk kam pas pretendime të bëjë vepër letrare të nivelit që pretendoni Ju. Jam përcaktuar për këtë variant të parqitjes se ngjarjeve, me shpresë se do mund të demitizojë veprimtarinë e secilit personazh, të përshkruaj paraqes veprimtarinë me të mirat dhe të metat e saj...
Sa i përketë emërtimit, unë kam parasysh se kanë ndodhur tre antetate ndaj tre personaliteteve, tashmë historike. Pastaj kanë veprimtarisë se atëhershme patriotike i kanë ndodhur një mori atentatesh dhe rilindja e Organëzatës që patën formuar Jusufi, Kaddriu, Bardhoshi e Mirani qe vërtetë e vështirë, me sakrifica të mëdha dhe me atentate të rënda shpirtërore.
Fundja, autori e ka këtë të drejtë.
Do mirëpres vlerësimin Tuaj profesional, nëse keni kohë e dëshirë për ta bërë. Dhe atë e mirëpres, qoftë këtu, qoftë në mail-adresën time.
Edhe pse kam bërë studime në germanistikë, më beso i kam harruar gjerat teorike, pasi që nga 1981 ju pata përkushtuar me mish e shpirt, siç i thonë një fjale, vetëm veprimtarisë patriotike çlirimtare. Dhe ai angazhim, fatmirësisht, nuk më ka shkuar huç, pavarësisht se disa kanë sa të duash kritika dhe armiqësi ndaj angazhimit tim.
Ju uroj mbarësi!

profile | edit | quote

**Kruja**

**Anëtar që nga:** 12.03.2004
**Afishime:** 1932

**Afishuar me:** 23.03.2007 20:16

z. Kelmendi,
Cila ka qene vija politike e levizjes ku ju kini marre pjese ne raport me Tiranen zyrtare te asaj kohe [e kam fjalen per kohen e Enver Hoxhes]?
Se dyti, ju si person, c'fare mendoni se do te kishit bere ndryshe nese do te ktheheshit perseri prapa ne kohe?
----
Kruja.

profile | edit | quote

**tarasi**

**Anëtar që nga:** 06.01.2006
**Afishime:** 1806

**Afishuar me:** 23.03.2007 20:24

I nderuari Ibrahim
Unë ju njohë ju mjaftë mirë sikurse edhe familjen tuaj për mua shumë të nderuar.
Kur fola për librin më herët e pata parasysh faktin që, SIKUR TË KISHIT HYRË ME SHUMË NË ZBËRTHIMIN E KARAKTERËVE TË PERSONAZHEVE ( dhe mundesisht ikjes së emertimeve siç i keni bërë) dhe herë herë ngjerjet të zhvendoseshin nga dialogu në stilin narrativ do të bëhej një libër për merak. Ani pse edhe ashtu libri është shumë interesant për ta lexuar.
Një analiz do t'ja bëjë librit gjithësesi dhe do t'ua dergojë me postë.
Unë po ta themë troq; as edhe një herë s'kam dyshuar në figurën tuaj ani pse herën e fundit jemi takuar mu te varezat e Shtutgartit, me rastin e përcjelljës së eshtrave të vëllezërve gërvalla dhe të Kadri Zekës.
sa i përket apostrofimeve që u keni bërë disa figurave të organizuara si Xhafer Durmishit, sabri Novosellës... s'do të themë asgjë ngaqë s'jam avokat i tyre kështu që po deshën le të reagojnë vet.
Kjo është ajo që themë unë; sikur të kishit bërë emertimin e personazheve pak më ndryshe- shumë veta do ta gjenin vet-veten.
Shpresoj që me këtë, së paku i keni detyruar edhe të tjerët, që të flasin.
Kujtojmë që nuk ishte vetëm vrasja e Untengrupahit enigmatike.mendja më thotë që tano do të bënin mirë që të flasin që të gjthë ata që dijnë diçka më shumë për vrasjet e Rexhep Malës dhe NUhi berishës.
Ajo që oficeri ka udhëhequr ekspediten ndeshkuese dihet që ka qenë Tahir Zema por shtrohet pyetja; cili ishte informatori?
Po ashtu në Rrethimin e Afrim Zhitisë dhe të Fahri fazliut kanë marrë pjesë polic shqiptarë, bile- bile me sa e di unë ekspeditës së njësis speciale i ka prirë vet Nuredin Ibishi më vonë Komandant Leka. tashti këta nuk kanë marrë pjesë në atë kordonin e parë por megjithatë më thotë mendja që për opinionin do të bënin mirë sikur të tregonin burim e informatës!
Në mos për asgjë tjetër për të shpërlarë ndegjegjen e tyre!
sa për librin " Atentatet" e lexova me ta thënë të drejtën me një frymë megjithëse shumicën nga ngjarjet dhe përshkrimet veq i kisha të njohura!
Libri është më shumë i zhvilluar në formë dialogjesh dhe pse jo; mundesia e bërjes Film...
Por jë analiz më të thellë do ta bëjë më vonë dhe do t'ua dergojë me postë.
besoj që do ta mirëpritni këtë gjë ngaqë Ju me siguri do të shkruani pjesen e dytë që për sa u përket nderskamcave iq s'ka qenë më pak interesante se ajo e para...
Përshendetje nga unë tarasi.

profile | edit | quote

**Shqipëruesi**

**Anëtar që nga:** 08.08.2004
**Afishime:** 556
**Vendbanimi:** Prishtinë

**Afishuar me:** 23.03.2007 20:29

Zoti Kelmendi,
Më vjen mirë (të ju them të drejtën u befasova për të mirë) që pranuat të flisni edhe këtu ,në forumin tonë. Me Tarasin,shpresoj të keni raste të tjera dhe biseda më të detajuara ngaqë shihet se keni bërë një rrugë identike dhe i përkisni të së njejtës lëvizje...
E di që kjo nuk ka të bëjë me romanin tuaj dhe bashkë me te edhe me temën,por ka të bëjë me ju,me figurën tuaj, prandaj unë do të kisha qenë shumë i lumtur sikur ju të kishit bërë ca shpjegime për mua dhe për forumistët tjerë (ngaqë jam i bindur se edhe për ata do të ishte me shumë interes) për dy gjëra,që janë:

Fondi "Vendlindja Thërret" , cili ishte roli juaj në keqpërdorimet eventuale të fondit?
dhe e dyta,
Cili ishte roli juaj në "ngjarjet e vitit të mbrapsht në Shqipëri ,në vitin 1997 ?
Pres përgjigjen tuaj të sinqertë.
Njëherit,ju përshëndes dhe ju falenderoj paraprakisht.
Shqipëruesi

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Afishuar me:** 23.03.2007 20:29

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

I nderuar "Qosi",
të falenderoj për ca sqarime, pasi është bërë kohë e gjatë dhe ndonjëherë nuk më rikujtohen personat, pa më ndihmuar ndokush.
Sa i përketë Ymer Abazoviqit, duhet të ketë qenë në Hamburg, ndoshta edhe involvuar në një krim të rëndë. Një bashkëveprimtar nga Tetova (Ramazani), pat vrarë në vetëmbrojtje dy veta nga Rrethi i Kamenicës. Kjo ngjarje e rëndë pat ndodhë para Klubit shqiptar "Ibe Palikuqi" në Hamburg. Pas ngjarjes pata mbajtur një konferncë shtypi në Hamburg, duke paraqitur edhe me shkrim rrjedhjen e saj. Vetë prokurori ka asistuar në konferncë shtypi dhe pastaj më ka sygjeruar: "Nëse rrefimi Juaj është i vërtetë, ndërprene aksionin për të grumbulluar ndihma për advokatë të Ramazanit. Më duhen 4-5 javë që të verifikoj dy-tre pika nga rrefimi Juaj, pastaj do lirohet Ramazani..." Vërtetë ashtu ndodhi. Dy viktimat u identifikuan si të nxitur nga ai farë Ymeri, i cili sa po ndodhi tragjedia, u arratis nga Gjermania. Emri i tij qe lakuar nga hetuesia dhe mediat gjermane...
Edhe polici Ymer Kuçi ka qenë në Hamburg, i kamufluar si mësues...
Kusheritë Kuçi janë nga Fshat Millovanc (ngjitur me Grozhdevcin e Poqestën), rreth 8 km larg Pejës.
Tung

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Afishuar me:** 23.03.2007 20:39

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

Zoti "taras",
e mirëpres vlerësimin Tuaj dhe besoj tani e dini mail-adresën time.
Vërtetë do të ishte e ndershme të rrefejnë gjithëcili për ato që dinë, pasi do ndihmonte "katarsisin" ("shpërlarjen e shpirtit), e sidomos do ishte e ndërshme dhe çmueshme të informonin ata që komanduar përndjekjen e vrasjen e veprimtarëve patriot.
Kam lutur disa ish-UDBashë për intervista, por e kanë thënë sinqerisht, se akoma i frikësohen Serbisë.
Po shpresoj se pas pavarësimit të Kosovës, të njohur ndërkombëtarisht, edhe UDBashët do marrin guximin që të rrefejnë për bëmat e atyre strukturave, meqë atëherë do mund t'i mbrojmë nga hakmarrja serbe.
Miqësisht
Ibrahimi

profile | edit quote

**tarasi**

**Afishuar me:** 23.03.2007 20:46

**Anëtar që nga:** 06.01.2006
**Afishime:** 1806

> Quote:
>
> I_Kelmendi afishoj me 2007-03-23 20:39 :
> Zoti "taras",
> e mirëpres vlerësimin Tuaj dhe besoj tani e dini mail-adresën

time.
Vërtetë do të ishte e ndershme të rrefejnë gjithëcili për ato që dinë, pasi do ndihmonte "katarsisin" ("shpërlarjen e shpirtit), e sidomos do ishte e ndërshme dhe çmueshme të informonin ata që komanduar përndjekjen e vrasjen e veprimtarëve patriot.
Kam lutur disa ish-UDBashë për intervista, por e kanë thënë sinqerisht, se akoma i frikësohen Serbisë.
Po shpresoj se pas pavarësimit të Kosovës, të njohur ndërkombëtarisht, edhe UDBashët do marrin guximin që të rrefejnë për bëmat e atyre strukturave, meqë atëherë do mund t'i mbrojmë nga hakmarrja serbe.
Miqësisht
Ibrahimi

---

I nderuari Ibrahim
Unë do të tërhiqem nga debati ngaqë e vërejë që është kërkesa e forumistëve të tjerë; natyrisht që do ta bëjë një recenzion të " vogël " për librin dhe do t'ua dërgojë...
Për forumistët e tjerë
Tani e keni rastin të flisni për të gjitha ato probleme që keni shtruar më herët; librezat e LPK-ës, 1000 markshin dhe gjëra të tjera...
ja ku e keni Njeriun të cilin e akuzuat hiq më largë se para dy ditësh.
Mos ngurroni por bëni pyetjet e juaja...
Unë do të lexojë të gjitha postimet dhe përgjigjet por do të rezervohem nga kyqja në debat për t'ju mundësuar të tjerëve këtë gjë.
P.S.
Shpresoj që po ashtu, herët e vonë, do të bëni edhe një promovim të librit në Gjermani, Zvicër por pse jo edhe në SHBA ( keni pjesen e MIranit në atë Kontinent)...Në njëren nga ato do të jem me siguri si pjesmarrës...
përshendetje nga unë tarasi

---

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 20:48

---

I/e nderuar "kruja",
po të kishit kohë ta lexonit romanin ATENTATET, do kishit marrë përgjigje të kompletuar për marrëdhëniet tona me pushtetin e atëhershëm monist. E kam shpreh edhe në roman, se edhe atëherë kam qenë i indinjuar, pse ai regjim ndihmonte partitë komuniste në vende të ndryshme të botës, kurse në veprimtarët patriotë, disa edhe "enveristë" të thekur, hiqnim edhe për bukë goje.
Sa i përkrtë pyetjes se dytë, është tepër hipotetike dhe vetëm se mund të spekulojmë. Kemi një proverb popullor: "O Zot, më bëjë edhe një herë nuse, se e di si nusëroj."
Sigurisht, kemi bërë gabime, por nuk kanë qenë të qëllimshme; Siç kemi ditur e mundur kemi vepruar. Sa mirë do të ishte sikur të mund të riktheheshа në atë moshë - 21-vjeçare...
Mbarësi e shëndet!
Ibrahim Kelmendi

---

profile | edit quote

**piloti**

**Anëtar që nga:** 22.02.2002
**Afishime:** 1439

**Afishuar me:** 23.03.2007 20:56

---

z.Kelmendi ,
Mos më keq kuptoni (nuk eshtë pyetje)provokative ,
Disi nuk po e kam te kjart ,se si eshtë e mundur qe një intelektual i kategoris së lart -doktor shkence , i cili madje beri qmos per ti perfundur studimet ne afat dhe per tu berë madje doktor , si eshtë e mundur qe

**Vendbanimi:** Gjermani

një person i till te jetë BIXHOZGJI , e pastaj Ju me ndihmen e Migracionit Kroat madje ja "falni" 50000DM ,
tju themë te drejten , diqka ketu nuk po perputhet ,
me nderime
PILOTI

profile | edit quote

**bumerang**

**Anëtar që nga:** 15.01.2005
**Afishime:** 229

**Afishuar me:** 23.03.2007 21:01

Pershendetje Z. Kelemendi !
Ju pergezoje per kurorezimin e mundit Tuaj ne leter.
Une kame nje pyetje tjeter: A keni kontakte te aferta me me te afermit e vellezerve Gervalla e sidomos me Donika Gervallen?
Falemnderit per pergjigjen.

profile | edit quote

**TAFILIBRIGI**

**Anëtar që nga:** 06.03.2006
**Afishime:** 56
**Vendbanimi:** SHIPTARI

**Afishuar me:** 23.03.2007 21:02

> Quote:
>
> global_info afishoj me 2007-03-23 19:48 :
> Autorin e kam` pas idoll edhe para botimit te romanit "atentatet" tani edhe me shume kame rrespekt per te. E kame takuar vetem dy-her` gjate jetes time! njeher n`Tirane, pastaj n`Prishtine.
> Une nuk dua te shtoj gje tjeter, pos te them se; me nxjerrjen e romanit "atentatet" per shqipetaret je bere nje "DAN BROWN" shqipetarë !
> Pritni, ju lutem, Zoti Kelmendi, te falat e mia me nderime.

KODI I DAVINçIT ME TË VËRRTET ËSHTË NJË ROMAN I SHTJELLUAR BUKUR,POR NË FUND TË ROMANIT AUTORI THOT PËRSIRI KY ËSHTË VETËM NJË ROMAN, KURSE KTU ËSHTË KRIM I VËRTET QË KA NDODHUR.
E SIPAS MENDIMIT TIM "ATENTATET" SDUHET TË TITULLOHET ROMAN . KJO ËSHTË NJË NJGJARJE E VËRTET

profile | edit quote

**Kruja**

**Anëtar që nga:** 12.03.2004
**Afishime:** 1932

**Afishuar me:** 23.03.2007 21:14

z. Kelmendi,
Faleminderit per pergjigjen tuaj te kursyer. Pyetjet e mija ishin te hapura dhe prisja pergjigje te hapura. Ju i dhate ato ne menyren tuaj dhe te jeni i sigurt se une e kuptoj tani se nga c'fare dritaresh e kini pare ju realitetin kur ishit 21 vjec.
Mendoj se heronjte nuk jane kurre te vegjel por as edhe te hiperbolizuar ne dimensione. Ky ka qene njeri nga shqetesimet tuaja prandaj edhe kini dashur te kontriboni qe ato figura historike te shikoheshin me realizem.
Ashtu eshte realisht. Vellezerit Gervalla dhe shoket e tyre jane Heronj te Shqiperise. Dhe ate qe ata bene ishte e madherishme. Pra mendoj se vepra e tyre eshte e madherishme, gje per te cilen mendoj se ju nuk do te kini ndonje rezerve sikur te merrte edhe dimensione kombetare.
Nje pyetje te mbyllur per ju z. Kelmendi:
A mendoni ju se Vellezerit Gervalla dhe shoket e tyre jane heronj te Shqiperise, apo mendoni se ata ishin njerez te cilet i perkasin Kosoves

dhe kontribuan per Kosoven dhe kombin kosovar?
Pergjigja me nje Po ose me nje Jo do te ishte e mjaftueshme.
Persa i perket romanit tuaj, e respektoj mundin tuaj per te shkruar. Sinqerisht ju them se jam shume pak kurioz te mesoj se cila ishte dora qe perdori serbia per te marre ne menyre kriminale jeten e aktivisteve shqiptare. Rendesi ka qe autor ishte serbia kurse ekzekutuesi nuk ngre peshe mendoj ne ballancen historike. Autori njihet - Serbia. Vellezerit Gervalla dhe shoket e tyre jane vertet te gjalle te pakten ne njerez si une dhe atje ku jane, ne ndergjegjen time, nuk i ze dot as dora e Satanit.
Ju falenderoj sinqerisht per kete shkembim mendimesh.
Kruja.

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 21:18

I nderuar „shqipërues“!

Kam qenë përgjegjës për Fondin „Vendlinda thërret“ në Gjermani dhe një si i dytë, pas të ndjerit dhe të lavdishmit Jashar Salihu, për gjithë Fondin.
Në xhepat e mij të grisur nuk ka bir nëne (e as bir kurve), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje.
Siç do duhej ta dini, ai nuk ishte Fond publik, por thjeshtë i LPK-së dhe UÇK-së. Besoj, mund ta dini, se jo secili qytetar ka të drejtë të kërkoj llogari për një fond jo-publik.
Megjithatë, nuk vë dorën në zjarrë, se nuk ka kepërdorime, pasi ndonjëherë njeriu i keqpërdor edhe financat personale e familjare. Për ndonjë keqpërdorim të dyshuar do flas kur do e vlerësoj se është koha për të folur. Kjo nuk do thotë se kam heshtur vetëm për të pritur kohë, që unë e çmoj për të përshtatshme. Në strukturat ku është dashur të flas, kam fol me kohë...

Sa i përketë pyetjes se dytë, më duket jam përgjigj njëherë sot.
Megjithatë po ju përgjigjem edhe Ju shkurtimisht:
Më 5 mars 1997 kam arritur në Gjirokastër. Ishim një ekip e revistës gjermane DER SPIGEL, të cilin e kryesonte redaktori i saj për Evropë Juglindore, Z. Roland Schleicher. Kemi qëndruar 10 ditë dhe kemi përgatitur reportazhë të gjatë për revistën. Pasi jam kthyer, materialet e grumbulluara në terren dhe përjetimet, i kam botuar në një libër publicistik, që e pata tituluar: SHQIPËRIA JASHTË "VERIUT" DHE "JUGUT". Ai libër qe botuar në qershor të vitit 1997 në Perëndim dhe qe ribotuar dy herë në Tiranë.
I falënderoj gjithë ata që më kanë fajsuar për atë rrebelim popullor, sikur unë të isha Gjergj Elez Alia, me fuqi mbinjerëzore për të bërë gjëra të mëdha atje.
Pra, kam qenë me detyrë të gazetarit dhe të publicistit. Më ka dhimbt shpirti për gjithë ato tragjedi, por kam parandjerë se aty e ka bazën armatosëse Lufta Çlirimtare e Kosovës, pasi deri atëherë, pushtetet e Tiranës na pamundësonin sigurimin e armëve të domosdoshme për UÇK-në...
Tung

**D**

**Afishuar me:** 23.03.2007 21:22

**Anëtar që nga:**

Z. Ibrahim Kelmendi

| | |
|---|---|
| 27.04.2002<br>**Afishime:** 1253 | Une po e repredukoj edhe një herë mendimin tim rreth intervistës dhe librit tuaj të thëna në temën te Intervista juaj.<br>***<br>Një, që në fillim dua të them se kurr nuk i kam besuar teorisë se "me 17 janar 1982 në qerim hesapesh numbën jetën 3 emigarnt nacionalist..." kjo ishte e Tanjugut !!<br>E di se në vitin 1980, ky Riza Salihu ka pas pakënaqsi pse gazeta e Organizatës së Jusufit e ka po të njetin emër si "gazeta" e tij "Zëri i Kosovës"!!<br>Jusufi është takue me këta Grupi Komunist "Zëri i Kosovës", që ishin Riza Salihu, Hysen Gega... një Blakaj .. etj.<br>E di se edhe Ibrahim Kelmendi ka pas pakënaqsi për përfshirjen ose mos përfshirjne e tij në bisedime për bashkimin në Frontin për Republikën e Kosovës ... pas publikimit të Tezave të OMLK-së në vjeshtë të vitit 1981.<br>Po të gjitha këto nuk janë motiv i mjaftueshëm që këta shqiptar të qërojn hesapet dhe të vriten mes veti !!<br>Edhe pohimi i Ibrahim Kelmendit se Rezili është dorasi, për mua është pohim subjektiv, pohim i njeriut që nuk mund të dal nga rrethi vicioz i dyshimeve dhe përfoljeve për armiqët e brendshëm !<br>Me të vra Rezili (Riza Salihu) është si me të hangër qenët, apo me të rrah "gabelët" (nuk e kam fjalën te gabelët si etni - po te mënyra e sjelljes - sjellje "gabele" kanë edhe ndoj shqiptar, turk, serb apo edhe gjerman)!!<br>Nuk i besoj kësaj teorie e as të atyre që thon se Ibrahim Kelmendi i ka shty Riza Salihun dhe Hysen Gegën !!<br>Vrasjen, apo atentatin e ka krye policia sekret Serbe me tri fjalë: UDB-ja.<br>Fjalët e fundit të Jusuf Gërvallës të publikuara nga shtypi i kohës, shtypi gjerman ishin se "prapa atentatit është policia sekrete serbe" !!<br>Gjithmon mu ka dukur "mveshje" se gjoja Jusufi ka thënë :"nëse është shqiptar kurr mos u zbuloft" !!<br>Kjo nuk përkon me realitetin dhe me konceptet e Jusufit të shpalluara në shkrimet e tij dhe në sielljen e tij !!<br>Kush do të mund të thoshte pas një plaçkitje : " në qoft se plaçkitsi është shqiptar, kurr mos u zbuloft" !!??<br>Këtë nuk do ta thoshte Jusuf Gërvalla dhe askush tjetër kur dihet se vrasësi, krimineli, hajni ... janë kategori anacionale dhe nuk pyesin për komb dhe patriotizëm !<br>Une e kam ditë se I.Kelmendi ka punue shum në malin e Halabakut ... po kam pas mendue se se e ka lshue Halabakun dhe ka ra në shehër !!<br>Unë në një temë më lart e kam tregue një mesele dhe do ta përsëris edhe një herë do ta tregoj një mesele, thuaj se jo mesele veq fjalë, po realitet !!<br>Na për disa punë e kemi një shprehje "si puna e vllaznive të Halabakut" !!<br>e tash ku jemi te puna !! me sqarue pak<br>Halabaku një vend malor malësi, me tokë shum pak pjellore dhe popullatës gjithë koha i ka shkue duke qel mal për me i bë ara ose livadhe !!<br>Ishin kanë kallabllak do vëllazni në Halabak dhe kishin pas bukur do tokë , po shumica male e bokrrina që nieri mos me mujt me ju thënë as mal as livadh e ma pakë arë pjellore.<br>nejse<br>tema është te puna dhe mundimi, sa e si kanë punue vllaznia e Halabakut ??!<br>puno err e terr, pa ja nda, me sopata e me kazma me qel malë e me bë tokë pjellore !!<br>U kish pas shkue krejt ymri tuj punue me sopat e kazëm, deri në pleqni .... deri ju kishin pas shkue djemt e tyre në qytet (në shehër Prishtinë) ata djemt e tyre shkollohen bëjnë trual dhe shtëpia në Qytet stabilizoehn dhe bëjnë jetë normale !!<br>E tash ku po mbetet shprehja ; "si puna e vëllaznive të Halabakut" |

Tash çka u bë me Vëllaznit Halabaku, çka bënë me malin, a e qelën a çka bënë ??!!
ata deri i kish pas lshue shpirti kishin pas punue ... po ju kish pas met as mal as ar as livadh !!
E kisha porosit I.Kelmedin ... le more Halabakun se nuk janë kah na vyejn arat e livadhet në shkëmbinjë e bokrrina ... këtheju rrafshit e kije gjan e gat !!
"D" .- Shefqet Cakiqi - Llapashica (po e thej rregulloren e Forumit - po nejse)

profile aim | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 21:32

I nderuar "pilot",
Po të lexonit romanin, do e kuptonit gjithë fatkeqësinë. Z. Hysen Muhaxheri, nga Rrethi i Ferizajit, nuk e njihja personalisht. Ate e kishte dërguar Elektro-Ekonomia e Kosovës për specializim. Ishte nip i Kryetarit të atëhershëm të Klubit në Dyzeldorf. Ky m'u drejtua për ndihmë, pasi më nuk kishte mundësi ta ndihmonte vetë dhe kolegët e tij. Unë ju drejtova një miku kroat. Ia paraqita "hallin", siç ma kishte paraqitur Kryetari i Klubit. Miku kroat ia dha Hysenit (jo mua) ato 50 mijë DM, më dëshirë që të ndihmoj doktorimin e Hysenit. Doli se ai, pos që ishte intelektual, ishte edhe bixhozgji. Ai kishte mbledhur nga bashkatdhetarët rreth 200 mijë DM, nga dy kogë gjermanë, profesorë në univerzitet të Duisburgut, rreth 400 mijë DM, etj. Për ato 50 mijë marka është folur e shkruar nga dashakëqijtë dhe të manipuluarit, sikur të kishin qenë të hollat e tyre. Miku kroat e pat përpunuar si fatkeqësi të përbashkët.
Më gjasë nuk e ditkeni, se përplot intelektualë e personalitete kanë ves prej bixhozxhiu (shembull tepër flagrant është rasti i Fatos Nanos)...
Tung

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 21:39

I nderuar "bumerang",
Ju falënderoj për përgëzimet.
Ka vite që nuk kam kontakte me Familjen e nderuar Gërvalla dhe as me Zonjën Donikë Gërvalla. Kjo ka qenë njëra nga fatkeqësitë e mia dhe të kësaj Familjeje. Bazat e shkëputjes se kontaktit janë të trajtuara në roman. Ky ka qenë edhe një atentat më shumë ndaj Familjes Gërvalla dhe ndaj meje.
Po shpresoj se pas sqarimit të gjërave, do kemi fuqi reciproke për t'u mirëkuptuar.
Tung

profile | edit quote

**Shqipëruesi**

**Anëtar që nga:** 08.08.2004
**Afishime:** 556
**Vendbanimi:** Prishtinë

**Afishuar me:** 23.03.2007 21:40

I nderuar z. Kelmendi,
- Falemnderit për përgjegjen tuaj. Sa i përket fondit "Vendlindja Thërret dhe shpërdorimeve eventuale,kohë më parë kishte folur hapur(në një intervistë me një gazetë lokale) Sylejman Selimi. Ai vjen nga radhët e UCK-së. Kur ai e thotë ashtu hapur kuptohet që nuk është vetëm fjalë rruge e një të painformuari ose dezinformuari.
Pastaj,nuk më pëlqen fakti që ju shihni dicka pozitive te "rrebelimi komunist" i vitit të mbrapsht në Shqipëri dhe (më falni por do të

shprehem sic e meriton) arësyeja juaj banale për "lehtësimin e armatosjes së UCK-së" pas nxjerrjes së armëve jashtë kazermave. Po të lexoshë mes rreshtash i bie se ju e kishit kërkuar që të ndodhte për...arësyen që e thatë vetë. Unë këtë quaj ABSURD,z. Kelmendi. Në 'ngjarjet e 97-ës nuk shoh asgjë pozitive,përkundrazi. E lëmë me kaq.për të ju dhënë rastin që të sqaroheni pak më shumë se ndryshe lind dyshimi...

Me nderime, Shqipëruesi

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 21:47

Shumë i nderuari Miku "kruaja",
Pak rëndësi ka mendimi im individual, meqë nga i gjithë kombi çmohen heronjë. Përmes romanit jam munduar t'ua kthejë nderin që më kanë bërë - si shokë e vprimtar i Tyre që isha!
Ndoshta pushtetarëve përkatës do u bie ndërmend ta zyrtarizojnë heroizmin e Tyre...
Ju falënderoj dhe mbarësi në jetën Tuaj dhe të Familjes!
Miqësisht
I. Kelmendi

profile | edit quote

**Labinoti**

**Anëtar që nga:** 23.07.2002
**Afishime:** 143
**Vendbanimi:** Te rrapi në Mashkullorë

**Afishuar me:** 23.03.2007 21:53

Përshëndetje z. Kelmendi. E çmoj shumë gatishmërinë tuaj për t'u përgjigjur rreth romanit. Personazhet që i njoh i keni përshkruar të tillë siç kanë qenë.
Në roman qëndrimi i shtetit shqiptar, ose më saktë i përfaqësisë së saj në Vjenë, del shumë i nxirë. Në këtë pikë s'besoj se do të arrijmë të pajtohemi. Por, më mirë ta lëmë.
Është sqaruar ndonjëherë roli i atij "mysafirit të paftuar" nga Bllaca e Therandës që Mirani ia përmend "ëndrrën"?
Gjithë të mirat!

profile | edit quote

**caka**

**Anëtar që nga:** 05.03.2005
**Afishime:** 759
**Vendbanimi:** germany_k

**Afishuar me:** 23.03.2007 22:01

per mua i nderuari I.Kelmendi,
do te ishte interesant te beje nji kronologji (te shkurter po qe nevoja)rreth "Fondi Vendlindja-Therret",
kjo per arsye personale pasi qe ketu ku gjindem kam pasur rolin e koordinatorit te Fondit me lidhje direkte Frauenfeld-Aarau.
dhe po te deshironi mund ta beni ne emailin tim qe po u jap ne mesazh privat
pershendetje

**piloti**

**Anëtar që nga:** 22.02.2002

**Afishuar me:** 23.03.2007 22:42

I_Kelmendi
Anëtar që nga: 23.03.2007
Afishime: 19 Afishuar me: 23.03.2007 21:32
--------------------------------------------------------------------------------

**Afishime:** 1439
**Vendbanimi:** Gjermani

I nderuar "pilot",
Po të lexonit romanin, do e kuptonit gjithë fatkeqësinë. Z. Hysen Muhaxheri, nga Rrethi i Ferizajit, nuk e njihja personalisht. Ate e kishte dërguar Elektro-Ekonomia e Kosovës për specializim. Ishte nip i Kryetarit të atëhershëm të Klubit në Dyzeldorf. Ky m'u drejtua për ndihmë, pasi më nuk kishte mundësi ta ndihmonte vetë dhe kolegët e tij. Unë ju drejtova një miku kroat. Ia paraqita "hallin", siç ma kishte paraqitur Kryetari i Klubit. Miku kroat ia dha Hysenit (jo mua) ato 50 mijë DM, më dëshirë që të ndihmoj doktorimin e Hysenit. Doli se ai, pos që ishte intelektual, ishte edhe bixhozgji. Ai kishte mbledhur nga bashkatdhetarët rreth 200 mijë DM, nga dy kogë gjermanë, profesorë në univerzitet të Duisburgut, rreth 400 mijë DM, etj. Për ato 50 mijë marka është folur e shkruar nga dashakëqijtë dhe të manipuluarit, sikur të kishin qenë të hollat e tyre. Miku kroat e pat përpunuar si fatkeqësi të përbashkët.
Më gjasë nuk e ditkeni, se përplot intelektualë e personalitete kanë ves prej bixhozxhiu (shembull tepër flagrant është rasti i Fatos Nanos)...
Tung
:::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::::

z.Kelmendi,
Ju falenderoi per pergjegje , eshtë e njejta pergjegje sikur qe figuron edhe ne liber , librin jamë duke e lexuar , e lexoi ngadale dhe me plot vemendje , nuk jam kritik letrar qe te japi vlersime apo kritika letrare , nga kendi im veshtrues "lexues i thjeshtë" me pelqen ky liber , pasi qe sado kudo do te mesoi edhe një episod te perpjekjeve te vazhdueshme te bijve dhe bijave tona per tu qliruar nga okupatori shekullor -serbosllav .
Ju deshiroi shendet dhe suksese te matutjeshme
PILOTI

---

profile | edit | quote

**Dongil**

**Anëtar që nga:** 04.01.2006
**Afishime:** 471

**Afishuar me:** 23.03.2007 22:52

---

z.Kelmendi sa jeni të njoftuar ,a është ndihmuar zona e dugagjinit nga fondi ,,vendlindja therret''dhe sa ashte shuma ,sepse ndegjohen zera se nuk e keni ndihmuar!!!
flm
d.gili

---

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 22:57

---

I nderuar Z. Cakiqi-Llapashtica!
Fillimisht Ju falënderoj që dekonspiruat D-në dhe u konkretizuat se jeni Ju.
Po përpiqem të përgjigjem, duke e shndëërruar në një si bashkbisedim të drejtëpërdrejtë.
Cakiqi-Llapashtica:
E di se në vitin 1980, ky Riza Salihu ka pas pakënaqsi pse gazeta e Organizatës së Jusufit e ka po të njetin emër si "gazeta" e tij "Zëri i Kosovës"!!
Kelmendi:
Në vitin 1980 Jusufi nuk kishte filluar me botim të "Zërit të Kosovës", por tek në Nëntor të vitit 1981, kur "Grupi komunist Zëri i Kosovës" nuk ekziston te më. Rezli pat filluar fushtaën kundër Jusufit, sapo Jusufi arriti në Gjermani. Gjithë kohën shpifte: "UDB-ja ka dërguar Jusuf Gërvallën..."
Cakiqi-Llapashtica:
Jusufi është takue me këta Grupi Komunist "Zëri i Kosovës", që ishin Riza Salihu, Hysen Gega... një Blakaj .. etj.
Kelmendi:

Sipas romanit del se, sapo ka arritur Jusufi në Gjermani, Bardhi ka informuar Vasilin dhe janë takuar. Pas dy-tre muajve Rizili, si Kryetar i "Grupit komunist Zëri i Kosovës", e ka urdhëruar Vasilin (që e kishte kooptuar Rezili për nënkryetar të këtij Grupi), për të bërë atentat ndaj Jusufit. 5-6 muajt e parë Jusufi dhe rezili nuk janë takuar asnjëherë. Takimi i parë i tyre ka qenë ballafaqimi për të gjykur urdhërin për atentat.

Cakiqi-Llapashtica:

E di se edhe Ibrahim Kelmendi ka pas pakënaqsi për përfshirjen ose mos përfshirjne e tij në bisedime për bashkimin në Frontin për Republikën e Kosovës ... pas publikimit të Tezave të OMLK-së në vjeshtë të vitit 1981.

Kelmendi:

Sigurisht se nuk e dinë më mirë se unë, që do të thotë se unë kam qenë i inkuadruar në të gjitha takimet për bisedime. Në ndonjërin nga ato takime kam shkuar me bashkëveprimtarë, të cilët mund të dëshmojnë.

Cakiqi-Llapashtica:

Po të gjitha këto nuk janë motiv i mjaftueshëm që këta shqiptar të qërojn hesapet dhe të vriten mes veti !!

Kelmendi:

Nuk kanë qruar shqiptarët hesape në mes tyre, por UDB-ja ka bërë atentate kundër veprimtarëve patriotë.

Cakiqi-Llapashtica:

Edhe pohimi i Ibrahim Kelmendit se Rezili është dorasi, për mua është pohim subjektiv, pohim i njeriut që nuk mund të dal nga rrethi vicioz i dyshimeve dhe përfoljeve për armiqët e brendshëm !

Kelmendi:

Sigurisht se është pohim subjektiv, pasi sikur të mos nisesha nga vetja ime nuk do bëja këtë akuzë. Besoj se akuza qëndron. Për këtë më pat bindur edhe krye-hetuesi gjerman. Në fakt, në mengjezin e të hënës se 18 janarit 1982, kam deklaruar para krye-hetuesit: "UDB-ja ka urdhëruar të behet atentati, kurse dorasi duhet të jetë Rezili, nëse nuk ka alibi..." Sigurisht që ka edhe një dyzinë njerëzish që i kam dyshuar dhe luftuar për UDBashë. Fatkeqësisht atë listë kam mundut ta reduktoj fare pak, edhe pas kaq vitesh. Por tani jam i tërhequr nga veprimtaria politike, pasi Kosova ka institucione...

Cakiqi-Llapashtica:

Me të vra Rezili (Riza Salihu) është si me të hangër qenët, apo me të rrah "gabelët" (nuk e kam fjalën te gabelët si etni - po te mënyra e sjelljes - sjellje "gabele" kanë edhe ndoj shqiptar, turk, serb apo edhe gjerman)!!

Kelmendi:

Për këtë lloj paushalizimi nuk kam koment.

Cakiqi-Llapashtica:

Nuk i besoj kësaj teorie e as të atyre që thon se Ibrahim Kelmendi i ka shty Riza Salihun dhe Hysen Gegën !!

Kelmendi:

Për herë të parë dëgjoj të tillë spekulime. Ndoshta dinë të pakten një njeri, me emër e mbiemër, që ta ka shfaq këtë lloj spekulimi.

Cakiqi-Llapashtica:

Vrasjen, apo atentatin e ka krye policia sekret Serbe me tri fjalë: UDB-ja.

Kelmendi:

Sigurisht. Por UDB-ja ka pas edhe shqiptar në strukturat e veta (rreth 30-40 mijë profesionistë e informatorë vetëm në Kosovë).

Cakiqi-Llapashtica:

Fjalët e fundit të Jusuf Gërvallës të publikuara nga shtypi i kohës, shtypi gjerman ishin se "prapa atentatit është policia sekrete serbe" !!

Kelmendi:

E vërtetë, por nuk kanë qenë fjalët e fundit të jetës se tij, pasi ai ka biseduar shumëçka edhe me bashkëshortën e tij, Z. Suzanë Gërvalla.

Cakiqi-Llapashtica:
Gjithmon mu ka dukur "mveshje" se gjoja Jusufi ka thënë :"nëse është shqiptar kurr mos u zbuloft" !!
Kelmendi:
Këtë porosi/dëshirë/amanet Jusufi ia ka thënë bashkëshortës. Ajo na e pat treguar që në mengjezin e ditës se hënë.

Cakiqi-Llapashtica:
Kjo nuk përkon me realitetin dhe me konceptet e Jusufit të shpalluara në shkrimet e tij dhe në sielljen e tij !!
Kelmendi:
Ky është supozim i Juaj. Ai në fakt ka idealizuar shqiptarin dhe kurrë nuk ka pritur t'i vi vdekja nga dora e shqiptarit. Në këtë kontekst mund ta ketë shpreh këtë dëshirë dhe kjo tregon karakterin e tij prej shqiptari 24 karatë.
Cakiqi-Llapashtica:
Kush do të mund të thoshte pas një plaçkitje : " në qoft se plaçkitsi është shqiptar, kurr mos u zbuloft" !!??
Kelmendi:
Askush, por krahasimet çalojnë!
Cakiqi-Llapashtica:
Këtë nuk do ta thoshte Jusuf Gërvalla dhe askush tjetër kur dihet se vrasësi, krimineli, hajni ... janë kategori anacionale dhe nuk pyesin për komb dhe patriotizëm !
Kelmendi:
Ndoshta të drejtë në këto mendime hipotetike...
Cakiqi-Llapashtica:
Une e kam ditë se I.Kelmendi ka punue shum në malin e Halabakut ... po kam pas mendue se se e ka lshue Halabakun dhe ka ra në shehër !!
Kelmendi:
Mbase do të konkretizoheni. Unë kam shpreh bindjet e mendimet e mia ndërsa Ju keni të drejtë t'i komentoni e vlerësoni.
Nuk dëshiroj ta komentoj anekdotën Tuaj në vijim.
Cakiqi-Llapashtica:
E kisha porosit I.Kelmedin ... le more Halabakun se nuk janë kah na vyejn arat e livadhet në shkëmbinjë e bokrrina ... këtheju rrafshit e kije gjan e gat !!
Kelmendi:
Të falënderoj për këshillën, do ta kem parasysh.
Cakiqi-Llapashtica:
"D" .- Shefqet Cakiqi - Llapashica (po e thej rregulloren e Forumit - po nejse)
Kelmendi:
Të falënderoj që u konkretizuat; nuk di nëse Forumi ka rregullore që të mos paraqitën njerëzit më emrin e mbiemrin e tyre të vërtetë. Në rastin tim ata nuk ma ndaluan.
Tung, Z. Cakiqi-Llapashtica!
I. Kelmendi

---

profile | edit quote

**drenasi_28**

**Anëtar që nga:** 28.04.2002
**Afishime:** 163
**Vendbanimi:** drenas

**Afishuar me:** 23.03.2007 23:04

---

Quote:

---

tarasi afishoj me 2007-03-17 15:23 :
.....
Tu them të drejten edhe haptas; unë tarasi gjithnjë i kam pas dyshimet në gruan e Jusufit Suzanën!
U them haptas.

Aq më parë që duke parë një dëshmi të gruas së bardhit e cila le ërshtypjen që " sikur Suzana ka ditë diçka që do të ndodhë në atë natë ngaqë djalin e madh të cilin Jusufi kishte dashtë ta merrë me vete, ajo në mënyrë kategorike ia kshte kapur nga dora duke i thënë: ky sonte s'do të dalë me Ju"! Pra secili nga ne i kemi pas dyshimet tona sikur që i kemi akoma...

---

**********************************
Zotni Kelmendi
Ti po i drejtohesh Tarasit me "shum i nderuari taras" !!
A nuk është kjo loj e pa shije kur po ky tarasi në temën për librin tuaj shpreh këso fyerjesh për bashkshorten e "mikut" tuaj Jusuf Gërvalla nga e cile edhe keni ngrënë buk ??!!
pak pa shije aa !!!

---

profile add aim edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 23.03.2007 23:05

---

I nderuar "Dongil",
Ka pas përpjekje nga disa që pretendojnë komprmentueshëm, se janë bosat e UÇK-së, të stabotojnë UÇK-në e Zonës se Dukagjinit, pasi doni të impononi për "komandant" ndonjë puthadorë të tyre, por nuk ia kanë dal. Fondi "Vendlindja thërret" i ka ofruar sektorit të logjistikës se UÇK-së për këtë zonë dhe zona të tjera aq financa e mjete, sa kanë kërkuar dhe sa kanë qenë në gjendje t'i vënë në praktikë.
Tung

---

profile edit quote

**D**

**Anëtar që nga:** 27.04.2002
**Afishime:** 1253

**Afishuar me:** 23.03.2007 23:08

---

OK Zotri Ibrahim Kelmendi
Unë Cakiqi i Llapashticës po qëndroj në bindjet dhe opinionet e mija e ti qëndro në tuajat ! nuk ka problem.
Unë kam shpreh opinjonet e mija ...është normale që publikimet kanë interpretime të ndryshme.
suksese

---

profile aim edit quote

**sportisti007**

**Anëtar që nga:** 22.03.2007
**Afishime:** 23

**Afishuar me:** 23.03.2007 23:24

---

Shkresa cenzurohet

Rrufeja_123

[ Ky afishim u ndryshua nga: Rrufeja_123 më 2007-03-23 23:25 ]

---

profile edit quote

**caka** | **Afishuar me:** 23.03.2007 23:27

**Anëtar që nga:** 05.03.2005
**Afishime:** 759
**Vendbanimi:** germany_k

lidhur me ket postim

Po,por per patriotet e vertete (ne kuptimin e plote te fjales) ,golgotat e rrugeve te ndryshme pas ballafaqimeve shpiejne ne nje rruge.
Rruga e Lirise eshte nje dhe nuk ka tjeter.
Por per patriotet shqipetar eshte bere shprehi qe edhe pas ballafaqimeve vazhdohet me te vjetren.

profile | edit quote

**kreksi** | **Afishuar me:** 23.03.2007 23:28

**Anëtar që nga:** 28.02.2005
**Afishime:** 471
**Vendbanimi:** Francë

I nderuari Z. Kelmendi,
Se pari Ju uroje per librin qe keni nxjerrur ne dritë, kam filluar ta lexoj, por mos harro se na ke borxh gjith ata lot qe derdh lexuesi qe ne fillim te ngjarjes, kete se ka pritur asnjeri prej juve !
Libri juaj është më shumë se një roman, ky liber eshte nje makin qe rikthen kohen mbrapa, por jo vetem kohen me biseda e ngjarje por Ju ringjallni edhe heronjet e shqitarizmit, Bardhoshin, Kadriun e Jusufin duke i shetitur tani ne kosoven e lirë, ndoshta ashtu si e ëndrruan, të lirë.
Ne anen tjeter çfare tragjedije familjare !
Jetim pas jetimi... duke u sakrifuar per liri.
Ne kete forum ne juve ju kemi shpallur dyluftim jo te barabart, se ne jemi me maska"nofka" kurse ju jeni autori qe mbron krijesen e tije te shtrenjte qe ketu askush tjeter nuk do guxonte te nderrmarri nje hap te tille si ju por e di qe jeni guximtar dhe i vendosur dhe me siguri se do ti perballoni keto qaste te veshtira.
Ju pershendes perzemersishtë;
kreksi
P.S; Mendoje se ky liber do kete interesim edhe per lexuesit ne gjuhet e huaja, e pse jo edhe pershtatje kinematografike.

[ Ky afishim u ndryshua nga: kreksi më 2007-03-23 23:57 ]

profile | edit quote

**sportisti007** | **Afishuar me:** 23.03.2007 23:51

**Anëtar që nga:** 22.03.2007
**Afishime:** 23

z. Rrufeja
Nuk e di se përse Ju shlyeni shkrimin tim i cili e ka për qëllim ta mbrojë z. Kelmendin nga sulmet që tentojnë të ia bëjnë si bie fjala" D" me nofka tjera...
Ai ka hyrë me sinçeritetin më të madh duke mos e ditur që ka të bëjë me të pasinçertët...

profile | edit quote

**Rrufeja_123**
**Moderator global** | **Afishuar me:** 23.03.2007 23:58

**Anëtar që nga:** 19.11.2005
**Afishime:** 333

> Quote:
>
> sportisti007 afishoj me 2007-03-23 23:51 :
> z. Rrufeja
> Nuk e di se përse Ju shlyeni shkrimin tim i cili e ka për qëllim ta mbrojë z. Kelmendin nga sulmet që tentojnë të ia bëjnë si bie fjala" D" me nofka tjera...
> Ai ka hyrë me sinçeritetin më të madh duke mos e ditur që ka të bëjë me të pasinçertët...

z. sportisti007,

Ti, nuk ishe i implikuar ne debatin Kelmendi-Cakiqi-Llapashtica. Kjo eshte arsyeja qe isha i detyruar ta largoj afishimi tend. Nuk do te lejoje qe tema te devijoje nga qellimi per te cilin eshte hapur.
Rrufeja_123

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 24.03.2007 00:41

E/i nderuar "Rrufeja_123"!
Do ju lutesha të mos "censuroni" aske, edhe nëse shajnë e ofendojnë, pasi të tillët mund t'i akumulojnë energjitë etyre negative dhe kjo nuk është e shëndetshme për kombin tonë. Duhet të ndihmojmë me sqarime e dashuri edhe ata që janë elektrizuar me energji negative. Të qytetruarit nuk kanë nevojë për sqarime...
Paraprakisht ju falënderoj për mirëkuptim!
I. Kelmendi

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 24.03.2007 00:48

Shumë i/e nderuar „drenasi_28"!
Më fal për mënyrën e drejtimit, pasi nuk po pa mati me peshore filigrami. Unë kam respect të madh për Zonjat Gërvalla dhe asnjëherë nuk kam shfaqur dyshim ndaj tyre. Më ka ardhur keq kur të tjerët I kanë manipuluar, në emër të ku di unë çkaje.
Të shpreh mirënjohje për vërejtjen.
Tung

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 24.03.2007 01:09

Të gjithë u dëshiroj natë e gjum të mirë! Nesër do ritakohemi sërish.
Uroj të keni shëndet e suksese!
Tung
I. Kelmendi

profile | edit quote

**mili2**

**Anëtar që nga:** 07.07.2001
**Afishime:** 1115
**Vendbanimi:** North America

**Afishuar me:** 24.03.2007 01:24

Desha ta pershndes z. Kelmendi dhe njeherit te pergozoj per punen qe ke be. Librin ende nuk e kam lexue dhe nuk po bej asnje pyetje: si, pse, ku, kush etj sepse per te be pyetje te tilla ose duhet te kesh qene i kycur direkt ne rrjedha dhe aktivitetete te Levizjeve Ilegale shqiptare te asaj kohe (qoft per interesa shqiptare qoft per ato te UDB-es) ose s'paku duhet lexuar librin me vemendje dhe ne menyre te paanshme te japesh edhe vlersimin mbi akteret e ngjarjeve te asaj kohe. Keshtu qe posa te kam mundesi ta kem ne dore dhe ta lexoj do te mundohem qe te jap edhe mendimin ne lidhje me vlersimin e asaj periudhe nga ana juaj si dhe vlersimin per aktivitetin e personazheve te asaj periudhe. Gjithashtu ne baze te diskutimeve

qe u bene ne kete teme une jam i mendimit se ky liber nuk eshte roman sepse aty kemi te bejm me personazheve me emra te vertet. Pra, thjesht mund te quhet Liber ne te cilin eshte pershkruar aktiviteti i Levizjeve Ilegale Shqiptare ne Perendim. Shpresoj qe si pike e pare ky liber i juaj do ti ndihmoj drejtesis Gjermane qe te zbuloj jo vetem vrasesit qe kryen vepren kriminale, por edhe ata te cilet urdheruan (edhe pse ne e dime qe eshte UDB-a serbe) kete vrasje te vllezrve Grvalla dhe Kadri Zekes. Dhe si pike e dyte ky liber ti sherbej gjeneratave te reja qe te kane material te shkruar nga ana e vet akterve qe kane qene pjese e ketyre aktiviteteve. Pyetjet qe parashtrojne disa pjesmarres te forumit se; "perse u dasht kaq vite qe ju me ne fund edhe vet te flitni per kete ngjarje"? Per mendimin tim jane shume naive dhe te pavend sepse edhe ne vendet me demokraci 100 vjeqare ka raste e raste te vrasjeve qe per shkaqe te ndryshme mbesin te pazbuluara dhe pas 15-20 vite arrihet qe drejtesia ta thot fjalen e vet dhe kriminelet denohen. Pozita ne te cilen kane qene shqiptaret jashte shtetit Ame, gjegjesisht ne ish jugosllavi e dine te gjithe, pervec disa bashkpunetorve te atij rexhimi (i cili ishte varr kolektiv per shqiptaret ne pergjithesi) qe per interesa te tyre personale shtiren se ka qene ndryshe dhe mundohen ti mjegullonje ngjarjet e asaj kohe. Ka raste e raste kur, shume familje te cilat e kane dite se kush jane egzekutuesit dhe kush jane urdheruesit e vrasjeve te gjysherve, prindve, vllezerve, motrave, bijve e bijave te tyre. Mirpo, jo vetem qe nuk kane pas se ku te kerkojen drejtesi (merre me mend te kerkohet drejtesi tek ai i cili ka dhene urdher me te vra), por edhe jane kercnue se "do te vriten e gjithe familja dhe farefisi nese vetem e bejne te madhe kete pune"! Andaj, kjo eshte arsyeja te pergezoj per punen qe ke bere qe brezave te ardhshem mos tu mbeten vetem fjalet nga populli se kush ishte vrasesi i gjyshit, prindit, vllaut, motres, djalit, bijes me te afermit dhe shqiptarve ne pergjithesi, por te kane edhe materiale nga vet aktivistet e asaj kohe, per te ardhe ne perfundim se kush mund te jet konkretisht vrasesi.
nderimet e mia,
mili

profile edit quote

**gentelmeni**

**Anëtar që nga:** 20.06.2001
**Afishime:** 6360
**Vendbanimi:** angli-londer

**Afishuar me:** 24.03.2007 01:48

I nderuari Kelmendi,
Ku po e gjene gjithe kete fuqi shpirterore qe edhe djallin e bene engjull.
Ndjehem shume i vogel kundrejt Juve.
genti

profile mail edit quote

**Shqipëruesi**

**Anëtar që nga:** 08.08.2004
**Afishime:** 556
**Vendbanimi:** Prishtinë

**Afishuar me:** 24.03.2007 11:05

I nderuar zoti Kelmendi,
Ju mes tjerash thatë edhe këtë :
"Në xhepat e mij të grisur nuk ka bir nëne (e as bir kurve), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje".
Më bëtë për të qeshur zotëri. Pse,paratë në xhepa të grisur do mbaheshin ?!
Paratë rrijnë në konto bankare.
Mos më pandehni kaq naiv,ju lutem.
Ju i dini mirë "pasuritë"e tundshme dhe të patundshme të Hashim Thaqit,Jakup Krasniqit,Ramush Haradinajt...e shumë të tjerëve.

Ne jemi këtu. I shohim përditë.
Edhe fondi 'i Bukoshit" ,tre përqindëshi" pra,edhe pse askush nuk e thotë zyrtarisht,është shpërdorur. Të kujt janë "BEN-AF-ët?
Populli thotë,janë të Bukoshit.
Pra,edhe fondi që keni udhëhequr ju,është shpërdoruar(më mirë të shprehem keqpërdoruar).
Dhe ju përsëri me "xhepa të grisur" !!!
Rrofshin bankat !

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 24.03.2007 11:15

I nderuar „mili2‟ dhe të nderuar „forumistë‟ !
Ju që ende nuk keni pas mundësi ta lexoni romanit ATENTATET, ndoshta Ju ndihmoj nëse këtu publikoj disa vlerësime që i janë bërë këtij romani. Po shpresoj se do keni kohë, vullnet të mirë e interes për t'i lexuar.
Jam në dispozicion Tuajin për pyetjet që do beni, njëherit i mirëpres vlerësimet dhe kritikat. Po shpresoj se administratoret, gjegjësisht "mbikëqyrja" e këtij bashkëbisedimi, nuk do "censurojnë" asnjërin, për të shpreh mendimet e tyre, qoftë edhe fyerjet dhe sharjet. E pata shpreh edhe një herë, se sidomos të tillët kanë nevojë të "zbrazen". Kështu ata do të ndihmohen për t'u qytetruar.
Dihet, jo vetë kombi ynë, ka edhe plangprishës dhe të pa qytetëruar. Dhe, pse ka të tillë, nuk është faji vetëm i tyre, por faji i të gjithëve. Sikur të ishim komb më i fortë dhe më i zhvilluar, do kishim më pak të tillë, pasi kombi i zhvilluar "prodhon" më pak plangprishës (të pa qytetëruar) dhe pastaj me atë kategori merret seriozisht, për t'i ngritur dhe integruar në shoqërinë e qytetëruar.
Në vazhdim i keni disa vlerësime për romanin ATENTATET:
Adem Gashi (shkrimtar):
DYNDALLA E MENDIMEVE
(Ekskursion paranoik nëpër librin "Atentatet" të Ibrahim Kelmendit)
Referenca për U. Uitmenin "Uollt, ti ke mjaft brenda vetes, përse nuk e zbraz?"...

1.
Derisa lexoja dorëshkrimin "Atentatet" (ndonja 600 faqe tekst) nga pozicioni i lexuesit të parë e ndieja trysninë e lodhjes e të trishtimit, të përhumbjes e të kotësisë, të mllefit e të ngazëllimit, të vajit e të ekzaltimit. Autori kishte hedhur furtunshëm mbresat, kujtimet e përvojën e tij disa vjeçare në një radhor tekstual, pas një çerekshekulli. E pranova torturën i joshur nga tri a katër elemente që i konsiderova vlera. E para: duke qenë vetë njëri nga aktorët e këtyre ngjarjeve, merr kurajën të shkruajë pa shtihamë e krekosje: Ky është varianti im i rrëfimit dhe i së vërtetës! – thotë ai. Mistifikimi i vetëm: autori narrator vetëpersonifikohet me kryepersonazhin në veten e tretë – Miranin; E dyta: duke e bartur peshën e tragjedisë për rreth çerekshekulli, autori krijon largesën e nevojshme me aktndodhjen, pa lënë shteg ndikimi në kohën tonë nga përndezja e pasioneve, po aq sa edhe nga marrëzia e harresës; E treta: tejkalimi i vetvetes dhe i rrethanave kontekstuale duke e shpërfaqur dramën-dilemë për foshnjërinë dhe adoleshencën politike, kur njeriu brenda ditës gdhihej atdhetar e ngrysej tradhtar, ngrysej politikan e gdhihej demagog, kur trasta e kredos politike të veprimtarëve ngjante me strajcën e magjupës përzier me teorira ideologjish të skajshme politike. Nuk thashë kot në fillim ekskursion paranoid, sepse pranë mendimeve-perla të një filozofi të lashtësisë shfaqeshin broçkullat e ndonjë mistreci komunist, pranë urtisë popullore sloganet e zvjerdhura të moralit të shpëlarë, pranë dijes së orakullit fodullëku i

të parit të mëhallës. Megjithatë, megjithatë... gjithë kësaj shtjelle nuk i mungonte vullneti dhe aspirata për liri.

2. Për tragjedinë shqiptare të 17 janarit të vitit 1982, kur u vranë Jusufi, Kadriu e Bardhi, unë kam lexuar tri vepra që i përkasin lëmit të letërsisë. "Baladë për vdekjen e J. G.", tregim i Ismail Kadaresë; "Jusufi", novelë e Zejnullah Rrahmanit dhe "Atentatet", roman i Ibrahim Kelmendit. Tregimi i të parit ndërtohet sipas skemës së rrëfimit policor, novela e të dytit sipas predikimit mitik, biblik e simbolik, romani i të tretit sipas modelit-përvojë të Atë Zef Pllumbit "Rrno për me kallxue". Ibrahim Kelmendin e kam takuar së pari në verën e vitit 1990, në Zvicër. Ai ka rrojtur që të rrëfejë (në fund të fundit letërsia s'është tjetër veçse një rrëfim a një vetërrëfim). Së fundi e pashë sot paradite, në mos edhe para pak çasteve këtu në këtë sallë. E kam ditur dhuntinë e tij për shkrime të tjera, po kurrë për letërsi. "Atentatet" është një roman ku brenda shtatë kaptinave përvijohet jeta dhe veprimtaria e shqiptarëve në emigracion, në dekadën e shtatë, të tetë dhe të nëntë të shekullit të kaluar. Pavarësisht nga titulli atentatet romani më së paku e trajton aktin kulmor të shkrepjes së plumbave. Krismat vijnë vetëm si jehonë e kumtit të përzishëm, si jehonë mandate. E po vepra letrare nuk është kronikë a lajm gazete. Ajo sjell atmosferën, gjendjen psikologjike e shpirtërore, vrasjen, vetëvrasjen, grackën, lëkundjen, tundimin e ndërgjegjes së njerëzve. Aty është farka ku nga shkëndijat e vogla plasin zjarret e mëdha të dramave, të tragjedive, po edhe të fitoreve të mëdha.
Në planin e gjuhës e të stilit autori nuk del më tej mëhallës së amatorive. Veçoj me këtë rast dialogun. S'di pse m'i kujton romanet e Remarkut. Kelmendi shumë më saktë e jep tablonë përmes bashkëbisedimit sesa përmes përshkrimit. Vetjet e romanit, po të flisja sipas teorisë së dramës, i përkasin personave autentikë të emigracionit, duke u shfaqur me siglat e emrave e të mbiemrave. Kelmendi është nga të rrallët autorë që ka pasur kurajën t'i shpalojë edhe marrëzitë e çoroditjet, shfytyrimin e çnatyrimin e bëmave të njerëzve, pa e kursyer as veten. Kur ta lexojmë me këtë dioptri kritike historinë tonë dhe sidomos historinë tonë politike them se kemi maturuar në planin e ideve politike e shoqërore.

3. S'ka shumë kohë që lexova një intervistë të Gabos së madh, Garsia Markezit. Kur e pyetën si ndodhi që gjatë gjithë vitit 2005 as shkroi dhe as botoi gjë, ai u përgjigj: Besoj se ju të gjithë e dini se unë, së paku më përvojën që kam, kurdo mund të ulem e të shkruaj një roman. Madje një roman shumë të mirë. Po nuk e bëj dot nga konsiderata që kam për lexuesin tim. Ai lehtë do ta hetonte se në romanin tim mungon shpirti im, qenia ime. Në dy veprat e para që zura ngoje për këtë vullkan ngjarje, në tregimin e Kadaresë dhe në novelën e Rrahmanit shkëlqen mjeshtëria shkrimore, zanati i shkrimtarit. Në romanin e Kelmendit është derdhur furtunshëm shpirti i i autorit, bashkëveprimtarit të heronjve. Zgjidhni dhe merrni!

Sali Kabashi (Botues, publicist, kolumnist):

Për romanin ATENTATET

Do të doja të prezantoja librin e ri të një pjesëtari të njohur të Mërgatës shqiptare të Evropës. Ibrahim Kelmendi nuk është kushdokushi. Ai është për rreth 30 vite aktiv në gjirin e asaj që të shumtën e kohës është quajtur Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës, e cila, siç dihet sot, njihet me emrin LPK dhe është e pranishme me një deputet edhe në Parlamentin e Kosovës. Këtu nuk do të shkruaj për këtë, por për librin Atentatet dhe për autorin e tij, pasiqë në rastin konkret ata as nuk mund të ndahen nga njëri-tjetri. Ibrahim Kelmendi edhe më parë e ka sprovuar pendën e tij në

publikime e libra të tjerë. Por, kësaj radhe ai ka dalë me një libër, që në fakt është një evokim kujtimesh nga gjiri i Lëvizjes atdhetare më të përfolur e më të kontestuar, njëherit edhe më të lëvduar e më të glorifikuar. Në ballë të saj, mu në majat e saj, bile edhe ndër themeluesit e Lëvizjes, të gjithë e kanë ditur se qëndronte vetë Ibrahim Kelmendi. Lidhur me të janë thënë e stërthënë gjera tepër fantastike. Ka pas aq shumë përgojime, sa mua personalisht më brengoste dhe njëherit më mahniste këmbëngulja e tij për të heshtur. Ai heshtte pothuajse për gjithë bjeshkët e thashethemnajave. Nuk ka shumë muaj qyshse në një komunikim përmes postës elektronike i kisha shkruar se ai duhej, më në fund, të shkruante versionin e tij lidhur me atentatin e UDB-së mbi Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën e Bardhosh Gërvallën. E kam ruajtur atë komunikim relativisht të shkurtër dhe nuk e kam vështirë të kujtoj se ai ende kishte mëdyshjet e tij që do ta bënte librin, do ta linte për një kohë tjetër apo do ta braktiste fare një ide të tillë. Kjo ishte përshtypja ime e asaj kohe dhe mbështetej në një gati indiferencë e tij lidhur me një libër eventual. Por një gjë e kisha të sigurt: Ibrahim Kelmendi ishte njëri ndër njohësit më të mëdhenj të realiteteve të mërgatës shqiptare. Për mendimin tim ai ishte një profesionist në politikë. Student gjerman dhe për pasojë një njohës i shkëlqyeshëm i gjuhës gjermane, një orator shembullor, një njeri i hazërxhevapeve, siç thonë, Ibrahim Kelmendi më pati fascinuar mua dhe një mikun tim, shkrimtar i shquar slloven, kur të ftuar nga një asociacion për të drejta të njeriut nga Munihu (München), patëm shkuar që të shpalosnim dosjen shqiptaro-sllovene të Kosovës se vitit 1989. Miku im, më një nuhatje fantastike, më pat thënë e më vonë edhe e pat shkruar në shtypin slloven, se lider i ardhshëm i Kosovës se re paskomuniste do të ishte Ibrahim Kelmendi. Peter Bozhiç quhej shkrimtari slloven dhe si fëmijë kishte kaluar nëpër kampet naziste në Gjermani.

Nejse, kjo është ajo që më ka mbetur në kujtesë nga ajo kohë. Tashti kemi librin Atentatet. Kemi edhe autorin e tij, për të cilin thashë se e konsideroja një njeri me profesion politikani. Tash Ibrahim Kelmendi nuk është askund në politikë. Apo ai vazhdon ta bëjë politikën në mënyrën e tij tejet origjinale. Edhe libri i tij është origjinal në shumë pikëpamje. Origjinal si zhanër. Ai e quan roman, mbase për të shpëtuar nga grackat e akuzave që pas botimit të librit atij mund t'ia bëjnë njerëz që janë përmendur me emra të gjymtuar, me emra të shpifur, me emra të vërtetë. Mirani është personazhi kryesor i librit dhe nuk është vështirë të merret vesh se ai personifikon vetë autorin. Ç'deshi Ibrahim Kelmendi që të shfaqet me këtë libër vetëm tashti? Ishte një shqetësim i tij intelektual, apo një kthim kusuri të gjithë atyre që e kishin sharë e akuzuar derisa ai kryesisht heshtte? Mund të jetë dhe mund të jetë tjetra, por mund të jenë edhe të dyja bashkë. Sido që të jetë, pasi e lexova librin, edhe unë kam nxjerrë konkluzionet e mia:

E para, libri i tij e pasuron atë që ne e quajmë literaturë e Diasporës shqiptare, e cila dita ditës po bëhet më e begatshme dhe pasuruese e letërsisë dhe publicistikës sonë kombëtare.

E dyta, libri Atentatet do të çojë shumë pluhur dhe do të nxisë edhe të tjerë veprimtarë në Diasporën tonë që të shkruajnë memoaret e tyre. Bile kjo do ta inkurajojë më shumë edhe vetë Kelmendin që të shkruaj edhe libra të tjerë. Sepse, nëse përpara është thënë se fjala nxjerrë fjalën, tash mund të thuhet, sidomos në rast si ky, se libri nxjerr librin, tëndin apo të tjetrit që do ta kundërshtojë librin tënd.

E treta, libri Atentatet, në të vërtetë është një kundërgoditje e fuqishme për gjithë ato që unë i quajta fabrikues të atyre bjeshkëve të mëdha të shpifjeve e të thashethemeve.

E katërta, përmes romanit të tij politik dhe memoaristik, Ibrahim Kelmendi ka sfiduar edhe ata që ende janë të fuqishëm dhe që janë gjallë, por që kanë qenë, për faqen e zezë të tyre, shërbëtorë të UDB-së famëkeqe, e cila ka veshur në të zeza shumë motra e nëna. Po të zhvishej nga ai petk i hollë i literaturës së mirëfilltë, anarkisti Ibrahim, siç e kanë quajtur të tjerët dhe që, siç duket, i pëlqen ta quajnë, përmes kësaj vepre u ka hapur shtegun zbulimit të shtisëve e dorasëve mbi vëllezërit Gërvalla dhe të Kadri Zekës. Libri ka sfiduar rëndë spekulantë të ndryshëm që akuzonin pa fije turpi njerëz të pafaj për gjoja vrasjen e tre heronjve të Kosovës. Po të kishim të ndërtuara struktura drejtësie, siç ka në vende evropiane, prokurorët, qysh në ditën e daljes së librit në treg, do t'i priste një punë e ngutshme.

Dhe e pesta, libri edhepse voluminoz, lexohet me një frymë. Libri ka ritmin e tij që të rrëmben dhe të bën të jesh ngjitur me te deri në faqet e fundit, kur në kopertinë qëndrojnë vlerësimet e Prend Buzhalës e të Adem Gashit. Ky i fundit në parafjalën e tij ka lënë të shkruar: "Ky shkrim s'është gjë tjetër veçse një akt dëshmimi i autorit, blatuar hyjneshës se tij, të vetmes dhe të tërëkohshmes." Prend Buzhala, ndërkaq, flet për Rrëfimtarin autorial dhe për librin që lexohet si dorëshkrim letrar.

Vetë autori e ka parë të udhës që në fund të sqarojë (citoj): "Ngjarjet e romanit janë fragmente të jetës dhe veprimtarisë në ekzil, gjatë viteve 1979-1982, të personaliteteve tashmë historike, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla dhe të bashkëveprimtarëve e të kundërshtarëve të tyre. Ato janë pasqyruar ashtu siç i kam përjetuar dhe siç i kam mbajtur mend, pa pretendime për të qenë të vërteta historike. Mendimet dhe vlerësimet janë të kohës kur kanë ndodhur ngjarjet."

Krejt në fund edhe ky element i rëndësishëm për raste të këtilla: Libri është botuar nga Focus, është botuar gjatë janarit dhe fillimshkurtit nga shtypshkronja Blini në Gjakovë. Kopertinën e ka punuar Ngadhnim Memhmeti në Shkup, ndërsa për faqosje autori nuk ka paguar asgjë, sepse e ka bërë vetë. As shtypi nuk i ka kushtuar gjë, sepse brendësinë e ka financuar Focusi, kurse kopertinën Ngadhnjim Mehmeti. Deri në dalje të librit autori është ndihmuar me mbi 3.000 euro nga individë të ndryshëm. Pra, mund të kenë ardhur ende në adresën e tij, sepse ai aty ka të shënuar edhe dy konto bankare. Është shënuar se libri është botuar në 3.000 ekzemplarë dhe është paralajmëruar se do të ketë edhe një ribotim. Nga kjo pikë Ibrahim Kelmendi del krejtësisht dhe plotësisht i suksesshëm, sepse në epokën paskomuniste librat nuk botohen më në tirazhe kaq monumentale. Ndërsa polemikat për librin, pa ftohur mirë ai nga rotativat, kanë filluar me bujë. Ne diasporikët, kësodore, do të fusim bashkëkombësit tanë në Atdhe që t'i flugën leximit dhe t'i shkëpusim nga limonadat serike latino-amerikane.
(Revista REPUBLIKA, nr. 3, 2007)

Sadri Ramabaja (Politolog, kritik letrar):

Dëshmitari dhe krijuesi i historisë
Roje e vetëdijes kombëtare dhe e së vërtetës

(Dy fjalë për romanin ATENTATET, autor Ibrahim Kelmendi, botues Fokusi, Prishtinë 2007)

Në këtë fjalë rasti për romanin e veçantë ATENTATET, të autorit poashtu për shumëçka të veçantë, Ibrahim Kelmendi, duke pas

parasysh se të tjerët mund të ndalen dhe ta kundrojnë atë nga aspekti thjesht letrar, dua të nënvizojë pikërëndesat dhe ndërlidhjet që reflekton poetika e romanit në bashkëjetesën e natyrshme të artit me politikën.

Në letërsinë shqipe bashkjetesa e artit me politikën ka pas që në zanafillën e saj edhe mision historik: zgjimin e vetëdijes kombëtare dhe krijimn e shtetit shqiptar. Ndërkaq si vazhdim i kësaj tradite pozitive në letërsinë shqipe, autori i romanit ATENTATET, i ka vënë vetës për detyrë parasëgjithash mbrojtjen e së vërtetës dhe vetëm të vërtetës. Krahas kësaj përmes përmbysjes së hierarkisë së ideolatrisë utopiste, ai prajshëm, por pa atë modestinë që e karakterizon në jetë, ndjek hullinë e Brehtit të madh, duke u shndrruar plotësisht në një shkrimtar të angazhuar në kuptimin e mirëfilltë dhe më pozitiv të mundëshëm të kësaj fjale.
Heronjtë kryesor të romanit triller ATENTATET: Mirani, prapa të cilit, e qartë, është vet autori, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla, do të hyjnë kështu në galerinë e personazheve - roje të vetëdijes kombëtare.
Ndërkaq kryeheroi i biografisë së romanizuar – Mirani, mund të shikohet si model i bashkëjetesës dhe përplotësimit reciprok të narratorit si personazh letrar dhe autorit të romanit i njohur parasëgjithash si veprimtar politik.

Përzgjedhja e këtij zhanri të letërsisë për t' ju qasur epokës së ilegales shqiptare, duke pasur përherë si motiv qenësor intencën kombëtare të veprimtarëve të saj, i ka dhuruar letërsisë sonë një model të veçantë të heroit- Miranin – që si busull orjentuese në jetën e tij, si personalitet i kompletuar, ka intencën kombëtare, njerëzoren dhe të vërtetën. Intenca kombëtare me kalimin e kohës i bëhet pikë referuese, standart për të gjykuar për çdo hap në jetë edhe në kohën kur ai fillon studimet në Filozofi dhe gjermanistikë, zgjidhet si student aktiv në Kryesi të organizatës së Studentëve të Universitetit të Bohumit, kur fillon botimin e Bashkimit, shtron platformën politike të Frontit të Kuq, kur bashk me Jusuf Gërvallën dhe Kadri Zekën diskutojnë rreth Tezave e Frontit, që më vonë do të shndrrohen në Platformë politike të Lëvizjes për Republikën e Kosovës etj. Ai për asnjë qast, si intelektual i kompletuar nuk lejon që të shndrrohet në farë idealisti utopist. Shi për këtë me kohë mendon diferencueshëm, nuk e identifikon socializmin teorik me pseudosocializmin e shteteve pseudosocialiste, gjegjësisht me sistemin diktatorial monist.

Duke pas parasysh rrethanat në të cilat vepronin Mirani, Jusufi, Kadriu, Bardhi etj., duke njohur brumin përmes të cilit mëton ta bëjë bukën – armatën e emigracionit tonë gjysmëanalfabet etj. puna e tyrej prej titani del edhe më në pah, meqë ata i kishin shtruar vetes detyrën fisnike prej revolucionari dhe edukatori: të ndikojë te këta njerëz dhe në krejt procesin historik duke ndikuar në vetëdijsimin e tyre, që do të rezultojë me luftën për çlirimin e pjesëve të pushtuara të atdheut.
Këtë punë Mirani e bënë me përkushtim, me këmbënguljen tipike të revolucionarëve dhe si busullë ditore ka interesin kombëtar.
Ndërkaq ai nuk lodhej fort se çfarë mendonte për të dhe bashkëpunëtorët e tij "ajka" e reaksionit të ashtuquajtur djathtist që nuk e kishin për turp të krenohen edhe për aktet makabre siç ishte rasti i Muharrem Bajraktarit në vrasjen e Bajram Currit. Kjo shtresë e llumit historik me atë të ashtuquajturin patriotizëm të tyre arkaik, ishin shndrruar në mumje neveriitëse edhe për fëmijët e tyre, shumica e të cilëve tashmë nuk flisnin shqip.siç do të shpreht në një rast një bijë e Malësisë së Gjakovës, studjuese e shkencave politike, që e takon krejt rastësisht në relacionin Bruksel-Nju Jork.

Romanin ATENTATET kam prirje ta shikoj si një vepër letrare që ka

një mison tjetër jashtëletrar – të dëshmojë për të vërtetën rreth atentatit fizik dhe atentateve tjerë politik etj. që iu bë Jusufit, Kadriut e Bardhit më 17 janar 1982 dhe Lëvizjes si tërësi deri në qershor të vitit 1999.
"UDB-ja, shprehet në një rast Mirani, personazhi kryesor i romanit, nuk e ka pasur për synim vetëm vetëm mënjanimin fizik të Jusufit, Kadriut e Bardhit, sepse atë mund ta bënte edhe më heret. Ajo ka përgaditur terrenin që, pas atentateve fizike ndaj shokëve, të bëjë atentate të njëpasnjëshme ndaj lëvizjes sonë patriotike".
Duke qenë pjesë e kësaj Lëvizje dhe mik i autorit për më se 20 vjet rresht, pra edhe njohës i shpirtit të tij krijues, mund të shpreh bindjen këtu dhe në këtë rast se romani që do ta pasojë këtë, si temë bosht do ta ketë të ashtuquajturën alternativë politike të ngritur në Kosovëë në vitet e 90-ta dhe pjesë të tëra të saj që shërbyen si mekanizëm i UDB-së për shpërlarjen e trurit të një populli të tërë, duke e bindur atë për pamundësinë për t`përballuar luftën me Serbinë. Nëse autori nuk do taë arrijë ta bëjë këtë për një arsye apo tjetër, sigurisht romani ATENTATET, do të shërbejë si model i mirë për ndonjë autorë tjetër nga kjo lagje e kriptoelitës sonë që tashmë po del në shesh.
Po të mos ndodhte atentati i 17 janarit 1982 dhe atentatet politike që pasuan brenda Lëvizjes dhe më pas edhe brenda UÇK-së, sigurisht se Kosova dhe shqiptarët në tërësi sot do të ishin subjekt dhe faktor i dinjitetshëm i familjes së popujve në Evropë, pa qenë të shtrënguar të përgaditen të jetojnë edhe më të ndarë dhe me tutorë mbi kokë.

Romani ATENTATET natyrshëm më ngjet se do të jetë si një ledh mbrojtës përball demistifikuesve të strategjisë kombëtare në letrat shqipe dhe gjetkë. Autori i tij, meqë i takon kripto elitës kombëtare tërësisht të pakontrollueshme, që përmbysi shumë plane të superstrukturave elitare intelektuale dhe ushtarake, duke krijuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës që do ti hapte rrugë çlirimit të Kosovës nga zgjedha serbe... natyrshëm, duke u identifikuar plotësisht me Miranin si narrator, para lexuesit të gjerë na prezantohet jo vetëm si dëshmitar i historisë, po edhe si krijues i saj. (Kjo fjalë eshtë botuar edhe në gazetën FAKTI në Tetovë.)end Buzhala:

Prend Buzhala (Kritik letrar):

PROMOVIM – IBRAHIM KELMENDI: "ATENTATET",
(roman, botues FOCUS, Prishtinë 2007)
Kur merr fund leximi i romanit "Atentatet" të Ibrahim Kelmendit, tek iu bëhet homazh përjetësisë së tri personaliteteve historike, vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla e Kadri Zeka, në trevjetorin e rënies, lexuesi e ndien se nuk është në gjendje të dalë nga gjeratoret e misterit të krimit politik; të dalë nga humnerat e enigmave dhe të intrigave të rretheve nga më të ndryshmet, qofshin ato politike, të organizatave e lëvizjeve atdhetare, familjare a të interesave nga më meskinet; nga skenarë të fshehtë shtetërorë a të shërbimeve sekrete ndërshtetërore e ndërkombëtare që thuren pafundësisht; nga ngritje, hapje e përmbysje çështjesh e faktesh të ditura e të paditura; nga të provuarit e një morie përjetimesh që të tronditin; nga zbulime të vrullshme, nga pak të rrëmbyeshme e dehëse. I del parasysh panorama e gjerë epike e romanit, në të cilin parakalojnë personazhe të mërgatës shqiptare të të gjitha ngjyrave, me huqet e karaktereve që kanë, parakalojnë revolucionarë, politikanë kafenesh, pseudonacionalistë të shitur për një femër serbe, mashtrues e qelepirxhinj të ndryshëm, bixhozxhinj të shitur si politikanë e atdhetarë, janë njerëz të thjeshtë të emigracionit ekonomik, ende të shtypur nga mendësia e skllavit, vijnë ambasadorë, diplomatë,

komunistë e pseudo-ideologji të të gjitha tarafeve, spiunë, intelektualë, gazetarë, nëpunës policie, parakalojnë ngjarje, qytete e shtete të Evropës perëndimore. Parakalojnë demonstratat shqiptare për Kosovën Republikë nëpër qytetet gjermane e zvicerane, në Bruksel e SHBA, janë ecejeaket e pafund të atdhetarëve për drejtësi kombëtare nëpër zyra shtetesh, kancelarish ndërkombëtare a media botërore.

Kurse receptuesi i veprës, mandej, ka nevojë për një këndellje: e këtë mundësi ia krijon vetë autori me ndërthurjet e pleksjet e strukturës kompozicionale që e lë të hapur. Bartës i rrëfimit është Mirani, ndryshe një personazh ideografik i veprës (sikundër e ka përkufizuar këtë formalizim të ligjërimit që më 1879 logjicienti Gottlob Frege). Së këndejmi, autori ka arritur t`i bëjë një Artin e Jetës dhe Artin e Fjalës, t`i shquajë pistat, të përafërta e të përkundërta, të Idealistit dhe Revolucionarit, të Krijuesit dhe kronikanit letrar kundruall psedudove të shumtë, qofshin ata të stolisur me emra të bukur, si atdhetarë, revolucionarë, idealistë apo me emra të preferuar të kohës, si marksistë-leninistë, komunistë etj etj. I quajtur tashmë roman-thriler, vepra "Atentatet" e Ibrahim Kelmendit, megjithatë, ka shumë përbërës: veprimtaria e organizuar atdhetare dhe përpjekjet për bashkim të mërgatës politike shqiptare të Kosovës gjatë atyre viteve, si dhe rrethanat, si shprehet autori, para e pas atentatit ndaj tre personaliteteve tashmë historike, Jusuf Gërtvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës; një rrëfim autobiografik i pikëzuar përgjatë gjithë veprës, ashtu sikundër e afishon këtë edhe autori "fragmente të jetës dhe veprimtarisë në ekzil gjatë viteve 1979 – 1982", një relatë dashurie, takimesh, bashkëpunimi e debatesh me Renatën, studente gjermane. Sado që modeli diskurziv i kësaj vepre i përket autofikcionit a romanit autobiografik, tek lexohet si roman personal, a si publicistikë intime letrare, megjithatë, në kontekstin e përtashëm sociokulturor e historik, ai përpiqet ta mbajë distancën objektive me realitetin e viteve '80. Vetë epizmi romanor e përcakton këtë distancë me kohët e me njerëzit, ashtu sikundër e përcakton edhe motivacioni i personazheve me karakterologjinë e tyre.

Zhvillimin fabular të ngjarjeve shkrimtari e "defabulizon" përmes shtatë kapitujve: në kapitullin e parë romani hapet me festën e krishtlindjes, me panoramën epike të lëvizjeve atdhetare jashtë me bartësit e tyre dhe me arratisjen e Jusufit nga Kosova e pushtuar; në të dytin jepen pjesë autobiografike të personazhit të Miranit, nëpërmes trajtës së esesë e të kronikës letrare, në të tretin çmaskimi e shpërbërja e grupit pseudoatdhetar të personazhit të Rezilit, një dorë e zgjatur e shërbimit sekret jugosllav; në të katërtin jepet gjendja politike e mërgatës dhe ajo në Kosovë në prag të shpërthimit të demonstratave, si dhe përplasjet dramatike të mërgatës politike për t'u bashkuar; në pestin ndodh arrestimi tragjik i njërit ndër personazhet kryesore të veprës, Vasilit, jehona e demonstratave shqiptare në Kosovë, organizimi i tyre në mërgim, hartimi i tezave për bashkim politik; në të gjashtin kulmi arrin me vrasjen e tre personaliteteve në çastin kur po arrihej ideali i atdhetarizmit shqiptar për bashkim të organizatave të tyre politike dhe në të shtatin gjendja pas këtyre atentateve. Vepra është konceptuar sipas strukturës së romanit kriminalistik: meqenëse lexuesi di për vrasjen e tri figurave të shquara atdhetare, po ashtu ky receptues i letrave shqipe di se vrasja është e mbështjellë me një mister, kurse këtu, personazhi i veprës, Mirani, më shumë gjendet në rolin e zbërthimit të kësaj enigme, i cili bën punë të palodhur jo vetëm në çmaskimin e personave të infiltruar të armikut në radhët e mërgatës atdhetare, po edhe në çmaskimin e pseudove e të karaktereve të dyshimtë e joqëllimimirë, jorevolucionarë, që kishin ardhur aty jo për qëllime çlirimtare, po për qëllime të tjera. Autori përqendrohet në përshkrimin e aktorëve e të atyre rrethanave, të mbështjella ende me mjegulla të pleksura e me kundërthënie, me

pohime hamendëse, për të ringjallë interesime për intriga të shoshitura e të bëra sipas një skenari politik. Shumë ndër këta aktantë që ende janë gjallë, autori i përmend e i pikëzon me emrat e mbiemrat e tyre të vërtetë. E, mbi të gjitha, aty përcillen mesazhe atdhetarie e humanizmi. Në poetikën e ndërthurjes shumështresore, autori na detyron që në tryezën e leximit të na vijnë nocionet teorike-letrare post/moderne si eseja biokritike, hibridizimi i zhanreve, biografia letrare, autobiografia, memoari, biografia e romanizuar, trajta letrare e kronikës, bioletra, epistola etj etj e që po i përkufizojmë me nocionin bioproza. Sa do që "Atentatet" është dëshmi dokumentare për dramën shqiptare të këtyre anëve në shtegtimet e lirisë, që nga viti 1979 e deri më 1982, për vëllezërit Gërvalla e Kadri Zekën; sa do që lënda e pasur dokumentare e librit është paraqitje dokumentare e fatit të njerëzve; sa do që autori është rrëfimtar i jetës së përditshme; sa do që ai gërsheton elemente të reportazhit e të romanit, të letrës e të kronikës publicistike me strukturën tekstore të udhëpërshkrimit dhe, më në fund, rrëfimin në veten e tretë me dialogun sokratik-platonian – kudo është i pranishëm Rrëfimtari Autorial që unifikohet me Unë-in e personazheve tjerë autentikë: si modalitet i veçantë i së vërtetës. Është jeta ajo që e ka përgatitur shkrimin e veprës, do të thoshim: krijimin e rrëfimit. Mandej lexohen linjat narrative art-jetë, fikcion-realitet.

"Atentatet", në radhë të parë do lexuar si vepër letrare, si roman, meqë të tillë e ka përkufizuar edhe vetë autori. Kjo do të thotë se edhe ky roman kuintesencë estetike të veten e ka imagjinatën letrare, fikcionin autorial. Është thënë shpesh se s' ka letërsi pa imagjinatë letrare, e cila thuret e endëzohet mbi të vërtetat e një kohe, mbi veçoritë thelbësore të jetës, mbi tiparet individuale të personave të veçantë, mbi universin e paanë të jetës, të kohës, të historisë e të ambienteve. Romani t'i jep ato mundësi që nuk t'i jep, bie fjala, një libër dokumentar, i mbështetur e i thurur mbi dëshminë, mbi faktin dhe mbi të vërtetën. Dhe sa e sa herë lexuesit e kanë shtruar pyetjen: a na e mëson të vërtetën imagjinata letrare? Bioproza e Ibrahim Kelmendit përbën një thurje shumështresore dhe të ndjeshme, përbën një modalitet të veçantë të së vërtetës; sado që, në pamje të parë, të lë përshtypjen e një rrëfimi të thjeshtë. Aq sa të duket se po lexon një bioroman, po aq futesh në shtigjet e romanit kriminalistik. Ndryshe, shumështresimi romanor hap shtigje të shumta pajtimi a mospajtimi po edhe mundësi të shumta për lexim.

2007, Prishtinë 5 shkurt 2007 (Botuar edhe në gazetë javore FOCUS)

Avni Dahari (poet e publicist):

"Atentatet" - sjell kujtimin për vrasjen tragjike të 17 janarit '82

"Nëse dorasit janë shqiptarë, mos u zbulofshin kurrë!" – amaneti i Jusuf Gërvallës me të cilin i shpallet luftë përçarjes dhe vëllavrasjes.

Me rastin e 25 vjetorit të rënies së tre dëshmorëve Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla shtëpia botuese "Focus" në Prishtinës e botoi romanin "Atentatet" të autorit Ibrahim Kelmendi. Romani trajton për temë veprimtarinë patriotike të Jusufit, Kadriut, Bardhoshit, Ibrahim Kelmendit dhe bashkëveprimtarëve të tyre në mërgim, kryesisht në Gjermani dhe në Zvicër. Gama e veprimtarisë së tyre me theks çlirimtar shtrihet edhe në disa shtete të Evropës dhe të kontinenteve të tjera. Tema që shtjellohet në këtë roman, ka për bazë synimin dhe përpjekjet çlirimtare të popullit tonë të pushtuar nën Jugosllavi, i cili në mars dhe prill të vitit 1981 u ngrit në demonstrata gjithëpopullore për liri dhe barazi me popujt e tjerë në këtë shtet.

Romani “Atentatet” është shkruar nga një autor, i cili një kohë të gjatë ka vepruar me tre dëshmorët, të cilët të përndjekur për shkak të veprimtarisë patriotike në Kosovë, detyrohen të gjejnë strehim, Kadriu në Zvicër, ndërsa Jusufi e Bardhoshi në Gjermani, ku do të kryhet atentati në natën e kobshme të natës së 17 janarit të vitit 1982. Si bashkëveprimtar i tyre Ibrahim Kelmendi ka sjellë brumë të mjaftueshëm për t'u njohur me përpjekjet dhe veprimtarinë organizative për çlirimin e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi.
Jusufi, Kadriu e Bardhoshi, bashkë me kryeprotagonistin, autorin, që në roman mban emrin Mirani, janë veprimtarë të rinj. Ata janë të pajisur me dëshirën më sublime, përkushtimin për punë dhe gatishmërinë për sakrificë deri në vetëflijim. Edhe pse kishin thithur njohuri teorike nga librat e shumtë për luftërat çlirimtare dhe revolucionet që kishin lexuar e që po lexonin, atyre u mungonin përvoja dhe shumë njohuri të artit të luftës. Të vetëdijshëm për këto mangësi ata do t'i vënë vetes për obligim që me njohuri të tilla teorike e praktike të pajisen krahas ushtrimit të veprimtarisë organizative me mërgimtarët.
Të katër bashkëveprimtarët janë më se të vetëdijshëm se bashkimi i organizatave OMLK, LNÇKVSHJ dhe Froniti i Kuq Popullor që përfaqësoheshin me organet “Liria”, “Lajmëtari i lirisë”dhe “Bashkimi” ishte më se i domosdoshëm. Ata do t'i hyjnë punës së palodhshme për bashkimin e këtyre organizatave në organizatën Lëvizja/ Fronti për Republikën e Kosovës, e cila do ta marrë përsipër organizimin e veprimtarisë patriotike në mërgim dhe në trojet tona nën Jugosllavi. Gjatë realizimit të këtij qëllimi tepër fisnik ata do të hasin në vështirësi të ndryshme dhe të shumta. Numri i vogël i përkrahësve nga radhët e mërgimtarëve ekonomikë, që në roman përfaqësohen në mënyrë tipike nga Hysni G.  Vasili, Maksi, Rexhep Halimi, Hakani e ndonjë tjetër, edhe pse të përkushtuar deri në sakrificë, do të jetë mbështetje e pamjaftueshme për t'u bërë ballë sfidave të shumta. Kundër tyre ishin angazhuar pseudopatriotët, naivët, demagogët, udbashët dhe bashkëpunëtorët e tyre, të cilët duke u futur nëpër klube dhe organizimet politike manipulonin me mërgimtarët tanë ekonomikë që, si pasojë e robërisë, kishin nivel shumë të ulët arsimor. Me mashtrime, kërcënime, frikësime, shantazhime, me marrjen e pasaportave, torturave fizike dhe me burgosje (kur mërgimtarët ktheheshin në atdhe), ata i përçanin këta hallexhinj dhe ushtronin presion mbi ta që jo vetëm të distancoheshin nga veprimtaria patriotike që zhvillohej në vend dhe në mërgim, por edhe ta dënonin e ta luftonin atë.
Shumica e personazheve në këtë roman ose janë bashkëpunëtorë të autori dhe dëshmorëve ose kundërshtarë të tyre. Një pjesë e emrave të tyre janë të vërtetë, ndërsa të tjerët edhe pse të sajuar shumë lehtë mund të identifikohen me bartësit e tyre. Në figurën e Jusuf Gërvallës gërshetohen tiparet e një atdhetari me edukatë tradicionale kombëtare dhe të një intelektuali me një diapazon të gjerë kulturor që vihet me tërë qenien për çlirimin dhe bashkimin kombëtar. Amaneti i tij “Të mos jua dëgjojë kush vajin, sepse e kemi krenari të flijohemi për Kosovën!” – që në çastet e fundit ia thotë bashkëshortes, janë fjalët më të spikatura që flasin për përkushtimin e vetëdijshëm të tre dëshmorëve deri në flijim. Kadri Zeka, që po ashtu është personazh kryesor në këtë roman, krejt kapitalin e tij patriotik dhe të gjitha aftësitë dhe njohuritë revolucionare i shkrin po për këtë ideal. Në roman shquhet edhe figura e Nënëmadhes Ajshes, nënës së vëllezërve Gërvalla, e cila pas atentatit nuk pranon t'i shihte djemtë e vetë të vrarë, para se t'i fliste Kadriut, të cilin e quan djalë. Ajo do t'i bëhet nënë edhe Miranit, të cilin nuk e ndan nga Kadriu, Jusufi, e Bardhi. I tillë është edhe Babai i Kadri Zekës, i cili duke e pasur parasysh se në mesin e atyre që vinin për ngushëllime, kishte bashkëpunëtorë të UDBsë, ndër të tjera thoshte: "Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje u bëra i

njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllime dy ditët e para sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha, do ta kisha vrarë vetë djalin tim dhe do t'ia kisha lënë fajin UDBsë." Me përshkrime të gjalla na paraqiten Drita bashkëshortja e Jusufit, Saranda bashkëshortja e Kadriut, fëmijët e Jusufit që një dhomë në shtëpinë e tyre e quanin dhoma e xhaxhit Miran. "Shyqyr që na shpëtove ti, xhaxhi Miran!" – janë fjalët e vajzës së Jusufit, Dardanës së vogël, që shprehin afërsinë dhe besimin për njeriun që e çmonin si anëtar të familjes dhe luftëtar të çështjes kombëtare.
Mirani Ibrahim Kelmendi, njeri praktik, që për veprimtarinë e mëtejme mbështetet fort në Jusufin e Kadriun, mallkon veten që nuk kishte qëlluar të vritej në natën e kobshme të 17 janarit. Bashkë me brengën e madhe në shpirt, ai, tani, pa shokët e idealit, duhej të luftonte kundër UDB-së e cila në bashkëpunim me Rezilët, Qerosët e Xhahilët dhe shërbimet e fshehta gjermane dhe të shteteve të tjera, sabotuan, minuan e kryen atentatin. Dorasit duke i vrarë tre bashkëluftëtarët e tij bënë atentat shpirtëror edhe mbi Miranin, mbi familjen Gërvalla, mbi familjen Zeka, mbi shumë bashkëveprimtarë të tjerë dhe mbi tërë Lëvizjen, e cila do ta marrë të mbarën falë përkushtimit dhe sakrificës së pasuesve të mirëfilltët që do ta ndjekin shembullin e të rënëve më 17 janar në Gjermani.

(Botuar në gazetën javore "Focus", më 02.03.2007)

Rasim Selmanaj (poet e publicist):

Botimi i gazetës FOCUS, ma ka ushqyer, pashmangshëm "mallin e stampes" – siç do të thoshte Buzuku mendjendritur. Prirë nga kjo ndjenjë, kam publikuar një dyzinë librash të zhanreve të ndryshme letrare. Midis këtij korpusi, ja edhe kjo e sotmja, "Atentatet" e Ibrahim Kelmendit.

Raportet e mia me këtë libër dhe me këtë autor, nuk janë raporte të rëndomta të botuesit me autorin, dhe as të interesit. Është jehona e ngjarjes së madhe të para-çerekshekullit që vjen në jehonën e kohës duke më ndjekur gjithandej, vijave që formojnë biografinë time: në shkollë, në punë, në luftë, në burg, në liri e në paqe. Në këtë përthyerje vijash, jeta ime ndahet përgjysmë: para atentatit dhe pas atentatit. Çuditërisht, në këtë të dytën, zë fill misteri si një lum nëntokësor që herë shfaqet, e herë humbet, duke lënë sheshit vetëm ca shenja e kode si pika orientimi brenda një hapësire të pacaktuar.

Deri tashti, për këtë tragjedi janë dhënë qindra lajme e kumtesa me variante e nënvariante, me siglën sekret, top-sekret, rezervat etj. Mendja më thoshte dhe më thotë se çdo kumtesë "zyrtare" shtetërore është më çoroditëse se rrëfimi më i trilluar i krijuesit, sado e mëvetësishme dhe subjektive qoftë ajo.

Shpalimin e këtij libri doja ta bëja mu në përvjetorin e rënies së heronjve, më 17 janar, në Deçan, por qenë defektet e makinave të shtypshkronjave, mungesa e dritave, korrentit që e bënë vonesën. Tani jemi këtu, sonte. Defektet e makinave i kuptojmë dhe i lëmë me një anë! Por nuk i kuptojmë dhe nuk i lëmë siç nuk na lënë të qetë defektet e ndërgjegjes sonë. Ndaj, që ato të mos ndodhin, që ato të mos përsëriten, që mbretëria e territ të mos kthehet në mendjet tona, po i japim dorë fillimit të shpalimit të enigmës.
Kurdo qoftë është më i pranueshëm një sherr që duket, sesa një lajkë erëkëndshme, e padukshme. Për aq sa është në dorën time, unë do të vazhdoj t'i shpalos "sherret" edhe me botime të tjera.

Shemsi Reçica (Ligjerues i loshikës në Univerzitetin e Prishtinës,

Nënkryetar i Komunës se Lipjani, publicist):

(Fjala në përurimin e romanit ATENTATET, më 05.03.2007, në hotel VICTORIA në Prishtinë)

Zonja e zotërinj,

Në qoftë se më lejohet të shprehem në mënyrën dhe stilin që është shprehur autori Ibrahim Kelmendi në librin më të ri të tij, ATENTATET, dhe në qoftë se lejohet që në përurime librash të thuhet diçka e veçantë ose edhe e kundërt me vijën e përgjithshme që është praktikuar të ndiqet në raste të tilla, atëherë mund të them se lexuesit shqiptarë kanë në duar një libër problematik, në të cilin flitet për ngjarje e personalitete, gjithashtu problematike.

Gjykuar sipas përmbajtjes së librit dhe sipas dialogëve e debateve të ashpra ndërmjet personazheve të librit ATENATET, njëri prej të cilëve është, pa dyshim, Ibrahim Kelmendi, edhe për vetë autorin e librit mund të thuhet se është problematik.

Sa di unë, ATENTATET është libri i dytë i Ibrahim Kelmendi. Edhe libri i parë i tij, SHQIPËRIA JASHTË "VERIUT" DHE "JUGUT", mund të quhet libër problematik, ashtu siç mund të quhen problematike edhe ngjarjet që trajtohen në atë libër.

Për ngjarjet dhe për personalitetet që trajtohen në të dy librat e Ibrahim Kelmendit kanë shkruar shumë autorë, por pothuajse të gjithë, me ndonjë përjashtim të rrallë, këto ngjarje ata i kanë parë nga jashtë dhe nga larg. Për dallim prej tyre, Ibrahim Kelmendi këto ngjarje i ka parë nga afër dhe nga brenda. Pikërisht këtu qëndron e veçanta e përbashkët dhe njëra nga vlerat e mëdha të këtyre librave të autorit Ibrahim Kelmendi.

U takon letrarëve dhe historianëve të thonë nëse libri ATENTATET është roman, libër kujtimesh apo diçka tjetër. Pavarësisht nga kjo, unë mund të them se në këtë libër ka premise të qarta, në bazë të cilave lexuesit dhe studiuesit mund të arrijnë në përfundime interesante:

E para: siç del nga vetë libri, Mërgata shqiptare e para vitit '81 dhe e pas atij viti, edhe pse e madhe në numër, ishte analfabete ose gjysmanalfabete.

E dyta: siç del nga vetë personazhet kryesore të librit ATENTATET, me ndonjë përjashtim të rrallë, gjysmanalfabetë ishin edhe personalitetet që përpiqeshin ta organizonin Mërgatën shqiptare.

E treta: Organizatat shqiptare në Perëndim ishin të mbyllura hermetikisht dhe të izoluar nga njëra-tjetra dhe nga vendorët. Ato, në emër të konspiracionit, i fshihnin nga njëra-tjetra dobësitë, paaftësitë dhe mossuksesin e tyre. Ato, siç del nga personazhet e librit, e survijonin, e minonin dhe e denonconin njëra-tjetrën.

E katërta: përkundër konspiracionit të thellë, organizatat shqiptare në Perëndim mbikëqyreshin nga Sigurimi i shtetit shqiptar dhe nga Shërbimi i Sigurimit Shtetëror serb dhe jugosllav. Siç del nga personazhet kryesore të librit ATENTATET, pothuajse secili nga personalitetet që qëndronin në krye të organizimit të Mërgatës shqiptare, dyshonte në të tjerët dhe i akuzonte ata se po punonin për dikë tjetër.

Dhe e pesta: paradoksi më i madh qëndron në faktin se organizatat shqiptare vepronin në Perëndim, pra në botën e kapitalit dhe të

pronës private dhe, me ndonjë përjashtim, vetëquheshin komuniste-marksiste-leniniste!

Në fund, zonja e zotërinj, me lejoni të them, se në kohën kur organizatat shqiptare po vepronin në Perëndim, Kosova e kishte Universitetin, e kishte Akademinë e Shkencave dhe të Arteve. Pra, në Kosovë ishte formuar në elitë profesionale, intelektuale, shkencore dhe politike, por ajo, me ndonjë përjashtim të rrallë, nuk po denjonte t'i printe organizimit të shqiptarëve. Kështu ka ndodhur gjatë '81-shit, kështu ka ndodhur gjatë Luftës se fundit në Kosovë, por edhe pas saj. Mbase pikërisht këtu qëndron arsyeja e vonesës së shqiptarëve.

Saime Jusufi (personazhe e romanit / bashkëshortja e Kadri Zekës):

I nderuar Ibrahim,

Ka kohë (vite) që nuk jemi parë, por ja që bota është e vogël dhe për të gjallët krijohen mundësi kontakti. Në këtë rast kontakti elektronik. Këtë e bëj, pas leximit të veprës tënde historike "Atentatet", për të cilën të përgëzoj nga zemra! Edhe njëherë urime! Me të dalë nga shtypi e lexova me një frymë. Pasi jam njëra ndër protagonistet e asaj ngjarjeje makabre që bëri UDB-a me vrasjen e tre bijve (udhëheqësve të denjë) të Kosovës dhe në disa rrethana kam qenë edhe pjesëmarrëse direkte në ato ndodhi para dhe pas vrasjes, nuk u durova pa të shkruar, për të përgëzuar. Të them të drejtën, u ktheva prapa 25 vjet, duke kujtuar e përmalluar dhe plot emocione atë kohë sa të bujshme, aq edhe të dhimbshme, ku ti me spikamë ke paraqitur çdo personazh. Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë. Kjo më bën të besoj se edhe ata të cilët nuk pata mundësi t'i njihja, i ke paraqitur tamam ashtu siç ishin në realitet, të lidhur me UDB-në jugosllave, për të shkatërruar lëvizjen...

(Mail-letër, 05.03.2007)

Fragmente nga letra elektronike e Ramiz Kelmendit (14.03.2007):

(...) Librin e kam marre bashke me "Fokusin", sapo ka dale. Edhe e kam
lexuar.
(...) Si pune e pare, mund te te them se me ke habitur - jo pak! - me stilin, ta quaj romanesk, te librit.D.m.th., me ke gezuar, ta kam pelqyer.

E dyta, libri lexohet me nje fryme, edhe pse, perkunder natyres sate, si te njoh une, d.m.th. qe nuk nguron fare t'i thuash te bardhes e bardhe
dhe te zezez e seze, kesaj here me ka munguar kjo kurajo jotja duke u
fshehur pas emrave te trilluar (me ndonje perjashtim).
(...) Libri ka nevoje per nje lekture me te mire. (...)

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Afishuar me:** 24.03.2007 11:49

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

I nderuar „shqipërues"!
Përgjigjes sime lidhur me mjetet e Fondit VENDLINDJA THËRRET ju i keni bërë komentin vijues:
"Më bëtë për të qeshur zotëri. Pse, paratë në xhepa të grisur do mbaheshin ?! Paratë rrijnë në konto bankare. Mos më pandehni kaq naiv, ju lutem. Ju i dini mirë "pasuritë" e tundshme dhe të patundshme të Hashim Thaqit, Jakup Krasniqit, Ramush Haradinajt... e shumë të tjerëve. Ne jemi këtu. I shohim përditë. Edhe fondi „i Bukoshit - tre përqindëshi" pra, edhe pse askush nuk e thotë zyrtarisht, është shpërdorur. Të kujt janë "BEN-AF-ët? Populli thotë, janë të Bukoshit. Pra, edhe fondi që keni udhëhequr ju,është shpërdoruar (më mirë të shprehem keqpërdoruar). Dhe ju përsëri me "xhepa të grisur" !!! Rrofshin bankat !"
Përgjigjja nga unë:
Mua më kishit pyetur për veten time dhe jo për të tjerët dhe prandaj jam përgjigjur:
"Në xhepat e mij të grisur nuk ka bir nëne (e as bir kurve), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje".
Edhe mua po me neverisin po më hidhërojnë e revoltojnë super-vilat e liderëve, duke filluar te super-vila, e cila përpara quhej "Presidenca". Ajo që blerë me para publike. Tani, ai pallat në pronësi të kujt është (zot/pronar i këtij pallati, i blerë dikur me para publike, thuhet se është Familja Rugova!)?
"Fondi i Republikës se Kosovës" (që u menaxhua nga Bujar Bukoshi e Isa Mustafa), ishte fond shtëror, në të cilin paguhej "tatimi" prej 3-përqind e të ardhura dhe kontribute të tjera. Në atë Fond, sipas të dhënave të qveritarëve gjermanë, në prill të vitit 1999 ishin rreth 940 milionë DM (marka gjermane), ose rreth 470 milionë euro. As unë nuk e dij, se ku kanë përfunduar gjithë ato mjete. Maksimalisht, nga ai Fond publik janë shpënzuar për Luftën Çlirimtare rreth 70 milionë euro. Ku përfunduan të tjerat? – është pyetje që do duhet ndonjëherë t'i përgjigjen institucionet përkatëse të Kosovës.
Vilat e Hashim Thaçit e Ramush Haredinajt, etj. (lista ime e shpërdoruesve është më e gjatë se lista Juaj), sigurisht nuk janë blerë me të holla personale. Po shpresoj se Kosova do të shtetëzohet se shpejti në ato përmasa, sa të sqarojë prejardhjen e pasurisë se secilit (edhe të Veton Surroit dhe disa biznismenëve tepër të dyshimtë).
Më pat fascinuar Kryeprokurori i Prishtinës, Z. Tahir Rrecaj, i cili në një debat televiziv pat bërë kërkesën, që të miratohet ligji për prejardhjen e pasurisë, për të luftuar në mënyrë efektive kriminalitetin dhe korrupcionin. Por akoma më i rëndësishëm është ndërgjegjësimi kritik i qytetarëve për të mos u shkuar prapa shpërdoruesve, gjegjësisht për të mos ia dhënë voten të tillëve (sigurisht, as Bexhet Pacollit).
Të shpresojmë se bashku, se numri i qytetarëve, që do shfaqin hidhërim e revoltë si Ju, do të shtohet...
Shëndet e suksese!
Tung

---

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Afishuar me:** 24.03.2007 11:53

---

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

I dashur "Gentlemeni"!
Të falënderoj për paraqitjenn Tënde, por nuk preferoj të biesh në këtë nivel, pasi Ti je i madh, po aq sa të gjithë. Secili duhet të ketë peshore individuale për të peshuar madhështinë e tij dhe, ju lutem, para askujt mos u vogëlsoni !

Shëndet dhe suksese!
Tung

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 24.03.2007 12:07

I/e nderuar Z. Caka,
pata shpreh mendimin, se Fondi VENDLINDJA THËRRET nuk ka qenë Fond publik, por i dy subjekteve: LPK-së dhe UÇK-së. Nëse Ju keni kontribuar në këtë Fondt, atëherë mund t'i drejtoheni të autorizuarit të Fondit, të cilit ia keni dhënë ndihmat, të Ju jep llogari.
Në parim, mjetet e këtij Fondi i janë përcjellë sektorit të logjistikës, Shtabit të përgjithshëm dhe shtabeve të zonave operative të UÇK-së. Shiquar në aspekt të thjeshtëzuar, ne përgjegjësit e Fondit, duhet të japim llogari për mjetet që kanë dhën kontribuesit, deri sa ato u janë dorëzuar strukturave e mekanizmave të mësipërpërmendura.
Sigurisht, Shteti i Kosovës, gjegjësisht institucionet përkarkatëse të tij, do jenë në gjendje dhe do e vlerësojnë për të domosdoshme që të shqyrtojnë me përkushtim e konsekuenca të gjitha fondet.
Shëndet dhe suksese!
Tung

profile | edit quote

**Kitka-ch**

**Anëtar që nga:** 09.01.2002
**Afishime:** 294
**Vendbanimi:** Zürich

**Afishuar me:** 24.03.2007 12:26

Tung zotri Kelmendi.
Se pari pershendetje te perzemerta dhe me pastja nje pytje;
Sa dhe qka dini per Zija Shemsiun.

profile | edit quote

**xhevati**

**Anëtar që nga:** 26.02.2006
**Afishime:** 69

**Afishuar me:** 24.03.2007 12:33

i nderuar Ibrahim
Te pergezoj per romanin Atentatet dhe kam nje sygjerim te vogel qe besoj se mund ta permiresosh ne rast te ribotmit te romanit, edhe pse ndoshta nuk eshte me rendesi por mendoj se nuk ke qene ne "Ostbahnhof" te Vjenes por ne "Südbahnhof".
shendet
Xhevat Xhemaili

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 24.03.2007 12:38

I/E nderuar Z. "Kitka-ch"!
Zija Shemsiu ka qenë bjë veprimtar i shquar i Lëvizjes, i cili dha jetën e tij të vlefshme për çlirimin e Kosovës.
Ka qenë emigrant në Bern të Zvicrës dhe ka qenë shumë i përkushtuar në veprimtarinë e tij çlirimtare, prandaj ndiej krenari që kemi gravituar në të njëjtat radhë të organizuara.
Dij që ka qenë në një mesion çlirimtar, e ka arrestuar hunta e atëhershme pushtetare dhe e kanë mbytur në burg.
Po shpresoj se detajet për jetë dhe veprimtarinë e tij nuk ju duhen, për momentin, ose mund t'i dini më mirë se unë (të cilat do i mirëprisja).
Shëndet dhe suksese!
Tung

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 24.03.2007 12:43

I dashur Mik Xhevat !
Të falënderoj për përgëzimet. Me sa mbaj mend, sa herë kam udhëtuar për në Vjenë, fillisht më është dashur të zbres në West-Bahnhof, pasi e kishin stacionin e fundit trenat që shkonin nga Gjermania. Prej aty orientohesha në caqet që i dëshiroja.

Shëndet e suksese!
Tung
Ibrahimi

profile | edit quote

**Kembana**

**Anëtar që nga:** 01.09.2005
**Afishime:** 64

**Afishuar me:** 24.03.2007 13:09

I kam dy peyetje per ju z Kelmendi

1. Pse keni vendosur qe ngjarjet historike ti shkruani ne form Romani,kure dihet se Romanet Historike, nuke jan ngjarje reale, dhe si te tilla perveq Letersise nuk i hyne ne pun historis dhe Historiografis Shqiptare ne pergjithesi-sikurse veprat shkencore.

2. Cilen lufte e Konsideroni Lufte Atdhetaresh Luften e Nacionalizmes te Udhehequr nga Shaban Polluzha e Mehemet Gradica me Shok, apo luften e komunisteve te udhehequr nga Fadil Hoxha me komunistet shqiptar e sllav. Dhe sipas jush vazhdimesi e ciles lufte esht Lufta e Ushtris Qlirimtare te Kosoves.

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 24.03.2007 13:58

I/E nderuar Z. "kembana"!
Thënë të drejtën, ka zgjedhur romanin historik për të parqitur një fragment të historisë sonë, pasi më jepte më shumë mundësi për të shpreh edhe ndjenjat. Studimit historik nuk i interesojnë ndjenjat. Pastaj, studime historike bëjnë historianet dhe unë nuk jam i tillë. Aketrëve të ngjarjeve nuk u takon të shkruajnë studime historike, pasi do jenë tepër subjektiv.
Sa i përketë LNÇ, është paksa e ngatërruar. Shaban Polluzha ishte personalitet i të njëjtit krah, por kur LNÇ-ja në Kosovë u tradhëtua, vazhdoj Luftën e lavdishme çlirimtare. Fadil Hoxha ishte i mundur dhe përtoj të vdiste; me gjasë u përcaktua për luftë evolucioniste, e cila ia kushtëzojë që të vëhet në sherbim të pushtuesve.
Nuk kam idhtar i trajtimit bardh / zi të historisë, por të vlerësohet sa më objektivisht, në kohë e hapësirë. Ndonjëherë, ne, pasardhësit e atij brezi, na vije më leht të bëjmë shabllonizime bardh / zi...
Shendet e suksese!
ibrahim_kelmend@yaho, de

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 24.03.2007 14:01

Të nderuar "forumistë" !
Më falni që po largohem për disa orë. Të gjitha pyetjeve do ju përgjigjem, sapo të jem këthyer në bashkëbisedim.
Ditë të mbarë!
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

profile | edit | quote

**Shqipëruesi**

**Anëtar që nga:** 08.08.2004
**Afishime:** 556
**Vendbanimi:** Prishtinë

**Afishuar me:** 24.03.2007 14:04

Zoti Kelmendi,

Megjithë rrespektin për guximin tuaj të ballafaqoheni madje edhe me "plangprishës",sic u shprehet ju,unë nuk ju pyes as për Fondin e Qeverisë Bukoshi as për Vilën e Presidencës,por ju pyes për Fondin Vendlindja Thërret.
Ju flisni për të tjerët,keni akuza për të tjerët por vazhdimisht po i ikni përgjiegjes që ua shtrova.
Sa ishte fondi "Vendlindja Thërret pasi e dini kaq mirë sa paska qenë "Fondi i Qeverisë?
Flisni për vete se për tjerat do të përgjigjen të tjerët.
Dhe,unë nuk shfryhem këtu dhe nuk mendoj se jam kaq i paqytetëruar,sic mundoheni ju ti quani ata që nuk ju pëlqejnë. Kur dini kaq mirë ti kritikoni dhe akuzoni të tjerët,të shohim pak kush jeni ju vet,apo s'është kështu,i nderuar.

Me nderime,

Qytetari i brengosur, Shqipëruesi

profile | edit | quote

**gjarperi**

**Anëtar që nga:** 27.11.2005
**Afishime:** 526

**Afishuar me:** 24.03.2007 14:26

Te pershendes Zotri Ibrahim Kelmendi, une drejten me te thane, sa i perket librit dhe te gjithe atyre personazheve ne liber nuk kame njohuri, dhe ende se kame lexuar( dhe mu nga kjo mosnjohje ndoshta mundem me qene ma objektiv ne vlersime), por duhet ta kish te qarte se nese nuk i pershtates ideologjis se dikuj ne kete forum, ata do te fillojn te qesin ne koder dhe breg, dhe kete e vrejta edhe te afishimi i tarasit, i cili qe ne momentin kur e vrejti se nuk jeni ne anen e ideologjis se tije filloj me perbuzje siqe din ai( shitja e librezave te LPK-s 1000 marka), pra une ne fillim kisha me te bere disa pytje
1. cilin rregullim shtetror e simpatizoni dhe cilin nga keto do ti preferoni Kosoves
1. Mbretrin
2. Monizmin
3. Demokracin
Sa i perket kosoves cilin opcion nga keta do ta kishe preferuar, Kosoven e pamvarur, apo Bashkimin me Shqiperi si nje regjion i njejt me regjionet tjera te shqiperis, ose opcionin e Ballkanis,
dhe ne fund po te tregoj se nje bashkeatedhetar nga suedija pat deklaruar se e ka bler librezen e LPK-s per 1000 marka, ne menyr qe te fiton azilin politik, kjo ka ndodh nevitin 1993, une jam i bindur se ajo shitje nuk kane qene me dijen e juaj, por kete e ka shfrytezuar ndoni metrapaz, ku per fate te keqe kemi shume, prandaj ju kisha lutur qe te shiqosh se kush ka mundur ta beje kete ne emer te juajin, sepse me siguri ju e keni listen e antarve te LPK-s, nga suedija e ati viti, dhe kush eshte marrur me te, libreza eshte leshuar nga mesi vitit 1993, dhe personi qe bleu librezen tani gjendet ne kosove, zotri Ibrahim une nuk jame i interesuar fare per pergjigje, por eshte mire qe te pergjigjesh per shkak te tjerve sepse ne cdo moment qe nuk i konvenojn pergjigjet e juaja ata do te sillen rredh kesaj dukurije, siq beri tarasi.

profile | edit | quote

**tarasi**

**Anëtar që nga:** 06.01.2006
**Afishime:** 1806

**Afishuar me:** 24.03.2007 14:58

z. gjarpëri
Ti i perzien gjërat. Së pari, të kam sqaruar Ty dhe të tjerëve që, s'ka pas libreza por ka ekzistuar Programi dhe Statuti i botuar në formë të një liberthi të xhepit.
Gjatë viteve, ka ndodhur që ndonjë individi t'i leshohet ndonjë deklarat personale, me të cilën ke dëshmuar që " filan fisteki" ka qenë i organizuar ( ani pse s'ka qenë) gjoja për t'i ndihmuar pak në kërkesën e tij për azil...
Por t'i ke deklaruar; që TY ta ka dhënë Librezën dhe se ti në rastin më të parë, ke me kërkuar, që ai të t'i kthejë parat...
Nëse të intereson personalisht ia kam leshuar një kësi vërtetimi mu vëllait të Ibrahimit ( Osmanit) i cili po ashtu gjendet në Kosovë( dashtë zoti do ta qafim sa më parë)...
Unë me asgjë nuk e kam sulmuar Ibrahimin ngaqë si Njeri dhe patriot meriton respekt dhe unë e kam thënë që; edhe më herët kam pas një respekt të heshtur për të sepse e dija që boll " i praptë është" por i drejtë dhe i sinçertë.
E sa i përket librit " Atentatet" një vështrim do t'ja dërgojë ndoshta qysh nesër ngaqë në mungesë kohe s'po mundem të ulem dhe ta shkruaj.
Një nga ato vërejtje që kam pas unë besoj që i kishte prekur Ramë Shkreli...kur kishte folur për një lektyrim më të mirë...
Pra do të flasë për librin nga ana artistike.
E, sa i përket vështrimeve politike dhe të bartësve të politikës në Konstalacion me kohën gjithësesi që nuk pajtohem me zotin Kelmendi.Por ato mos-pajtime natyrisht që nuk do t'ja themë këtu ngaqë siq ka thënë kush(?) " zot më ruaj nga miqtë se nga armiqtë ruhem vetë"...
Zoti Kelmendi, s'ka hyrë këtu që mua të më japë përgjigje ngaqë të gjitha ato që ka shkruar në kohën e Ilegalitetit dhe në gazetat tona Ilegale në një formë ose tjetrën kanë kaluar edhe nëpër duar të miat...
Ka nga ato vështrime që edhe sot janë aktuale...

profile | edit quote

**hotiani**

**Anëtar që nga:** 06.06.2006
**Afishime:** 229

**Afishuar me:** 24.03.2007 16:48

Pergezime dhe respekte zoti Kelmendi ,per librin dhe komunikimin ne kete forum ,per modestine dhe sinqeritetin me te cilin i pershkruan ngjarjet e atyre viteve te stuhishme si nje nder protagonistet kryesor te asaj kohe ku me gjak e sakrifice u vune themelete nje rrokallielli i cili pas perpjekjeve shekullore do te arrinte realizonte endrren shekullore per mvehtesine e Kosoves.
Nuk pata fatin as rastin te ju njoh personalisht,por emeri dhe vepra e juaj dhe bashkeluftetareve dhje bashkeveprimtareve juaj ka qene nje udherrefyes per secilin nga ne qe me zemer dhe pa hile i sherbyem aq sa ditem e mundem atdheut .
Me beri pershtypje modestia dhe sinqeriteti pothuajse femijeror i parashtrimit si ne roman si ne pershkrimet dhe pergjegjejet tuaja forumisteve ,pra parashtrimi i rolit tuaj ne ato rrjedha historike. Nese sot bejme krahasime mes menyres qe shkruni ju dhe asaj qe shkruajne disa persona qe ndoshta kishin role sekundare dhe epizodike dhe qe rrahin gjoks se pothaujse kane qene te pazavendesushem . KUr keto i krahasoj atehere me duhet te terheqe pyetjen kryesore te cilen desha ta drejtoj: Perse valle ne skenen politike te Kosoves se pasluftes nuk gjendet IBrahim Kelmendi?
Zoti Kelmendi , vete modestia dhe sinqeriteti juaj me bene te besoj se sa thelle e keni perjetuar ngjarjen te cilen e pershkruani,sa te

padrejta kane qene akuzat qe ju kane drejtuar disa mosnjohes dhe mosperfilles te asaj perballje mbinjerezore me nje nga sherbimet me te sofistikur te Europes.
Sidoqofte idealet ,sakrifica dhe gjaku i juaj dhe bashkeluftetareve tuaj nuk shkoi kote dhe per kete ju duhet te jeni nder te paret qe duhet te krenohi,me gjithese sot kemi ne te gjitha anet qakej qe rrahin gjoks per forma te ndryshme te meritave.
Me lejoni te ju bej nje pyetje direkte : Si e keni perjetua menyren e rivarrimit ne Kosove te Jusuf dhe Bardhosh Gervalles ne njeren ane dhe Kadri Zekes ne anen tjeter? Po te ishte e mundur e pamundura a do te pajtohej JUsuf Gervalla me kete vendim ?

[ Ky afishim u ndryshua nga: hotiani më 2007-03-25 00:29 ]

profile | edit | quote

**gjarperi**

**Anëtar që nga:** 27.11.2005
**Afishime:** 526

**Afishuar me:** 24.03.2007 16:51

Te peshendes tarasi, une me dhjetra here te kame treguar se une nuk kame bler librez, dhe as qe do ta kisha ber kete, por ate e ka bler nje bashkeatedhetar, dhe mu per shkak te kesaj libreze ai ka marrur refuzimin dhe sot gjendet ne kosove, une nuk e di se a ka pasur kjo parti libreza apo jo, por personi qe bleu librezen ma tregoj kete librez dhe ne te figuronte nje nenshkrim i Ibrahim kelmendit, une jam i bindur se dikush nga matrapazet e njohur e ka shfrytezuar Ibrahim Kelmendin, per keso mallverzime, prandaj duhet qe IK te deklaron se a ka poseduar apo jo kjo parti libreza per adhuruesit e vete,dhe nese jo ateher duhet te shiqoj se kush manipuloj me keso librezash apo vertetima, siq po e vrej se keso lloj librezash dhe vertetima paskan qene te verteta, por nja nuk po mundem me dite se ato u lashuan nga Ibrahimi apo nga matrapazet ne emer te Ibrahimit, dhe nja ta dish se keso marinash nuk kane egzistuar vetem ne kete parti por ne te gjitha te tjerat pa dallim.

profile | edit | quote

**qeku11**

**Anëtar që nga:** 05.03.2006
**Afishime:** 40

**Afishuar me:** 24.03.2007 17:05

Me nderime z.Kelmendi
I lexova disa nga pergjigjejt tuaj ne ket forum, dhe i vlersova shum pozitivisht.
Nese nuk jam keq informuar ju e keni djal te vellaut Qerimin qe eshte nje nga themeluesit e UÇK-se (sidomos i rendesishum ne zonen e Dugagjinit).
pyetje : sa her jeni takuar ju me komandantin e lavdishum Ilir Konushevci, dhe a ka te ngjare qe atentati qe u be ndaj ti te jet si shkak i zenkes se tij me Gjavitin , por njikosisht edhe konflikti juaj me Gjavitin e Azemin.
shpresoj ne pergjigjeje te siqert dhe objektive.

profile | edit | quote

**okii**

**Anëtar që nga:** 13.02.2003
**Afishime:** 32

**Afishuar me:** 24.03.2007 17:28

Zoti Kelmendi
a mund te na tregoni per Vrasjen e Skender Kuqit nga Lutogllava.pse u vra aj.a kini ndonje info te sakt?kisha pas deshir ta di.ju falemenderit

profile | edit | quote

**Delegati** 🗋 **Afishuar me:** 24.03.2007 18:02

**Anëtar që nga:** 12.05.2006
**Afishime:** 548

Quote:

Shqipëruesi afishoj me 2007-03-24 14:04 :
Zoti Kelmendi,

Megjithë rrespektin për guximin tuaj të ballafaqoheni madje edhe me "plangprishës",sic u shprehet ju,unë nuk ju pyes as për Fondin e Qeverisë Bukoshi as për Vilën e Presidencës,por ju pyes për Fondin Vendlindja Thërret.
Ju flisni për të tjerët,keni akuza për të tjerët por vazhdimisht po i ikni përgjiegjes që ua shtrova.
Sa ishte fondi "Vendlindja Thërret pasi e dini kaq mirë sa paska qenë "Fondi i Qeverisë?
Flisni për vete se për tjerat do të përgjigjen të tjerët.
Dhe,unë nuk shfryhem këtu dhe nuk mendoj se jam kaq i paqytetëruar,sic mundoheni ju ti quani ata që nuk ju pëlqejnë. Kur dini kaq mirë ti kritikoni dhe akuzoni të tjerët,të shohim pak kush jeni ju vet,apo s'është kështu,i nderuar.
Me nderime,
Qytetari i brengosur, Shqipëruesi

Kur njeriu i lexon afishimet e Shqipëruesit bëhet gati që t'ia shtrijë dorën e përshëndetjes, por kur atë e njohim më parë del se të gjitha afishimet janë të maskuara edhe më shumë se vet forumisti që mëshifet mbrapa nofkës Shqipëruesi.
Nuk dua t'i dal në mbrojtje Zotit Kelmendi sepse atë e mbronë jo vetja e tij, por puna e tij.
Do ti tregoj Shqipëruesit se Fondi " Vendlindja Thërret" ka qenë fond i krijuar eksluzivisht për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Në atë fond kanë kontribuar njerëzit që e kanë dashur Kosovën të çliruar. Tani iu them të gjithë atyre se iu ka shpërblyer vullneti i mirë për ta parë Kosovën të lirë.
Ka pasë edhe më parë polemika rreth fondit të UÇK-së, pra atij "Vendlindja Thërret" se janë keqpërdorur ato mjete e vërejtje të ngjashme.
Tani shtrohet pyetja kush thotë se janë keqpërdorur ato mjete; ata që kanë kontribuar në atë fond, ata që kanë kontribuar në fondin e Bukoshit me 3%-shin ose ata që nuk kanë kontribuar askund dhe për ta ngushlluar veten thirren dhe aludojnë se gjoja janë keqpërdorur mjetet.
Unë nuk po flas për veten time edhe pse kam shumë çfarë të them dhe të dëshmoj për kontributin tim, por po them se i njoh njerëzit që kanë dhënë shuma të konsiderueshme parashë dhe kurrë nuk flasin, bile-bile janë shumë të gëzuar që e kanë ndihmuar luftën çlirimtare.
Të gjithë ata që kanë dhënë në fondin e luftës janë paisur nga Këshilli Qëndror i Financimit me një fletëdëshmi, që ne e quanim Fletëfalënderim, me shumën e parave të dhëna nga liridashësi.
I përshëndes përzemërsisht të sinqertit dhe kontribuesit e luftës çlirimtare.
Aqif Kastrati- Delegati.
Shëndet Ibrahim Kelmendi.

profile | edit | quote

**diogjeni** 🗋 **Afishuar me:** 24.03.2007 18:12

Quote:

**Anëtar që nga:**
05.01.2005
**Afishime:** 46

hotiani afishoj me 2007-03-24 16:48 :
...
Me lejoni te ju bej nje pyetje direkte : Si e keni perjetua menyren e rivarrimit ne Kosove te Jusuf dhe Bardhosh Gervalles ne njeren ane dhe Kadri Zekes ne anen tjeter. Po te ishte e mundur e pamundura a do te pajtohej JUsuf Gervalla me kete vendim .

Quote:

tarasi afishoj me 2007-03-24 14:58 :
z. gjarpëri
Ti i perzien gjërat. Së pari, të kam sqaruar Ty dhe të tjerëve që, s'ka pas libreza por ka ekzistuar Programi dhe Statuti i botuar në formë të një liberthi të xhepit.
...
Unë me asgjë nuk e kam sulmuar Ibrahimin ngaqë si Njeri dhe patriot meriton respekt dhe unë e kam thënë që; edhe më herët kam pas një respekt të heshtur për të sepse e dija që boll " i praptë është" por i drejtë dhe i sinçertë.
E sa i përket librit " Atentatet" një vështrim do t'ja dërgojë ndoshta qysh nesër ngaqë në mungesë kohe s'po mundem të ulem dhe ta shkruaj.
Një nga ato vërejtje që kam pas unë besoj që i kishte prekur Ramë Shkreli...kur kishte folur për një lektyrim më të mirë...
Pra do të flasë për librin nga ana artistike.
....
Ka nga ato vështrime që edhe sot janë aktuale...

Z. Kelemendi urime per librin dhe guximin. Librin ne tersi nuk e kam lexuar ende, disa pjese po, por kjo nuk me lejon te jap ndonje vleresim. Fundja, Ju s'keni kerkaur asnje vleresim nga ne ketu, por keni shprehur vullnetin t'iu pergjiegjni pyetjeve tona per te na e shuar kurreshtjen rreth vrasjes se trefisht ne fjale qe trajton romani juaj.
Pyetjet e mia do t'i filloj me paragrafin e fundit te shkrimit te nofkes **hotiani** te cilen do ta formuloja keshtu:
Eshte thene tashme disa here se me fajin e vllezerve gervalla te gjalle (Hysenit, Avdylit) u be ndarja e rivarrimit te deshmoreve ne Kosove. Nuk kam qellim ta shfajsoj askend nga pergjegjesia (pergjegjesite) por kujtoj se ata kurre nuk ishin bashkë. Ata ishin takuar te Jusufi per tu bashkuar pas nje deshtimi qe kishte ndodhur ne Turqi.
1. Z. Kelmendi, sipas bisedave qe jane zhvilluar ate nate, na trego cka iu ndante me Organizaten e Kadri Zekes dhe cfare bisedash per bashkim jane zhvilluar ate nate te kobshme ne banesen e Jusuf Gervalles?
2. Ne nje vend keni thene: "Bardhi me lajmeroi se Jusufi ka ardhur ne Gjermani". Na tregoni ku punonte dhe cfare pune bente Bardhi ne ate kohe ne Gjermani?
3. Ne nje vend keni thene se fondi "Vendlindja therret" ishte fond privat. Ketu me falni, por nuk pajtohem. Nje fond nuk mund te jete privat kur hapet ne emer te Atdheut. Fondi privat mban emrin dhe mbiemrin e perveçshem te personit si dhe adresen e tij kopmlet. A jane keqperdorur a jo eshte pune tjeter, por ato jane kerkuar ne te gjitha shtetet ne emer te Popullit per clirimin e Atdheut. Sigurisht, nese te mban shendet, une lutem qe te mbaje, nje dite do ta shkruajsh nje liber tjeter edhe per Fondin "Vendlindja therret. Kete

gje duhet ta bej edhe Bukoshi detyrimisht. Ai dihet qe ka gjynahe shume sepse ka sabotuar gjithcka- edhe ne paqe edhe en lufte! Nese me lejon nofka tarasi kam deshire t'i nderroj dy-tre fjale me te. tarasi, z. Kelmendi me sa kuptova nga mesazhet publike ketu nuk po kerkon nga askush vleresim teknik as artistik. Vleresimi juaj artistik (stilistik) per neve s'ka asnje vlere nese Ju ia dergoni z. Kelmendit ne posten e tij elektronike. Ai vleresim mund t'i sherbej per ndonje liber tjeter. Kaq! Perndryshe, gjithe vellon e madheshtise qe ti, apo ndonje tjeter me dekada eshte munduar t'ia veshni Levizjes (LPK) z. Kelmendi e ka demistifikuar ne ate moment kur ka pranuar qe shkrimi i z. Adem Gashi t'i paraprije romonit "Atentatet"

*Gjatë formimit shoqëror e kombëtar,*
*kulturor e religjioz, shkencor e politik,*
*autori ka njohur shumë mite, kulte, idole e hyjni.*
*Përfundimisht kredoja e tij e ka përmbysur*
*hierarkinë e idiolatrisë duke ia shpalosur surrogatët e tyre.*
*Ju mund ta akuzoni autorin për mungesë modestie,*
*gjatë gjithë kohës që ai njeh, respekton,*
*i falet me përkulje dhe devotshmëri vetëm të vërtetës.*

*Është krejt i ndërgjegjshëm se një ditë të gjithë do t'ia kthejnë shpinën e do ta lënë.*
*Një ditë, është plotësisht i ndërgjegjshëm, gjithçkaje të kësobotshme do t'ia kthejë shpinën e do ta lërë.*
*Edhe kur e lënë, edhe kur i lë, në thelb nuk ndërron gjë.*
*E vërteta do të qëndrojë e përjetshme në fronin e saj.*
*Kjo vravashkë s'ka të bëjë as me Dialogëte Platonit, as me Mbrojtjen e Sokratit.*
*Ky shkrim s'është tjetër veçse një akt dëshmimi i autorit, blatuar hyjneshës së tij, të vetmës dhe të tërëkohshmës.*
*Adem Gashi*

Me vjen mire per "zbutjen" tende tarasi. Deshira jote per te lene pershtypjen se ne Levizje ende ka shume gjera qe nuk dihen apo s'duhet te dihen (ne emer te patriotizmit) vetem se e ngarkon me dyshime vete Levizjen dhe kreretv e saj. Edhe aty ku i drejtohesh z. Ibrahimit, e dija që boll " i praptë është" por i drejtë dhe i sinçertë... nuk qendron, sespe njeriu mundet te jete i prapte dhe i sinqerte, por kurre i prapte dhe i drejte. Une e e kopjove fjaline tende pa thojza. E di qe je i afte te me kuptosh pse e bera kete.
Edhe tentim spjegimet se ky liber eshte roman artistik apo hstorik apo te dyjat, z. Kelmendi e ka thene vete me pak rreshta si:

*Ngjarjet e romanit janë fragmente të jetës dhe veprimtarisë në ekzil, gjatë viteve 1979 – 1982, të personaliteteve tashmë historike, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla dhe të bashkëve¬primtarëve e kundërshtarëve të tyre, si dhe rrethanat para atentat¬eve, më 17 Janar 1982, në Untergruppenbach, afër Hajbronit (Heil¬bronn) të Gjermanisë dhe pas atentateve, deri më 17 janar 1985. Ato janë paraqitur ashtu siç i kam përjetuar dhe siç i kam mbajtur mend, pa pretendim për të qenë të vërteta historike. Mendimet dhe vlerësimet janë të kohës, kur kanë ndodhur ngjarjet.*
*Autori*

Z. Kelmendi, per fund dua sinqerisht t'iu pershendes. Nuk te njoh as kurre nuk te kam pare. Ne jeten time kam degjuar pershkrime nga me te ndryshmet per ju: nga ato se je njeri teper arrogant dhe agresiv dhe bashkepunetor i UDBes deri ta ato me pozitivet se je njeri shume patriot apo patriot mbi patriot.

Nga komunikimi qe po beni me debatuesit, se pakut ne shkrim, nese kete nuk e beni ne menyre "te prapte", keni fituar simpatin time si

nje bashkebisedues i zoti dhe i afert me njerezit.
Kur e kam pare temen e hapur kam menduar se do te kete nje rrebesh pyetjesh nga me te zeshmit ne kete forum, por disi, pervec tarasit, jane zbutur, apo i zbutet edhe shume zeboria te ketij forumi.
Ndoshta eshte wikend e kane dalur per relaksim ne natyre.
Rrofte dita e hene! “Dite e re, nafake e re”.

[ Ky afishim u ndryshua nga: diogjeni më 2007-03-24 18:19 ]

profile | edit quote

**trixi**

**Anëtar që nga:** 18.08.2006
**Afishime:** 1935
**Vendbanimi:** Gjermani-Dardani

**Afishuar me:** 24.03.2007 18:48

Z.Kelmendi,
Ne bindjen e njeriut nuk mund te ndikon kurrfar romani,kur eshte fjala per te verteta,andaj keto "arsyetimet"dhe berja me gisht tash pas 25-vitesh sikur tingllon shfajsim, larje e ndergjegjjes se papaster apo edhe ri-atentat !!
Une nuk i perkas kesaj kategoris se puthadoreve te cilet shkelin mbi gjakun e deshmoreve dhe me nje HOP(roman)harrohen 25-vitet e ketij misteri te cilen tash po na e zbulon shoku i ngusht i Jusufit,Bardhit dhe Kadriut !!!!!
Pyetje: Si mund ta arsyetosh heshtjen dhe mos ndermarrjen e asgjeje per 25-vite per keta "shoket" me te ngusht nese veq e ke dijt te verteten ?!!!
Pyetje: Si mund te rrish per 25-vite indiferent ndaj familjes Gervalla-Zeka,dhe femijve te Jusufit ?!!!
Pyetje:Si mund ti akuzosh dhe perbuzish deshmoret ne Belgjik ?!!
Pyetje:sikur te ishe ti rezili (dorasi)si do te veproje ne kete rast me I.Kelmendin dhe me akuzen ?
Kam edhe disa pyetje por kesaj po te kursej per me vone.
Edhe per nje ju lutem forumisteve qe mos ta marrin rolin e avokatit apo te mbrojtesit te I.Kelmendit,sepse ky me vetdeshir ka pranu dialog !
Andaj nuk kam nevoj per komentimet e askujt perveq Z.Kelmendit.
Me nderime,Trixi

profile | edit quote

**piloti**

**Anëtar që nga:** 22.02.2002
**Afishime:** 1439
**Vendbanimi:** Gjermani

**Afishuar me:** 24.03.2007 18:50

Inderuari z.Kelmendi ,
Ju lutem pergjegjuni sinqerisht , per cilin opcion politik jeni(perkrahni):
1. Kosova shtet i pamëvarur
2. Bashkimi Kombetar
Me nderime
Piloti

profile | edit quote

**tarasi**

**Anëtar që nga:** 06.01.2006
**Afishime:** 1806

**Afishuar me:** 24.03.2007 19:00

z. diogjeni
Ju kuptova!
Unë do t'i bëjë një vështrim librit patjetër ngaqë e di që për një autor kjo do të thotë shumë. E di po ashtu se si ndjehet, autori i librit, si nga ata që e lëvdojnë dhe po ashtu nga ata që e kritikojnë.
Unë e kam thënë edhe më herët që Librin e kam lexuar me një frymë

dhe se është një nga ata libra që " vështirë se mundë ta lexojë njeriu për së dyti".
Tashti, unë s'dua të flasë për shumë gjëra ngaqë mendoj që" nuk është vendi dhe as kuvendi" sepse sa i përket Fondit " Vendlindja Thërret" edhe unë kam për të folur për aq sa ndodhta vetë zoti Kelmendi!
Po ashtu kam thënë që nuk pajtohem me çasjen që u ka bërë disa figurave të organizuara të kohës sikurse që janë; Xhafer Durmishi, Sabri Novosella, Xhafer Shatri pse jo edhe Abdullah Prapashtica.
Për këtë arsye kam cekur që sikur të kishte përdorur emertime tjeter fare ( roman është) shumë veta do të kishin pasur mundësi ta identifikojnë vetveten. tashti, ta themë shkurtë; Në përfundim të librit megjithatë mbeten enigmat! tashti " rezili" sikur na delë se ishte i lidhur me të githë...
Por, po ashtu e ka thënë që " s'do të bëhem avokat i të apostrofuarve". Ata po deshën le të reagojnë vetë!
sa ër atë z. diogjeni që i kam thënë Z. kelmendi që " boll i praptë" je, e kam thënë pikërisht në formë respekti! ja pse ta themë këtë gjë: Shpeshë herë prindi i drejtohet fëmijës së tij në formë përkëdhelje me ndonjë fjalë që ndoshta në raste tjera s'do të tingëlonte mirë.
Ibrahim Kelmendi ka qenë njeriu i vetëm, të cilin e kam takuar nga ata të viteve të 70-ta dhe që më është dukur i sinçertë. Më kujtohet një rastë ( I.K. ishte në Kryesi të LPK-ës) dhe kur Kryesia doli para anëtarësis me një qëndrim të tyre, z. kelmendi pat reaguar duke na thënë: " Vëllezër, na jemi marr vesh në Kryesi për tjeter sendë ndersa kta ktu po ju flasin për krejt gjera tjera. Po dojnë me ju mashtrue.."
Natyrisht që një Njeri i tillë i ka humbur disa " miq" mbrenda Kryesis por me këtë ka fituar disa "miq" të tjerë nga anëtarsia!
Autori do të dilte shumë i sukseshëm sikur të bënte emertimin e personazheve diçka të ngjashme sikur te libri " Arka e Djallit" e Dritero Agollit që po ashtu, Driteroi pra, fletë për një të kaluarë të tij. Tashti emertimi i sabri katunriut( Novosellës) lë për t'u kuptuar. Po ashtu e di që ai fletë me modesti por nuk duhet të turpërohet ngaqë gjatë kohës së Luftës ka qenë në Shqiperi " punkti i Kelmendëve" ( kështu i thonim ne) të cilët, thuase të vetmit kishin furnizuar Dukagjinin me çdo gjë!
Po, ashtu sa i përket Fondit " Vendlindja Thërret" jam i bindur qindpërqind që I. kelmendi s'ka bë keqperdorime ngaqë " këta të shkretit" akoma kur shkojnë në vendlindje për pushime ( Mustafa, dauti, Ademi..) shkojnë te dhëndëri ( te motra) ngaqë s'kanë "qenë të zotet" me bë një shtepi për vete!
Ju keni të drejtë z. Diogjeni kur thoni që disa gjëra s'ka nevojë të thuhen ngaqë unë si them dot! Nuk i them ngaqë unë jam rritur me figurën e Enver Hoxhës, këngët e Fatime Sokolit Fitnete rexhës dhe filmin që Mirani e shikon me shokë për Shotë dhe Azem galicën sikurse me të madhen gjëmëmadhen Lëvizjen Popullore të Kosovës!
Unë kam thënë me një rastë dhe do ta përseris sërish: As edhe jë Historian nuk do të mundë të shkruaj për ngjarjet në Shqiperi të vitit 1997 pa e marrë në duar për ta lexuar Librin e Ibrahim kelmendit Shqiperia jashtë veriut dhe Jugut sikurse që s'do të mundë të mohohet aktiviteti i tij që nga vitet e 70-ta e deri më sot!
Por libri si liber na lë me dilema të mëdha.
Përshembull, nuk e kuptojë se përse një kapitull të tërin se ka shkruar për gjykimin e rezilit apo edhe për vet- dëshmin e tij në gjykatë. tashti besoj që autori e ka lexuar " Tragjedin Amerikane" të Teodor Drajzerit dhe paraqitjen e karaktereve të secilit personazh.
Atë që e kam thënë më herët e them edhe tani; Unë e admiroj z. kelmendi për guximin e tij dhe për qendresen e tij për gjithë këto vite! Por disa nga figurat e organizimeve s'kam mundur t'i marrë që kanë qenë të atillë siç përshkruhen. Por saime zeka e verteton këtë gjë që autori i ka përshkruar ashtu çfarë kanë qenë. Me këtë, tani për tani, më shumë ka të drejtë ajo Saimja se sa unë gaqë ajo ka

vepruar drejt për drejtë me ta. or edhe deklarata e saj ka mundur me qenë jo fortë reale ngaqë po ashtu ne adresë të saj aso kohe ka pattur akuza nga më të ndryshmet!
sa i përket Lëvizjes ao për vite me radhë ka njohë për datë të bashkimit MAJIn!
Këtë vit ajo festojë në shkurt dhe atë 17 shkurtin!

Ibrahim Kelmendit të gjitha hallal i kofshin prej meje tarsit veq nja s'ja bëjë hallall( si ajo puna e devës); kur na e qiti perpara me udhëheqë bedri Islamin!
Por kjo nuk është për forumistët!
Do t'ju lutesha forumistëve që të më shmangin mua nga diskutimet ( hapni ju lutem një temë tjetër) ndersa kjo le të jetë kryesisht tema në të cilën do të përgjigjet IBRAHIM KeLMENDI..
P.S.
Edhe një gjë, hiq mos e kurseni sepse ai s'ka hyre këtu që të kursehet por që t'a thotë fjalën e tij!

**kreksi**

**Anëtar që nga:** 28.02.2005
**Afishime:** 471
**Vendbanimi:** Francë

**Afishuar me:** 24.03.2007 19:07

I nderuari Ibrahim,
Tani nuk po kam kohe as te haj as drek as dark se jam duke lexuar librin tuaj, e ne tjetren an kam deshire qe ti ndjeki bisedimet direkte edhe ketu ne forum....
Mbase je mysafir i yni pra ne kete forum do ishte mire qe te organizoni nje orar, prej sa ores deri ne sa fillojn bisedat.
Per mua ky eshte "bestselleri" i pare qe po lexoje ne gjuhen shqipe.
Po me habit tirazhi, vetem 3000 kopje, pse nuk keni nxjerrur me shumë ?

profile | edit quote

**piloti**

**Anëtar që nga:** 22.02.2002
**Afishime:** 1439
**Vendbanimi:** Gjermani

**Afishuar me:** 24.03.2007 19:21

Inderuri z.Tarasi,
Tashma e kemi te ditur perkushtimin tend per atëdhe , megjithat me duket se teper je duke shkruar ne veten e parë njejs ,
Mosë hargjo energji per ketë -ske nevoi , ne jemi ata te cilet do te lavderoim punen e juaj , populli thotë:
Nganjeher edhe konsumimi i tepert i ushqimit te benë "zarar" ,
Ne "laiket" jemi ketu te cilet nuk do tjua harroim kontributin dhe mundin e te gjith juve te cilet "luftuat erë e terr per liri , pamvarsi , bashkim kombetar, liri te te gjitha trojeve shqiptare etj" ,
me nderime
piloti

profile | edit quote

**sharraxhiu**

**Anëtar që nga:** 26.02.2007
**Afishime:** 9

**Afishuar me:** 24.03.2007 20:59

Zoti I Kelmendi,
Une kam bere kritike ne kete forum per vonesen tende ne shkruarjen e ketij libri,gjegjesisht ne zbardhjen e fakteve per vrasjen e tre bashkeveprimtareve tuaj. Lexova librin ne teresi dhe pergjegjejet tua ne kete forum . Me duhet te pranoj se me vjen keq per ate qe kam shkrua,andaj te kerkoj falje sinqerisht.
Nga njehere njeriu nga informimi jo i drejte krijon paragjykime te gabuara . Ky liber nga njera ane per ne qe kemi degjua dhe lexua aq shum per ju ,por qe nuk ju kemi njohur ,ju demistifikon ndoshta ndoshta nga nje idhull ne nje menyre ju sjelle ne nje njeri te

zakonshem.Kesaj me siguri i kontriboni edhe ju me modestine tuaj . Megjitheate per mua kjo thjeshtesi eshte veti e njerzeve te medhej dhe kjo ju ngrite ne planin njerezor.
Vertete librin tuaj e lexova pothuajse ne nje fryme dhe ky eshte nje shembull i gjhalle se si per ngjarjet qe ndryshojne rrjedhat e historise mund te shkruhet ne gjuhen e njeriut te thjeshte.
Ju kisha pyetur nga kurreshtja ,por edhe nga deshira per zbardhjen e ngjarjeve dhe veprimeve te asaj periudhe, a keni ndermend te vazhdoni te shkruani ne te ardhmen.
Ju deshiroj shendet dhe suksese ne punen tuaj.

[ Ky afishim u ndryshua nga: sharraxhiu më 2007-03-24 23:22 ]

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 24.03.2007 23:13

I nderuar "Shqiperues" !
Sapo u ktheva dhe mire se ju gjeta.
"Shqiperues" i nderuar, do me vinte keq nese me keni keqkuptuar, pasi une nuk i vleresoj ata qe pyetin dhe nuk shajne e fyeejne, nuk i diskualifikoj si te paqytetruar. Gjithesesi, ju falenderoi per interesimin Tuaj.
Mbase i dini te dhenat per te tjeret, kurse sa i perkete Fondit VENDLINDJA THERRET, ai ka qene thjeshte fond i karakterit ushtarak dhe mbi strukturat e fondit kane qene Shtabi i Pergjithshem i UCK-se. Ndoshta do me kuptoni, se nuk jame i thirrur qe te jap sekrete, qe ne ate kohe kane qene ushtarake.
Ndoshta nuk e teproj te ua rikujtoj, se nuk ka qene fond publik, sic ka qene fondi shteteror. Per ate fond mund te kerkoj llogari secili qytetar, kurse per fondin Vendlindja therret, them se nuk mund te kerkoj dhe te jap kush te doj e kur te doj llogari.
Shendet e suksese!

ibrahim_kelmendi@yahoo.de

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 24.03.2007 23:44

I nderuar "Gjarper" "
Lidhur me bashkebisedimin Tuaj dhe te "Tarasit", une nuk kam nevoje te behem refer. edhe me pak gjyqtar. Por mund te jap nje sqarim te vogel se i perkete librezave e vertetimeve te LPK-se.
Shpesh here na jane drejtuar organet e shteteve perkatese me pyetjen nese njeri ose tjetri jane anetar et LPK-se. Dhe vazhdimisht u kemi kthye pergjigje, se nuk kemi te dhena konkrete per anetaret ne Kosove. Une vete kam qene edhe perkthyes ne Gjermani dhe ne kete shtete nuk mund te gjendet individ qe me ka dhene te holla per ta ndihmuar gjate shqyrtimit te kerkeses per azil. Nese kam mundur t'i ndihmoj, atehere e kam bere pa kundershperblim. Kurse deshmine e te qenurit anetar i LPK-se, azilkerkuesi eshte dashur ta vertetoj gjate intervistimit / degjimit dhe jo me vertetim te leshuar nga udheheqja e LPK-se. Nuk perjashtohet mundesia qe ndonje keqberes te kete sajuar verteteime false, pasi ne ate kohe keqberesit cfare nuk sajonin.
Tani pergjigjet ne pyetjet Tua:
Pyetje: Cilin rregullim shtetror e simpatizoni dhe cilin nga keto do ti preferoni Kosoves?
Pergjigje: Ate qe e deshirojne dhe e votojne shumica e qytetareve. Per shije timen eshte demokracia popullore dhe ajo qe e duan pseudo-demokratet..

Pyetje: Sa i perket kosoves cilin opcion nga keta do ta kishe preferuar, Kosoven e pamvarur, apo Bashkimin me Shqiperi si nje regjion i njejt me regjionet tjera te shqiperis, ose opcionin e Ballkanis?
Pegjigje: Do e parapelqeja ate qe eshte e natyrshme, por fatkeqesisht, nuk po eshte e mundur ate qe po deshirojme. Prandaj jemi te detyruar te pranojme te mundshmen, meqe nuk kemi vullnet e fuqi per ta fituar te deshirueshmen dhe te drejten.
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 24.03.2007 23:49

I / E nderuar "qeku11" !
Libri mua nuk me ka kushtuar asgje, sepse financimin e botimit e ka bere shtepia botuese FOCUS (i ka kushtuar 1,20 euro libri). Kopertinen e ka bere nje Mik nga Shkupi. Jane shtypur 3'000 ekzemplare (3.600 euro). Po botuesi i ka shitur 2.600 ekzemplare nga 2,99 euro (bashk me gazeten FOCUS), kurse mua per honorar m'i ka dhene 400 libra.
Tung

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 25.03.2007 00:00

I nderuar Z. "hotiani" !
Ju falendroj per urimet Tuaja.
"Hotiani" (pyetje): Perse valle ne skenen politike te Kosoves se pasluftes nuk gjendet IBrahim Kelmendi?
Pergjigje: Sapo m'u mundesua te kthehem ne Kosoven e cliruar, m'u duke vetja imigrant, pasi nuk kisha qene gati 25 vjet. Vendosa fillimisht te beje riintegrim social e shoqeror dhe pastaj te shoh, nese ka nevoje ndokush per angazhim timin.
Pyetje: Si e keni perjetua menyren e rivarrimit ne Kosove te Jusuf dhe Bardhosh Gervalles ne njeren ane dhe Kadri Zekes ne anen tjeter?
Pergjigje: Si nje atentat shpirteror...
Pyetje: Po te ishte e mundur e pamundura a do te pajtohej JUsuf Gervalla me kete vendim ?
Pergjigje: Pergjigjja eshte e vetekutueshme.
Shendet dhe suksese!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 25.03.2007 00:06

I / E nderuar Z. "qku11"
Ju: Nese nuk jam keq informuar ju e keni djal te vellaut Qerimin qe eshte nje nga themeluesit e UÇK-se (sidomos i rendesishum ne zonen e Dugagjinit).
Une: Qerim Kelmendi eshte vellau im me i vogli.
JU: Sa her jeni takuar ju me komandantin e lavdishum Ilir Konushevci, dhe a ka te ngjare qe atentati qe u be ndaj ti te jet si shkak i zenkes se tij me Gjavitin , por njikosisht edhe konflikti juaj me Gjavitin e Azemin?
Une: Me te Lavdishmin Iliri Konushevci nuk jam takuar disa here, por

kemi bashlvepruar ngusht, sidomos gjate muajve mars e prill 1998.
Me Xhavitin e Azemin nuk jam ne konflikt...
Shendet dhe suksese!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 25.03.2007 00:14

Z. "okii",
Ju: A mund te na tregoni per Vrasjen e Skender Kuqit nga Lutogllava.pse u vra aj.a kini ndonje info te sakt?
Une: Nuk dij gje, bile nuk jam interesuar te pyes, nga se me ka ardh keq. E kisha fqinj, shoke klase ne shkolle te mesme dhe familjet miq prej dekadash. E kam perjetuar rende lajmin per vrasjen e tij, sepse kur na erdhi lajmi, mbesa e tij (vajza e vellaut) po bente pune vullnetare ne zyre te Fondit VENDLINDJA THERRET (ne Bon te Gjermanise). Meqe nuk kam jetuar per gati 25 vite ne Kosove, nuk ia di veprimtarine.
Shpresoj te sqarohet rasti i vrasjes se tij, nese nuk eshte sqaruar deri tani.
Tung

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 25.03.2007 00:36

I / E nderuar "Diogjen" !
Ju: Eshte thene tashme disa here se me fajin e vllezerve gervalla te gjalle (Hysenit, Avdylit) u be ndarja e rivarrimit te deshmoreve ne Kosove. Nuk kam qellim ta shfajsoj askend nga pergjegjesia (pergjegjesite) por kujtoj se ata kurre nuk ishin bashkë. Ata ishin takuar te Jusufi per tu bashkuar pas nje deshtimi qe kishte ndodhur ne Turqi.
Une: Qe nga fillimi i prillit 1981 e deri kur kane ndodhur atentatet e kobshme, Jusufi dhe Kadriu kane vepruar me ngushte ne mes tyre, se sa t'i perkishnin nje organizate, nese mund te formulohet domethenshem pershkrimi i bashkpunimit te Tyre.
JU Z. Kelmendi, sipas bisedave qe jane zhvilluar ate nate, na trego cka iu ndante me Organizaten e Kadri Zekes dhe cfare bisedash per bashkim jane zhvilluar ate nate te kobshme ne banesen e Jusuf Gervalles?
Une: Ne naten e fundit Jusufi, Kadriu, Bardhi e une kemi vendosur bashkimin, faktikisht e konkretisht, per te cilin jemi pajtuar qysh ne gushte te vitit 1981
Ju: Ne nje vend keni thene: “Bardhi me lajmeroi se Jusufi ka ardhur ne Gjermani”. Na tregoni ku punonte dhe cfare pune bente Bardhi ne ate kohe ne Gjermani?
Une: Eshte pershkruar ne roman me gjeresisht. Bardhi ka qene i punesuar ne ARBEITER WOHLFAHRT gjerman. Ky ka qene institucion gjerman qe eshte marre me keshillim te punetoreve te huaj. Ky institucion ekziston edhe tani. Bardhi ka konkuruar ne kerkesen qe ka bere ky institucion gjerman dhe e ka fituar vendin e punes per shkak te pergatitjes se tij profesionale.
Ju: Ne nje vend keni thene se fondi “Vendlindja therret” ishte fond privat. Ketu me falni, por nuk pajtohem. Nje fond nuk mund te jete privat kur hapet ne emer te Atdheut. Fondi privat mban emrin dhe mbiemrin e perveçshem te personit si dhe adresen e tij kopmlet. A jane keqperdorur a jo eshte pune tjeter, por ato jane kerkuar ne te gjitha shtetet ne emer te Popullit per clirimin e Atdheut. Sigurisht, nese te mban shendet, une lutem qe te mbaje, nje dite do ta

shkruajsh nje liber tjeter edhe per Fondin “Vendlindja therret. Kete gje duhet ta bej edhe Bukoshi detyrimisht. Ai dihet qe ka gjynahe shume sepse ka sabotuar gjithcka- edhe ne paqe edhe en lufte!
Une: Fondi VENDLINDJA THERRET nuk ka qene privat dhe as publik, ne kuptim te mirefillet te fjales. Ate e ka themeluar LPK-ja per te ndihmuar UCK-ne. Ndoshta profesionalistet do te na shpjegojne se cfare tretmani duhet t'i japim keti Fondi. Po sigurova deshmi kokeforta, se ndokush i ka pervetesuar ose tjetersuar mjetet e ketij Fondi, sigurisht qe do te reagoj, pasi nuk ua fal dhe nuk beje kompromis me keqberesit.
Shendet dhe suksese!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

Ti i perzien gjërat. Së pari, të kam sqaruar Ty dhe të tjerëve që, s'ka pas libreza por ka ekzistuar Programi dhe Statuti i botuar në formë të një liberthi të xhepit.
...
Unë me asgjë nuk e kam sulmuar Ibrahimin ngaqë si Njeri dhe patriot meriton respekt dhe unë e kam thënë që; edhe më herët kam pas një respekt të heshtur për të sepse e dija që boll " i praptë është" por i drejtë dhe i sinçertë.
E sa i përket librit " Atentatet" një vështrim do t'ja dërgojë ndoshta qysh nesër ngaqë në mungesë kohe s'po mundem të ulem dhe ta shkruaj.
Një nga ato vërejtje që kam pas unë besoj që i kishte prekur Ramë Shkreli...kur kishte folur për një lektyrim më të mirë...
Pra do të flasë për librin nga ana artistike.
....
Ka nga ato vështrime që edhe sot janë aktuale...
[/quote]

Z. Kelemendi urime per librin dhe guximin. Librin ne tersi nuk e kam lexuar ende, disa pjese po, por kjo nuk me lejon te jap ndonje vleresim. Fundja, Ju s’keni kerkaur asnje vleresim nga ne ketu, por keni shprehur vullnetin t’iu pergjiegjni pyetjeve tona per te na e shuar kurreshtjen rreth vrasjes se trefisht ne fjale qe trajton romani juaj.
Pyetjet e mia do t’i filloj me paragrafin e fundit te shkrimit te nofkes **hotiani** te cilen do ta formuloja keshtu:
Eshte thene tashme disa here se me fajin e vllezerve gervalla te gjalle (Hysenit, Avdylit) u be ndarja e rivarrimit te deshmoreve ne Kosove. Nuk kam qellim ta shfajsoj askend nga pergjegjesia (pergjegjesite) por kujtoj se ata kurre nuk ishin bashkë. Ata ishin takuar te Jusufi per tu bashkuar pas nje deshtimi qe kishte ndodhur ne Turqi.
1. Z. Kelmendi, sipas bisedave qe jane zhvilluar ate nate, na trego cka iu ndante me Organizaten e Kadri Zekes dhe cfare bisedash per bashkim jane zhvilluar ate nate te kobshme ne banesen e Jusuf Gervalles?
2. Ne nje vend keni thene: “Bardhi me lajmeroi se Jusufi ka ardhur ne Gjermani”. Na tregoni ku punonte dhe cfare pune bente Bardhi ne ate kohe ne Gjermani?
3. Ne nje vend keni thene se fondi “Vendlindja therret” ishte fond privat. Ketu me falni, por nuk pajtohem. Nje fond nuk mund te jete privat kur hapet ne emer te Atdheut. Fondi privat mban emrin dhe mbiemrin e perveçshem te personit si dhe adresen e tij kopmlet. A jane keqperdorur a jo eshte pune tjeter, por ato jane kerkuar ne te gjitha shtetet ne emer te Popullit per clirimin e Atdheut. Sigurisht, nese te mban shendet, une lutem qe te mbaje, nje dite do ta shkruajsh nje liber tjeter edhe per Fondin “Vendlindja therret. Kete gje duhet ta bej edhe Bukoshi detyrimisht. Ai dihet qe ka gjynahe shume sepse ka sabotuar gjithcka- edhe ne paqe edhe en lufte!

Nese me lejon nofka tarasi kam deshire t'i nderroj dy-tre fjale me te. tarasi, z. Kelmendi me sa kuptova nga mesazhet publike ketu nuk po kerkon nga askush vleresim teknik as artistik. Vleresimi juaj artistik (stilistik) per neve s'ka asnje vlere nese Ju ia dergoni z. Kelmendit ne posten e tij elektronike. Ai vleresim mund t'i sherbej per ndonje liber tjeter. Kaq! Perndryshe, gjithe vellon e madheshtise qe ti, apo ndonje tjeter me dekada eshte munduar t'ia veshni Levizjes (LPK) z. Kelmendi e ka demistifikuar ne ate moment kur ka pranuar qe shkrimi i z. Adem Gashi t'i paraprije romonit "Atentatet"

*Gjatë formimit shoqëror e kombëtar,*
*kulturor e religjioz, shkencor e politik,*
*autori ka njohur shumë mite, kulte, idole e hyjni.*
*Përfundimisht kredoja e tij e ka përmbysur*
*hierarkinë e idiolatrisë duke ia shpalosur surrogatët e tyre.*
*Ju mund ta akuzoni autorin për mungesë modestie,*
*gjatë gjithë kohës që ai njeh, respekton,*
*i falet me përkulje dhe devotshmëri vetëm të vërtetës.*

*Është krejt i ndërgjegjshëm se një ditë të gjithë do t'ia kthejnë shpinën e do ta lënë.*
*Një ditë, është plotësisht i ndërgjegjshëm, gjithçkaje të kësobotshme do t'ia kthejë shpinën e do ta lërë.*
*Edhe kur e lënë, edhe kur i lë, në thelb nuk ndërron gjë.*
*E vërteta do të qëndrojë e përjetshme në fronin e saj.*
*Kjo vravashkë s'ka të bëjë as me Dialogëte Platonit, as me Mbrojtjen e Sokratit.*
*Ky shkrim s'është tjetër veçse një akt dëshmimi i autorit, blatuar hyjneshës së tij, të vetmës dhe të tërëkohshmës.*
*Adem Gashi*

Me vjen mire per "zbutjen" tende tarasi. Deshira jote per te lene pershtypjen se ne Levizje ende ka shume gjera qe nuk dihen apo s'duhet te dihen (ne emer te patriotizmit) vetem se e ngarkon me dyshime vete Levizjen dhe kreretv e saj. Edhe aty ku i drejtohesh z. Ibrahimit, **e dija që boll " i praptë është" por i drejtë dhe i sinçertë...** nuk qendron, sespe njeriu mundet te jete i prapte dhe i sinqerte, por kurre i prapte dhe i drejte. Une e e kopjove fjaline tende pa thojza. E di qe je i afte te me kuptosh pse e bera kete. Edhe tentim spjegimet se ky liber eshte roman artistik apo hstorik apo te dyjat, z. Kelmendi e ka thene vete me pak rreshta si:

*Ngjarjet e romanit janë fragmente të jetës dhe veprimtarisë në ekzil, gjatë viteve 1979 – 1982, të personaliteteve tashmë historike,* ***Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla*** *dhe të bashkëve¬primtarëve e kundërshtarëve të tyre, si dhe rrethanat para atentat¬eve, më 17 Janar 1982, në Untergruppenbach, afër Hajbronit (Heil¬bronn) të Gjermanisë dhe pas atentateve, deri më 17 janar 1985. Ato janë paraqitur ashtu siç i kam përjetuar dhe siç i kam mbajtur mend, pa pretendim për të qenë të vërteta historike. Mendimet dhe vlerësimet janë të kohës, kur kanë ndodhur ngjarjet.*
*Autori*

Z. Kelmendi, per fund dua sinqerisht t'iu pershendes. Nuk te njoh as kurre nuk te kam pare. Ne jeten time kam degjuar pershkrime nga me te ndryshmet per ju: nga ato se je njeri teper arrogant dhe agresiv dhe bashkepunetor i UDBes deri ta ato me pozitivet se je njeri shume patriot apo patriot mbi patriot.
Nga komunikimi qe po beni me debatuesit, se pakut ne shkrim, nese kete nuk e beni ne menyre "te prapte", keni fituar simpatin time si nje bashkebisedues i zoti dhe i afert me njerezit.
Kur e kam pare temen e hapur kam menduar se do te kete nje

rrebesh pyetjesh nga me te zeshmit ne kete forum, por disi, pervec tarasit, jane zbutur, apo i zbutet edhe shume zeboria te ketij forumi. Ndoshta eshte wikend e kane dalur per relaksim ne natyre.
Rrofte dita e hene! "Dite e re, nafake e re".

<font class=editedby>[ Ky afishim u ndryshua nga: diogjeni më 2007-03-24 18:19 ]</font>
[/quote]

profile | edit | quote

**Andi**

**Anëtar që nga:** 15.07.2004
**Afishime:** 94
**Vendbanimi:** Zvicër

**Afishuar me:** 25.03.2007 00:42

I nderuar z. Kelmendi.
Ju përgëzoj për librin. Jam ndër lexuesit e tij të parë besoj.
Në libër më ka bërë përshtypje figura e Xhabir Shatorit. Spjegimi që i keni bërë atij personazhi më ka rezultuar edhe me ndonjë personazh gjatë luftës çlirimtare i cili si duket ishte më dinak se Xhabir Shatori.
E pres me padurim vazhdimin e romanit dhe përballjen e Miranit me këta peronazhe.
Shëndet e suksese
Andi

profile | mail | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 25.03.2007 00:59

I / E nderuar "trixi" !
JU: Ne bindjen e njeriut nuk mund te ndikon kurrfar romani,kur eshte fjala per te verteta,andaj keto "arsyetimet"dhe berja me gisht tash pas 25-vitesh sikur tingllon shfajsim, larje e ndergjegjjes se papaster apo edhe ri-atentat !!
Une: Sa per informim, qysh nga momenti i atentateve jam angazhuar per te zbulluar dhe denuar doraset, kurse urdheruesve te tyre (UDB-se) i eshte dhene pergjigja - ka ndodhur ülirimi i Kosovases nga pasuesit e rruges qe pergatiten Jusufi e Bardhi.
Meqe organet gjermane nuk kane mundur ta denojne vrasesin e dyshuar (Rezilin), une jam angazhuar qe te beje presion mbi strukturat perkatese ne Kosove qe te merren me zbulimin e denimin e vrasesve dhe te mos behen sikur nuk ka ndodhur gje para 25 viteve.
JU: Une nuk i perkas kesaj kategoris se puthadoreve te cilet shkelin mbi gjakun e deshmoreve dhe me nje HOP(roman)harrohen 25-vitet e ketij misteri te cilen tash po na e zbulon shoku i ngusht i Jusufit,Bardhit dhe Kadriut !!!!!
Une: Lum si ju qe nuk jeni puthador...
JU: Pyetje: Si mund ta arsyetosh heshtjen dhe mos ndermarrjen e asgjeje per 25-vite per keta "shoket" me te ngusht nese veq e ke dijt te verteten ?!!!
Une: Nuk kam hesht, por jam angazhua gjate gjithe kohes, me gjithe energjine e diturine, qe te hakmerrem per atentatet makaber ndaj ketyre personaliteteve historike. Edhe romani eshte pjese e kontrubutit tim per hakmarrje konstruktive.
JU: Pyetje: Si mund te rrish per 25-vite indiferent ndaj familjes Gervalla-Zeka,dhe femijve te Jusufit ?!!!
Une: Nuk kam ndejuar indiferent, por jam angazhuar t'ua beje respektin ne menyren me te mire, duke vazhduar rrugen e tyre; ka disa qe ju lariten familjeve te personaliteteve, sa per te afirmuar pamerituesh em veten e tyre...
JU: Pyetje:Si mund ti akuzosh dhe perbuzish deshmoret ne Belgjik ?!!
Une: Nuk akuzoj dhe perbuz asnje deshmor, ndersa kam pershkruar

mendimet e kohes per personazhe te romanit. Edhe une, mendoj, te mos jem puthador i askujt dhe te mos beje lajka.
JU: Pyetje:sikur te ishe ti rezili (dorasi)si do te veproje ne kete rast me I.Kelmendin dhe me akuzen ?

Une: Nuk deshiroj te ve veten ne pozite te Rezilit as ne menyre hipotetike.
JU: Kam edhe disa pyetje por kesaj po te kursej per me vone.
Une: Vetem urdheroni.
JU: Edhe per nje ju lutem forumisteve qe mos ta marrin rolin e avokatit apo te mbrojtesit te I.Kelmendit,sepse ky me vetdeshir ka pranu dialog !
Andaj nuk kam nevoj per komentimet e askujt perveq Z.Kelmendit.
Une: Them qe nuk te shkon percaktimi, se si duhet te bashkebisedojne "forumistet"; Eshte kulture qytetare qe te mbrohet drejtesia...
Shendet dhe suksese!
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

profile | edit | quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 25.03.2007 01:02

piloti afishoj me 2007-03-24 18:50 :
Inderuari z.Kelmendi ,
Ju lutem pergjegjuni sinqerisht , per cilin opcion politik jeni(perkrahni):
1. Kosova shtet i pamëvarur
2. Bashkimi Kombetar
PERGJIGJE: E deshiroj bashkimin kombetar, e pranoj pavaresimin shteteror te Kosoves.
Tung

profile | edit | quote

**Delegati**

**Anëtar që nga:** 12.05.2006
**Afishime:** 548

**Afishuar me:** 25.03.2007 01:03

> Quote:
>
> I_Kelmendi afishoj me 2007-03-25 00:14 :
> Z. "okii",
> Ju: A mund te na tregoni per Vrasjen e Skender Kuqit nga Lutogllava.pse u vra aj.a kini ndonje info te sakt?
> Une: Nuk dij gje, bile nuk jam interesuar te pyes, nga se me ka ardh keq. E kisha fqinj, shoke klase ne shkolle te mesme dhe familjet miq prej dekadash. E kam perjetuar rende lajmin per vrasjen e tij, sepse kur na erdhi lajmi, mbesa e tij (vajza e vellaut) po bente pune vullnetare ne zyre te Fondit VENDLINDJA THERRET (ne Bon te Gjermanise). Meqe nuk kam jetuar per gati 25 vite ne Kosove, nuk ia di veprimtarine.
> Shpresoj te sqarohet rasti i vrasjes se tij, nese nuk eshte sqaruar deri tani.
> Tung

I nderuar zoti Ibrahim Kelmendi,
Ashtu siç kam qenë gjithmonë i drejtpërdrejt ashtu do të jam edhe tani dhe të them se nuk po më pëlqejnë këto biseda me forumistët anonim.
Unë e dij se ti i përballon të gjithë sepse nuk ka këtu penda të forta.

Më lehtë mund të them se ka provokatorë të fortë, prandaj nuk të preferoj që të përgjigjesh në çdo pyetje të njerëzve që nuk njihen.
Unë jam zbuluar në këtë forum sepse më kanë quajtur kopil të Miladin Popoviqit. Për t'iu treguar se nuk jam pjellë e Miladinit iu kam treguar se jam Aqif Kastrati i biri i Sabit Kastratit nga Hogoshti.
Dy herë më parë u paraqita; njëherë në këtë temë, herën tjetër në atë temën, ku flitet për vrasësin e vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zeka.
Edhe një herë po të them se nuk e vlenë të humbasësh kohë duke iu përgjigjur disa shpifësve dhe provokatorëve.
Nuk e dij se a e ke përcjellur "forumi. de" më parë, por në një tëmë tjetër, pikërisht për ty, kanë shkretëtuar disa forumistë, që tani paraqiten më të butë sesa qingji.
Të përshëndes Aqif Kastrati.

profile | edit quote

**hotiani**

**Anëtar që nga:** 06.06.2006
**Afishime:** 229

**Afishuar me:** 25.03.2007 01:12

Z. Kelmendi.
Disa vleresime tuaj per shqiptaret qe me besnikeri i sherbyen regjimit sllavo-komunist me duken shume te buta dhe pragmatike.
Ne kete rast ne radhe te pare e kam fjalen per ata te cilet kishin funksione ne organet e sigurimit,gjyqesor dhe per nje pjese te politikajve dhe gazetareve. Keta qe zbatuzan me perkushtim direktivat pa marre parasysh pasojat qe u shkaktonin bashkombaseve.
Keto elemente pas renjes se komunizmit u kamufluan ne disa parti politike .ku shume prej tyre vazhduan ne menyre te sofistikuar ti sherbejne te njejtes politike . Kam pershtypjen se shumica edhe sot ne forma te ndryshme zbatojne direktivat e padronit nga Beogradi.
Ne kete aspekt ju kisha lutur per mendimin tuaj:
A mendon Ibrahim Kelmendi se pas pavaresise Kuvendi i Kosoves duhet te aprovon ligjin e lustracionit ne menyre qe ata qe zgjaten agonine dhe vuajtjet popullit te Kosoves se paku te largohen nga vendet kyqe te organeve te pushtetit?
A ishte veprimi i ketyre strukturave te ish regjimit shkaktari kryesor i perqarjes dhe polarizimeve kaq te medha te skenes politike ?

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 25.03.2007 01:16

I nderuar "taras" !
Ju i paskeni suret e gjata.
Ndoshta do duhet te polemizojme me me nge.
Po patet pyetje konkrete dhe pak me te shkurta, urdheroni.
Bedi Islamin e ka zgjedhur Kuvendi i LPK-se, me vota te fshehta.
Edhe sot mendoj se ka zgjidhja me e mire per situaten. Per kete do bindeni, kur te kemi kohe te shkembejme mendime e vleresime me konkrete.
Sa u perkete emertimeve te personazheve, ju po na delni si usta i tyre, por une nuk dua t'ua miratoj ustallekun Tuaj.
Une i kam emertuar ata sipas deshires sime, kurse Ju, si lexues, keni te drejte te kritikoni.
Megjithate, ju falenderoj qe e keni lexuar romanin dhe tani po "harrgjoheni" me vleresime e kritika.
Tung

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 25.03.2007 01:23

I nderuar Z. "Sharraxhiu" !
Te falenderoj per komplimentet dhe per kerkim faljeje.
Kam te gatshme nje mori botimesh per angazhimin politik e patriotik te emigracionit (trajtim publicistik), por profesionalistet me kane keshilluar qe te pres distancen e duhur kohore (sic prita nje cerek shekulli per te publikuar romanin ATENTATET).
Tung

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 25.03.2007 01:48

I nderuar Z. Kastrati!
Ju falenderoj per keshillat dhe propozimet. Me gjithe respektin, une do perpiqem t'i pergjigjem cdo pyetje dhe te komentoj edhe mendimet kritike te "forumisteve". Une nuk deshiroj t'i paragjykoj njerezit, se bejne pyetje provokative meqe deshirojne te me njollosin. Une po nisem nga sinqeriteti i tyre, se ashtu jane (dez)informuar per mua dhe prandaj kane krijuar mendim. Deri tani jane (dez)informuar nga te tjeret per mua, tani po kerkojne pergjigje ne pyetjet e tyre dhe mendime nga une. Sigurisht, do i peshojne rishtas gjerat dhe ndoshta do te ndryshojne mendimin e tyre: ndonjeri do me "nxi" me shume, ndonje tjeter do me "zbardh" me shume.
Gjithesesi, njerezit kane te drejte te ndryshojne mendimet e tyre, sa here te duan. Por nuk ben t'ua privosh te drejten askujt, duke u thene se dje ke fol keq, prandaj sot nuk ke te drejte te heshtesh ose te mos folesh po aq keq, sa ke fol dje, aq me pak nuk ke te drejte t'u thuash, se nuk ke te drejte te follesh sot me mire se dje.
Ju lutem, mos mendoni se po zbrazem kunder Jush, por po shpreh ca mendime te pergjithesuara. Nuk eshte qyteteruese t'u privohet njerezve e drejta e permiresimit te perditshem, duke u thirrur ne ate se dje ishte i keq dhe sot nuk ben te behe me i mire se dje. Miresia e njeriut nuk ka fund, si nuk ka edhe e keqja. Avancimi i perditshem i kesaj miresie te njeriut, eshte ne fakt edhe historia e gjate e zhvillimit te njeriut - nga ai primitivi qe nuk e njihte as zjarrin, e deri te qyteterimi aktual, per te shkuar drejte nje qyteterimi akoma me te perparuar e me njerezor.
Me fal se e zgjata, por deshirova te shpreh gatishmeri per t'u pergjigjur te gjitha pyetjeve (per mua nuk ekziston pyetja provokuese). Ne fakt, me shume me interesojne pyetjet e kritikat e "kundershtareve", se sa, pyetjet e lavderimet e "bashkemendimtareve".
Shendet e suksese!
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

profile | edit quote

**Alfonsi**

**Anëtar që nga:** 07.08.2003
**Afishime:** 352

**Afishuar me:** 25.03.2007 01:56

z.Kelmendi,
Besoj se keni menduar shume deri sa keni shpallur publikisht kete emer.Tani me kjo u ba.
Qfar pritni tani dhe si deshironi te rrjedh e gjithe kjo e tera?
A keni marr ndonje ftese nga ndonje organ?Cili organ apo cila Gjykat mund te jet sipas mendimit tuaj kompetente?
A pritni qe Familjet e te vrareve(pasardhesit) te ngrisin padi private,apo Prokuroria ket duhet ta bej?
Po qese kjo ndodh ateher a mendoni se ka apo ju ne kete rast keni prova te mjaftueshme materiale per te provuar fajesin?

A ka mundesi qe vrasesi te deshmoj pafajsin e tij me provat e tij qe ndoshta do te jen me te shumta se te akuzuarit?
A ka mundesi se pas kalimit te nje kohe te gjat te vie ne shprehje "Parashkrimi i afatit",kalimi i afatit objektiv i te drejtes per te ngritur Padi
Pra ketu eshte qeshtja pak e komplikuar e sidomos tek e drejta e kompetences reale dhe territoriale.Vepra eshte kryer ne nje vend tjeter.I akuzuari ka mundesi te jetoj ne Kosove,apo ne ndonje shtet tjeter.Paditesi jeton dikund tjeter.Gjykata ka qdokund,por ne cilen Gjykat duhet ngrituar padin....etj.
Te gjithat keto me falni se nuk jan qeshtje qe ju takojn juve te i zgjidhni,dhe te pergjigjeni,por e tera ketu rrodhi nga ajo pyetja ime ne fillim se:Si keni deshir tani te rrjedh Procedura ta quajm keshtu? edhe diqka!
Mos rastesisht ai njeri qe ju keni shpallur si vrases ju ka kontaktuar,dhe a eshte lajmruar dikund publikisht lidhur me kete akuze.?

Ne fund te ju them sinqerisht se me keni len pershtypje gjat pergjigjeve tuaja ,sidomos ndaj atyre disa pyetje provokative.Paraqiteni shume gjakftoht dhe shume i kulturuar. Po te ishte ne rastin tuaj z.Tarasi ai do te humbte durimin dhe do ti quante "femij te shkines"apo edhe me keq.
Keta njerz sikur qe ju paraqiteni ne pergjigjet tuaja,meritojn respekt dhe jan per te u perkulur para tyre.Pa marre parasysh bindjet dhe qendrimet politike,ideologjike...etj, qe mund ti ken.
Andaj une do te kem shume respekt dhe ndoshta edhe po te kem fatin te takoj dikund edhe do te perkulem.
Shume shendet juve,dhe Familjes tuaj
p.s.permenda rastesisht personin me nofken Tarasi.Nuk do te thot se nuk kam respekt ndaj tij.Perkundrazi,edhe pse nganjeher edhe me mua humbte durimin.

---

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 25.03.2007 03:41

---

Quote:

---

hotiani afishoj me 2007-03-25 01:12 :
Z. Kelmendi.
Disa vleresime tuaj per shqiptaret qe me besnikeri i sherbyen regjimit sllavo-komunist me duken shume te buta dhe pragmatike. Ne kete rast ne radhe te pare e kam fjalen per ata te cilet kishin funksione ne organet e sigurimit,gjyqesor dhe per nje pjese te politikajve dhe gazetareve. Keta qe zbatuzan me perkushtim direktivat pa marre parasysh pasojat qe u shkaktonin bashkombaseve.
Keto elemente pas renjes se komunizmit u kamufluan ne disa parti politike .ku shume prej tyre vazhduan ne menyre te sofistikuar ti sherbejne te njejtes politike . Kam pershtypjen se shumica edhe sot ne forma te ndryshme zbatojne direktivat e padronit nga Beogradi.
Ne kete aspekt ju kisha lutur per mendimin tuaj:
A mendon Ibrahim Kelmendi se pas pavaresise Kuvendi i Kosoves duhet te aprovon ligjin e lustracionit ne menyre qe ata qe zgjaten agonine dhe vuajtjet popullit te Kosoves se paku te largohen nga vendet kyqe te organeve te pushtetit?
A ishte veprimi i ketyre strukturave te ish regjimit shkaktari

kryesor i perqarjes dhe polarizimeve kaq te medha te skenes politike ?

---

I / E nderuar Z. "hotiani" !

Do te lutesha per mirekuptim. Kosova ishte e pushtuar dhe rrethanat e pushtimit te imponojne edhe sjellje te padeshirueshme, deri edhe kunderkombetare. Por, ne ato rrethana, i njejti kuvend krahinore (i KASA-se) dhe federativ (RSFJ-se), ka aprovuar ligjet perkatese per arsim, me UDB-ne, etj. Qe do te thote, kane qene hallka te te njejtin zingjir, gjegjesisht struktura te te njejtit sistem. Mesuesi dhe UDBashi i kane sherbyer te njejtit sistem. Sic nuk kerkohet te denohet mesuese, nese ka respektuar ato ligje, gjithashtu as per UDBashin qe ka zbatuar ligjet e te njejtit sistem, nuk duhet te kerkohet qe te denohet.

Po sjell nje shembull paksa brutal, i cili ndoshta do ju ndihmon ne rigjykime: Sa vite Gjergj Kastrioti i ka sherbyer shume pushtuesve osmanlinj dhe kur vendosi t'i kthehet kombit te vet, ju fal e kaluara dhe u vleresua Hero legjendar. Bile, shqiptaret harrojne ta therrasin ne merin qe ia kishin vene prinderit, por e therrasin ne emrin tjetersues - Skender Beu, qe ia vune pushtuesit ne menyre te perdhunshme. Pastaj, a nuk ka qene Hasan Prishtina parlamentar turk, a nuk ka qene Ismajl Qemali pasha turk, etj. Iu kthyen kombit dhe u vleresuan heronje te kombit.

Qe te mos ta zgjas, pasi po mund te merrne me mend kriteret e mia, jam per te ndeshkuar ata UDBashe, gjyqtare, prokurore, etj., qe kane bere krime te kunderligjshme dhe per secilin rast duhet te behen denoncime konkrete, nga njerez te demtuar.
Ligji per "lustrime" nuk do na ndihmoj shume. Do thirremi ne dosje qe i kane perpiluar ata qe Ju propozoni te perndiqen, ose qe do riperpilohen nga specialiste ne Beograd, ku gjenden ato dosje, etj, etj.
Naten e mire!

**Shqipëruesi**

**Afishuar me:** 25.03.2007 10:18

---

**Anëtar që nga:** 08.08.2004
**Afishime:** 556
**Vendbanimi:** Prishtinë

I nderuar z. Kelmendi,
- Kam një karakter të tillë që nuk mjaftohem me përgjegje asnjërëse.
Ajo që më pengoi në rastin tuaj ishte se u treguat i njëanshëm,duke folur për Vilën e Presidentit dhe Fondin e Qeverisë.
E kam cekur edhe më lart se unë nuk kam shumë informata për keqpërdorimin e Fondit Vendlindja Thërret por kjo ka qenë publike,pas

një interviste në një gazetë lokale që ja kishte dhënë z. Sylejman Selimi lidhur me ato keqpërdorime.
Pra,unë nuk e shpika vet dhe nuk po shpif këtu. Pastaj,ky fond ka pasë degët e tij në të gjitha shtetet Perëndimore ,edhe në Kanadë,me sa di unë.
Ajo që unë këmbëngul të di ,është,që të dëgjoj nga goja juaj:
A ËSHTË KEQPËRDOR FONDI APO JO?
Kaq dhe hiq më shumë.
Përndryshe,më duhet të vlerësoj sjelljen tuaj korrekte që në këtë forum e kishim harruar. Ju falenderoj.Keni përgëzimin tim. Gjithashtu

falemnderit për mundin tuaj t'u përgjigjeni pyetjeve tona.
Gjthë të mirat nga Shqipëruesi

profile | edit quote

**hotiani**

**Anëtar që nga:** 06.06.2006
**Afishime:** 229

**Afishuar me:** 25.03.2007 11:01

Me gjithe respektin per kete debat , duke i kerkuar ndjese zotit Kelmendi, me duhet te shprehe indinjate per keqperdorimin e miresise dhe korrektesise se nikoqirit te ketij debati nga disa forumiste. Rasti me drastik eshte ky i Shqiperuesit ,i cili merr rolin e prokurorit dhe pas dy pergjegjejeve korrekte te zotit Kelmendi,ai kerkon pergjegjejen qe atij i konvenon ,madje sikur ne gjykatore Po ose Jo.
Zoterise nuk i interesojne keqperdorimi i qindera miliona eurosh te Fondit te qeverise, as villat e Velanise e makinat supelusoze qe humbin si sopata pa bisht. Jo.. ky zoteri kerkon nje pergjegjeje per fondin i cili pothuajse ishte burimi kryesor i finansimit te luftes se UÇK- se.e cila u kurorezua me fitore.
Perse e bene kete ? Ne qe lexojme per dite shkrimet e njeaneshme plote akuza ndaj prijseve te UÇK-se dhe LPK-se ,dhe rolin e meritat e politikes pacifiste dhe " te derguarit te perendise" i cili na solli lirine,te ketij forumisti dhe disa nga bashkemendimtaret e tij . Ne e dijme fare mire se ky insistim eshte tendencioz dhe ka si qellim qe te nxjerre se paku nje gjysme pohimi nga personaliteti emblem i Ibrahim Kelmendit per ta perdore si argument komprimitimi dhe demkosje te luftetareve te lirise dhe njerzeve qe vune themelet e UÇK-se ,kesaj force qe beri mrekulline e shekullit duke ndrruar rrjedhat e historise dhe duke mahnitur boten.
Kjo menyre e sjelljes se disa forumisteve te cilet po keqperdorin miresine dhe korrektesine e I. Kelmendit , i cili me tere qenjen e tij ka qene ne anen e atyre qe dhane me se shumti per Kosoven,me beri te reagoj i vetedijshem se zoti Kelmendi i kupton keto dhe shume me mire se me te tille u perballe pothuajse tere jeten dhe ne secilin moment ai edhe bashkeluftetaret e tiju paten pergjegjejen adekuate.
Une kerkoj falje nga moderatoret dhe forumistet e nderuar per kete nderhyrje,por kete e bera i nxitur edhe nga reagimi i forumistit te nderuar Aqif Kastratit i cili preku mu kete segment ; Nuk jemi ne dijeni sa I. Kelmendi ka percjelle rrjeshat e debatit ne kete forum . A e din se nje pjese e forumisteve me shkrimet e tyre tere kohen ,ne menyre direkte apo indirekte perpiqen te demkosin luftetaret dhe organizatoret e luftes se UÇK-se dhe luften e tyre me qellim qe te ngrisin dhe glorifikojne rolin dhe meritat e opcionit te nenshtrimit dhe liderit te saje.
Kesaj pjese te forumisteve i perkete ky Shqiperuesi dhe ne kete fryme eshte insistimi i tij per te degjuar pergjegjejen te cilen deshiron ta degjoje.

Te kerkoj falje edhe nje here z. Kelmendi ndoshta nderhyra fare pa arsye ,por me besoni se perpjekjet ne vazhdimesi te injorimit te vlerave te verteta te vulosura me gjak,gjymtyre te humbura,rini te kaluara neper burgje e tortura jo vetem qe me iritojne por me lendojne thelle ne shpirt aq me teper kur keto vlera sublime tentohen te zevendesohen me antivlera qyqare.

[ Ky afishim u ndryshua nga: hotiani më 2007-03-25 11:13 ]

profile | edit quote

**gjarperi**

**Afishuar me:** 25.03.2007 11:49

**Anëtar që nga:** 27.11.2005
**Afishime:** 526

Te pershendes zotri Ibrahim Kelmendi, Ju falenderoj per pergjigjen, dhe nese e ke lexuar afishimin me vemendje, e shef se edhe une kame pasur bindjen, dhe kame se ato qe ndodhen me libreza dhe vertetime te leshuar nga partija e juaj, dhe nga gjitha partit tjera kane qene te organizuar dhe dirigjuar nga mafiozet e pa skrupullt, qe ter kohen luajten me ndjenjat dhe mjerimin e azilkerkuesve neper bote, dhe puna e librezave dhe vertetimave ishte vetem njera nder njeqind marrzirat e matrapazve ndaj refugjateve, kurse sa i perket polemikat mes meje e tarasit, te kerkoj falje nese kame kerkuar ndoni ndermjetsim, sepse nuk kame nevoj, per pergjegjejen kushtuar opcioneve edhe une jame shume i knaqur, dhe se mendimi ime eshte dhe ishte dhe do te mbetet se rruga ma e mire drejt Bashkimit Kombetar eshte pavarsimi i Kosoves, kurse per rregullimin shtetror te Kosoves le te vendos populli ne nje referendum, edhe une do te pajtohem me ate qe pajtohet shumica, pra ne fund te falenderoj edhe nje her perzemersisht per pergjigjen e dhane.

profile | edit quote

**gjarperi**

**Afishuar me:** 25.03.2007 11:57

**Anëtar që nga:** 27.11.2005
**Afishime:** 526

Te pershendes hotiani, une nuk deshiroj te hy ndermjet teje, dhe shqiperusit, por duhet te jeni real(qe te dy), dhe se nje duhet ta dini ju dhe te gjith se nuk i lejohet askuj te keqeperdor mjetet ne emer te qeveris, dhe as ne emer te UCK-s, e keqeperdorimet jane bere nga te dyja taborret, pra krimit duhet ti thuhet krim pa marr parasysh nga kush u be, e kush ka bere keqeperdorim ma shume, une nuk mund ta vlersoj, sepse per kete duhet ta bejn e ata qe jane pergjegjes per kete.

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Afishuar me:** 25.03.2007 12:11

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

I / E nderuar "Shqiperuesi" !
U pergjigja edhe me heret, se shperdorime duhet te kene ndodhur edhe ne Fondin VENDLINDJA RHERRET, sic ndodhin edhe ne familje, bile njerezit shpredorojne edhe financat personale. I gjithe marifeti eshte qe ato te jene sa me te vogla. Dhe, po shpresoj qe te mos kete pasur shperdorime te medhe, sic po perflitet.
Tung

profile | edit quote

**gjarperi**

**Afishuar me:** 25.03.2007 12:16

**Anëtar që nga:** 27.11.2005
**Afishime:** 526

Te pershendes Zotri Ibrahim Kelmendi, cdo respekt nga une, per afishimin(pergjigjen) e kastratit, dhe nese vetem 50% e keni kete veti ne praktik mjafton, kete nuk e them se dyshoj por kjo kishte me mjaftuar per te gjithe.

profile | edit quote

**Ministri**

**Afishuar me:** 25.03.2007 12:16

**Anëtar që nga:** 20.09.2005
**Afishime:** 264

...." Ato para jane marre per dicka tjetr dhe per nje ceshtje tjeter , dhe jane perdorur per interesat e tua.Per tjeter jan kerkuar dhe per tjeter jan shfrytezuar"J. Gervalla.
Eshte fjala pe 50.000 DM te marra nga Mergata Kroate per blerjen e arnatimit!!!!! Kurse te shfrytezuara per nje lokal ne Peje?????

Pergjigjeja e juaj ishte perafersisht ; :::SE, KUR GJEN BUDALLENJE PSE MOS TE PERFITOSH ...
A jan fjalet e Jusufit ato me lart?
A eshte e vertete kjo ceshtje dhe
A gjeje shpesh BUDALLENJE !!!!!!! per te perfituar????????????????
Me nderime ministri me m te vogel!

profile | edit quote

**Delegati**

**Anëtar që nga:** 12.05.2006
**Afishime:** 548

**Afishuar me:** 25.03.2007 12:31

Quote:
I_Kelmendi afishoj me 2007-03-25 01:48 :
I nderuar Z. Kastrati!
Ju falenderoj per keshillat dhe propozimet. Me gjithe respektin, une do perpiqem t'i pergjigjem cdo pyetje dhe te komentoj edhe mendimet kritike te "forumisteve". Une nuk deshiroj t'i paragjykoj njerezit, se bejne pyetje provokative meqe deshirojne te me njollosin. Une po nisem nga sinqeriteti i tyre, se ashtu jane (dez)informuar per mua dhe prandaj kane krijuar mendim. Deri tani jane (dez)informuar nga te tjeret per mua, tani po kerkojne pergjigje ne pyetjet e tyre dhe mendime nga une. Sigurisht, do i peshojne rishtas gjerat dhe ndoshta do te ndryshojne mendimin e tyre: ndonjeri do me "nxi" me shume, ndonje tjeter do me "zbardh" me shume. Gjithesesi, njerezit kane te drejte te ndryshojne mendimet e tyre, sa here te duan. Por nuk ben t'ua privosh te drejten askujt, duke u thene se dje ke fol keq, prandaj sot nuk ke te drejte te heshtesh ose te mos folesh po aq keq, sa ke fol dje, aq me pak nuk ke te drejte t'u thuash, se nuk ke te drejte te follesh sot me mire se dje.
Ju lutem, mos mendoni se po zbrazem kunder Jush, por po shpreh ca mendime te pergjithesuara. Nuk eshte qyteteruese t'u privohet njerezve e drejta e permiresimit te perditshem, duke u thirrur ne ate se dje ishte i keq dhe sot nuk ben te behe me i mire se dje. Miresia e njeriut nuk ka fund, si nuk ka edhe e keqja. Avancimi i perditshem i kesaj miresie te njeriut, eshte ne fakt edhe historia e gjate e zhvillimit te njeriut - nga ai primitivi qe nuk e njihte as zjarrin, e deri te qyteterimi aktual, per te shkuar drejte nje qyteterimi akoma me te perparuar e me njerezor.

Me fal se e zgjata, por deshirova te shpreh gatishmeri per t'u pergjigjur te gjitha pyetjeve (per mua nuk ekziston pyetja provokuese). Ne fakt, me shume me interesojne pyetjet e kritikat e "kundershtareve", se sa, pyetjet e lavderimet e "bashkemendimtareve".
Shendet e suksese!
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

============

Ibrahim,
Në një paraqitje timen thash se nuk dua ta marr në mbrojtje Z.Kelmendi sepse atë nuk e mbronë vetja e tij, por puna e tij.
Tani po them se Ibrahimi e ka kuptuar shumë mbrapsht thirrjen time.
Për mua debati apo pyetjet dhe përgjigjet duhet të jenë korrekte.
Për mua, debat apo pyetje e përgjegje thuhet se është i tillë vetëm kur njihen dy debatuesit apo ai që pyet dhe ai që përgjiegjet.
Nuk e dij se pse u përgjegjët në atë mënyrë ndaj kërkesës sime!
Nga fakti që njihemi desha të paralajmëroj se:
Në tubimet me bashkatdhetarë nëpër Zvicër, Gjermani, Austri, Francë itali dhe gjetkë që i mbanim ne bartësit e zhvillimit të Fondit "Vendlindja Thërret", e në disa prej tyre edhe ti merrje pjesë, ku një pjesë e bashkatdhetarëve vinin të provokonin dhe të loznin me fatin e çlirimtarëve duke propaganduar "luftën" anti luftës çlirimtare, edhe këtu në forum ka të tillë.
Unë nuk dua të polemizoj me ty në asnjë mënyrë sepse gjithsecili i ka

qëllimet dhe projektet e tija.
Po të përshëndes duke të dëshiruar sukses në këtë praktikë të papraktikë.
Aqifi.

---

profile | edit quote

**Shqipëruesi**

**Anëtar që nga:** 08.08.2004
**Afishime:** 556
**Vendbanimi:** Prishtinë

**Afishuar me:** 25.03.2007 12:35

---

I nderuar Gjarpëri,

- Nuk dua të merrem me Delegatin dhe Hotianin .
Aty ku ti thua, "duhet të jeni real që të dy",
krejt cfarë dua unë është të dalë sheshazi ,se jo të gjithë kanë qenë pa hile,
jo të gjithë kanë luftuar për Kosovën dhe lirinë e saj pa menduar në përvetësime dhe kariera personale.
Por,e them prapë,nuk kërkova përgjegje nga z.Kelmendi për Fondin e Qeverisë sepse ai s'ka të bëjë me te.Për këtë,një ditë do ia bëjmë pyetjen z. Bukoshi.
Për Vilën Presidenciale,do ia shtrojmë pyetjen atij që ka qenë më së shumti përgjegjës ndër të gjallët meqë Presidenti Rugova tashmë është i ndjerë.
Keqpërdorimet janë e njeta gjë. Si Qeveria, si Presidenca ashtu edhe UCK-ja duhet dhënë përgjegjësi. Asnjërën nuk e shfajësova. Por,në rastin konkret kemi të bëjmë me z.Ibrahim Kelmendi dhe ai ka qenë drejtëpërsëdrejti i kycur në "Fondin Vendlindja Thërret".
Pasurimi i përnjëhershëm i disa ish-liderëve të UCK-së con drejt dyshimit,jo vec pse e tha z.Selimi. Për mua,janë këta që kanë shkelur mbi gjakun e dëshmorëve,sepse paratë që janë dhënë për të luftuar serbin mund të kenë qenë të përdorur nga ish-komandantë për tu pasuruar. Dhe ky për mua është KRIM...

---

profile | edit quote

**trixi**

**Anëtar që nga:** 18.08.2006
**Afishime:** 1935
**Vendbanimi:** Gjermani-Dardani

**Afishuar me:** 25.03.2007 12:48

---

Quote:

---

I_Kelmendi afishoj me 2007-03-25 00:59 :
I / E nderuar "trixi" !
JU: Ne bindjen e njeriut nuk mund te ndikon kurrfar romani,kur eshte fjala per te verteta,andaj keto "arsyetimet"dhe berja me gisht tash pas 25-vitesh sikur tingllon shfajsim, larje e ndergjegjjes se papaster apo edhe ri-atentat !!
Une: Sa per informim, qysh nga momenti i atentateve jam angazhuar per te zbulluar dhe denuar doraset, kurse urdheruesve te tyre (UDB-se) i eshte dhene pergjigja - ka ndodhur ülirimi i Kosovases nga pasuesit e rruges qe pergatiten Jusufi e Bardhi.
Meqe organet gjermane nuk kane mundur ta denojne vrasesin e dyshuar (Rezilin), une jam angazhuar qe te beje presion mbi strukturat perkatese ne Kosove qe te merren me zbulimin e denimin e vrasesve dhe te mos behen sikur nuk ka ndodhur gje para 25 viteve.
JU: Une nuk i perkas kesaj kategoris se puthadoreve te cilet shkelin mbi gjakun e deshmoreve dhe me nje HOP(roman)harrohen 25-vitet e ketij misteri te cilen tash po na e zbulon shoku i ngusht i Jusufit,Bardhit dhe Kadriut !!!!!
Une: Lum si ju qe nuk jeni puthador...

JU: Pyetje: Si mund ta arsyetosh heshtjen dhe mos ndermarrjen e asgjeje per 25-vite per keta "shoket" me te ngusht nese veq e ke dijt te verteten ?!!!
Une: Nuk kam hesht, por jam angazhua gjate gjithe kohes, me gjithe energjine e diturine, qe te hakmerrem per atentatet makaber ndaj ketyre personaliteteve historike. Edhe romani eshte pjese e kontrubutit tim per hakmarrje konstruktive.

JU: Pyetje: Si mund te rrish per 25-vite indiferent ndaj familjes Gervalla-Zeka,dhe femijve te Jusufit ?!!!
Une: Nuk kam ndejuar indiferent, por jam angazhuar t'ua beje respektin ne menyren me te mire, duke vazhduar rrugen e tyre; ka disa qe ju lariten familjeve te personaliteteve, sa per te afirmuar pameritueshem veten e tyre...

JU: Pyetje:Si mund ti akuzosh dhe perbuzish deshmoret ne Belgjik ?!!
Une: Nuk akuzoj dhe perbuz asnje deshmor, ndersa kam pershkruar mendimet e kohes per personazhe te romanit. Edhe une, mendoj, te mos jem puthador i askujt dhe te mos beje lajka.
JU: Pyetje:sikur te ishe ti rezili (dorasi)si do te veproje ne kete rast me I.Kelmendin dhe me akuzen ?
Une: Nuk deshiroj te ve veten ne pozite te Rezilit as ne menyre hipotetike.
JU: Kam edhe disa pyetje por kesaj po te kursej per me vone.
Une: Vetem urdheroni.
JU: Edhe per nje ju lutem forumisteve qe mos ta marrin rolin e avokatit apo te mbrojtesit te I.Kelmendit,sepse ky me vetdeshir ka pranu dialog !
Andaj nuk kam nevoj per komentimet e askujt perveq Z.Kelmendit.
Une: Them qe nuk te shkon percaktimi, se si duhet te bashkebisedojne "forumistet"; Eshte kulture qytetare qe te mbrohet drejtesia...
Shendet dhe suksese!
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

---

I/E nderuari Z.Kelmendi,
Te falenderoj per "pergjegjen" dhe mundimin qe ke bere por thene te drejten nese te tjeret te ngrisin deri ne qiell me levdata,une veq mund te them se nuk jam i knaqur me arsyetimin tend,edhe pse qe ne fillim e kam dijt perafersisht se do ti ikesh pergjegjjes se drejtperdrejt ashtu siq i ke ik
realitetit per me se 25-vjet !!
Te le ne shoqeri me keta "patriotat" e forumit dhe te fjalemdhejve,ndersa mua me mbetet prap ajo bindja ime e pare,gjate ketyre 25 viteve .....
fatkeqsisht .
Une nuk shkruaj veq sa per te shkruar,
une te njoh mire Ty,Muhamet Kelmendin.....por edhe Familjen Gervalla,gjithashtu,andaj gjerat nuk mund ti mbulosh me "pergjegjje"veq sa per te shkruar diqka !Lexoje edhe njehere se si me ke shkruar...?!!!

Tung edhe nje here Trixi
ps.edhe nese nuk merr mundimin te me kthesh pergjegjje nuk ka dert,pres une edhe 25-vjet te tjera per vazhdimin e romanit tjeter....!!!

---

profile | edit quote

**Qosi**

**Anëtar që nga:** 22.02.2007
**Afishime:** 29

**Afishuar me:** 25.03.2007 13:02

Z.Kelmendi pershendetje per ju dhe per te tjeret ne kete forum.
Ju e keni marre nji barre te rende mbi supet tuaja dhe nese keshtu vazhdoni sdo te ia dilni ne kry.
Fjalen e kame se kure po shof se qfare pytje jane duke jau ber disa forumist eshte per tu qudit-pytje pa vend dhe shum pa krip,pytje te cilat fare ste takojne te pergjigjesh.
Disa forumist po ma qojne mallin si me qene prokuror apo fare organi hetus..Me vjene keq nese e lodh trurin dhe pergjigjesh ne ato pytje te cilat fare skane te bejne me ju.
Ne funde i nderuari z.Kelmendi ekame nji pytje nese sme pegjigjesh prap flm.
Fjalen e kame per prof.Muje Rugoven sa ka kontribu ky persone per qeshtjen e Kosoves dhe pse u prishen me Bukoshin?? pa marre parasysh nga pergjigja juaj une prap e kame mendimin tim per prof.M.Rugoven.
Qosi ju deshiron pushim te rehatshem dhe te mire atje ku jeni.

profile | edit quote

**qeku11**

**Anëtar që nga:** 05.03.2006
**Afishime:** 40

**Afishuar me:** 25.03.2007 13:41

Perseri me z.Kelmendi vazdim i pyetjes , sepse nuk thate pergjigjeje te mirfillt me rastin e atentatit te lavdishmit Ilir Konushevci.
po perseris:
-a munt te jete vrasje (atentat) per shkak te bindjeve politike dhe qe nuk ishte vegel e LPK-se e sidomos e rrjetit te Gjavitit, por njikosisht (ju personalisht ishit ne konflikt te hapur me Gjavitin (per interesa qe ju i dini ).
Kurse Iliri kishte nje bashkpunim me te mire me ju(dhe shum flitet dhe dyshohet ) se ka te ngjare qe vrasja eshte per qellime perfitimi politik dhe avansim per te mbizotruar ne UÇK-se.
Kjo ishte pyetja si esence.
Edhe nje pyetje thate se ne muajn mars-prill keni bashkpunue ngusht, po pse jo edhe ne muajn Maje 98(nese nuk jam keq informuar ju nuk keni marr pjes fare ne varimin e tij ne Tirane).
Shpresoj ne mirkuptim dhe se tani do te pergjigjeni me sakte (pa bere intriga ).
pershendetje te perzemerta

profile | edit quote

**hotiani**

**Anëtar që nga:** 06.06.2006
**Afishime:** 229

**Afishuar me:** 25.03.2007 14:30

> Quote:
>
> Shqipëruesi afishoj me 2007-03-25 12:35 :
> I nderuar Gjarpëri,
>
> - Nuk dua të merrem me Delegatin dhe Hotianin .
> Aty ku ti thua, "duhet të jeni real që të dy",
> krejt cfarë dua unë është të dalë sheshazi ,se jo të gjithë kanë qenë pa hile,
> jo të gjithë kanë luftuar për Kosovën dhe lirinë e saj pa menduar në përvetësime dhe kariera personale.
> Por,e them prapë,nuk kërkova përgjegje nga z.Kelmendi për Fondin e Qeverisë sepse ai s'ka të bëjë me te.Për këtë,një ditë do ia bëjmë pyetjen z. Bukoshi.
> Për Vilën Presidenciale,do ia shtrojmë pyetjen atij që ka qenë

më së shumti përgjegjës ndër të gjallët meqë Presidenti Rugova tashmë është i ndjerë.
Keqpërdorimet janë e njeta gjë. Si Qeveria, si Presidenca ashtu edhe UCK-ja duhet dhënë përgjegjësi. Asnjërën nuk e shfajësova. Por,në rastin konkret kemi të bëjmë me z.Ibrahim Kelmendi dhe ai ka qenë drejtëpërsëdrejti i kycur në "Fondin Vendlindja Thërret".
Pasurimi i përnjëhershëm i disa ish-liderëve të UCK-së con drejt dyshimit,jo vec pse e tha z.Selimi. Për mua,janë këta që kanë shkelur mbi gjakun e dëshmorëve,sepse paratë që janë dhënë për të luftuar serbin mund të kenë qenë të përdorur nga ish-komandantë për tu pasuruar. Dhe ky për mua është KRIM...

---

As une nuk pata qellim te merresha me ju,por u nisa nga mundesia qe Ibrahim Kelmendi nuk ka njohuri per rrjedhat e debatit ne kete forum ne tema te ngjajshme madje edhe lidhje me vrasjen e vllezerve Gervalla dhe Kadri Zekes,dhe per vete rolin e Kelmendit.Me vjen mire qe ne kete debat ti dhe bashkemendimtaret tuaj po tregohi shume me te arsyeshem ,sofistikuar desha te them. Por prapse prap nuk po arrini te kamufloni qellimin . Une vetem desha te perkujtoj se ketu ne forum edhe vete dreqi mund te paraqitet me nofken e engjullit per te provokuar.
Mos harroni akuzat dhe shkrimet tuaja lidhur me vrasjen e ketyre heronjeve dhe veprimtarine e Levizjes . Ju disa me teper keni vjellur vrere kunder krahut te luftes se sa kunder krimeve dhe masakrave te Serbise.
Keshtu sa per dijeni. Nuk do vahdoj me per kete per hire te Ibrahim Kelmendit dhe menyres korrekte dhe civilizuese me te cilen ai po i pergjigjet secilit .
Ky njeri po tregon madhesine e prijseve te Levizjes ,per te cilen gje jam krenar.

[ Ky afishim u ndryshua nga: hotiani më 2007-03-25 14:31 ]

---

profile | edit quote

**Delegati**

**Afishuar me:** 25.03.2007 15:08

**Anëtar që nga:** 12.05.2006
**Afishime:** 548

---

Quote:

---

Shqipëruesi afishoj me 2007-03-25 12:35 :
I nderuar Gjarpëri,
- Nuk dua të merrem me Delegatin dhe Hotianin .
Aty ku ti thua, "duhet të jeni real që të dy",
krejt cfarë dua unë është të dalë sheshazi ,se jo të gjithë kanë qenë pa hile,
jo të gjithë kanë luftuar për Kosovën dhe lirinë e saj pa menduar në përvetësime dhe kariera personale.
Por,e them prapë,nuk kërkova përgjegje nga z.Kelmendi për Fondin e Qeverisë sepse ai s'ka të bëjë me te.Për këtë,një ditë do ia bëjmë pyetjen z. Bukoshi.
Për Vilën Presidenciale,do ia shtrojmë pyetjen atij që ka qenë më së shumti përgjegjës ndër të gjallët meqë Presidenti Rugova tashmë është i ndjerë.
Keqpërdorimet janë e njeta gjë. Si Qeveria, si Presidenca ashtu edhe UCK-ja duhet dhënë përgjegjësi. Asnjërën nuk e shfajësova. Por,në rastin konkret kemi të bëjmë me z.Ibrahim Kelmendi dhe ai ka qenë drejtëpërsëdrejti i kycur në "Fondin Vendlindja Thërret".

Pasurimi i përnjëhershëm i disa ish-liderëve të UCK-së con drejt dyshimit,jo vec pse e tha z.Selimi. Për mua,janë këta që kanë shkelur mbi gjakun e dëshmorëve,sepse paratë që janë dhënë për të luftuar serbin mund të kenë qenë të përdorur nga ish-komandantë për tu pasuruar. Dhe ky për mua është KRIM...

---

Shqipëruesi,
Ti me mua nuk mund të merresh sepse nuk ke dorëza. Nuk po e ngir veten, por po e tregoj poziten tënde.
Unë të kam thënë edhe më herët se ti vetëm shkruan rrjedhshëm. Brëndia e afishimeve tua është shumë destruktive.
Kërkon nga Ibrahimi që të thotë atë që të konvenon ty dhe pastaj të "rritesh" duke e quajtur sukses tëndin modestinë e I. Kelmendit.
Bëhu, vetëm një herë në jetën tënde, i sinqert dhe trego se sa para i ke dhënë në Fondin "Vendlindja Thërret" që po interesohesh aq shumë për rrjedhat e atij Fondi?
Kur t'i dëshmosh kontributet tua atëherë mund të flasim për të gjitha të bëmat dhe të pabëmat që të interesojnë për të gjithë ata që kanë pasur vende delikate dhe me përgjegjësi.
Në të kundërten, nuk ka nevojë as forumi e as bartësit e Fondit "Vendlindja Thërret" për kujdestarë, të cilët marrin në thumb të tjerët për t'i mshehur mosangazhimet, për të mos thënë angazhimet e tija kundër luftës çlirimtare.

---

profile | edit quote

**Delegati**

**Anëtar që nga:** 12.05.2006
**Afishime:** 548

**Afishuar me:** 25.03.2007 15:10

---

Quote:

---

Delegati afishoj me 2007-03-25 15:08 :
Quote:

---

Shqipërouesi afishoj me 2007-03-25 12:35 :
I nderuar Gjarpëri,
- Nuk dua të merrem me Delegatin dhe Hotianin .
Aty ku ti thua, "duhet të jeni real që të dy",
krejt cfarë dua unë është të dalë sheshazi ,se jo të gjithë kanë qenë pa hile,
jo të gjithë kanë luftuar për Kosovën dhe lirinë e saj pa menduar në përvetësime dhe kariera personale.
Por,e them prapë,nuk kërkova përgjegje nga z.Kelmendi për Fondin e Qeverisë sepse ai s'ka të bëjë me te.Për këtë,një ditë do ia bëjmë pyetjen z. Bukoshi.
Për Vilën Presidenciale,do ia shtrojmë pyetjen atij që ka qenë më së shumti përgjegjës ndër të gjallët meqë Presidenti Rugova tashmë është i ndjerë.
Keqpërdorimet janë e njeta gjë. Si Qeveria, si Presidenca ashtu edhe UCK-ja duhet dhënë përgjegjësi. Asnjërën nuk e shfajësova. Por,në rastin konkret kemi të bëjmë me z.Ibrahim Kelmendi dhe ai ka qenë drejtëpërsëdrejti i kycur në "Fondin Vendlindja Thërret".
Pasurimi i përnjëhershëm i disa ish-liderëve të UCK-së con drejt dyshimit,jo vec pse e tha z.Selimi. Për mua,janë këta që kanë shkelur mbi gjakun e dëshmorëve,sepse paratë që janë dhënë për të luftuar serbin mund të kenë qenë të përdorur nga

ish-komandantë për tu pasuruar. Dhe ky për mua është KRIM...

---

Shqipëruesi,
Ti me mua nuk mund të merresh sepse nuk ke dorëza. Nuk po e ngris veten, por po e tregoj poziten tënde.
Unë të kam thënë edhe më herët se ti vetëm shkruan rrjedhshëm.
Brëndia e afishimeve tua është shumë destruktive.
Kërkon nga Ibrahimi që të thotë atë që të konvenon ty dhe pastaj të "rritesh" duke e quajtur sukses tëndin modestinë e I. Kelmendit.
Bëhu, vetëm një herë në jetën tënde, i sinqert dhe trego se sa para i ke dhënë në Fondin "Vendlindja Thërret" që po interesohesh aq shumë për rrjedhat e atij Fondi?
Kur t'i dëshmosh kontributet tua atëherë mund të flasim për të gjitha të bëmat dhe të pabëmat që të interesojnë për të gjithë ata që kanë pasur vende delikate dhe me përgjegjësi.
Në të kundërten, nuk ka nevojë as forumi e as bartësit e Fondit "Vendlindja Thërret" për kujdestarë, të cilët marrin në thumb të tjerët për t'i mshehur mosangazhimet, për të mos thënë angazhimet e tija kundër luftës çlirimtare.

---

profile | edit quote

**D**

**Anëtar që nga:** 27.04.2002
**Afishime:** 1253

**Afishuar me:** 25.03.2007 16:08

---

Edhe diçka Z. Ibrahim Kelmendi
Gjatë leximit të librit pash se edhe atje e ke shkrua shumë gjëra „Halabakçe" !
Unë do të potencoj dy-tre raste për të cilat më duket se janë bash krejt halabakçe !!
1.
Ajo çka shkruan për dëshmorin e UÇK-së Avdullah Tahiri nga Malisheva e Gjilanit nuk qëndron !!
Ti në libër thua se i ke thënë Avdullahut se i ke "tradhtuar shokët" !! pas burgosjes së tij për ngjarjet e 11. marsit dhe 26. marsit ( ti në shumë vende e habit këtë date duke e potencuar 25. marsi 1981) !!
Ky konstatim dhe kjo përmendje në këtë mënyrë e dëshmorit të UÇK-së dhe veprimtarit të ilegales edhe para 1981-tës nuk qëndron !!
Avdullah Tahiri nuk ka qenë dëshmitar në asnjë proces Gjyqësor në vitet 1981 e më vonë.

2.
Ajo çka shkruan për Hysen Tërpezën dhe e cilëson kriminel si djalin e agjës së tij – nuk qëndron !!

3.
Ajo çka shkruan për dëshmorin Enver Hadri duke aluduar dhe dyshuar se ishte provokator i UDB-së nuk qëndron – ai u vra nga UDB-ja dhe vitin e kaluar është burgos vrasësi i tij i cili dyshohet se është nga e njëjta grup që ka bërë atentatin edhe në Untergrupenbach – do të shohim - filli i zbulimit të krimeve të UDB-së në Gjermani dhe Evropë ka filluat të sqarohet.

4.
Edhe pohimet tuaja për Musa Hotin që vret një punëtor të Konsullatës Jugosllave, se ishte provokator dhe bashkëpunëtor i UDB-së nuk

qëndron !! Musa Hoti u vra nga UDB-ja …
Etj etj…. Ka edhe shum Halabakllëçe në librin tuaj, por ata që janë të gjallë e kanë gojën dhe duart dhe munden vet të shkruajnë e pohojnë ose mohojnë cilësimet që ua bënë .
Unë potencova personat që Kosova i dinë si dëshmor dhe i nderon dhe respekton, nuk besoj se ti me dyshimet mbi ta mundesh ta zbehësh personalitetin e tyre.

Z. Ibrahim Kelmendi
A të ka shkua mendja se edhe dikush mundet me të paragjykue ty !!
Ti ishe në Gjermani me pasaportë Jugosllave dhe krejt aktivitetin dhe udhëtimet deri në Amerikë i bëje me pasaportë Jugosllave !!
Deri në muajin dhjetor 1982 -janar 1983!!
Ti gjithë kohën, pra deri me 1983, kishe dokument valid të Jugosllavisë të cilin validitet kanë mundur ta anulojnë organet Jugosllave !!
E po të mendohet Halabakqe, si i gjykon ti të tjerët … edhe ty të do të kishin mundur të paragjykonin dhe dyshonin për UDB-ash…. Madje edhe me dëshmi konkrete të pasaportës tënde dhe udhëtimeve tuaj edhe në Kosovë!!
Unë po të them se kam veprimtari nga viti 1980 deri me 1991 në Kosovë dhe nga 1991 deri 2007 në mërgim.
Po këto 16 vite jete dhe veprimtarie në mërgim nuk bartin as 16. ditëshin e rrezikshmërisë të veprimtarisë në Kosovë.
Po ashtu dua të përkujtoj se edhe 25. vitet tua në mërgim nuk e kanë peshën 25. ditëve të sakrificës dhe aktivitetit çlirimtar të Dëshmorit Avdullah Tahirit dhe veprimtarit Hysen Tërpezës në Kosovë.

---

profile aim | edit quote

**Nositi**
**Administrator**




**Anëtar që nga:** 14.01.2004
**Afishime:** 1683
**Vendbanimi:** Anës liqenit

**Afishuar me:** 25.03.2007 17:35

---

[quote]

Nositi afishoj me 2007-03-25 17:30 :

Quote:

---

trixi afishoj me 2007-03-25 12:48 :

Quote:

---

I_Kelmendi afishoj me 2007-03-25 00:59 :
I / E nderuar "trixi" !
JU: Ne bindjen e njeriut nuk mund te ndikon kurrfar romani,kur eshte fjala per te verteta,andaj keto "arsyetimet"dhe berja me gisht tash pas 25-vitesh sikur tingllon shfajsim, larje e ndergjegjjes se papaster apo edhe ri-atentat !!
Une: Sa per informim, qysh nga momenti i atentateve jam angazhuar per te zbulluar dhe denuar doraset, kurse urdheruesve te tyre (UDB-se) i eshte dhene pergjigja - ka ndodhur ülirimi i Kosovases nga pasuesit e rruges qe pergatiten Jusufi e Bardhi.
Meqe organet gjermane nuk kane mundur ta denojne vrasesin e dyshuar (Rezilin), une jam

angazhuar qe te beje presion mbi strukturat perkatese ne Kosove qe te merren me zbulimin e denimin e vrasesve dhe te mos behen sikur nuk ka ndodhur gje para 25 viteve.

JU: Une nuk i perkas kesaj kategoris se puthadoreve te cilet shkelin mbi gjakun e deshmoreve dhe me nje HOP(roman)harrohen 25-vitet e ketij misteri te cilen tash po na e zbulon shoku i ngusht i Jusufit,Bardhit dhe Kadriut !!!!!

Une: Lum si ju qe nuk jeni puthador...

JU: Pyetje: Si mund ta arsyetosh heshtjen dhe mos ndermarrjen e asgjeje per 25-vite per keta "shoket" me te ngusht nese veq e ke dijt te verteten ?!!!

Une: Nuk kam hesht, por jam angazhua gjate gjithe kohes, me gjithe energjine e diturine, qe te hakmerrem per atentatet makaber ndaj ketyre personaliteteve historike. Edhe romani eshte pjese e kontrubutit tim per hakmarrje konstruktive.

JU: Pyetje: Si mund te rrish per 25-vite indiferent ndaj familjes Gervalla-Zeka,dhe femijve te Jusufit ?!!!

Une: Nuk kam ndejuar indiferent, por jam angazhuar t'ua beje respektin ne menyren me te mire, duke vazhduar rrugen e tyre; ka disa qe ju lariten familjeve te personaliteteve, sa per te afirmuar pameritueshem veten e tyre...

JU: Pyetje:Si mund ti akuzosh dhe perbuzish deshmoret ne Belgjik ?!!

Une: Nuk akuzoj dhe perbuz asnje deshmor, ndersa kam pershkruar mendimet e kohes per personazhe te romanit. Edhe une, mendoj, te mos jem puthador i askujt dhe te mos beje lajka.

JU: Pyetje:sikur te ishe ti rezili (dorasi)si do te veproje ne kete rast me I.Kelmendin dhe me akuzen ?

Une: Nuk deshiroj te ve veten ne pozite te Rezilit as ne menyre hipotetike.

JU: Kam edhe disa pyetje por kesaj po te kursej per me vone.

Une: Vetem urdheroni.

JU: Edhe per nje ju lutem forumisteve qe mos ta marrin rolin e avokatit apo te mbrojtesit te I.Kelmendit,sepse ky me vetdeshir ka pranu dialog !
Andaj nuk kam nevoj per komentimet e askujt perveq Z.Kelmendit.

Une: Them qe nuk te shkon percaktimi, se si duhet te bashkebisedojne "forumistet"; Eshte kulture qytetare qe te mbrohet drejtesia...

Shendet dhe suksese!

ibrahim_kelmendi@yahoo.de

---

I/E nderuari Z.Kelmendi,
Te falenderoj per "pergjegjen" dhe mundimin qe ke bere por thene te drejten nese te tjeret te ngrisin deri ne qiell me levdata,une veq mund te them se nuk jam i knaqur me arsyetimin tend,edhe pse qe ne fillim e kam dijt perafersisht se do ti ikesh pergjegjjes se drejtperdrejt ashtu siq i ke ik
realitetit per me se 25-vjet !!
Te le ne shoqeri me keta "patriotat" e forumit dhe te fjalemdhejve,ndersa mua me mbetet prap ajo bindja ime e pare,gjate ketyre 25 viteve .....
fatkeqsisht .
Une nuk shkruaj veq sa per te shkruar,
une te njoh mire Ty,Muhamet Kelmendin.....por edhe Familjen Gervalla,gjithashtu,andaj gjerat nuk mund ti mbulosh me "pergjegjje"veq sa per te shkruar diqka !Lexoje edhe njehere se si me ke shkruar...?!!!

Tung edhe nje here Trixi
ps.edhe nese nuk merr mundimin te me kthesh pergjegjje nuk ka dert,pres une edhe 25-vjet te tjera per vazhdimin e romanit tjeter....!!!

---

*Trixi,*

*Nese nuk je i kenaqur me pergjigjen, kjo nuk do te thote qe z.Ibrahim Kelmendit t`i drejtohesh me me nyjet dydjinore* **I/E** !

*Akoma ti nuk beson se bashkebiseduesi juaj eshte* **I nderuari z.Ibrahim Kelmendi** , *apo keshtu deshiron qe qellimshem dhe ne menyren me cinike te vesh ne tallje sinqeritetin e bshkebiseduesit ?!*
*E ke marre pergjigjen dhe e mira e se mires do te ishte qe fare te mos dukesh kendejpari, sepse ti nuk ke kapacitet per nenforumin e Politikes. Ike atje ne nenforumet ku e gjen veten me nivelin tend, perndryshe nuk toleroj ta perbaltesh mbarevajtjen e temes dhe sinqeritetin e bashkebiseduesit !!!*

*I kerkoj falje z.Kelmendi dhe te gjithe bashkebiseduesve per kete nderhyrje, ndersa nga ti Trixi nuk dua asnje koment !*
*Nositi*

---

profile mail | edit quote

**trixi**

**Anëtar që nga:** 18.08.2006
**Afishime:** 1935
**Vendbanimi:** Gjermani-Dardani

**Afishuar me:** 25.03.2007 18:01

---

Nositi,
Nuk ka nevoj per sqarime,sepse secili e din se Trix-I,eshte i gjinis mashkullore ,andaj qellimisht kam dashur te sqaroj se nuk ka nevoj per I/E,
te falenderoj per rolin e tuteles,edhe pse I.Kelmendi nuk ka nevoj per nderhyrje te askujt,sepse me vetdeshir ka pranuar dialog !!!!
Trixiiiiiii

ps.ndoshta nuk po ju shkoj per qejfi sikur doni Nosit,por besoj se ka ik koha e diferencimeve dhe bajraktarve,nuk ta bej amin edhe nese me perjashton,
ti nuk ke kapacitet me me vlersu.....
<font class=editedby>[ Ky afishim u ndryshua nga: trixi më 2007-03-25 18:13 ]</font>

*Ok. Trixi,*
*Shpresoj te jemi mirekuptuar tani. Le ta shuajme kurreshtjen duke lexuar te tjeret ne kete teme me shume interes !*
*te pershendes,*
*Nositi*

[ Ky afishim u ndryshua nga: Nositi më 2007-03-25 18:33 ]

---

profile | edit quote

**hotiani**

**Afishuar me:** 25.03.2007 19:27

**Anëtar që nga:** 06.06.2006
**Afishime:** 229

---

Quote:

---

Shqipëruesi afishoj me 2007-03-25 12:35 :
I nderuar Gjarpëri,
- Nuk dua të merrem me Delegatin dhe Hotianin .
Aty ku ti thua, "duhet të jeni real që të dy",
krejt cfarë dua unë është të dalë sheshazi ,se jo të gjithë kanë qenë pa hile,
jo të gjithë kanë luftuar për Kosovën dhe lirinë e saj pa menduar në përvetësime dhe kariera personale.
Por,e them prapë,nuk kërkova përgjegje nga z.Kelmendi për Fondin e Qeverisë sepse ai s'ka të bëjë me te.Për këtë,një ditë do ia bëjmë pyetjen z. Bukoshi.
Për Vilën Presidenciale,do ia shtrojmë pyetjen atij që ka qenë më së shumti përgjegjës ndër të gjallët meqë Presidenti Rugova tashmë është i ndjerë.
Keqpërdorimet janë e njeta gjë. Si Qeveria, si Presidenca ashtu edhe UCK-ja duhet dhënë përgjegjësi. Asnjërën nuk e shfajësova. Por,në rastin konkret kemi të bëjmë me z.Ibrahim Kelmendi dhe ai ka qenë drejtëpërsëdrejti i kycur në "Fondin Vendlindja Thërret".
Pasurimi i përnjëhershëm i disa ish-liderëve të UCK-së con drejt dyshimit,jo vec pse e tha z.Selimi. Për mua,janë këta që kanë shkelur mbi gjakun e dëshmorëve,sepse paratë që janë dhënë për të luftuar serbin mund të kenë qenë të përdorur nga ish-komandantë për tu pasuruar. Dhe ky për mua është KRIM...

---

Pasi zoti I. Kelmendi me siguri eshte i zenun i drejtohem Shqiperuesit por edhe Trixit me dy tri pyetje:
Sa shkrime dhe kerkesa keni bere per te zbardhe keqperdorimet e fondit te qeverise Bukoshi ,presidences se Kosoves dhe kryeparlamentarit Daci '?
A nuk jeni ju ata qe sa here jane parashtrua tema dhe kerkesa te tilla keni mbrojtur individet dhe institucionet qe veheshin ne dyshim duke i ngritur edhe ne pegajmer?Kete e keni bere edhe kur keqperdorimet dhe hajnit jane vertetuar nga komisioni neutral i auditimit,madje edhe kur jane ngrite aktpadi penale nga nderkombetret?
Perse aq teper insistoni per fondin "Vendlindja thrret" kur me siguri te plote ju dhe bashkemendimtaret tuaj nuk e keni dhene ne kete fond asnje metelik.

Une as kerkush nuk eshte kunder transparences dhe pergjegjesise ,por jam kunder qellimeve tendencioze dhe te njeaneshme .
Na sjellni ketu ne forum Isa Mustafen dhe te ballafaqohet per shpenzimet e afer 1 miliard markash te popullit.

[ Ky afishim u ndryshua nga: hotiani më 2007-03-25 19:31 ]

profile | edit quote

**trixi**

**Anëtar që nga:** 18.08.2006
**Afishime:** 1935
**Vendbanimi:** Gjermani-Dardani

**Afishuar me:** 25.03.2007 20:26

Hotjanit,
I nderuar askush nuk po te pengon qe ta hapesh nje teme per fondin e Bukoshit, besoj se ketu eshte teme krejt tjeter andaj edhe nuk kam arsye te polemizoj ne kete teme,sepse po e humbim seriozitetin e dialogut.
Trixi

**"panta_rhei"**

**Anëtar që nga:** 11.02.2006
**Afishime:** 194

**Afishuar me:** 25.03.2007 21:11

Pershendetje,
Romani juaj "Atentatet" mendoj se "eshte shkruar ne vitin 2007", po e potencoj "ne vitin 2007"!
Personazhi "krysor" Mirani (dmth I. Kelmendi) gjate viteve 1979-1982, gjate gjithe asaj kohe i njeh saktesisht te gjitha ngjarjet e se ardhmes deri ne vitin 2007, bile gjate gjithe romanit, mendon ne ate menyre dhe ndjehet ne ate menyre, pra si zot i gjithedijshem (pra qe i din saktesisht te gjitha ngjarjet qe do te pasojne deri ne vitin 2007). (kjo me se paku eshte njerezore)
Si pasoje e kesaj mendoj se romani permban vetem gjerat "qe i han pazari".
Krejt kjo si qellim ka ngritjen sa me larte te autorit ne saje te nje tragjedie kombtare.
Kryesisht romani "Atentatet" mund te pershkruhet me shprehjen e popullit "me la m... me sh.rr."
Te jeni i sigurte z. Kelmendi se ju falenderoj nga zemra qe keni shkruar nje roman te tille pikerisht ju. Absolutisht e keni vertetuar se te gjitha dyshimet kane qene shume te bazuara. Poashtu e keni vertetuar permes ketij romani se ju jeni me te vertete Ibrahim Kelmendi, tamam ashtu siq kemi degjuar dhe siq ju njohim.
Besoj se po kaq i "mireseardhur" do te jete edhe "romani" i Rezilit.

Personalisht per te gjitha keto kam lexuar dhe vazhdimisht kam lexuar, dhe impresionet e mia vijne nga nje permbledhje e krejt asaj qe kam arritur si konkludim permes fakteve nga te gjitha anet.
Edhepse jam i lindur pas kohes kur kane ndodhur "atentatet", keto dhe mosmarreveshjet tjera me qellime karrieriste me kane preokupuar vazhdimisht si prapambeturia dhe plaga me e rende e kombit.
Une gjithsesi ju pershendes per ndermarrjen dhe si pyetje konkrete meqe romani titullohet "Atentatet", a e konsideroni romanin "kriminalistik", dhe a e konsideroni veten te pergatitur ne kete fushe?
tung

profile | edit quote

**Çakalli**

**Anëtar që nga:** 20.02.2007

**Afishuar me:** 25.03.2007 21:24

*Ndryshuar...*
*z.Çakalli permbajuni temes !*
*Nositi*

**Afishime:** 128
**Vendbanimi:** Ne strofull te dreqit

[ Ky afishim u ndryshua nga: Nositi më 2007-03-25 22:53 ]

profile | edit | quote

---

**Feni-X**

**Anëtar që nga:** 10.05.2002
**Afishime:** 2626
**Vendbanimi:** Në mesin e askundit

**Afishuar me:** 25.03.2007 22:31

Nderimet e mia, z.Ibrahim Kelmendi
Ju pergezoj per vepren tuaj, dhe njekohsisht gjith angazhimin tuaj per ceshtjen dhe kauzen tone kombetare, per te cilen mendoi se sot e kesaj dite mundoheni qe t\i jepni nje kohezion dhe nje te ardhme me te ndritur (me ato mundesi qe keni) duke hedhur drite mbi fakte, e duke i drejtuar gishtin kolaboracionisteve dhe jashqtitjes sone kombetare qe sa me shpejt te dalin para drejtesis dhe te japin llogari.
Edhe pse nje pjese e madhe, me sa kam degjuar dhe lexuar ju llogarisin si nje personalitet i dyshuar i ilegales, megjithate koha do t'i tregoj te ghitha te bemat tuaja , te cilet une personalisht nuk i kontestoj ne asnje menyr.
Siq shihet edhe ketu mund te theksohet nje pezem dhe vrer kunder jush nga nje pjese e antareve te mbeshtjellur nen vellon e intimitetit, edhe pse me fjale disi te ;'buta, si kadife'.
Megjithate ju po i qendroni stoik , sikur qe i keni qendruar stiok gjith asaj periudhe kur fryenin 'stuhit e uliksit' gjithandej mbernda dhe jasht viseve tona shqiptare.
Ne fakt, une shkruaj nga Maqedonia dhe pyetja ime ka te bej rreth angazhimit tuaj ne kete haspire..
Para disa muajsh patet realizuar nje vizit ne Maqedoni, ku edhe pas largimit tuaj nga atje, botuat nje opinion ne gazeten fakti ne lidhje me disa takime qe keni realizuar me lidershipin shqiptar ketu.
Fillimisht kishit takuar z.Arben Xhaferin, siq keni shkruar dhe detajizuar ne gazet, ne zyren e tij ne Tetove dhe me pastaj edhe kryetarin e BDI-se z.Ali Ahmeti, tashme si parti opozitare ne MAqedoni.
Konkretisht:
Cili ishte motivi i vizites suaj, dhe influenca juaj qe ndikuat ne lidershipin e partive shqiptare ketu,.?
Dhe kur ve nje paralele ne mes Juve dhe Ali AHmetit, mund te gjykoj lirshem se qe te dyni keni qen promotor te ilegales dhe ndoshta sa do pak keni disa segmente me te perbashketa, se te tjeret.
Theksi im mbi kurreshtjen time : pse pikerisht takuat Arber Xhaferin dhe s'di pse me thot mendja se jeni me te afert me te dhe jo me shoket tuaj te ilegales te cilet keni 'notuar' ne te njejtat vale, ne kete rast me z.Ahmetin (?).
Pershendetje ..

profile | www | aim | Y! | edit | quote

---

**Livadhi**

**Anëtar që nga:** 19.06.2005
**Afishime:** 221

**Afishuar me:** 25.03.2007 22:46

> Quote:
>
> D afishoj me 2007-03-25 16:08 :
> Edhe diçka Z. Ibrahim Kelmendi
>
> Gjatë leximit të librit pash se edhe atje e ke shkrua shumë gjëra „Halabakçe" !
>
> Unë do të potencoj dy-tre raste për të cilat më duket se janë bash krejt halabakçe !!
>
> 1.
> Ajo çka shkruan për dëshmorin e UÇK-së Avdullah Tahiri nga

Malisheva e Gjilanit nuk qëndron !!

Ti në libër thua se i ke thënë Avdullahut se i ke "tradhtuar shokët" !! pas burgosjes së tij për ngjarjet e 11. marsit dhe 26. marsit ( ti në shumë vende e habit këtë date duke e potencuar 25. marsi 1981) !! Ky konstatim dhe kjo përmendje në këtë mënyrë e dëshmorit të UÇK-së dhe veprimtarit të ilegales edhe para 1981-tës nuk qëndron !! Avdullah Tahiri nuk ka qenë dëshmitar në asnjë proces Gjyqësor në vitet 1981 e më vonë.

2.
Ajo çka shkruan për Hysen Tërpezën dhe e cilëson kriminel si djalin e agjës së tij – nuk qëndron !!

3.
Ajo çka shkruan për dëshmorin Enver Hadri duke aluduar dhe dyshuar se ishte provokator i UDB-së nuk qëndron – ai u vra nga UDB-ja dhe vitin e kaluar është burgos vrasësi i tij i cili dyshohet se është nga e njëjta grup që ka bërë atentatin edhe në Untergrupenbach – do të shohim - filli i zbulimit të krimeve të UDB-së në Gjermani dhe Evropë ka filluat të sqarohet.

4.
Edhe pohimet tuaja për Musa Hotin që vret një punëtor të Konsullatës Jugosllave, se ishte provokator dhe bashkëpunëtor i UDB-së nuk qëndron !! Musa Hoti u vra nga UDB-ja …

Etj etj…. Ka edhe shum Halabakllëçe në librin tuaj, por ata që janë të gjallë e kanë gojën dhe duart dhe munden vet të shkruajnë e pohojnë ose mohojnë cilësimet që ua bënë .

Unë potencova personat që Kosova i dinë si dëshmor dhe i nderon dhe respekton, nuk besoj se ti me dyshimet mbi ta mundesh ta zbehësh personalitetin e tyre.

Z. Ibrahim Kelmendi

A të ka shkua mendja se edhe dikush mundet me të paragjykue ty !!

Ti ishe në Gjermani me pasaportë Jugosllave dhe krejt aktivitetin dhe udhëtimet deri në Amerikë i bëje me pasaportë Jugosllave !!

Deri në muajin dhjetor 1982 -janar 1983!!

Ti gjithë kohën, pra deri me 1983, kishe dokument valid të Jugosllavisë të cilin validitet kanë mundur ta anulojnë organet Jugosllave !!

E po të mendohet Halabakqe, si i gjykon ti të tjerët … edhe ty të do të kishin mundur të paragjykonin dhe dyshonin për UDB-ash…. Madje edhe me dëshmi konkrete të pasaportës tënde dhe udhëtimeve tuaj edhe në Kosovë!!

Unë po të them se kam veprimtari nga viti 1980 deri me 1991 në Kosovë dhe nga 1991 deri 2007 në mërgim.
Po këto 16 vite jete dhe veprimtarie në mërgim nuk bartin as 16. ditëshin e rrezikshmërisë të veprimtarisë në Kosovë.

Po ashtu dua të përkujtoj se edhe 25. vitet tua në mërgim nuk e kanë peshën 25. ditëve të sakrificës dhe aktivitetit çlirimtar

të Dëshmorit Avdullah Tahirit dhe veprimtarit Hysen Tërpezës në Kosovë.

---

I nderuari D
Personalishte ne mungese te Kohese nuk kam lexuare end Romanin e I Kelemendit .Por ate qe mesoji nga Forumi me jep te kuptoji se ketu fshihet diqka tjeter. personalishte jam shume i kenaqur me LPK dhe ndihmen qe gjate dekadave ja ofroji atdheut.Kuptoi edhe presijonin qe z Kelemendi kishte rrethe vrasjeve te vllezerve Gervalla.Por duke pasure parasushe se LPK veprimtarin e Vete ne 80% e kryente ne menyre ilegale besoji qe eshte jo ne rregulle qe z Kelemendi del me nje libere Romane dhe provon te sjell fakte rrethe ngjarjese dhe personaliteteve qe me vite ju besuam.Pse?
Sepse veprimtari ilegale e LPK eshte pasuri e gjithe veprimtareve qe ishin te kyqure ne LPK.
Dhe te nxirren deshmi ose fakte rrethe punese se saji duhet te merren vendime Kolegjijale dhe me pase te deshmohet per kete apo ate rast .
-Per mose ta zgjatur shume z Kelemndi me apo pa vetedije paraprake provon ta marre timonin ne LPK mu si Daci ne LDk.Besoji se menyre qe ka zgjedhure z Kelmendi shpije atu.
Me Respekt.

---

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 26.03.2007 04:56

---

I / E nderuar Z. „Alfonsi" !
Meqë isha i zënë me ca angazhime, do më falni që kam pauzuar bashkëbisedimin që mbrëmë dhe sot nuk u jam përgjigjur Juve dhe të tjerëve. Do ju lutesha të më mirëkuptoni, pasi nuk kam dëshiruar të Ju injoroj.
Tani, me shpresë se nuk e keni humbur durimin, po vazhdoj me përgjigje:

JU: Besoj se keni menduar shume deri sa keni shpallur publikisht kete emer.Tani me kjo u ba.

Unë: Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikur ndonjë emër tjetër të këtij personazhi.

JU: Qfar pritni tani dhe si deshironi te rrjedh e gjithe kjo e tera?

Unë: Që romani të mirëpritet nga lexuesit.

JU: A keni marr ndonje ftese nga ndonje organ?Cili organ apo cila Gjykat mund te jet sipas mendimit tuaj kompetente?

Unë: Nuk kam asnjë ftesë. Dij se organet përkatëse në Gjermani gjithësesi janë kopetente dhe nuk duhet t'i kenë mbyll hetimet lidhur me atentatet e 17.01.1982. Nuk jam jurist dhe nuk dij nëse janë kopetente edhe organet përkatëse dhe drejtësia e Kosovës.

JU: A pritni qe Familjet e te vrareve(pasardhesit) te ngrisin padi private,apo Prokuroria ket duhet ta bej?

Unë: Nuk e dij.

JU: Po qese kjo ndodh ateher a mendoni se ka apo ju ne kete rast keni prova te mjaftueshme materiale per te provuar fajesin?

Unë: Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim. Pas përmbajtjes se romanit qendroj.

JU: A ka mundesi qe vrasesi te deshmoj pafajsin e tij me provat e tij qe ndoshta do te jen me te shumta se te akuzuarit?

Unë: Nuk e dij se çfarë ka ndermend të veproj "Vrasësi".

JU: A ka mundesi se pas kalimit te nje kohe te gjat te vie ne shprehje "Parashkrimi i afatit",kalimi i afatit objektiv i te drejtes per te ngritur Padi ?

Unë: Nuk jam jurist, por kam dëgjuar se krime të kësaj natyre nuk parashkruhen.

JU: Pra ketu eshte qeshtja pak e komplikuar e sidomos tek e drejta e kompetences reale dhe territoriale.Vepra eshte kryer ne nje vend tjeter.I akuzuari ka mundesi te jetoj ne Kosove,apo ne ndonje shtet tjeter.Paditesi jeton dikund tjeter.Gjykata ka qdokund,por ne cilen Gjykat duhet ngrituar padin....etj.
Te gjithat keto me falni se nuk jan qeshtje qe ju takojn juve te i zgjidhni,dhe te pergjigjeni,por e tera ketu rrodhi nga ajo pyetja ime ne fillim se:Si keni deshir tani te rrjedh Procedura ta quajm keshtu?

Unë: Nuk jam jurist dhe nuk jam kopetnt të bëjë komentime juridike. Po shpresoj se edhe ndokush, që ka të dhëna konkrete për rastin, do i përgjigjet thirrjes se ndërgjegjes dhe do i publikoj të dhënat që di.

JU: Mos rastesisht ai njeri qe ju keni shpallur si vrases ju ka kontaktuar,dhe a eshte lajmruar dikund publikisht lidhur me kete akuze.?

JU: Nuk kam shpalluar askë për vrasës, por kam shpreh dyshime dhe kam bërë sqarime se para organeve gjermane kam deklaruar, se nëse Rezili nuk ka alibi, duhet të jetë dorasi. Nëse e keni fjalën për Rezilin, mua nuk më është lajmëruar dhe nuk di të ketë bërë ndokund reagim publik ndaj dyshimit tim.

JU: Ne fund te ju them sinqerisht se me keni len pershtypje gjat pergjigjeve tuaja ,sidomos ndaj atyre disa pyetje provokative.Paraqiteni shume gjakftoht dhe shume i kulturuar. Po te ishte ne rastin tuaj z.Tarasi ai do te humbte durimin dhe do ti quante "femij te shkines"apo edhe me keq.

Unë: Ju falënderoj për komplimentin. Jeta më ka më ka mësuar të ruaj gjakftohtësinë dhe do i këshilloja edhe të tjerët për këtë. Edhe Tarasin do e këshilloja që mos fyej asnjë shqiptar, nëse vërtetë i ka fyer, siç shkruani Ju.

JU: Keta njerz sikur qe ju paraqiteni ne pergjigjet tuaja,meritojn respekt dhe jan per te u perkulur para tyre.Pa marre parasysh bindjet dhe qendrimet politike,ideologjike...etj, qe mund ti ken. Andaj une do te kem shume respekt dhe ndoshta edhe po te kem fatin te takoj dikund edhe do te perkulem.

Unë: Ju falënderoj dhe mirë u takofshim. Edhe pse keni menduar figurativisht, do ju këshilloja që të mos përkuleni para askujt, pasi shqiptari do duhej të mbaj korrizin vetëm vertikalisht, dhe jo ta përkul para asnjërit.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I / E nderuar Z. “Shqiperuesi” !
JU: - Kam një karakter të tillë që nuk mjaftohem me përgjegje asnjërëse. Ajo që më pengoi në rastin tuaj ishte se u treguat i njëanshëm,duke folur për Vilën e Presidentit dhe Fondin e Qeverisë. E kam cekur edhe më lart se unë nuk kam shumë informata për keqpërdorimin e Fondit Vendlindja Thërret por kjo ka qenë publike,pas një interviste në një gazetë lokale që ja kishte dhënë z. Sylejman Selimi lidhur me ato keqpërdorime.
Pra,unë nuk e shpika vet dhe nuk po shpif këtu. Pastaj,ky fond ka pasë degët e tij në të gjitha shtetet Perëndimore ,edhe në Kanadë,me sa di unë.
Ajo që unë këmbëngul të di ,është,që të dëgjoj nga goja juaj:
A ËSHTË KEQPËRDOR FONDI APO JO?
Kaq dhe hiq më shumë. Përndryshe,më duhet të vlerësoj sjelljen tuaj korrekte që në këtë forum e kishim harruar. Ju falenderoj.Keni përgëzimin tim. Gjithashtu falemnderit për mundin tuaj t'u përgjigjeni pyetjeve tona.

Unë: Besoj se nuk jam prononcuar vetëm për Vilën e Presidentit (Rugova) dhe për “Fondin e Qevrisë”, por edhe për vila të tjera dhe për Fondin VENDLINDJA THERRET. Edhe Fondi ynë mund të jetë keqpërdor. Sapo të siguroj të dhëna të pakontestueshme, do shpreh publikisht indinjatën time.
Ju falënderoj për komplimentet dhe uroj që kudo bashkëbisedimet të ruajnë nivelin minimal qytetërues.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I / E nderuar Z. “Hotiani”
(Afishuar me: 25.03.2007 11:01)
Mendimet dhe komentet Tuaja nuk parapelqej t’i komentoj, pasi unë këtu ndihem se duhet të përgjigjem në pyetjet që më drejtohen mua dhe jo të komentoj polemikat dhe “përplasjet” në mes të “forumistëve”.
Po hetoj se Ju nuk dakordoheni nëse ndokush kritikon UÇK-në, gjegjësisht komandantet dhe ushtarët e saj. Unë mendoj se gjithëke kemi të drejtë të kritikojmë, nëse vërtetë ua dimë dhe ua argumentojmë gabimet. As UÇK-ja nuk është aq e shejtë, sa të mos kritikohen gabimet e saj. Pjesëtarët e saj kanë bërë detyrë qytetare e patriotike dhe ndonjëri edhe mund të ketë bërë gabime, bile edhe të rënda. Bile, nëse ndonjë pjestar i saj ka bërë krime lufte, jam për atë që të tjerët që ua dinë, t’i denoncojnë. Por, njëherit, jam për të kritikuar e denoncuar edhe ata që kanë sabotuar Luftën çlirimtare...
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I / E nderuar Z. “Gjarperi” !
(Afishuar me: 25.03.2007 11:49)
Ne nuk kishim parti, por Lëvizje (Lëvizja Popullore e Kosovës). Ne nuk kemi lëshuar libreza e vërtetime, por ndonjë dëshmi individuale (pozitive ose negative), nëse kanë bërë pyetje konkrete për ndonjë person organet gjyqësore. Ndërsa matrapazllëqet me të arratisur kanë qenë vërtetë të shumta dhe ndonjëherë edhe tepër të rënda, duke filluar nga udhëtimi i organizuar me autobus nga Kosova, e deri të arritja në vendin e dëshiruar. Sa mirë do ishte të flasin vetë të goditurit.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I / E nderuar Z. “Gjarperi”
(Afishuar me: 25.03.2007 11:57)

JU: Te pershendes hotiani, une nuk deshiroj te hy ndermjet teje, dhe shqiperusit, por duhet te jeni real(qe te dy), dhe se nje duhet ta dini ju dhe te gjith se nuk i lejohet askuj te keqeperdor mjetet ne emer te qeveris, dhe as ne emer te UCK-s, e keqeperdorimet jane bere nga te dyja taborret, pra krimit duhet ti thuhet krim pa marr parasysh nga kush u be, e kush ka bere keqeperdorim ma shume, une nuk mund ta vlersoj, sepse per kete duhet ta bejn e ata qe jane pergjegjes per kete.

Unë: Do kisha preferuar që të mos ngriten akuza të përgjithësuar dhe të paushallizuara. Kebërësve kjo ju konvenon. Kështu po ndodh kur po (për)flitet edhe për korrupcionin aktual. Shumë më efektivisht do diskreditoheshin keqëbërësit, sikur të fillojmë me denoncim publik dhe juridik të rasteve të konkretizuara e të argumentuara. “Ujjqërit duan mjegull”, - shprehet populli. Them se mjegullnajë janë përgjithësimet dhe paushallizimet, kurse luftë konstruktive do mund të bëjmë vetëm me konkretizime të argumentuara.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I / E nderuar Z. “Ministri” !
(Afishuar me: 25.03.2007 12:16)
JU: ...." Ato para jane marre per dicka tjetr dhe per nje ceshtje tjeter , dhe jane perdorur per interesat e tua.Per tjeter jan kerkuar dhe per tjeter jan shfrytezuar"J. Gervalla.
Eshte fjala pe 50.000 DM te marra nga Mergata Kroate per blerjen e arnatimit!!!!! Kurse te shfrytezuara per nje lokal ne Peje?????
Pergjigjeja e juaj ishte perafersisht ; :::SE, KUR GJEN BUDALLENJE PSE MOS TE PERFITOSH ...
A jan fjalet e Jusufit ato me lart?
A eshte e vertete kjo ceshtje dhe
A gjeje shpesh BUDALLENJE !!!!!!! per te perfituar????????????????
Me nderime ministri me m te vogel!

Unë: Janë thash-e-themnaja, emndoj unë. Kështu mendoj edhe nëse duhet t’i ketë thënë edhe Jusuf Gërvalla (e unë nuk e di t’i ketë thënë). Ai nuk ka qenë profet dhe ndonjëherë edhe mund të mos ia ketë qëlluar. Thuhet se secili njeri i kësaj botshme bënë gabime, edhe ata që vlerësohen për heronjë.
Kroatet nuk më kanë dhënë të holla për të blerë armë. Atëherë nuk ua kam kërkuar, por as më vonë. Sikur të më jepnin të holla për armë, do iu isha mirënjohës.
Sa për lokalin e blerë nga unë në Pejë, provo ta dëshmoni Ju dhe kushdo qoftë dhe ju siguroj se do e keni dhuratë nga unë !
Unë nuk kam dhënë përgjigje të tillë, pasi nuk ka qenë dhe nuk është në kulturën time.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I / E nderuar Z. “Delgati” !
(Afishuar me: 25.03.2007 12:31)
Ju kërkoj falje nëse mendoni se ju kam keqkuptuar!
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I / E nderuar Z. “Shqiperuesi” !
(Afishuar me: 25.03.2007 12:35)
Disa mendime i ndajë me Ju. E kam përkrah kërkesën publike të Kryeprokurorit të Prishtinës, Z. Tahir Rreci, që të miratohet ligji për prejardhje të pasurisë, që të mund të verifikohet pasurimi i cilit do qoftë. Shpërdoruesit dhe përvetësuesit e pasurisë se popullit duhet të shprensohen dhe të marrin denim të merituar !
Besoj, për Fondin VENDLINDJA THERRET jam përgjigjur disa herë. Do

i isha shumë mirënjohës, nëse ndokush do publikonte në mënyrë konkrete e të argumentuar secilin shpërdorues e përvetësues edhe të këtyre mjeteve.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I / E nderuar Z. "Triksi" !
(Afishuar me: 25.03.2007 12:48)
Unë po përgjigjem si di (për të mos thënë si dua) unë dhe këtë të drejtë nuk mund të ma privoni as Ju. Kurse e drejta Juaj është t'i komentoni sipas arshin, ngritjes e kulturës Suaj dhe të mbani qëndrimin që dëshironi.
Më vjen keq nëse largoheni, pasi mund të bëni edhe pyetje, sqarime e vlerësime të tjera. Por, edhe të largoheni, keni të drejtë, ama edhe gjatë largimit, do ju lutesha, të përpiqeni që të na leni një shije të mirë, që të ndjejmë keqaedhje për largimin Tuaj.
Qytetëruese do ishte, meqë më njihke mua, kusheririn tim, Muhametin, Gërvallajt e nderuar, të na informosh, nëse ne ju njohim Ju dhe nëse po, si ju vlerësojmë. Po nuk mundet ta bëni këtu, urdhëroni e më shkruani në mail-adresën time, që të vazhdojmë bashkëbisedimin. Mbase, pas sqarimeve, mund të miqësohemi.
Uroj të rrosh jo vetëm 25, por të bëhesh plak me mjekërr të bardhë dhe i nderuar!
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I / E nderuar Z. "Qosi" !
(Afishuar me: 25.03.2007 13:02)
Do ju lutesha që të tregoheni më zemërgjerë, lidhur me mënyrën e bërjes se pyetjeve. E kam në konsideratë kërkesën e këshillën Tuaj, por unë do përpiqem të përgjigjem deri sa të mendojmë se jemi "konsumuar".
Njeriu nuk mund të dal nga lëkura e tij, i thonë një fjale. Pyetjet, por edhe vlerësimet, i bënë sipas informimit, vetëdijes, ndërgjegjës e përcaktimit. Sigurisht që kemi nevojë për sqarime e mirëkuptim reciprok. E kam thënë edhe njëherë, por po e përseris sërish: Nuk duhet të ketë pyetje të "mira" dhe të "këqija".
Sa i përketë Prof. Mujë Rugova, them se ka kontribuar bollshëm, por, mendoj, në parim njeriu ka mundësi të kontribuoj edhe më shumë se sa kontribuon. Ndoshta Prof. Mujë Rugova ka pas mundësi të kontribuoj edhe më shumë. Me Bukoshin u prish, kur u bind se ai po keqmenaxhonte "Fondin e Republikës se Kosovës", gjegjësisht kur u bind se ai nuk po ndihmonte UÇK-në. Përafërsisht kështu ka qenë shpjegimi i tij.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I / E nderuar Z. "Qeku11" !
(Afishuar me: 25.03.2007 13:41)
JU: A munt te jete vrasje (atentat) per shkak te bindjeve politike dhe qe nuk ishte vegel e LPK-se e sidomos e rrjetit te Gjavitit, por njikosisht (ju personalisht ishit ne konflikt te hapur me Gjavitin (per interesa qe ju i dini ).
Kurse Iliri kishte nje bashkpunim me te mire me ju(dhe shum flitet dhe dyshohet ) se ka te ngjare qe vrasja eshte per qellime perfitimi politik dhe avansim per te mbizotruar ne UÇK-se.

Unë: Nëse nuk përgjigjem siç prisni ose dëshironi Ju, besoj se nuk do thotë dhe nuk bëjë intriga. Unë ruaj të drejten personale që të rezervohem në ndonjë përgjigje.

JU: Edhe nje pyetje thate se ne muajn mars-prill keni bashkpunue ngusht, po pse jo edhe ne muajn Maje 98(nese nuk jam keq informuar

ju nuk keni marr pjes fare ne varimin e tij ne Tirane).
Shpresoj ne mirkuptim dhe se tani do te pergjigjeni me sakte (pa bere intriga ).

Unë: Në fund të prillit 1998 duhet të jem larguar nga Shqipëria dhe prandaj nuk kam pasur bashkëpunim të drejtëpërdrejtë me Ilirin, nga unë shumë lartë të çmuar. Është e vërtetë se nuk isha në varrimin e Ilirit.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I / E nderuar Z. "Hotiani" !
(Afishuar me: 25.03.2007 14:30)
Do ju lutesha të më lejoni të ju bëjë një këshillë: Përqëndrohuni në ndryshimi pozitiv të secilit dhe mos insistoni të jetë edhe sot, siç ishte dje. Besoj, edhe për Ju duhet të jetë i mirëseardhur, qoftë edhe ndryshimi i vogël pozitiv, pasi nëse ky është i vogël brënda 4-5 ditëve, do zmadhohet në ditët e mëpastajmë. Me rëndësi është të ndodh fillimi i kthesës pozitive dhe këtë duhet ta përshendesim.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I nderuar Z. "D" !
(Afishuar me: 25.03.2007 16:08)
JU: Gjatë leximit të librit pash se edhe atje e ke shkrua shumë gjëra „Halabakçe" !
Unë do të potencoj dy-tre raste për të cilat më duket se janë bash krejt halabakçe !!

Unë: Ju falënderoj për këtë diskualifikim kaq vullgar, meqë jeni i sinqert.

JU: 1. Ajo çka shkruan për dëshmorin e UÇK-së Avdullah Tahiri nga Malisheva e Gjilanit nuk qëndron !!
Ti në libër thua se i ke thënë Avdullahut se i ke "tradhtuar shokët" !! pas burgosjes së tij për ngjarjet e 11. marsit dhe 26. marsit ( ti në shumë vende e habit këtë date duke e potencuar 25. marsi 1981) !!
Ky konstatim dhe kjo përmendje në këtë mënyrë e dëshmorit të UÇK-së dhe veprimtarit të ilegales edhe para 1981-tës nuk qëndron !!
Avdullah Tahiri nuk ka qenë dëshmitar në asnjë proces Gjyqësor në vitet 1981 e më vonë.

Unë: Në roman është vlerësimi i personazhit Mirani, ti ketë thën Avdullahut, se "ka tradhëtuar shokët". Pastaj bëhet informimi se ai është liruar nga burgu hetues dhe nuk është thënë se ai ka dëshmuar gjatë proceseve gjyqësore. Keni të drejtë që bëhet fjalë për 26 dhe jo 25 marsin, siç thuhet në roman. Por, unë nuk kam thënë se kam bërë studim historik, por e kam quajtur roman. Dhe, mendoj se nuk është sakrilegj i madh, nëse në roman lëshohet gabim i datës.
Sikur të ma mbushnit mendjen, se e keni merakun për të mbrojtur Mikun dhe Bashkëveprimtarin tim, të nderuemin Avdullah Tahiri, do më behej qejfi.

JU: 2. Ajo çka shkruan për Hysen Tërpezën dhe e cilëson kriminel si djalin e agjës së tij – nuk qëndron !!

Unë: Nuk janë vlerësime të bëra nga unë, por nga bashkëveprimtarët e tij (si Xhelë Kalishta, etj.).

JU: 3. Ajo çka shkruan për dëshmorin Enver Hadri duke aluduar dhe dyshuar se ishte provokator i UDB-së nuk qëndron – ai u vra nga UDB-ja dhe vitin e kaluar është burgos vrasësi i tij i cili dyshohet se është nga e njëjta grup që ka bërë atentatin edhe në

Untergrupenbach – do të shohim - filli i zbulimit të krimeve të UDB-së në Gjermani dhe Evropë ka filluat të sqarohet.

Unë: Ju lutem, mos më keqkuptoni, mendimet e vlerësime janë të kohës (të viteve 1978-1984). Nuk bëhet fjalë për vlerësime përfundimtare, por mendime e vlerësime të kohës. Pra, në atë kohë, një rreth i veprimtarëve (ndër ta edhe unë), ka dyshuar e menduar se Enver Hadri është spiun i UDB-së dhe i Sigurimit të R. Se Shqipërisë. Nuk do të kishte qenë e ndershme të gënjeja, se atëherë ky rreth i veprimtarëve e ka vlerësuar pozitivisht Enver Hadrin. Edhe njëherë: Bëhet fjalë për dyshimet, vlerësimet dhe marrëdhëniet e atyre viteve.

JU: 4. Edhe pohimet tuaja për Musa Hotin që vret një punëtor të Konsullatës Jugosllave, se ishte provokator dhe bashkëpunëtor i UDB-së nuk qëndron !! Musa Hoti u vra nga UDB-ja …

Unë: Edhe lidhur me Musa Hotin ashtu, në atë kohë është menduar, vlerësuar e mbajtur qëndrim, siç rrefehet në roman. Besoj se po më kuptoni, se nuk janë mendimet e vlerësimet e atyre viteve identike me mendimet dhe vlerësimet e tanishme.

JU: Ka edhe shum Halabakllëçe në librin tuaj, por ata që janë të gjallë e kanë gojën dhe duart dhe munden vet të shkruajnë e pohojnë ose mohojnë cilësimet që ua bënë .

Unë: Rrofshin të gjallët dhe të shpresojmë se do shkruajnë e reagojnë, që të kemi sa më shumë këndveshtrime, pasi do na mundësohet të bëjmë vlerësime sa më objektive.

JU: Unë potencova personat që Kosova i dinë si dëshmor dhe i nderon dhe respekton, nuk besoj se ti me dyshimet mbi ta mundesh ta zbehësh personalitetin e tyre.

Unë: Edhe nëse gjithë qytetarët e Kosovës kanë një vlerësim të caktuar, mua nuk mund të më imponohet të që të ndryshojë mendimin personal. Kemi përplot shembuj për qëndrime të gabuara, pavarësisht se pas tyre në kohë e hapësirë të caktuar kanë qëndruar me miliona veta. Le t'i kujtoj qëndrimet e miliona njerëzve për Hitlerin, për Titon, për Enverin, etj. Besoj, jeni i mendimit me mua, se këto qëndrime i kanë ndryshuar ata miliona vetë, kur kanë mundur të informohen dhe kur janë ndërgjegjësuar. Gati një shekull është menduar se Rrust Kabashi, anëtar i Lidhjes se Prizrenit, ka qenë patriot i madh, bile Presidenti Sali Berisha e pat dekretuar "post mortum", si hero kombëtar, por historiografia e Kosovës ka dhënë sqarime se ai kishte qenë në shërbim të Serbisë...

JU: A të ka shkua mendja se edhe dikush mundet me të paragjykue ty !!

Unë: Jo vetëm që mundet, por janë me mijëra që më kanë paragjykuar (e luftuar), besoj se Ju mund ta dini, se njëri nga këta mijëra jeni edhe Ju. Dhe unë nuk ju hidhërohem, por shpresoj se do ndryshoni mendimin, kur të keni kompletuar informatat sa më kritike e sa më korrekte dhe nëse do keni "programim" të kohës për t'i përpunuar informata pa anshmëri e paragjykime. Uroj.

JU: A të ka shkua mendja se edhe dikush mundet me të paragjykue ty !! Ti ishe në Gjermani me pasaportë Jugosllave dhe krejt aktivitetin dhe udhëtimet deri në Amerikë i bëje me pasaportë Jugosllave !! Deri në muajin dhjetor 1982 -janar 1983!!
Ti gjithë kohën, pra deri me 1983, kishe dokument valid të Jugosllavisë të cilin validitet kanë mundur ta anulojnë organet Jugosllave !!

Unë: E vërtetë që kisha pasaportë të RSFJ-së deri në dhjetor të vitit 1982. Sipas insinuatës Suaj, si duhet t'i "shabllonizojmë" gjithë ato personalitete, që e udhëheqnin Republikën e Kosovës (1990-1999), por që bënin vizita diplomatike, duke përdor pasaporta serbe !?

JU: E po të mendohet Halabakqe, si i gjykon ti të tjerët … edhe ty të do të kishin mundur të paragjykonin dhe dyshonin për UDB-ash…. Madje edhe me dëshmi konkrete të pasaportës tënde dhe udhëtimeve tuaj edhe në Kosovë!!

Unë: Jo vetëm që mund të më paragjykonin dhe dyshonin për UDB-ash, por më kanë paragjykuar, dyshuar e akuzuar për UDB-ash. Dikur ishin me mijëra, tani janë shumë më pak.

JU: Unë po të them se kam veprimtari nga viti 1980 deri me 1991 në Kosovë dhe nga 1991 deri 2007 në mërgim.
Po këto 16 vite jete dhe veprimtarie në mërgim nuk bartin as 16. ditëshin e rrezikshmërisë të veprimtarisë në Kosovë.

Unë: Nuk e njoh veprimtarinë Tuaj as në Kosovë e as jashtë, prandaj nuk i jap vetës të drejtë të gjykoj, se sa keni qenë i rrezikuar brendë e jashtë.

JU: Po ashtu dua të përkujtoj se edhe 25. vitet tua në mërgim nuk e kanë peshën 25. ditëve të sakrificës dhe aktivitetit çlirimtar të Dëshmorit Avdullah Tahirit dhe veprimtarit Hysen Tërpezës në Kosovë.

Unë: Është e drejta Juaj personale të gjykoni kështu.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I nderuar Z. Administrator ("Nositi"),
(Afishuar me: 25.03.2007 17:35)
Do ju lutesha që të mos përjashtoni asnjërin / asnjërën nga ky bashëbisedim (pra as "Trixi-in"), pasi shkëmbimi i informatave e vlerësimeve na bënë të gjithëve mirë. Sigurisht, do kish qenë e dëshirueshme të ruhet niveli minimal i mirësjelljes dhe i qytetarisë. Por, ne nuk jemi sa ka kinezë, që të bëjmë sleksionim sa më cilësor dhe prap të na mbesin mjaft. Secili shqiptar në vetvete ka vlerë, qoftë edhe vetëm për statistika.
Ju falënderoj për mirëkuptim.
Miqësisht
I_Kelmendi

I Nderuar Z. "Trixi" !
Më fal që për të gjithë Ju që po përdorni psedonimin, praktikova të përdor: "I / E..." Sa do të kisha dëshiruar që të lirohemi nga pseudonimet. Tani e tutje, kur patet mirësinë të dekonspironi të paktën gjinë Tuaj, do ju drejtohem në mënyrë përkatëse. Mua më kanë penguar edhe bashkëveprimtarët, që praktikonin pseudonime edhe në Perëndim, bile edhe në familje të tyre. Mos u ktheft ajo kohë kur njerëzit edhe për mendime denoheshin, prandaj detyroheshin të përdornin pseudonime. Tani, fatmirësisht, nuk keni pse të kamuflloheni, pasi për mendime të lira nuk përndjeket askush. Këtë po e them pa ditur se për çfarë arsye është zgjedhur kjo praktikë e bashkëbisedimit, të fshehur pas pseudonimeve.
Mirëutakofshim.
Ibrahim_kelmendi@yahoo.de

TË NDERUAR "FORUMISTË" !

DO JU LUTËM TË GJITHËVE TË MË FALNI QË NUK PO VAZHDOJ ME PËRGJIGJE TË PËRMBLEDHURA, PASI VËRTETË PO NDJEHEM I LODHUR DHE PO MË FLIHET (Ora është 05.55 e mengjezit).
ËNDRRA TË BUKURA E GJUMË TË MIRË GJITHË ATYRE QË JANË DUKE FJETUR !
ZGJIM TË DISPONUESHËM E DITË TË MBARË!
Tung

profile | edit quote

**Andi**

**Anëtar që nga:** 15.07.2004
**Afishime:** 94
**Vendbanimi:** Zvicër

**Afishuar me:** 26.03.2007 10:39

I nderuar z. Kelmendi.
Po më përlqen forma se si po u përgjigjeni formistëve.
Tani kam një pyetje në lidhje me librin. Para atentatit në shtëpinë e familjes Gërvalla thua se ishte një mysafir i paftuar i cili paskesh pasur frike të qëndrojë në banesën e tij. Sqarime të mëtejme për të munguan. Çka ndodhi me atë njeri u mor vesh kush ishte, pati një denoncim për të në polici?
A mund të na thoni a ka pasur të dyshuar tjerë nga ana e policisë përveq Rezilit?
Përshëndetje
Andi

profile mail | edit quote

**hotiani**

**Anëtar që nga:** 06.06.2006
**Afishime:** 229

**Afishuar me:** 26.03.2007 10:57

I / E nderuar Z. "Hotiani"
(Afishuar me: 25.03.2007 11:01)

Mendimet dhe komentet Tuaja nuk parapelqej t'i komentoj, pasi unë këtu ndihem se duhet të përgjigjem në pyetjet që më drejtohen mua dhe jo të komentoj polemikat dhe "përplasjet" në mes të "forumistëve".
Po hetoj se Ju nuk dakordoheni nëse ndokush kritikon UÇK-në, gjegjësisht komandantet dhe ushtarët e saj. Unë mendoj se gjithëke kemi të drejtë të kritikojmë, nëse vërtetë ua dimë dhe ua argumentojmë gabimet. As UÇK-ja nuk është aq e shejtë, sa të mos kritikohen gabimet e saj. Pjesëtarët e saj kanë bërë detyrë qytetare e patriotike dhe ndonjëri edhe mund të ketë bërë gabime, bile edhe të rënda. Bile, nëse ndonjë pjestar i saj ka bërë krime lufte, jam për atë që të tjerët që ua dinë, t'i denoncojnë. Por, njëherit, jam për të kritikuar e denoncuar edhe ata që kanë sabotuar Luftën çlirimtare...
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!

I nderuari Kelmendi,
Me tere respektin qe kam ndaj jush une nuk pajtohem me qendrimin tuaj dhe e konsideroj si politik. UÇK-ja u sulmua dhe u sabotua nga ata qe duhet te ishin komandant suprem dhe krah politik i saje.Partia me e madhe politike jo vetem qe nuk e perkrahu ,por ju kundervu duke e etiketuar dhe demonizuar para popullit dhe opinionit nderkombetar.
Kjo ushtri filloj rezistencen e armatosur ne kohen dhe rrethanat e duhura ,kete e verteton angazhimi i forces ushtarake me te madhe ne Bote ,dhe rezultati perfundimtare. Pra kete asnje njeri qellimmire nuk mund ta mohoje.
Une kete ushtri e konsideroj si te shenjte ,dhe besoj se lufta e saje dhe heroizmi dhe sakrifica e me te mireve eshte momenti me i ndriteshem ne historine tone.
Ti thua se ata kane bere detyren qytetare dhe patriotike. Pajtohem

por te analizojme qka bene shumica,nuk ishte mbrojtja dhe qlirimi i atdheut detyre e tyre patriotike.
Perse nuk e vejme doren ne zemer dhe te pyesim se a e kryem na secili kete detyre patriotiuke dhe qytetare. Ti , une, ai ,secili nga ne. A ju pergjegjem thirrjes se atdheut. A kane te drejte ata qe iken edhe me ndihmen e Milloshevigit te njollosin UÇK-ne .
Ne si popull me te gjitha institucionet ne vend qe se paku ti falenderojme dhe ti perkrahim keta djem dhe vajza ,ne i kemi margjinalizua dhe denua .
Ata jane te magjinalizuar,te pa perkujdesje dhe pa kushte elemtare per jete. E din ti zoti Kelmendi se edhe ata qe jane 100% invalid nuk kane asnje ndihme.
Ti thua tani duhet ti vejme para gjyqeve te huaja dhe para deshmitareve dhe deshmive te fabrikuara nga UDB-ja dhe klyshte e saj.
Te vehet secili ne poziten e lufettareve te lirise ,ne vendin e atyre qe luftuan dhe ofruan te gjitha dhe humben gjymtyrte dhe nuk kerkuan asgje. Zoteri Kelmendi na keta luftetare te cilet na sollen lirine nuk i perkrahem,nuk i ndihmuam .Me nje fjale i kryqezuam.
Nuk gjene shembull ne bote te sjelljes se ketille te nje populli ndaj qlirimtareve fitimtar.Po per mua UÇK-ja dhe lufta e saj jane vlera te shenjta.Para ketyre vlerave perulem me dinjitet dhe krenari.
Kam nje pyetje zoti Kelmendi,por te lutem mos mu pergjigj si politikan.
Si mund te spjegosh numrin aq te madh te shqiptareve te Kosoves ne sherbim te okupatorit gjat luftes?

profile | edit quote

**AmazInG**

**Afishuar me:** 26.03.2007 11:33

**Anëtar që nga:** 06.01.2003
**Afishime:** 2861
**Vendbanimi:** "Aty ku lahet Adelina"

Pershendetje z.I.Kelmendi ..
e kam i pyetje ..
Rezili ... kshtu quhet personi ,, apo ky emer eshte vetem Pseudenim ??
amani ju koft juve MOD mos ma fshini qeket shkres deri sa ta marr ni pergjigje tvogel bile .. -
flm per mirkuptim ..

profile www | edit quote

**urberari**

**Afishuar me:** 26.03.2007 11:49

**Anëtar që nga:** 28.12.2005
**Afishime:** 73

Pyetje Ibrahim Kelmendit: A e njeh ish ambasadorin e Shqiperise ne Beograd Sokrat Plaken dhe a je takue ndonjiher me te dhe eventualisht ndonji koment per te-per te mire per te keq.

profile | edit quote

**Shqipëruesi**

**Afishuar me:** 26.03.2007 12:24

**Anëtar që nga:** 08.08.2004
**Afishime:** 556
**Vendbanimi:** Prishtinë

I nderuar z. Kelmendi,
- Edhe pse nuk pajtohem plotësisht me përgjegjen tuaj,prapëseprapë më mbetet të ju përgëzoj për qëndrimin tuaj dhe kulturën e bisedës. Ju i patë këto "Rojat e Mjegullës" në forum(të personifikuara në disa forumistë,si Delegati,Hotiani apo edhe ndonjë tjetër),që kërkojnë nga ne, të ju thurrim himne për heroizmin dhe patriotizmin tuaj dhe që kundërshtojnë rreptësisht, cfarëdo pyetje ose qoftë dyshim, në ju apo tek luftëtarët e lirisë.
E kam thënë cdo herë dhe vazhdoj ta them, se nuk mund të ketë njeri

të paprekshëm, sepse ajo detyrimisht con drejt diktaturave të ardhshme,e ne shqiptarët më së miri provuam,cdo të thotë DIKTATURË.
Mënyra më e mirë është,të mos ketë temë tabu,të mos ketë "të paprekshëm", se vetëm dhe vetëm kështu,nxirret në dritë, e vërteta.
Unë të hetoj ty,por ti nuk ke të drejtë të më hetosh mua,këto janë disa nga "logjikat" këtu.
Kurse pyetja ime e ardhshme, ka të bëjë me Kadri Manin (Osmanin) dhe "fajin e tij", me rastin e vrasjes makabre, të Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës?
Edhe njëherë,përshëndetje dhe kalofshi një ditë të mbarë !
Shëndet
Shqipëruesi

profile | edit quote

**cercizi**

**Anëtar që nga:** 23.02.2004
**Afishime:** 237
**Vendbanimi:** rrez lumenjeve!

**Afishuar me:** 26.03.2007 13:20

Quote:
I_Kelmendi afishoj me 2007-03-23 15:47 :
"Qosi" pyet nëse di kush ka punuar atëherë në Ambasadën jugosllave. Përgjigje: Në atë kohë sekretar i parë (krye-udbash) në ambasadë ka qenë Z. Shefqet Hashani, për mendimin tim një person që respektonte ligjet përkatëse. Më vonë e arrestuan dhe e denuan më shumë vite burg. Duhet të ketë pas edhe të tjerë UDB-ashë në konsullatat jugosllave, pasi të tilla kishte shumë në Gjermani, por nuk i di. Në konsullatën e Stuttgart duhet të ketë qenë Bashkim Hisari, por nuk e dij çfarë funksioni ka ushtruar.
==========

Nje nderhyrje e vogel!
Bashkim Hisari,njifej si i deleguar i ambasades(udb-se)per resorin e kultures.Pas demostratave te 81-tes,ne nje demostrate perkrahje ne Stutgart ne mesin e atyre supovcave percjelles mergates sone ishte edhe i larte permenduri.Pasi keta fotografonin demostruesit gje ce ishte rrezik pe ate kohe, grupi i prire nga Bardhoshi,perleshet me kete bashkim hisar dhe supovca tjere ku edhe ju thyem aparatet.Kjo rezultoi me nje paraburgosje te disa shokeve deri sa shoket tjere permes avokateve paguan kaucion per lirim ne menyre qe mos te bihet ne duar te te shtetit terrorrist(jugosllav).

profile | edit quote

**qeku11**

**Anëtar që nga:** 05.03.2006
**Afishime:** 40

**Afishuar me:** 26.03.2007 13:30

me lejo qe prap te beje shtojc ne pyetjet e meparme,z:Kelmendi
Une e di dhe te kuptoj qe ndonje sekret nuk eshte e udhes qe ta tregosh ne kete forum, po:
Po nese i shiqon shkrimin e pare (pergjigjjen tuaj) thoni se nuk kam kurfar konflikti me Gjavitin me Compay(qa nuk eshte e vertet), kurse ne pergjigjejn e dyte qe drejtpersedrejti lidht me kete te pare prap nuk tregoni te vertete (shum thjesht :ishit ne konflikt per qellime te organizimit dhe mbeshtetjes poliotike te Ilirit-UÇK-se me Gjavitin kjo eshte esenca e kesaj ) kurse ato qa nuk tregohen jam as une per ti mos treguar.
Mos u brengos dhe shqeteso shum per keto qe po bashkebisedojm
Shpresoj ne sinqeritet te nderjellt.
Tung

profile | edit quote

**Burimi35**

**Afishuar me:** 26.03.2007 13:40

**Anëtar që nga:** 28.02.2006
**Afishime:** 469

Te nderuar Moderator !
Qe te kemi nje veshtrim me te mir rreth pyetjeve te Forumisteve dhe pergjigjeve te Ibrahim Kelmendit rreth Librit Historik "ATENTATET" kam nje kerkes !
Ne ket Teme te mbesin pyetjet e Forumisteve dhe pergjigjet e Ibrahim Kelmendit, te tjeret mesazhe te fshihen.
Qellimi i temes eshte ,pyetesit te marrin pergjigjet nga Autori i Librit e jo nga te tjeret.
Ju pershendes

profile | edit quote

**Delegati**

**Afishuar me:** 26.03.2007 14:29

**Anëtar që nga:** 12.05.2006
**Afishime:** 548

Ibrahim,
Unë për ty po e dij që nuk duhet të shpreh dyshime se a je I apo E nderuar meqenëse po të "thërras".
Si ti shkruan kështu për mua:
I / E nderuar Z. "Delgati" !
(Afishuar me: 25.03.2007 12:31)
Ju kërkoj falje nëse mendoni se ju kam keqkuptuar!
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!
Me të mira Ibrahim. Aqif Kastrati.

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Afishuar me:** 26.03.2007 15:45

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

I nderuar Z. "panta_rhei" !
(Afishuar me: 25.03.2007 21:11(
Po filloj që tani, prej Jush, t'i përshtatem gjinisë se pseodonimit, për të mos përdorur mënyrën e deritanishme: „I / E nderuar Z. …"

Ju keni të drejtë kur mendonis, se romanin ATENTATET nuk e ka shkruar Ibrahim Kelmendi i viteve 1978-1985, por Ibrahim Kelmendi i vitit 2007. Kapitullin e fundit ia kam dorëzuar redaktuesit (Z. Adem Gashi) në fillim të janarit të këtij viti.
Mos më keqkuptoni, por romanin e kam shkruar sipas qejfit dhe bindjeve të mia. Edhe po t'i dija qejfin, bindjet dhe përcaktimin Tuaj, ua them më keqardhje, nuk do ta kisha shkruar sipas tyre. Ju tani, si lexues, keni të drejtë t'i bëni vlerësimin romanit, sigurisht edhe mua, sipas arshinit Tuaj dhe më vjen mirë që nuk rezervoheni. Vlerësimet Tuaja i kam parasyshë dhe i respektoj, pasi kultura kryesore demokratike është, të respektosh njeriun që mendon ndryshe.

JU: Une gjithsesi ju pershendes per ndermarrjen dhe si pyetje konkrete meqe romani titullohet "Atentatet", a e konsideroni romanin "kriminalistik", dhe a e konsideroni veten te pergatitur ne kete fushe?

Unë: Sa u përketë zhanreve letrare të romanit, nuk jam aq kopetent të jam mendime teorike, edhe pse kam studjuar germanistikë e filozofi në Gjermani në vitet 1977-1982. Thënë të drejtën, shumëçka që kam studjuar në atë, i kam harruar. Por, do thoja se ka segmente në roman, që mund të i jepnin romanit nyuanca të në romani kriminalistik.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

*****************

I nderuar "Feni_X" !
(Afishuar me: 25.03.2007 22:31)
Ju falënderoj për konsideratën Tuaj. Uroj që të mos shqetësoheni më shumë se sa e meriton ndaj vlerësimeve diskualifikuese që po bën e do bënë ca "forumistë". UDB-ja nuk ka pasur për detyrë që të burgos e vrasë veprimtarë patriotë, por edhe më shumë është angazhuar që të formoj opinione për njerëzit dhe ngjarjet. Në kuadër të kësaj veprimtarie, UDB-së i ka interesuar të bëjë ujkun qingj dhe qingjin ujk, të ndërgjmin amoral, dhe amoralin të ndërshëm, patriotin tradhëtar dhe tradhëtarin patriot, etj. Edhe disa njerëz të mirë (e njeriu lind i mirë), nuk kanë pasur mundësi, përgatitje e fuqi për t'u mbrojtur nga kjo veprimtari (dez)informuese e UDB-së. Prandaj, fatkeqësisht, edhe të tillët janë viktima dhe duhet të mirëkuptohen si viktima. Pastaj, në dirinë e mendimit pluralist, formohen mendime e bindje të ndryshme, ndonjëherë edhe shumë kundërthënëse. Krejt marifeti është që të dimë e të mundim të respektejmë mendimet "kundërshtuese", ato t'i harmonizojmë në plan të përgjithshëm dhe të gjitha përplasjet në të ngelin e të harmonizohen në kuadratin e demokracisë se mirëfillët dhe në interes të emancipimit tonë të përgjithshëm shoqëror e kombëtar.

JU:
Para disa muajsh patet realizuar nje vizit ne Maqedoni, ku edhe pas largimit tuaj nga atje, botuat nje opinion ne gazeten fakti ne lidhje me disa takime qe keni realizuar me lidershipin shqiptar ketu.
Fillimisht kishit takuar z.Arben Xhaferin, siq keni shkruar dhe detajizuar ne gazet, ne zyren e tij ne Tetove dhe me pastaj edhe kryetarin e BDI-se z.Ali Ahmeti, tashme si parti opozitare ne MAqedoni.
Konkretisht:
Cili ishte motivi i vizites suaj, dhe influenca juaj qe ndikuat ne lidershipin e partive shqiptare ketu,.?
Dhe kur ve nje paralele ne mes Juve dhe Ali AHmetit, mund te gjykoj lirshem se qe te dyni keni qen promotor te ilegales dhe ndoshta sa do pak keni disa segmente me te perbashketa, se te tjeret.
Theksi im mbi kurreshtjen time : pse pikerisht takuat Arber Xhaferin dhe s'di pse me thot mendja se jeni me te afert me te dhe jo me shoket tuaj te ilegales te cilet keni 'notuar' ne te njejtat vale, ne kete rast me z.Ahmetin (?).

Unë:
Në Maqedoni kam qëndruar nga tetori i vitit 2005, deri në nëntor të vitit 2006. Edhe tani një pjesë të madhe të kohës e kaloj atje, pasi për hapësirën e atjeshme etnike shqiptare ndjejë një dashuri dhe një përgjegjësi të madhe.
Në dhjetor 2006 pata përgatitur një broshurë, të cilën e pata titulluar "Shqiptaret dhe sfidat e tyre në Maqedoni". Që shtypur në 10.000 ekzemplarë dhe qe shpërndarë falas. Në ndërkohë, kam në plan ta zgjeroj she ripunoj atë broshurë, për ta botuar si liberth.
Motivi i qëndrimit tim atje ka qenë njohja ime me realitetin e atyshëm dhe angazhimi im modest që të përparoj ai realitet. Unë nuk kam insistuar të influencoj asnkëri, por të shpreh mendime për mundësitë e përshpejtimit të zhvillimit të gjithëmbarshëm të asaj pjese të popullit tonë.
Me Ali Ahmetin jam bashëveprimtar që nga viti 1984 dhe për këtë fat ndjehem i nderuar.
Z. Arbër Xhaferi e kam takuar që në vitet e 90-ta në Gjermani, bile në një takim me bashkatdhetarët në Mynih (München), kemi qenë bashkarisht në podijum, për të shpjeguar secili përcaktimet e veta politike, duke iu përgjigjur pyetjeve të bashkatdhetarëve. Pastaj kemi pas një takim me rëndësi në Tiranë në fillim të Luftës për barazi kombëtare në Maqedoni. Vazhdoj ta di për Mik dhe të kem respekt për te, prandaj herë pas here bashkëbisedojmë për të shkëmbyer

mendime. Në gjerësinë e valëve tona, sigurisht ka segmente frekuencash ky puçemi, por përgjithësisht disa koncepte na bëjnë të dallueshëm.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

******************

I nderuar Z. "Livadhi" !
Ju falënderoj për konsideratën dhe për disa vlerësime që i keni bërë veprimtarisë kalndestine / të fshehtë (ilegale, siç quhet gabimisht), por po ndalem konkretisht të parshikimi Juaj:
JU:
Per mose ta zgjatur shume z Kelemndi me apo pa vetedije paraprake provon ta marre timonin ne LPK mu si Daci ne LDk.Besoji se menyre qe ka zgjedhure z Kelmendi shpije atu.
Unë:
Për mua LPK-ja aktuale është parti politike dhe nuk është Lëvizje, siç e kimim deri në vitin 1999. Në Kuvendin që mbajti në atë vit në Prizren, LPK-ja mori vendim të pushon së qenuri dhe Partia e tanishme e LPK-së po mundohet të jetë një kopje e saj, por e vlerësoj si një kopje e keqe, xhuxhe. Nuk kam kurfarë paramendimesh që gjasojnë me ato që bëni Ju.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

******************
I nderuar Z. "Andi" !
(Afishuar me: 26.03.2007 10:39)
Ju falënderoj që e paskeni lexuar kaq vëmendshem romanin. Për personazhin në fjlalë, meqë bindja e hetuesisë gjermane ishte, se ai ishte një "kajthitje" aksidentale, nuk i kam kushtuar më tepër rëndësi. Hetuesia gjermane ka pasur dyshime ndaj shumë vetave, por në fund u përqendrua në dyshimin ndaj Rezilit.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

******************
I Nderuar Z. "Hotiani" !
(Afishuar me: 26.03.2007 10:57)
Kam respekt për konsideratën Tuaj të shejtë ndaj UÇK-së, por për mua nuk është aq e shëjtë, sa të mos kritikohen gabimet e saj. Kam qenë njëri nga ata që i ka takuar hiarkisë drejtuese të saj dhe duke mos respektuar modestinë që kam dhe për nder Tuaj që të jeni sa më i informuar, nga qershori i vitit 1998, në atë hearki zyrtarisht kam pas pozicion më të lartë, ta zëmë se sa Z. Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Xhavit Halitaj, e të tjerë. Prandaj i jap vetës të drejtë, që kushdo ka të drejtë të vlerësoj kontributin e madh të saj, njëherit të kritikoj gabimet e saj (duke më përfshirë edhe mua), por askush nuk duhet të ketë të drejtë morale ta fyej e denigroj. Po shpresoj se në të ardhmen e afërt Ajo do mbrohet me ligj, që të japin llogari ligjore ata që e shajnë dhe fyejnë.
Sigurisht, ndonjëri mund të jetë penduar, për faktin që nuk është angazhuar me kohë në Luftën çlirimtare dhe për faktin se kanë shpifur për UÇK-në famëmadhe. Por disave prej tyre ju mungon kurrajo qytetare për t'u penduar edhe publikisht. Atyre u kanë ngelur akoma disa virues gërryes, që i kishte lansuar UDB-ja kundër kësaj Ushtrie. Sigurisht, me kalim të kohës, edhe ata pak virues që u kanë mbetur, do menjanohen dhe prandaj atyre duhet t'u ofrohet shansi e

mirësjellja vëllazërore, që të përzënë të tillë virues nga ndërdija e tyre.
Disa invalidë marrin ndonjë ndihmë por do miratoj Kosova e pavarësuar ligje përkatëse, që të ndihmohen e nderohen të gjithë ata që kanë sakrifikuar në Luftën çlirimtare.
Sa i prëketë "kryeqëzimeve" që ju bënë disa luftetarëve pas Lufte, edhe ata kanë hise të fajit në këtë "kryqëzatë", sepse nuk ruajten dinjitetin dhe vetëmbrojtjen e tyre, por u tërhoqen për t'ju lënë hapësirë shpërdoruese, edhe në emër të tyre, disa "komandantëve" e "udhëheqësve". Jo çdo herë duhet kërkuan fajin të tjetri. Sidomos luftetarët duhet të shqetësohen për vilat e liderucëve, të cilët na u shndërruan në profiterë të Luftës...
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

******************
I Nderuar Z. "AmazInG" !
(Afishuar me: 26.03.2007 11:33)
JU: Rezili ... kshtu quhet personi ,, apo ky emer eshte vetem Pseudenim ??
Unë: Rezili është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit. Ky nuk është emër i vërtetë njeriu.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

******************
I Nderuar Z. "Urberari" !
(Afishuar me: 26.03.2007 11:49)
Z. Sokrat Plaka nuk e njoh personalisht dhe nga ato që di, them se ka qenë personalitet pozitiv.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

******************
I Nderuar Z. " Shqiperuesi" !
Ju falënderoj për konsideratën.
(Afishuar me: 26.03.2007 12:24)
JU: Kurse pyetja ime e ardhshme, ka të bëjë me Kadri Manin (Osmanin) dhe "fajin e tij", me rastin e vrasjes makabre, të Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës?
Unë: Nuk di për rrolin e Z. Kadri Osmani në atë vrasje. Di se komandues zyrtar i njësisë policore që vrau këta dy heronjë ka qenë i ndjeri Tahir Zema, dhe për jo-profesionalizëm të tij, pasi vrau të përndjekurit, kur nuk kishim më municin për t'u mbrojtur, që degraduar nga strukturat e atëhershme drejtuese.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

******************
I Nderuar Z. "Cercizi" !
(Afishuar me: 26.03.2007 13:20)
JU:
Nje nderhyrje e vogel!
Bashkim Hisari,njifej si i deleguar i ambasades(udb-se)per resorin e kultures.Pas demostratave te 81-tes,ne nje demostrate perkrahje ne Stutgart ne mesin e atyre supovcave percjelles mergates sone ishte edhe i larte permenduri.Pasi keta fotografonin demostruesit gje ce ishte rrezik pe ate kohe, grupi i prire nga Bardhoshi,perleshet me kete

bashkim hisar dhe supovca tjere ku edhe ju thyem aparatet.Kjo rezultoi me nje paraburgosje te disa shokeve deri sa shoket tjere permes avokateve paguan kaucion per lirim ne menyre qe mos te bihet ne duar te te shtetit terrorrist(jugosllav).
Unë: Informimi dhe komentimi Juaj është i përafërt. Shpersojmë që të plotësohet nga ata që janë më të informuar, gjegjësisht që ishin pjesëmarrës.
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de
******************
I Nderuar Z. "qeku11" !
(Afishuar me: 26.03.2007 13:30)
JU: Me lejo qe prap te beje shtojc ne pyetjet e meparme, z:Kelmendi . Une e di dhe te kuptoj qe ndonje sekret nuk eshte e udhes qe ta tregosh ne kete forum, po:
Po nese i shiqon shkrimin e pare (pergjigjjen tuaj) thoni se nuk kam kurfar konflikti me Gjavitin me Compay(qa nuk eshte e vertet), kurse ne pergjigjejn e dyte qe drejtpersedrejti lidht me kete te pare prap nuk tregoni te vertete (shum thjesht :ishit ne konflikt per qellime te organizimit dhe mbeshtetjes poliotike te Ilirit-UÇK-se me Gjavitin kjo eshte esenca e kesaj ) kurse ato qa nuk tregohen jam as une per ti mos treguar.
Unë: Në mes të Ilirit dhe Xhavitit kishte një konflikt lidhur me konceptin e format e organizimit dhe kopetnecat. Unë mbajta anën e Ilirit...
- Shëndet dhe suksese në punë të mbara!
Tung
ibrahim_kelmendi@yahoo.de
Unë nuk do përcjellë pyetjet Tuaja për disa orë, pasi do kem një angazhim tjetër. Kalofshi ditë të mbarë! Tung

---

profile | edit | quote

**Shpetimi**

**Anëtar që nga:** 08.06.2001
**Afishime:** 1712

**Afishuar me:** 26.03.2007 16:54

---

Në një postim që e kisha në temën tjetër lidhur me librin (romanin) e I. Kelmendit "Atentatet", unë pata shprehur respektin tim për këtë hap të guximshëm të autorit.
Jo se romani (libri) ishte i një niveli të lartë artistik, por për vet tematikën e trajtuar, ky libër ka rëndësi shumë të madhe.
Dikush e akuzon I. Kelmendin se ai është vonuar me nxjerrjen e dëshmive lidhur me vrasjen e Vëllëzërve Gërvallaj dhe Kadri Zeka, e dikush tjetër e akuzon pse ai po i denoncon atentatorët e dyshuar. Kësaj pune i thonë "hip se t´vrava, zbrit se t´vrava"!

Nejse, sido që ta marrin të tjerët, Ibrahim Kemendi ka vendosur që të dal hapur me qendrimet e tij lidhur me ngjarjën tronditëse të atentatit mbi tre Dëshmorët e Kombit, dhe më ketë hapje të tij për publikun me siguri që do të daraviten dyshimet e hedhura poshtë e lartë nga njerz të painformuar dhe jokompetent, si dhe do tu ndalet turri i shpifjeve nga ana e armiqëve të maskuar të popullit shqiptar, të cilët ka 25 vite që vazhdojnë shpifjet më të ndyera kundër atdhetarëve shqiptar, në këtë vazhdë edhe kundër shokëve të idealit të Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës.

Në këtë temë ne patëm rastin e mirë që të lexojmë dhe njihemi me shumë pyetje të pjestarëve të forumit, si dhe përgjigjet e Ibrahim Kelmendit.
Gjithashtu në këtë temë ka edhe shumë komente rreth librit, si ato që tentojnë të hedhin dritë mbi ngjarjen, si ato që si qellim kanë

insinuatat negative të një grupi njerzish, të cilët nuk lënë rast pa hulumtuar për gjetjen e elementëve diskredituese të veprimtarëve politik të çeshtjës kombëtare, duke mos i kursyer as Jusufin, Bardhin e Kadriun me shokë.

Në bazë të përgjigjeve dhe komenteve të deritanishme të Ibrahim kelmendit, shihet se ai nuk ka qenë lexues i këtij forumi, ndaj dhe përgjigjet e tij janë jo subjektive (pa paragjykime për ata që pyesin), çka i jep kuptim dhe paanshmëëri pozitive këtij dialogu.
Gjithashtu Ibrahim kelmendi mund të lavdërohet për elasticitetin (diplomacinë) e tij në përgjigje, me çka ka arritur që deri diku ta fitoj simpatinë e disa, ti quaj ashtu, kundërshtarëve politik të tij.

Mbase u zgjata pak në shprehjen e mendimeve të lartëshenuara, dhe sigurisht që Ibrahim Kelmendi do të më radhis edhe mua në ata që i kanë "suret e gjata", siq i thoshte ai një pjesmarrësi tjetër në këtë dialog.
Por unë e pashë të arsyeshme që fillimsht ta shprehu opinionin tim lidhur me ecurinë e deritanishme të kësaj teme, në mënyrë që ato pyetje që do t´ia shtroj I. Kelmendit, ai mos ti keqkuptoj.

Si gjithë të tjerët, edhe unë e kam mendimet e mija subjektive lidhur me romanin "Atentatet".

E thëmë që në këtë postim se mendimet dhe opinionet e mija që do ti sjell në vazhdim nuk janë thjeshtë mendime të nxitura nga çasti, apo nga logjika e shëndoshë e një lexuesi, por këto mendime i kam të formuara qysh para se I. Kelmendi ta nxjerr në dritë romanin "Atentatet".

Unë nuk kam qenë pjesmarrës i angazhimit të drejtpërdrejtë në aktivitetin e organizimit atdhetar të shqiptarëve në diasporë, ndaj dhe pavarësishtë mendimeve të mija personale, unë nuk marr përsipër ti kontestoj ato që i thotë autori i romanit.
Por refleksionet e çdo veprimi të grupeve, organizatave dhe individëve me peshë në organizimin politik të viteve për të cilat rrëfen I. Kelmendi në romanin e tij, në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë pasur peshën dhe ndikimin e tyre edhe në organizimin e individëve, grupeve dhe organizatave atdhetare të rezistencës së organizuar për çlirim në Kosovë.

Për të mos u zgjatur më tepër, në këtë postim unë do ti shtroj disa pyetje I. Kelmendit.
Nese më lejohet, këto pyetje do ti bëjë në formë të komentit, dhe nese dëshiron Ibrahim të më përgjigjet, atëherë do ti jam mirnjohës.

Në roman e tij "Atentatet" I. Kelmendi ka si personazh edhe një studente gjermane me emrin Renata dhe disa student tjerë të Universitetit të Bochumit, me të cilët ai zhvillon dialogje të shumta lidhur me aktivitetin e tij politik për zgjidhjen e çeshtjës kombëtare shqiptare, si dhe dialogje për politikën ndërkombëtare në përgjithësi, politikë e cila kishte refleksione edhe për çeshtjën e pazgjidhur shqiptare.

Këto "dialogje" me Renatën dhe të tjerët Ibrahimit i japin hapsirën e mjaftueshme për ti shprehur mendimet e tij politike, hapsirë kjo që me siguri do ti mungonte po ta kishte shkruar librin e tij si libër historik, siq i preferojnë disa kritik të tij.

Unë kam vërejtur se në "dialogjet" e tij me gjermanët (edhe me disa bashkveprimtar të tij) I. Kelmendi flet (shkruan) me gjuhën dhe botkuptimet e sotshme politike, dhe jo me gjuhën dhe botkuptimet politike të cilat kanë qenë atëherë aktuale.

I. Kelmendi në roman e tij na del si një demokrat/djathtist i thekur, si një antikomunist e antienverist i madh, të cilit do ja kishin lakmi edhe "antikomunistët" dhe "antienveristët" më të mëdhënjë të ditëve të sotshme!!!
I. Kelmendi qysh atëherë (mes viteve 1975-1982) e paska predikuar "demokracinë" dhe "pluralizmin" politik, por ja që ne që vepronim në Kosovë nuk e paskemi ditur!!!

Sa për anarki, dekonspirim dhe jodisciplinë në Frontin e Kuq Popullor, këtë gjë mund ta predikoj e ta thotë sa të doj I. Kelmendi. Edhe ashtu ai asgjë konkrete nuk ka skjaruar në roman lidhur me organizimin e kësaj organizate atdhetare, së cilës organizatë vet i ka prirë deri në shuarjën e saj.

Por unë nuk e kuptoj se çka e shtynë I. Kelmendin të paraqitet, siq thotë populli, më "katolik se papa", kur dihet se në atë kohë edhe në Gjermani kishte rryma, organizata dhe parti të forta politike me orjentime të majta ideologjike, me të cilat I. Kelmendi në roman thotë kishte kontakte, por të cilët i "sfidonte".
Pastaj, nese me këto "përbetime" në demokraci e pluralizëm I. Kelmendi ka si objektiv të fitoj simpatinë e kundërshtarëve të tij politik, besoj se edhe ai e din se kot e ka, se këtij objektivi kurr nuk do ja arrij.
Edhe sikur I. Kelmendi të digjet para titistëve shqipfolës (të cilët sot përpiqen të shiten si demokrat e djathtist), ata nuk do ti besojnë se ai një ditë mund ti takoj "stanit" të tyre.

I. Kelmendi në roman i "rrëfen" edhe disa konflikte me përfaqësuesit e ambasadave shqiptare në Vjenë hde gjetke në shtetet e Europës, dhe më këtë "dëshmon" se sa trim dhe antikomunist ka qenë.
Dihet se ambasadat e shteteve të ndryshme kanë autonomi dhe imunitet, ndaj dhe po të sulmohet fizikisht ndonjë punonjës i tyre brënda objektit të konsullatës (ambasadës), atëherë sulmuesi mund të ka edhe reperkusione.
Por mbase perfaqësuesit e ambasadës shqiptare në Vjenë e kanë toleruar I. Kelmendin, kuptohet duke pasur parasysh se ata nuk kanë dëshiruar diskreditimin e një bashkëkombasi të tyre nga Kosova!
Unë dua ti besoj I. Kelmendit në rrefimin e tij lidhur me konfliktet e tij fizike me personelin e ambasadës shqiptare në Vjenë.
Mirëpo, nese I. Kelmendi me këtë "rrëfim" përpiqet që ta sanoj akuzën se gjoja ai ishte bashkpunëtor i Sigurimit të Shqipërisë, atëherë ai gabon rënd.
Unë mendoj se edhe nese I. Kelmendi do të kishte qenë vërtetë bashkpunëtor i Sigurimit shqiptar, kjo gjë nuk do ishte aspak diskredituese, sepse në fund të fundit ai shtetit dhe piopullit shqiptar do ti sherbente.

Objektivi tjetër i romanit "Atentatet", ku si personazh është Renata (edhe Marta), unë mendoj se I. Kelmendit i ka "sherbyer" edhe për diçka tjetër.

Dihet se kundër I. Kelmendit ka pasur akuza dhe shpifje nga më të ndryshmet. Atë e kanë akuzuar si; "spiun i UDB-së", "bashkpunëtor i Sigurimit të Shtetit shqiptar", "anarkist", "i pa diciplinuar", herë "enverist", e herë "antienverist", "don zhuan", "i pamoralshëm", e tjera e tjera.

Lidhur me akuzat e lartëshenuar I. Kelmendi është përpjekur që në një mënyrë ose tjetër, në roman të shpjegohet.
Unë kësaj radhe do të fokusohem tek njëra ndër akuzat për gjoja "amoralitetin" e tij, akuzë skandaloze, të cilës unë pesonalisht kurr nuk i kam besuar.

I. Kelmendi në roman e shfrytzon personazhin e Renatës, e cila vazhdimisht i ofron dashurinë e saj, por ky në asnjë mënyrë nuk pranon të "pushtohet" nga ndjenjat, apo siq lenë të kuptohet ai në roman; nga "epshet" e natyrshme të një të riu në moshën e pjekurisë.

Me këtë "dëshmi" Ibrahim Kelmendi sikur përpiqet që ta neutralizoj deri diku opinionin e keq kundër tij, me arsyetimin se; "po të ishte I. Kelmendi i pamoralshëm, atëherë ai do ti kishte shfrytëzuar ofertat e femrave gjermane, dhe nuk do të kishte pasur nevojë keqpërdorimin e besimit të shokëve të tij shqiptar".

I nderuari I. Kelmendi, pasi që e dij se ti nuk hidhrohesh (të drejtohem me "ti", sepse kështu i jemi drejtuar edhe më parë njëri tjetrit), dhe këtë e ke dëshmuar me vepër, atëherë desha që me këtë shkrim të të provokoj pak. Mbase do të "rrëfehesh" edhe në këto dy pyetje që ti shtrova unë, pa çka se, siq e thashë edhe në fillim, e dij se Ti edhe mua do më fusësh në ata që i kanë "suret e gjata".
Por mos harro se ti ke shkruar një roman, dhe romani gjithmonë i ka "suret e gjata", apo jo?
Të përshendes,
Shpetimi
P.S.
Mbase nuk është mirë që I. Kelmendit ti shtrohen pyetje jashtë objektivit të romanit "Atentatet", sepse ashtu do humbet kohë, e si pasojë edhe tema do ta humbte kuptimin.
Nese I. Kelmandi e sheh të nevojshme që tu përgjigjet njerzve edhe në pyetjet rreth "Fondit Vendlindja Thërret", organizimit të LPK-së dhe UÇK-së, apo çfardo teme tjetër, atëherë do ishte mirë që për këtë qellim të hapet një ose shumë tema të veçanta.

[ Ky afishim u ndryshua nga: Shpetimi më 2007-03-26 17:26 ]

profile | edit | quote

**lorik**

**Anëtar që nga:** 19.01.2005
**Afishime:** 144

**Afishuar me:** 26.03.2007 17:17

Përshëndetje z.Ibrahim Kelmendi ,
Së pari Ju përgëzoj për romanin tuaj dhe vullnetin që keni të ballafaqoheni me energjinë pozitive dhe atë negative të "forumistave" këtu!
Romanin kam filluar ta lexoj dhe kam arritur ne faqen 74 (pdf). Nuk jam ndonjë lexues i pasionuar i romaneve pasi që edhe drejtimi që kam kryer është i natyrës teknike, por së paku ua kam preferuar edhe farefisit ose njerëzve që i njohë ta lexojnë(pra një kontribut i vogël i imi). Bindja ime (joprofesionale) është se romani duhet lexuar!
...Ajo çka më shtyri më shumë të shkruaj në këtë temë është ky konstatim i Juaji:

> Quote:
>
> Sidomos luftetarët duhet të shqetësohen për vilat e liderucëve, të cilët na u shndërruan në profiterë të Luftës...

Edhe unë habitem pse lejohet popullata e jonë të manipulohet nga këta "politikanë" ose ma mirë të themi pseudopolitikanë.
Deri tash këta "politikanë" janë mshehur pas fjaës "Pavarësi", edhe pse dihet se shumë pak kanë bërë për të (nga dija ose ma shumë nga mosdija).
A është koha e duhur që kjo klasë Politike (sidomos këta pseudopolitikanë) të largohen nga skena Politike, pa marrë parasyshë

bindjet e tyre partiake "e majtë" ose "e djathtë"? (edhe pse këto shprehje besoj se nuk vlejnë në realitetin tonë politik!)

profile | edit | quote

**Delegati**

**Afishuar me:** 26.03.2007 18:13

**Anëtar që nga:** 12.05.2006
**Afishime:** 548

Quote:

> Shqipëruesi afishoj me 2007-03-26 12:24 :
> I nderuar z. Kelmendi,
>
> - Edhe pse nuk pajtohem plotësisht me përgjegjen tuaj,prapëseprapë më mbetet të ju përgëzoj për qëndrimin tuaj dhe kulturën e bisedës.
> Ju i patë këto "Rojat e Mjegullës" në forum(të personifikuara në disa forumistë,si Delegati,Hotiani apo edhe ndonjë tjetër),që kërkojnë nga ne, të ju thurrim himne për heroizmin dhe patriotizmin tuaj dhe që kundërshtojnë rreptësisht, cfarëdo pyetje ose qoftë dyshim, në ju apo tek luftëtarët e lirisë.
> E kam thënë cdo herë dhe vazhdoj ta them, se nuk mund të ketë njeri të paprekshëm, sepse ajo detyrimisht con drejt diktaturave të ardhshme,e ne shqiptarët më së miri provuam,cdo të thotë DIKTATURË.
> Mënyra më e mirë është,të mos ketë temë tabu,të mos ketë "të paprekshëm", se vetëm dhe vetëm kështu,nxirret në dritë, e vërteta.
> Unë të hetoj ty,por ti nuk ke të drejtë të më hetosh mua,këto janë disa nga "logjikat" këtu.
> Kurse pyetja ime e ardhshme, ka të bëjë me Kadri Manin (Osmanin) dhe "fajin e tij", me rastin e vrasjes makabre, të Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës?
> Edhe njëherë,përshëndetje dhe kalofshi një ditë të mbarë !
> Shëndet
> Shqipëruesi

Shqipëruesi i qëllimeve të errta,
Nuk mund të më quajsh mua roje të mjegullës sepse para meje ëshë horizont i kthjellët sikur loti, trupi im është i qelqit, pra i tejdukshëm.
Qëllimet e errëta tuat po duken me faktin që bëre këtë pyetje, që unë e quaj më shumë pyetje nga spiuni sesa për informim.

Si mund ta bësh këtë pyetje???!!!:

Kurse pyetja ime e ardhshme, ka të bëjë me Kadri Manin (Osmanin) dhe "fajin e tij", me rastin e vrasjes makabre, të Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës?

Kur një njeri bënë këtë pyetje atëherë duket hapur se dëshiron t'i fus në ngatërresë, deri në hasmëri e armiqësi, dy familje të njohura në Kosovë.
Unë familjen Malaj i kam timen, pra edhe ata janë Kastrat të të njejtit gjak.
Kardi Osmanin e njoh moti, ia dij vuajtjet dhe përjetimet.
Asnjëra nga këto familje nuk bënë të mendojnë keq për njëra tjetrën.
Dyshimi dhe pyetja jote padyshim se i futë në mendime për të reflektuar negativisht.
Këtë punë që bënë ti e bënë edhe argati i armikut.

profile | edit | quote

**piloti**

**Anëtar që nga:** 22.02.2002
**Afishime:** 1439
**Vendbanimi:** Gjermani

**Afishuar me:** 26.03.2007 18:38

I nderuari z.Kelmendi,
Një pasëdite të vitit 1987 në Skenderaj Plaku i Drenices Heroi Kombëtar Shaban Jashari në stacion te autobusve fshehurazi nga "qyrku" Palltoja e trashë nxori gazeten "Zëri I Kosovës" , dhe filloi të na rrefei (ishim dy-tre persona ne shoqeri ) per peerpjekjet qe po behen per tu organizuar një rezistenc kunder okupatorit......., pyetja:
-Keni rastësisht dijeni se a ishte xha Shaban Jashari atëbotë anëtar i LPK-së ?
Faleminderit
PILOTI

profile | edit | quote

**lu-gu**

**Anëtar që nga:** 18.07.2006
**Afishime:** 10
**Vendbanimi:** Gjermani

**Afishuar me:** 26.03.2007 19:05

[quote]
Nositi afishoj me 2007-03-25 17:35
*Trixi,*
*Nese nuk je i kenaqur me pergjigjen, kjo nuk do te thote qe z.Ibrahim Kelmendit t`i drejtohesh me me nyjet dydjinore* **I/E** !
*Akoma ti nuk beson se bashkebiseduesi juaj eshte* **I nderuari z.Ibrahim Kelmendi** *, apo keshtu deshiron qe qellimshem dhe ne menyren me cinike te vesh ne tallje sinqeritetin e bshkebiseduesit ?!*
*E ke marre pergjigjen dhe e mira e se mires do te ishte qe fare te mos dukesh kendejpari, sepse ti nuk ke kapacitet per nenforumin e Politikes. Ike atje ne nenforumet ku e gjen veten me nivelin tend, perndryshe nuk toleroj ta perbaltesh mbarevajtjen e temes dhe sinqeritetin e bashkebiseduesit !!!*
*I kerkoj falje z.Kelmendi dhe te gjithe bashkebiseduesve per kete nderhyrje, ndersa nga ti Trixi nuk dua asnje koment !*
*Nositi*

=================================================

Z.Nositi,
e paske marr punen si me vrull duke iu drejtuar Trix-it, shume ashper . Ti je vetem nje adminsitrator ketu ne forum. Ti nuk je ketu as avokati i z. Kelmendi e as psikolog qe tu caktosh njerzve diagnozat e kapacitetit intelektual , nese afishimet e tyre nuk te pelqejn. Meso edhe ti pak nga i nderuari Z.Kelmendi qe aq qete i pergjigjet qdo lloj pyetje , edhepse jam i sigurt qe nuk i pelqen secila pyetje.
Per ta provuar diken se kush eshte e sa vlene, ne popull thuhet "jepja shtagen per ta njoft dikend", e ti as me nje gjysem "shtage " po si nje "koqobash" kercnon me largim te antarit te forumit pse ty nuk te pelqen afishimi.
Le te ma falin te tjeret per kete nderhyrje e qe eshte jashte teme.
Sa per ty Nositi, pune e madhe qka mendon.

==========

*Zoteri,*
*Kur keni shprehur deshiren te regjistroheni ne Kosova.de, ju keni pranuar rregullat e parapara. Ne Stafi jemi ata qe kujdesemi t`i mbrojme ato rregulla. Dhe, duke qene keshtu edhe kemi te drejten dhe obligimin te nderhyjme ne raste te caktuara. Pra, puna e rregullave eshte shume e qarte (besoj edhe per ty), por per mua mbetet e paqarte se perse tani nofka lu-gu luan lojen e avokatit te trixit apo shkruan me doren e tij. E per me keq edhe synon te nxit polemika qe se kane vendin ketu. Sidoqofte, te sugjeroj qe per çdo pakenaqesi te kesaj natyre tanime e tutje t`i*

*drejtohesh Nositit permes boksit te mesazheve private. Aty eshte vendi per te tilla mosmarrevshje, e jo ketu t`ia zbehim rrjedhen temes!*
*flm. ne mirekuptim,*
*Nositi*
*p.s. trixi tashme eshte kthyer ne Forum !*

[ Ky afishim u ndryshua nga: Nositi më 2007-03-26 20:29 ]

**trixi**

**Anëtar që nga:** 18.08.2006
**Afishime:** 1935
**Vendbanimi:** Gjermani-Dardani

**Afishuar me:** 26.03.2007 21:09

Ju falenderoj per rikthimin tim ne Forumin Kosova.de,nese dikush ka mendu se me keto masa te dhunshme do te arrin ta "edukoj","permirsoj"Trixin,atehere ka gabuar sepse ne kohen dhe moshen time nuk mund te beje dredhime per hire te askujt dhe as edhe nje here !!
Ju mund te me perjashtoni dhe largoni kur te doni ,por jo edhe te me detyroni te shkruaj si te doni ju ,per deshiren tuaj !!!!!!!
Tung,edhe kerkoj falje per reagimin tim keshtu ne kete teme,sepse Demokracin njeriu duhet ta ndien ne JETE e jo ne leter.....

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 26.03.2007 21:21

I nderuar Z. “Shpetimi” !
(Afishuar me: 26.03.2007 16:54)
Më lejoni të shpreh konsideratën time ndaj angazhimit Tuaj përkushtues dhe të vëmendshëm. Do kishte qenë më e produktive, sikur Ju të dekonspironit veten dhe të mos e tretnit në anonimitet gjithë këtë angazhim. Them që nuk do “digjeshit”, pos që do ju digjej ky pseudonim. Ju sërish mund të hapni mail të ri, me pseudonim të ri. Ndoshta do parapelqeni ta bëni këtë në duke më shkruar në mail-adresën time.
Tani po merrem me paraqitjen Tuaj.

JU: Në një postim që e kisha në temën tjetër lidhur me librin (romanin) e I. Kelmendit "Atentatet", unë pata shprehur respektin tim për këtë hap të guximshëm të autorit.

Unë: Ju falënderoj dhe ju shpreh mirënjohje.

JU: Jo se romani (libri) ishte i një niveli të lartë artistik, por për vet tematikën e trajtuar, ky libër ka rëndësi shumë të madhe. Dikush e akuzon I. Kelmendin se ai është vonuar me nxjerrjen e dëshmive lidhur me vrasjen e Vëllëzërve Gërvallaj dhe Kadri Zeka, e dikush tjetër e akuzon pse ai po i denoncon atentatorët e dyshuar.
Kësaj pune i thonë "hip se t´vrava, zbrit se t´vrava"!

Unë: Do i mirëprisja vërejtjet Tuaja konkrete për nivelin artistik, pasi do më ndihmonit në ngritjen time përkatëse.

JU: Nejse, sido që ta marrin të tjerët, Ibrahim Kemendi ka vendosur që të dal hapur me qendrimet e tij lidhur me ngjarjën tronditëse të atentatit mbi tre Dëshmorët e Kombit, dhe më ketë hapje të tij për publikun me siguri që do të daraviten dyshimet e hedhura poshtë e lartë nga njerz të painformuar dhe jokompetent, si dhe do tu ndalet turri i shpifjeve nga ana e armiqëve të maskuar të popullit shqiptar, të cilët ka 25 vite që vazhdojnë shpifjet më të ndyera kundër atdhetarëve shqiptar, në këtë vazhdë edhe kundër shokëve të idealit të Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës.

Unë: Besoj, për publikun ka qenë e ditur se atentatin e ka komanduar

UDB-ja dhe ndodhta gjetja e dorasëve është me vlerë domëthënëse, por e dorës se dytë. Sa për dyshimet dhe spekulimet, UDB-ja ka qenë usta për këtë punë. Të vjen keq për ata që janë viktimizuar si rrjedhojë e paditurisë se tyre për t'u mbrojtur nga lufta speciale e UDB/së.

JU: Në këtë temë ne patëm rastin e mirë që të lexojmë dhe njihemi me shumë pyetje të pjestarëve të forumit, si dhe përgjigjet e Ibrahim Kelmendit.
Gjithashtu në këtë temë ka edhe shumë komente rreth librit, si ato që tentojnë të hedhin dritë mbi ngjarjen, si ato që si qellim kanë insinuatat negative të një grupi njerzish, të cilët nuk lënë rast pa hulumtuar për gjetjen e elementëve diskredituese të veprimtarëve politik të çeshtjës kombëtare, duke mos i kursyer as Jusufin, Bardhin e Kadriun me shokë.

Unë: Mos pandehni se UDB-ja dhe UDB-ashët kanë nderpreë luftën e tyre speciale. Edhe viktima të tyre, fatkeqësisht, do ketë edhe për shumë kohë.

JU: Në bazë të përgjigjeve dhe komenteve të deritanishme të Ibrahim kelmendit, shihet se ai nuk ka qenë lexues i këtij forumi, ndaj dhe përgjigjet e tij janë jo subjektive (pa paragjykime për ata që pyesin), çka i jep kuptim dhe paanshmëëri pozitive këtij dialogu.
Gjithashtu Ibrahim kelmendi mund të lavdërohet për elasticitetin (diplomacinë) e tij në përgjigje, me çka ka arritur që deri diku ta fitoj simpatinë e disa, ti quaj ashtu, kundërshtarëve politik të tij.

Unë: Me keqardhje ju bëjë me dije, se deri para katër ditësh nuk ditur për këtë forum e për këtë faqe. Dhe prandaj nuk i njoh mendimet e "forumistëve". Por, edhe po t'i njihja, nuk do t'i paragjykoja. E kam shpreh edhe një herë, unë nuk i urrej as edhe UDB-ashët dhe informatorët e tyre (gjithësejt mbi 30 mijë në Kosovë, siç kam lexuar ose dëgjuar), përderi sa ata kanë u janë përmbajtur ligjeve të Kohës. Sa i përketë elasticitetit (diplomacisë), është përvojë jetësore. Edhe gomari po të kish qenë i angazhuar për mbi 30 vjet, mbase do kishte mësuar se si duhej të sillej...

JU: Mbase u zgjata pak në shprehjen e mendimeve të lartëshenuara, dhe sigurisht që Ibrahim Kelmendi do të më radhis edhe mua në ata që i kanë "suret e gjata", siq i thoshte ai një pjesmarrësi tjetër në këtë dialog.
Por unë e pashë të arsyeshme që fillimsht ta shprehu opinionin tim lidhur me ecurinë e deritanishme të kësaj teme, në mënyrë që ato pyetje që do t´ia shtroj I. Kelmendit, ai mos ti keqkuptoj.

Unë: Edhe "suret e gjata" i mirëkuptoj, sepse "forumistet" nuk kanë kohë që të përmbledhin mendimet e tyre në "sure të shkurta". Pastaj, ndonjëri nuk ndjen përgjegjësi të bollshme për fjalën e thënës, sepse është i fshehur pas pseudonimit. Të shpresojmë se "ushtrimet" e shpeshta do t'i aftësojnë e avancojnë, për të bërë debat të kulturuar. Gjermanët thonë: "Die Übungen machen Meister" („ushtrimet të bëjnë mjeshtër").

JU: Si gjithë të tjerët, edhe unë e kam mendimet e mija subjektive lidhur me romanin "Atentatet".

Unë: Dhe nuk ka si të ndodh ndryshe, pos të kesh mendime subjektive, gjegjësisht vetanake.

JU: E thëmë që në këtë postim se mendimet dhe opinionet e mija që do ti sjell në vazhdim nuk janë thjeshtë mendime të nxitura nga çasti, apo nga logjika e shëndoshë e një lexuesi, por këto mendime i kam të

formuara qysh para se I. Kelmendi ta nxjerr në dritë romanin "Atentatet".

Unë: Domëthënë romani nuk ju paska ndihmuar dhe nuk po kuptoj, se po shprehni mendime për romanin, të formuluara para se të botohet romani (se mos jeni Haker dhe keni elxuar manuskriptin, që kur po e shkruaja në kompjuter romanin – hahaha).

JU: Unë nuk kam qenë pjesmarrës i angazhimit të drejtpërdrejtë në aktivitetin e organizimit atdhetar të shqiptarëve në diasporë, ndaj dhe pavarësishtë mendimeve të mija personale, unë nuk marr përsipër ti kontestoj ato që i thotë autori i romanit.

Unë: Romani bënë fjalë për jetën dhe veprimtarinë e emigracionit dhe jo të diasporës. Nëse do shkruaj diç për arbreshët në Itali, Greqi, Zarë, etj., atëherë do them se kam shkruar për diasporën.

JU: Por refleksionet e çdo veprimi të grupeve, organizatave dhe individëve me peshë në organizimin politik të viteve për të cilat rrëfen I. Kelmendi në romanin e tij, në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë pasur peshën dhe ndikimin e tyre edhe në organizimin e individëve, grupeve dhe organizatave atdhetare të rezistencës së organizuar për çlirim në Kosovë.

Unë: Kur të dihet gjithë e vërteta, mbase do e thekësoni rrolin e emigracionit, i cili për momentin po injorohet në Kosovë.

JU: Për të mos u zgjatur më tepër, në këtë postim unë do ti shtroj disa pyetje I. Kelmendit.
Nese më lejohet, këto pyetje do ti bëjë në formë të komentit, dhe nese dëshiron Ibrahim të më përgjigjet, atëherë do ti jam mirnjohës.

Unë: Për këtë jam paraqitur dhe po e bëjë me qejf, për çka ju jam mirënjohës që po tregoni interesim për këtë tematik.

JU: Në roman e tij "Atentatet" I. Kelmendi ka si personazh edhe një studente gjermane me emrin Renata dhe disa student tjerë të Universitetit të Bochumit, me të cilët ai zhvillon dialogje të shumta lidhur me aktivitetin e tij politik për zgjidhjen e çeshtjës kombëtare shqiptare, si dhe dialogje për politikën ndërkombëtare në përgjithësi, politikë e cila kishte refleksione edhe për çeshtjën e pazgjidhur shqiptare.
Këto "dialogje" me Renatën dhe të tjerët Ibrahimit i japin hapsirën e mjaftueshme për ti shprehur mendimet e tij politike, hapsirë kjo që me siguri do ti mungonte po ta kishte shkruar librin e tij si libër historik, siq i preferojnë disa kritik të tij.
Unë kam vërejtur se në "dialogjet" e tij me gjermanët (edhe me disa bashkveprimtar të tij) I. Kelmendi flet (shkruan) me gjuhën dhe botkuptimet e sotshme politike, dhe jo me gjuhën dhe botkuptimet politike të cilat kanë qenë atëherë aktuale.

Unë: E para, kam dëshiruar të rrefej për jetën studentore gjermane të kohës, me mendim se është me interes për lexuesit në vendlindje që të kenë të tillë informacione. Edhe sot e kësaj dite kam vërejtur hallet e studentëve e nxenësve në vendlindje, për t'u veshur me modë (janë "viktimë" e industrisë se modës), kurse në Gjermani ata nuk qajnë fortë b... për t'u veshur me rroba të modës. Dhe duke u "viktimizua" pas mode, viktimizohet edhe koha dhe kultura e leximit, nuk të mbeten të holla për të blerë libra dhe për t'u ushqyer më mirë, ngele i painformuar dhe pa profesionalizim më cilësor, etj.
E dyta, dialogjet duhet të kenë qenë shumë më të zgjeruara dhe më të thella dhe nuk jam merakosur për "modën" aktuale të demokracisë, e cila po më neverit, siç po më neverisin disa bashkëveprimtarë, të

cilët, për hirë të kësaj "mode" (trendi), bien copa të fshehin bindjet e tyre në të kaluarën. Po shpresoj se ky roman ka nxjerrë besnikërisht në dritë pikëpamjet, mendimet, organizimet e atëhershme.

JU: I. Kelmendi në roman e tij na del si një demokrat/djathtist i thekur, si një antikomunist e antienverist i madh, të cilit do ja kishin lakmi edhe "antikomunistët" dhe "antienveristët" më të mëdhënjë të ditëve të sotshme!!!

Unë: Mbase është si vlerësoni Ju, por unë edhe sot jam kundër djathëtistëve dhe antikomunistëve, për të mos shpreh të vërtetën, se po të isha i angazhuar politikisht, do u shpallja luftë politike. Por edhe "demokracia" e trendit aktual më neverit njësoj, si djathëtizmi dhe antikomunizmi.
Qysh në vitin 1978, kur mbarova se lexuari veprat e Enver Hoxhës, dhe meqë isha në vit të studimeve në Ruhr-Universität në Bochum, fillova të gjykojë më realisht, të mos ngelem „enverist" vetëm pse dëshiroja të isha anti-titist.
Natyrisht se duhet të kem bërë përparime në gjykime ideo-politike, dhe edhe më herë nuk kam gjykuar zi/bardh në këtë fushë, as për Enverin, As për Mahmut Bakallin dhe titistet e Kosovës, etj. Shpresoj se këtë të drejtë nuk ma përkufizoni dhe nuk duhet ta kenë disa që po dëshirojnë ta monopoizojnë – të kenë vetëm ata të drejtë në ndryshime të përparuar.
Për fund, që ta dini, në ato dialogje sikur ka mjaft materie, që shpjegojnë qëndrimin tim kritik ndaj demokracisë perëndimore, atëherë dhe tani.

JU: I. Kelmendi qysh atëherë (mes viteve 1975-1982) e paska predikuar "demokracinë" dhe "pluralizmin" politik, por ja që ne që vepronim në Kosovë nuk e paskemi ditur!!!

Unë: Meqë studjoja edhe filozofi në Gjermani, nuk kisha si të mos i dija. Por as atëherë dhe as tani nuk e ndiejë në Gjermani urrejtjen për klasikë të marksizmit, siç urrehen ata nga të "reformuarit" në Kosovë. Nuk e di çfarë keni ditur Ju atëherë në Kosovë, por mundësitë nuk kanë qenë edhe aq të mëdha që të sigurohen njohuri përkatëse, aq më pak kur ishte e ndaluar, që ato pak njohuri teorike të praktikohen (meqë mbretëronte sistem monist).

JU: Sa për anarki, dekonspirim dhe jodisciplinë në Frontin e Kuq Popullor, këtë gjë mund ta predikoj e ta thotë sa të doj I. Kelmendi. Edhe ashtu ai asgjë konkrete nuk ka skjaruar në roman lidhur me organizimin e kësaj organizate atdhetare, së cilës organizatë vet i ka prirë deri në shuarjën e saj.

Unë: Për aq sa më është dukur e nevojshme, them që kam sjellë shpjegime edhe për FRONTIN E KUQ POPULLOR. Më vjen keq nëse nuk ju mjaftojnë Juve, për të formuar mendime më konkrete.

JU: Por unë nuk e kuptoj se çka e shtynë I. Kelmendin të paraqitet, siq thotë populli, më "katolik se papa", kur dihet se në atë kohë edhe në Gjermani kishte rryma, organizata dhe parti të forta politike me orjentime të majta ideologjike, me të cilat I. Kelmendi në roman thotë kishte kontakte, por të cilët i "sfidonte".

Unë: Them se nuk duhet të qenë insistim i domosdoshëm, por përshkrim e parqitje e të vërtetës. Pastaj, ne atëherë nuk kishim si synim në vete të bënim luftë ideo-politike për pushtet në Gjermani e gjetiu, por të përpiqemi të organizojmë veprimtarinë tonë çlirimtare dhe prandaj me ndonjë parti (koministe) e organizatë ekstremiste nuk kishim si të bashkëpunonim, pasi ata kërkonin nga ne që të "shkriheshim" në ato subjekte për të bërë "luftën e klasave" në këto

vende...

JU: Pastaj, nese me këto "përbetime" në demokraci e pluralizëm I. Kelmendi ka si objektiv të fitoj simpatinë e kundërshtarëve të tij politik, besoj se edhe ai e din se kot e ka, se këtij objektivi kurr nuk do ja arrij.

Unë: Po të isha i organizuar në ndonjë parti në Kosovë dhe të bëja luftë për pushtet, sigurisht që do përzgjidhja taktikën efektive për t'ia arritur qëllimit.

JU: Edhe sikur I. Kelmendi të digjet para titistëve shqipfolës (të cilët sot përpiqen të shiten si demokrat e djathtist), ata nuk do ti besojnë se ai një ditë mund ti takoj "stanit" të tyre.

Unë: Po shpresoj se që kur është legalizuar pluralizmi politik edhe në Jugosllavi kanë kaluar vite të bollshme, që të mos bëhen kësi kategorizimësh, pasi kjo mënyrë e të menduarit dëmton edhe shëndetin shoqëror.
Nuk jam i interesuar t'i shkoj askujt në "stan", pasi e kam shtëpinë time.

JU: I. Kelmendi në roman i "rrëfen" edhe disa konflikte me përfaqësuesit e ambasadave shqiptare në Vjenë hde gjetke në shtetet e Europës, dhe më këtë "dëshmon" se sa trim dhe antikomunist ka qenë.
Dihet se ambasadat e shteteve të ndryshme kanë autonomi dhe imunitet, ndaj dhe po të sulmohet fizikisht ndonjë punonjës i tyre brënda objektit të konsullatës (ambasadës), atëherë sulmuesi mund të ka edhe reperkusione.
Por mbase perfaqësuesit e ambasadës shqiptare në Vjenë e kanë toleruar I. Kelmendin, kuptohet duke pasur parasysh se ata nuk kanë dëshiruar diskreditimin e një bashkëkombasi të tyre nga Kosova!

Unë: Në roman janë të përshkruara ngjarjet. Ju keni të drejtë të mos besoni dhe t'i komentoni si të dëshironi.

JU: Unë dua ti besoj I. Kelmendit në rrefimin e tij lidhur me konfliktet e tij fizike me personelin e ambasadës shqiptare në Vjenë.
Mirëpo, nese I. Kelmendi me këtë "rrëfim" përpiqet që ta sanoj akuzën se gjoja ai ishte bashkpunëtor i Sigurimit të Shqipërisë, atëherë ai gabon rënd.
Unë mendoj se edhe nese I. Kelmendi do të kishte qenë vërtetë bashkpunëtor i Sigurimit shqiptar, kjo gjë nuk do ishte aspak diskredituese, sepse në fund të fundit ai shtetit dhe piopullit shqiptar do ti sherbente.

Unë: Nuk më kanë shqetësuar akuzat, se gjoja jam bashkëpunëtor i Sigurimit, siç nuk më kanë shqetësuar akuzat shumë më të rënda se kjo, pasi shumë heret isha ndërgjegjësuar, se marrja me veprimtari çlirimtare i kishte brëndë edhe të tilla akuza. Unë dija të vërtetën dhe prandaj shqetësohesha vetëm kur më pengonin që të kem suksese.

JU:
Objektivi tjetër i romanit "Atentatet", ku si personazh është Renata (edhe Marta), unë mendoj se I. Kelmendit i ka "sherbyer" edhe për diçka tjetër.
Dihet se kundër I. Kelmendit ka pasur akuza dhe shpifje nga më të ndryshmet. Atë e kanë akuzuar si; "spiun i UDB-së", "bashkpunëtor i Sigurimit të Shtetit shqiptar", "anarkist", "i pa diciplinuar", herë "enverist", e herë "antienverist", "don zhuan", "i pamoralshëm", e tjera e tjera.

Lidhur me akuzat e lartëshenuar I. Kelmendi është përpjekur që në një mënyrë ose tjetër, në roman të shpjegohet.
Unë kësaj radhe do të fokusohem tek njëra ndër akuzat për gjoja "amoralitetin" e tij, akuzë skandaloze, të cilës unë pesonalisht kurr nuk i kam besuar.
I. Kelmendi në roman e shfrytzon personazhin e Renatës, e cila vazhdimisht i ofron dashurinë e saj, por ky në asnjë mënyrë nuk pranon të "pushtohet" nga ndjenjat, apo siq lenë të kuptohet ai në roman; nga "epshet" e natyrshme të një të riu në moshën e pjekurisë. Me këtë "dëshmi" Ibrahim Kelmendi sikur përpiqet që ta neutralizoj deri diku opinionin e keq kundër tij, me arsyetimin se; "po të ishte I. Kelmendi i pamoralshëm, atëherë ai do ti kishte shfrytëzuar ofertat e femrave gjermane, dhe nuk do të kishte pasur nevojë keqpërdorimin e besimit të shokëve të tij shqiptar".

Unë:
U përgjigja diç sa u përketë akuzave e shpifjeve. Ata i kam kuptuar si mjete të luftës speciale që më bënte UDB-ja. Sigurisht, më duhej të mbrohem, që të mos diskualifikohem si i mundur. Por, nuk do kishin mjaftuar mbrojtja me fjalë, sikur të mos isha i moralshëm edhe në sjellje.
Në vitin 1981 në Prizren e burgosin një bashkëveprimtar. Gjatë marrjes në pyetje, hetuesi i thotë (përifrazim i lirë): "Si e leni në shtëpi atë hamshor!? Ju zgjoheni heret të shkoni në punë dhe ai rrinë në banesa të jauaja me gruatë e juaja? A nuk ia keni frikën se mund t'ua shkerdhen...?" Bashëveprimtari i përgjigjet: "Meqë po angazhohet për të fituar Republikën, edhe mbi guan në gjetsha, do i thëmë punë e mbarë..." Hetuesi gjindoset dhe ia shton dozën e dajakut.
Po shpresoj se nuk kam nevojë të ua komentoj shembullin, se me cilën luftë të fëlliqur speciale janë përpjek të më luftojnë.
Ju e dini se bashkëveprimtaret atëherë nuk kanë mundur të lexojnë romanin e tanishëm, por ata i kanë nuhat e vlerësuar sjelljet e mia. Dhe do habiteni nëse e mësoni të vërtetën, se në qindra familje në emigracion kam pas strehë vëllazërore. Po të mos e kisha merituar, nuk do më mirëprisnin aq bujarisht, nuk do m'i lanin ndrresat bashkëveprimtarët, duke m'i ndërruar me ndrresa të burrave të tyre - shokëve që i kam dhe më kanë nderuar. Asnjëherë në Evropë P. Dhe në Amerikë nuk kam fjetur hoteleve, edhe pse vetëm një të tretën e kohës e kam kaluar në banesë time...

JU:
I nderuari I. Kelmendi, pasi që e dij se ti nuk hidhrohesh (të drejtohem me "ti", sepse kështu i jemi drejtuar edhe më parë njëri tjetrit), dhe këtë e ke dëshmuar me vepër, atëherë desha që me këtë shkrim të të provokoj pak. Mbase do të "rrëfehesh" edhe në këto dy pyetje që ti shtrova unë, pa çka se, siq e thashë edhe në fillim, e dij se Ti edhe mua do më fusësh në ata që i kanë "suret e gjata".
Por mos harro se ti ke shkruar një roman, dhe romani gjithmonë i ka "suret e gjata", apo jo?

Unë: Të gjitha po ua bëjë hallall, por që të më thuash se i jemi drejtuar njeri-tjetrit me "ti", këtë vështirë se do ta fal. Hiçni maskime me pseudonime. Mbase nuk jeni të informuar, se gjithandej është instaluar sistemi pluralist dhe pos ndërgjegjës suaj, nuk keni nga kush të frikësohen.
Për fund: Me gjasë e meritova një pauzë, prandaj ju uroj "forumizim" të këndshëm e relaksues.
Tung
Ibrahim_kelmendi@yahoo.de

profile | edit quote

**Mok**

**Afishuar me:** 26.03.2007 22:11

**Anëtar që nga:** 21.10.2005
**Afishime:** 78

Mok
Anëtar që nga: 21.10.2005
Afishime: 63
Afishuar me: 22.03.2007 14:58
Zoti kelmendi , a mendoni se keni me fituar diqka nga ky liber dhe sa keni planifikuar me fitu.
Përgjigjet Ibrahim Kelmendi: Me botimtë pare nuk kam fituar asgjë, pos respektit. Shtëpia botuese i ka shtypur 3.000 ekzemplarë, I ka shitur brënda dy javësh 2.200 copë nga 2,99 euro (bashk me gazetën FOCUS), mua në fund m'i ka dhënë 400 ekzemplarë (prej tyre 300 copë ua kam shpërndarë miqve. Tani i kam edhe 100 copë dhe kush është i interesuar, mund të porosit. Në Perëndim romani e ka çmimin 4,99 euro, ndërsa në Kosovë e kishte 2,99 euro.
Azem zogaj qe shet libra Para Grandit ne Prishtine me pat lan nje fjale kur e pyeta se si po shkon pazari?
Ai mu pergjigj keshtu:
Shyqyr zotit qe eshte kan Shaban Pluzha trim e luftar, Azem Bejta e Adem Jashari e Shum te tjere Trima se keta dhe kan Luftuar siq duhet e ma ne fund kan ra per LIRI, Ata kan Ra e tash shkrimtaret kush ma i pari turr e me shkrua Libra e Romana sa te duash , Fito ai e Fito Une qe po i shes. Kjo ishte puna e disa " Romansierve "

Përgjigjet Ibrahim Kelmendi: Z. Azem Zogaj ia kam dhënë 50 copë me çmim 2 euro libri. Atë e kam lutur të mos I shet më shtrejtë se 3 euro copën. Edhe 40 copa ua kam dhënë dy shitësve të hotel Grandi, me çmim gjithashtu 2 euro librin. Ndoshta po më kuptoni, se nuk e kam shkruar për të fituar me te, edhe pse nuk është e turpshme të jetosh nga shitja e librit.
Pershendes shum menyren si je pergjigjur.
Me duhet tju perkujtoj se ne vitin 1980 diku kah qershori rastesisht jemi takuar ne zyren e Bardhosh Gervalles ne LB
Aty me duket se nuk keni pasur nje pritje edhe aq te perzemert nga Bardhi por as edhe nga Jusufi sa kam mund me verejt une ne ate kohe.
Prandej kur e pyeta Jusufin pasi qe shkove ti se kush ishe TI, aj mu pergjigj : njani qe me ka lodhe me ate gazete, ma vone e mora vesh se ishte fjala per gazeten Bashkimi.
Ai mi pat dhan edhe disa numra te kesaj gazete dhe se bashku me shum te tjera gazeta e literatur per me i derguar ne Kosove.
Te gjitha i kom derguar disa here dhe kurr nuk kam ra ne kurth.
Kan ndegjua se shumica e atyre qe ju i keni ngarkuar kan arrit vetem deri ne kroaci ma se largu e aty ju ka ngel ashti ne fyt.
Nese nuk eshte ashtu trego e nese na binde neve ketu do te kerkoj falje publike.
[ Ky afishim u ndryshua nga: Mok më 2007-03-26 22:14 ]

profile | edit quote

**Apokalypse**

**Afishuar me:** 26.03.2007 22:56

**Anëtar që nga:** 24.01.2002
**Afishime:** 1451
**Vendbanimi:** Gjithesija

Ndryshuar
Rrufeja_123

[ Ky afishim u ndryshua nga: Rrufeja_123 më 2007-03-26 23:12 ]

profile | edit quote

**Qosi**

**Afishuar me:** 26.03.2007 22:56

**Anëtar që nga:** 22.02.2007
**Afishime:** 29

Z. Qosi,
Ndryshuar
Rrufeja_123

[ Ky afishim u ndryshua nga: Rrufeja_123 më 2007-03-26 23:02 ]

profile | edit quote

**Kruja**

**Anëtar që nga:** 12.03.2004
**Afishime:** 1932

**Afishuar me:** 26.03.2007 23:02

Quote:

> I_Kelmendi afishoj me 2007-03-23 21:47 :
> Shumë i nderuari Miku "kruaja",
> Pak rëndësi ka mendimi im individual, meqë nga i gjithë kombi çmohen heronjë. Përmes romanit jam munduar t'ua kthejë nderin që më kanë bërë - si shokë e vprimtar i Tyre që isha!
> Ndoshta pushtetarëve përkatës do u bie ndërmend ta zyrtarizojnë heroizmin e Tyre...
> Ju falënderoj dhe mbarësi në jetën Tuaj dhe të Familjes!
> Miqësisht
> I. Kelmendi

-------------------------------------

z. Kelmendi,
Nese shihni tek "kruaja" nje Mik atehere edhe une duhet te gjej tek ju nje Mik. Vecse kjo gjetje me duket shume e habiteshme, sinqerisht perseri!
A mund te gjendet nje Mik edhe ne internet?! Ne nuk njihemi personalisht, dhe normal (besoj edhe per ju) njeriu mund te beje Mik dike qe e njeh prej kohesh dhe mire e mire sidomos ne kohe te keqia.
Ju, shpresoj, t'i kini vene re me vemendje rezervat e mija ndaj qellimit te romanit tuaj. Nese mendon t'u kthesh nder atyre qe kane dhene jeten per Shqiperine duke shkruaj nje roman te tille, ju beni gabim (ky eshte mendimi im). Ju besoj bini dakort kur themi qe ishte UDB-ja autori i krimeve ndaj veprimtareve shqiptare. Perpjekja juaj per te gjetur kriminelet fizike nuk kontribon aspak mendoj une per te kthyer nje nder qe Jusufi ju ka bere duke ju mbajtur afer etj etj. Vrastari eshte ceshtje e "dores se dyte" sikurse shpreheni edhe ju vete. Perse duhet qe ju i nderuar z. Kelmendi te harxhoni energji me ceshtje te dores se dyte?!

z. Kelmendi,
Lexoni edhe njehere me vemendje se c'fare ju kane shkruar Pantera, Alfonsi dhe Shpetimi. Me dy te paret personalisht ndaj mendime te papajtueshme ne kete forum, kurse me te fundit pajtohem ne shume gjera. Vecse te tre keta forumiste kane thene shume mendoj une qe ju te kuptoni kotesine e gjetjes se nje vrastari sepse doni te ktheni nderin qe Jusufi ju ka bere juve dikur...
Ju z. Kelmendi jini nga ata njerez, te pakten ashtu sikurse paraqiteni ne kete forum, te cilet nuk bejne apo gjejne armiq jashte vetes.
Une mendoj se armiku juaj me i madh mund, mund te behet ose te gjendet brenda vetes tuaj.
Ju lutem merrini mesazhet e mija qellim mira dhe te sinqerta si pozitivisht konstruktive sepse te tilla jane ne thelb.
Miqesisht!

[ Ky afishim u ndryshua nga: Kruja më 2007-03-26 23:03 ]

profile | edit | quote

**kreksi**

**Anëtar që nga:** 28.02.2005
**Afishime:** 471
**Vendbanimi:** Francë

**Afishuar me:** 26.03.2007 23:46

---

Indruari Ibrahim,
Me pelqen shume personazhi "Renata" e cila e dashuron shume Miranin por edhe eshte një lloje mburoje se me sa e kuptova, kjo Renata e ka shpetuar Miranin nga zhdukja sepse udba as te tjeret nuk kan guzuar te prekin kete personazh derisa jeton me nje gjermane se po te ishte Mirani me nje shqiptare besoje se ata do e kishin me leht ti qerojne heapet me miranin. Një Alibi i forte....
**********************************
Pastaj kam vetem disa kritika krejt minime ne krahasim te tere librit, aty kur hasim tek personazhi i pa njohur, ai "lypsi" qe kerkon strehim tek familja Gervalla e qe kete person as qe dinin se nga ka ardhur kush ishte ai njer ,
Ketu, jo vetem autorit qe nuk i shkon mendja ta zbuloje por per çudi edhe organeve hetuese, edhe pse e pershkruani si i dyshimt por hetuesit nuk ndalen fare tek ky i panjohuri" x" ?
Une do e kisha larguar nga shtepija, do e kisha marrur me automobil e ua kisha lshu ne klub atyre iu kisha then; qe nje me teper... me siguri do ia kishin gjetur vendin bashkeatdhetaret
Ketu shifet moskujdesi o organizates por edhe i autorit apo edhe ne pergjithesi, si te l lejohet te hyje gjithkush ne shtepi ashtu pa e njohur ?
Mandej edhe ajo serbja ne klinike, a eshte marrur hetime ndaje saj ndonjehere ?
nejse po i perziej pytje roman e realitet por keshtu ne lexuesit e shofim nga ky kendi yni... se ketu ka patur naivitet duek ditur se ishi ne rrezike ne çdo hap.
Po te delte ndonje i huaji te lexonte vetem keto dy faqe mbi kete personazh, ai do dyshoje me siguri, perse nuk u ndermor asgje ndaje tije, se paku ketije kan mundur t'ia bejne nje foto robot....
*****************************************************
Po ndalem edhe tek epizoda e kobshme, derisa i sjellin heronjet ne shtepi pas morgit, ketu vrejta skena te hatashme e te pa pelqyera qe njollosin imazhin jo vetem te deshmorve por edhe te gjithe shqiptarve ne pergjithesi sidomos me planin e Nuriut per te akuzuar Miranin se gjoja ai eshte hajdut, ketu z. Kelmendi, keto skena neve na thejn qafen te gjithve po te perkthehet nje dite ky liber...
Sipas mendimit tim, botuesi eshte dashur te nderhyje ketu se deri ketu romani eshte i shkelqyshem por ne te pame te heronjve une per vete do ekisha pre aty, edhe pse ka ndodhur ashtu si ju e pershkruani.
Deshta te them se disa te verteta jane nganjehere aqe te hidhura, anmiqet na i kan vrar heronjet, por te bie imazhi i tyre aqe poshte nuk eshte dashur te botoni kete kapitull.
Po edhe nje e pa hjeshme ndodh aty, nje dialog i policit apo kapitenit gjerman qe vjen ne shtepi te heronjve dhe aty i del perpara djali i Jusufit, Ermiri dhe i thot; po qe se nuk i gjetet vrasesit une do te hakmirrm ndaje juve....
Edhe kjo neve na rrxon poshte per se tepermi ngase aty shtrihet i vrar babai i tije e aty per aty nje çuni te vogel 4 vjeçar i lejohet te shetitet n ete pame me nje revole plastike, pra as ky imazh nuk eshte i hjeshem per ne .... teper i tmerrshem qe une habitem perse askush nuk iu ka ndihmuar megjithese ka korrektor sa te duash por kjo nuk duhej te lshohej...
Kurse ato gabimet teknike ato jane te vogla....
Pra une kam ngelur tek faqja 358, besoje se do e gjeje edhe me tutje te njejten knaqesi duke lexuar deri ne fund kete roman jashtezakonishte te te pasionuar dhe teper i lexueshem qe se kisha besua se do nxirrni nje liber aqe te bukur.
Urime !

kreksi

<font class=editedby>[ Ky afishim u ndryshua nga: kreksi më 2007-03-26 23:57 ]</font>

[ Ky afishim u ndryshua nga: kreksi më 2007-03-27 00:02 ]

profile | edit quote

**I_Kelmendi**

**Anëtar që nga:** 23.03.2007
**Afishime:** 51

**Afishuar me:** 27.03.2007 00:23

I nderuar Z. "Livadhi" !
(Afishuar me: 25.03.2007 22:46)

JU:
(...) Por duke pasure parasushe se LPK veprimtarin e Vete ne 80% e kryente ne menyre ilegale besoji qe eshte jo ne rregulle qe z Kelemendi del me nje libere Romane dhe provon te sjell fakte rrethe ngjarjese dhe personaliteteve qe me vite ju besuam. Pse?
Sepse veprimtari ilegale e LPK eshte pasuri e gjithe veprimtareve qe ishin te kyqure ne LPK.
Dhe te nxirren deshmi ose fakte rrethe punese se saji duhet te merren vendime Kolegjijale dhe me pase te deshmohet per kete apo ate rast .

Unë:
Sa i përketë të drejtës për të „dekonspiruar" veprimtarinë e LPK-së, mendoj, se është distancë e bollshme kohore që ajo të dali në dritë. E dyta, nuk duhet të kem shpërdoruar tillë besim, siç pretendoni Ju, sepse tashmë ky fragment historik pothuajse është histori. Sikur Ju të insistonit të bënit tani karrierë politike, atëherë mund që duhet të ju kem dëmtuar ju dhe atyre që nuk kanë çfarë të ofrojnë tani, por duan të thirren në meritat patriotika nga e kaluara e largët. Dhe, shumëherë e disa syrësh, këtë të kaluar janë përpjekur ta glorifikojnë, sikur ne atëherë kemi vepruar çdo herë mirë. Disa të tjerë, me kalimin e kohës e kanë mitizuar të kaluarën. Dhe tani, kur u bie të lexojnë se si është vepruar, ndihen t'u jetë cenuar ai mit. Prandaj, më vjen keq nëse ju kam lenduar, duke ua prekur miti që duhet të keni ngulitur pavetëdidhëm në ndërdije.
E di që veprimtaria jonë e fshehtë është pronësi e të gjithë pjesëmarrësve në LPK, por tashmë nuk ekzistojnë mundësitë dhe nuk është e arsyeshme që të mblidhen të gjithë, për të vendosur nëse duhet ose jo të rrefejmë të kaluarën tonë. Unë jam i mendimit, se duke shkruar për këtë të kaluar, pra, duke e nxjerrë nga "harresa", i kam bërë nder, siç duhet të ju kem bërë nder edhe Ju.
Thënë të drejtën, mua nuk po ma mbushni mendjen, se keni qenë veprimtar i të njëjtave radhe ku isha edhe unë i angazhuar. Nuk besojmë të kemi pasur bashkëveprimtarë, të cilët panevojshëm fshihen pas pseudonimit, ose ndodhta ora Juaj ka ndaluar dhe nuk e keni kuptuar, se tani është realizuar çlirimi dhe vendosja e pluralizmit politik.
Sa për sqarim plotësues: Veprimtaria e LPK-së në Perëndim nuk ka qenë e fshehtë (ilegale). Kur mbahen kuvende me më shumë se 100 delgatë, ku zgjedhën në mënyrë demokratike organe drejtuese (Këshilli i Përgjithëm me mbi 21 anëtarë, kryesia me mbi 7 anëtarë), kur këto organe mbajnë mbledhje, të paktën një herë në muaj, atëherë kësaj nuk mund t'i thuhet veprimtari ilegale. Tjetër është se disa segmente, që kishin të bënin me organizimet në Kosovë, ishin tejet konspirative (të fsheha).
Që të bindi se nuk mund të merret vendim kolegjial, nëse duhet të rrefehet e ndriqohet e kaluara, atëherë po e zëmë se unë kam bërë faj, duke prishur rregullat (Tuaja) të ilegaliteti, provo si do ta shqyrosh këtë në mënyrë kolegjiale, për të vendosur për fajin tim.
Mos më keqkuptoni, por do ju lutesha të mos bëhen merak për këtë

çështje, sepse gjykoj se jam mjaftueshëm i përgjegjshëm për veprimet e mita.
- Shënet dhe suksese në punë të mbara !
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

*************************************

I nderuar Z. „Lorik" !
(Afishuar me: 26.03.2007 17:17)
Ju falënderoj për kontributin Tuaj – të reklamimit të romanit. Po më vika keq që e lexoki në pdf dhe jo si libër.
Po shfrytëzoj rastin të ju informoj, se fatmirësisht / fatkeqësisht (varësisht nga këndëvështrimi), botimi i parë ka mbaruar. Për ata që jetojnë në Perëndim, mund të gjendet edhe ndonjë ekzemplarë, pasi disa miq kanë marrë me vete ca copë kur ishin në Kosovë. Nëse ndokush është i interesuar të porosisë librin, mund ta bëjë këtë duke më shkruar në mail-adresë.
Sa i përketë korruptimit dhe tjetërsimit të disa politikanëve tanë, që Ju i thonjëzoni, ata nuk largohen vetëvetiu, siç keni sygjeruar Ju, pasi, siç po duket, kanë rënë në grazhd të majmë dhe nuk largohen me dëshirë. Por, me votë të ndërgjegjshme të qytetarëve, me miratim të ligjeve dhe me aftësim të organeve përkatëse shtetërore, kam shpresë se atyre do t'u mbetet në fytë pasurimi eksploziv – i pandershëm dhe i pamerituar, sepse nuk është sociale e njerëzore, që pasuria nacionale të tjetërsohet e përvetësohet, ajo të harxhohet në vila (jo-prodhuese), në makina luksoze (gjithashtu jo-prodhuese), në kohën kur disa fëmijë të heronjëve të Luftës sonë çlirimtare kanë problem të ngihen me bukë...
- Shënet dhe suksese në punë të mbara !
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

*************************************

I nderuar Z. "Piloti" !
(Afishuar me: 26.03.2007 18:38)
JU: Një pasëdite të vitit 1987 në Skenderaj Plaku i Drenices Heroi Kombëtar Shaban Jashari në stacion te autobusve fshehurazi nga "qyrku" Palltoja e trashë nxori gazeten "Zëri I Kosovës" , dhe filloi të na rrefei (ishim dy-tre persona ne shoqeri ) per peerpjekjet qe po behen per tu organizuar një rezistenc kunder okupatorit......., pyetja: Keni rastësisht dijeni se a ishte xha Shaban Jashari atëbotë anëtar i LPK-së ?

Unë: Konkretisht nuk mund t'ju informoj për këtë pyetje kaq konkrete. Di se Femi Lladrovci mbante lidhje të drejtëpërdrejta me Familjen JASHARAJ. Ndërs një përgjigje precize do të mund të siguronim edhe nga Ali Ahmeti, sepse edhe ai ishte në lidhje të rregullt dhe të drejtëpërdrejtë me Heroin (jo "legjendar" por real / faktik) ADEM JASHARI.
- Shënet dhe suksese në punë të mbara !
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

*************************************

I nderuar Z. "Trixi" !
(Afishuar me: 26.03.2007 21:09)
Mirë se u riktheve dhe e përgëzoj Z. "Nositi" që ua mundësoj rikëthimin Tuaj. Do i mirëpres pyetjet Tuaja, të cilat sa më kritike që t'i bëni, do jenë më pikante. Uroj të mos përjashtohet asnjëri / asnjëra nga Forumi dhe për këtë falënderoj administratorët. Do i lusja që të mbyllin njërin sy lidhur me këtë tematikë, sa i përketë respektimit të rregullorës.
- Shënet dhe suksese në punë të mbara !
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

*************************************
I nderuar Z. “Mok” !
(Afishuar me: 26.03.2007 22:11)
JU:
Me duhet tju perkujtoj se ne vitin 1980 diku kah qershori rastesisht jemi takuar ne zyren e Bardhosh Gervalles ne LB
Aty me duket se nuk keni pasur nje pritje edhe aq te perzemert nga Bardhi por as edhe nga Jusufi sa kam mund me verejt une ne ate kohe.
Prandej kur e pyeta Jusufin pasi qe shkove ti se kush ishe TI, aj mu pergjigj : njani qe me ka lodhe me ate gazete, ma vone e mora vesh se ishte fjala per gazeten Bashkimi.
Ai mi pat dhan edhe disa numra te kesaj gazete dhe se bashku me shum te tjera gazeta e literatur per me i derguar ne Kosove.
Te gjitha i kom derguar disa here dhe kurr nuk kam ra ne kurth.
Kan ndegjua se shumica e atyre qe ju i keni ngarkuar kan arrit vetem deri ne kroaci ma se largu e aty ju ka ngel ashti ne fyt.
Nese nuk eshte ashtu trego e nese na binde neve ketu do te kerkoj falje publike.

Unë:
I nderuar Zotëri, jemi ose nuk jemi takuar. Nuk i shkon „më duket“ kur flisni për diçka kaq konkrete. Për ato që rikujtoni ju, nuk kam si t’i komentoj, pasi nuk po më kujtoheni Ju dhe as rrjedha që sjellni këtu. Ju keni dëgjuar se shumica e atyre që unë kam ngarkaur të sjellin fshehurazi material në Kosovë e kanë pësuar. Ndërs unë do ju them se asnëri që kam angazhuar unë nuk e ka pësuar. I thonë një fjale, nëse don të thuash jo-të vërtetën, fol çka ke dëgjuar.
Unë nuk de dij si duhet të ju bind juve ndryshe momentalisht. Por shtrohet pyetja, kur i keni dëgjuar ato që thatë, sigurisht se është dashur nga të njëjtit të keni dëgjuar, se cili veprimtarë duhet ta ketë pësuar.
- Shënet dhe suksese në punë të mbara !
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

*************************************
I nderuar Z. “Kruaja” !
(Afishuar me: 26.03.2007 23:02)
Rëndom, në traditën tonë popullore, edhe kur kalonte një njeri i panjohur dhe ti ishe duke ngrënë, ai të thoshte: “Të bëftë mirë”. Përgjigja: “Urdhëro, Mik!”.
Në rastin konkret, të gjithë dëshiroj t’i trajtoj si miq të bashkëbisedimit, edhe pse jeni të kamufluar pas psedonimeve. Ndonjëri po e dekonspiron veten, duke më shkruar në mail-adresë, prandaj i falënderoj për këtë.

JU: Ju, shpresoj, t'i kini vene re me vemendje rezervat e mija ndaj qellimit te romanit tuaj. Nese mendon t'u kthesh nder atyre qe kane dhene jeten per Shqiperine duke shkruaj nje roman te tille, ju beni gabim (ky eshte mendimi im). Ju besoj bini dakort kur themi qe ishte UDB-ja autori i krimeve ndaj veprimtareve shqiptare. Perpjekja juaj per te gjetur kriminelet fizike nuk kontribon aspak mendoj une per te kthyer nje nder qe Jusufi ju ka bere duke ju mbajtur afer etj etj. Vrastari eshte ceshtje e "dores se dyte" sikurse shpreheni edhe ju vete. Perse duhet qe ju i nderuar z. Kelmendi te harxhoni energji me ceshtje te dores se dyte?!

Unë: Edhe keni të drejtë për mendimin që shprehni. Sigurisht, kushdo është i bindur që UDB-ja ka bërë atentatet, por ajo është përbërë nga UDB-ashë konkret dhe prandaj, them unë, mirë është që të mund t’i zbulojmë të tillët, që nuk kanë zbatuar ligjet e kohës, por kanë bërë krime.
Kushdo e di që pushteti i Hitlerit ka vrarë miliona veta, por ende po

ndiqën kriminelët konkret. Kushdo e di që regjimi i Milloseviqit i ka bërë krimet në Kosovë, por kriminelet po kërkohen, ndiqen e gjykohen personalisht. Nuk kemi pse ndruhemi, nëse dorasët janë shqiptarë, do të shkarkohet UDB-ja dhe pushteti i atëhershëm nga përgjegjësia. Mendoj, është dëshirë dhe kërkesë e shumicës, që të zbulohen e gjykohen dorasit.

JU: (...) Ju z. Kelmendi jini nga ata njerez, te pakten ashtu sikurse paraqiteni ne kete forum, te cilet nuk bejne apo gjejne armiq jashte vetes.
Une mendoj se armiku juaj me i madh mund, mund te behet ose te gjendet brenda vetes tuaj.

Unë: Jam duke dëshiruar të mos ketë armiq në këtë Forum dhe jam i prirur që secilin shqiptar të panjohur nga unë, fillimisht të mos e trajtoj si armik. Nëse pastaj do të konstatoj se ndonjëri do jetë në shërbim të amriqëve të kombit tim, ose nëse është i predispozuar të jetë vetë armik i kombit tim, atëherë, më besoni, nuk do ta trajtoj si mik dhe do përpiqesha që t'i tregojë vendin. Por, duhet peshuar gjerat me peshore figrami (ari) dhe të mos trajtohen për armiq ata që kanë mendime ndryshe, që shpifin e shajnë, të nxitur nga manipulimi e dezinformi. Këta unë i trajtoj si viktima dhe përpiqem, me informim e sqarim të sinqert, t'i ndihmoj që të emancipohen.
Juve ju falënderoj për merakosjet Tuaja dhe këshallat Tuaja do i kem në konsideratë.
- Shënet dhe suksese në punë të mbara !
ibrahim_kelmendi@yahoo.de

*************************************
Natë e gjum të mirë të gjithëve.
Nëse jeni të mendimit, gjykoj që unë nuk jam më i nevojshëm të vazhdoj me prëgjigje, pasi nga pyetjet, vlerësimet e mendimet Tuaja, sikur po më duket se këtë tematikë e kemi konsumuar.
Nëse do miratoni propozimin tim, atëherë të gjithëve dëshiroj të ju falënderohem për këtë bashkëbisedim, duke ju uruar shëndet dhe suksese në punë të mbara.
Mirëupafshim!
Ibrahim_kelmendi@yahoo. de

PS. Për ata që vërtetë kanë nevojë edhe për ndonjë përgjigje, mund të më drejtohen në mail-adresë.
Po ju le duke ju dëshiruar bashkëbisedim të nivelit e mirëkuptim vëllazëror!
Tung

---

profile | edit quote

**gjarperi**

**Anëtar që nga:** 27.11.2005
**Afishime:** 526

**Afishuar me:** 27.03.2007 00:54

---

Te pershendes Hotiani, une pajtohem plotesisht me mendimin e juaj lidhur me poziten e pjestarve te UCK-s, pas luftes, por nuk pajtohem kursesi per shkaktarin e kesaj pozite te mjerushme, une mendoj se shkaktar i kesaj pozite te pjestarve te UCk-s jane ata qe nenshkruan, kapitulimin e UCK-s pas luftes, Ky nenshkrim ishte hapja e deres per kete mjerim(per ndjekjen e tyre, burgosjen e tyre, dhe ne asnje dukument zyrtar te Kosoves nuk figuronte UCK-ja, deri me vitin 2007, kur u aprovuar ligji, tani ne kontekst te saj kisha me pytur zotri Ibrahim Kelmendin se qka mendon per nenshkrimin, per kapitulimin e UCK-s(une e konsideroj keshtu).

---

profile | edit quote

| | |
|---|---|
| **Shqipëruesi**<br><br>**Anëtar që nga:** 08.08.2004<br>**Afishime:** 556<br>**Vendbanimi:** Prishtinë | **Afishuar me:** 27.03.2007 02:41<br><br>I nderuar z.Kelmendi,<br>-- Të pyeta për rastin e vrasjes së Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës,pasi këtu në forum, më ka rënë të lexoj, se "Kadri Mani(Osmani) i "paska futur në kurth", Rexhepin dhe Nuhiun !!!<br>Arësyeja tjetër është, se Kadriu është i afërm i imi dhe ka gjëra që do të mund ti diskutoja, pastaj me te,më detajisht.<br>Ajo që më intrigon më shumë, është fakti, që ju përmendët Tahir Zemajn si "udhëdheheqësin e operacionit famëkeq !!!<br>Dicka e padëgjuar, për mua.Sidoqë të jetë,të falenderoj për përgjigjen dhe besoj se do të kem rastin të marr edhe ndonjë përgjegje tjetër me interes për mua, nga ju.<br>Kurse mua më intereson,a njiheni me Kadri Manin dhe cilat janë përshtypjet tua për te.<br>PS:<br>Njëfarë Delegati më pati thënë me një rast tjetër se Kadriu "paska luajtur mendësh",kurse këtu kinse e marrka në mbrojtje nga unë "spiuni" sic më quan Rojtësi i Mjegullave,mua...Cfarë mjerimi,hmm.<br>Shëndet dhe gjithë të mirat nga Shqipëruesi<br><br>profile \| edit quote |
| **Rrufeja_123**<br>**Moderator global**<br><br>**Anëtar që nga:** 19.11.2005<br>**Afishime:** 333 | **Afishuar me:** 27.03.2007 07:23<br><br>z. I_Kelmendi afishoj;<br>Nëse jeni të mendimit, gjykoj që unë nuk jam më i nevojshëm të vazhdoj me prëgjigje, pasi nga pyetjet, vlerësimet e mendimet Tuaja, sikur po më duket se këtë tematikë e kemi konsumuar.<br>Nëse do miratoni propozimin tim, atëherë të gjithëve dëshiroj të ju falënderohem për këtë bashkëbisedim, duke ju uruar shëndet dhe suksese në punë të mbara.<br>Mirëupafshim!<br>Z. Kelmendi,<br>Duke ju falenderuar per mundin dhe kohen qe keni humbur, tani kete teme po e mbylli.<br>Suksese edhe per Ju dhe shendet.<br>Rrufeja_123 |

## 16. BEDRI ISLAMI: VONESA E MBARË

(Shënime për romanin e Ibrahim Kelmendit "Atentatet")

Kur disa kohë më parë, miku im Ibrahim Kelmendi do të më niste fillimet e kapitujve të parë të romanit "Atentatet", nuk e kisha besuar se më në fund do të kishim një vepër të tillë, e cila, për nga përmasat që mbart, është shumë dimensionale.

Nuk e kisha besuar për dy  arsye të thjeshta : Kelmendi, jo rrallë ka filluar të gatuajë në "magjen" e tij të krijimit "bukën" e veprave të ardhshme, por po ashtu, jo rrallë, i ka lënë ata për një kohë tjetër, më të frytshme dhe më të vyer. Së dyti, nuk e kisha besuar, sepse, sado që njihem prej më shumë se 14 vitesh me të, nuk e kam ditur gjithë furinë që ai kishte kaluar dhe që do na e jepte një ditë. Pra, u gabova me autorin e librit dhe jam ndjerë shumë i kënaqur që u gabova.

Ibrahim Kelmendi është njëri ndër figurat më të njohura të disporës shqiptare, por edhe të lëvizjes politike ilegale në përgjithsi. Atë mund ta njohësh nga afër ose jo; mund ta duash ose, në të kundërtën, të mos ta durosh dot; ta kesh mik ose ta ndjesh se e ke kundërshtar të rrezikshëm; mund të kesh debatuar me të me orë të tëra ose nuk ke

folur as edhe një fjalë të vetme; mund të jetë i afërt ose krejt i huaj për të; të gjitha mund të ndodhin, por nuk mund të ndodhë që të jesh indiferent ndaj tij, ndaj jetës së tij, punës që ka bërë, asaj që ka kaluar, në fund të fundit, do apo nuk do, do të marësh një qëndrim. Ai, në të vertetë, nuk është ashtu thjeshtë, bardh e zi, ai ka pasur përkrahësit e tij ashtu si edhe kundërshtarët, dhe gjithnjë jam habitur, përse, në këto të fundit, disa nga më të "egërit" vinin, ashtu si ai, nga rradhët e lëvizjes ilegale, por që, jo si ai, kishin depërtuar në partitë legale.

Nuk e dija përse vinte një zemërim i tillë. Në fillimet e ardhjes sime në Perëndim, në të vetmin takim me Hafiz Gagicën, kur i thashë se kisha dëshirë të takohesha me Kelmendin, më befasioi përgjigjja e tij e menjëhershme: "është i rrezikshëm". Këtë e dëgjova edhe më pas, zakonisht nga ish pjestarë të lëvizjeve ilegale, të konvertuar zakonisht në LDK-istë, ashtu si do kisha rastin, më pas, të dëgjoja vlerësime të tjera.

Tani, pas leximit të librit, ndjehem i bindur se e di edhe mllefin e ish ilegalëve ndaj Kelmendit. Në fakt ky nuk ishte dhe nuk është mllef kundër tij, më shumë se gjithçka ishte një hidhërim kundër vetes, që nuk kishin mundur të qëndronin ashtu si duhej, që u kishin ikur ideve që kishin pasur, që ishin "zbutur", kur kishte ende të tjerë, që bënin më tej. Ishte edhe më shumë se kaq: frika e dëshmisë që mund të vinte nga Kelmendi, një ndjenjë frike e përhershme jo thjeshtë nga ai si njeri, sepse edhe ai do të kishte dobësitë dhe gabimet e tij, por nga ideja që do të vinte në lëvizjet ilegale.

Çuditërisht, për herë të parë, Kelmendin e kam takuar pikërisht në varrezat e Shtutgartit, në njërin nga përvjetorët e rënies së Jusufit, Bardhoshit dhe Kadriut. Ishte janari i vitit 1993, ftohtë i idhët, sapo kisha filluar jetën në Gjermani dhe ende nuk dija asgjë, ose thuajse asgjë, për përplasjet brenda politikës shqiptare në Kosovë e jashtë saj. Enigma e renies se tre herojve të Kosovës ishte e pranishme aty, ashtu si ka qenë që nga janari i vitit 1982 e deri në daljen e romanit "Atentatet". Kelmendi ishte me bashkëshorten e tij, gazetaren Mimoza Cika, të cilën e njihja që në Tiranë. Thënë të drejtën, enigma e atij njeriu, ende nuk kishte filluar tek unë, dhe pas takimit të parë, përgjithsisht i ftohtë dhe aspak interesant, nuk e kisha menduar se do të njiheshim më tej, e aq më pak se do të bëheshim miq e do të bashkëpunomim në të njëjtën organizatë.

Përse e thashë këtë? Kelmendi ka qenë i ftohtë, si të thuash, ndaj ngjarjes, që përbën pikun e jetës së tij. Ai e kishte përmbledhur enigmën në vete, megjithëse ishte munduar fillimisht ta zbërthente, dhe kur kishte menduar se duhej një kohë tjetër, kishte heshtur. E dija se Kelmendi ishte njeriu që kishte përgatitur fjalën e rastit në varrimin e tre herojve, e dija se kishte folur; dhe, ashtu si do të mësoja më vonë, pikërisht asaj dite, do të fillonte edhe krijimi i mjegullës për implikimin e tij në këtë ngjarje kobzezë. Se si ai kishte mundur të mbante peshën e kësaj ngjarje dhe gjithçka që është thurur rreth saj, vetëm ai mund ta dinte. Shumë vetë do të ishin thyer, do të kishin thirrur, do të ishin munduar të bënin të vertetën të afishueshme me të gjitha mjetet e mënyrat, ndërsa ai zgjodhi rrugën e pritjes.

Mendoj se kjo përbën edhe vlerën e parë themelore të romanit. Pra ai nuk është shkruar aty për aty, menjëherë pas ngjarjes, kur llava ishte ende përvëluese, dhe kur, si ndodh rëndom, sugjestioni i kohës, mund të kishte çuar në dreq gjithçka. Kelmendi ka pritur deri sa llava e romanit të tij të ftohet, të zërë vend, të krijojë shtratin e përshtatshëm për tu shkruar dhe, kur ka ardhur çasti i duhur, ai e ka thënë, ashtu si ka ditur. Dhe ka ditur ta thotë fare mirë.

Ndodh jo rrallë, që ende pa u ftohur një ngjarje, të bulojnë dhjetra libra, të cilat, po ashtu shpejt, harrohen dhe nuk kujtohen më. Ndryshe ndodh me romanin e Kelmendit, i cili, me narracionin krejtësisht të thjeshtë, nganjëherë deri në naivitet, sjell

realisht atë që njerëzit e kanë përjetuar, atë që njerëzit e kanë prekur me dorë, ngjarjen e madhe dhe ngjarjet pas saj. Kjo i bën reale, të besueshme, i bën të të detyrojnë të rilkthehesh dhe të bësh gjetje të tjera.

Ndodh tani, besoj se është deri diku e natyrshme, që autori të pyetet: përse e thua këtë tani, përse nuk e ke shkruar më parë, kur e paske ditur ngjarjen?

Duke qenë një pyetje, deri diku, e natyrshme, ajo, në të njëjtën kohë, është e panevojshme. Megjithëse autori sjell disa shkaqe, sidomos në intervistat e pas librit, përse është kjo vonesë, shumica e të cilave lidhen me angazhimet e tjera vendimtare të lëvizjeve ilegale, pjesë e rëndësishme e të cilave ka qenë edhe autori i librit, unë mendoj, se ajo nuk ka qenë themelorja. Më e rëndësishmja nga të gjitha ka qenë, për mendimin tim, edhe e ndenjur më gjatë në vetdijen e autorit, ka qenë pikërisht pritja e ngurtësimit të llavës së fakteve, saktësimi i tyre, përplasja e atyre që ndodhën në fillimin e viteve të '80-ta - me ato që do të ndodhnin më pas, dhe kur gjithçka u formësua tek ai, libri erdhi natyrshëm.

Jo rrallë, po ashtu natyrshëm, shumë njerëz, pasi kanë lexuar librin, kanë pyetur se cili qëndron pas njërit përsonazh apo tjetrit. Mendoj se kjo gjë e natyrshme ka lidhje me vërtetësinë që ka sjellë libri, sepse duke qenë i vertetë, ai ka zgjuar tek njerëzit dëshirën për të ditur edhe emrat real të atyre, që për mirë apo për keq, lëvizin nëpër faqet e romanit "Atentatetet". Në këtë grackë kam rënë edhe unë. Kisha haruar se kush fshihej pas "Rezilit" dhe thirra autorin të më tregonte. Mirëpo, pasi shkëputesh nga gracka, ku dashje pa dashje, të fut autenciteti i librit, atëherë ndjehesh i detyruar të mendosh më gjatë se kaq.

Çfarë më gjatë? mendoj se nuk është edhe aq e rëndësishme, në planin e romanit (sepse është e rëndësishme në planin e jetës) të dish se kush është pas këtij personazhi dhe cili është fshehur pas atij tjetrit. E rëndësishme është, dhe romani e sjell këtë, që përmes disa njerëzve, sillen përceptimet e epokës, ngjyrimet politike dhe njerëzore të saj, dobësitë dhe karakteret, thyerjet dhe ringritjet, ecja nëpër vorbull dhe dalja sipër vorbullës, sillet epoka, ashtu si ka qenë dhe që nuk është idealizuar, sepse tashmë kanë kaluar disa vite. Kelmendi në roman,nuk bën kompromisin që nganjëherë ka qenë i detyruar ta bëjë në jetë: pra nuk lë hapësira të mbyllura ose të fshira të kohës, nuk idealizon mërgatën shqiptare, nuk e ka për gjë të thyejë tabu ose mite, të cilat jo denjësisht janë bërë të tillë; nuk ngurron të thërrasë emrat e sakta të jetës së atëhershme, nëpër të cilat ka gjalluar jeta e shqiptarëve.

Romani "Atentatet" i Ibrahim Kelmendit është një libër i cili, në leximin e parë, të detyron të kalosh faqet. Për vete, megjithëse lexues jo i keq, më ka rastisur që disa herë të kaloj faqe të tëra, sidomos idilet dashurore të Miranit, sepse më ka interesuar të dijë se çfarë do të vijë më vonë. Kjo është një veti e librit.

Pse ndodh kjo? Thashë se autori e ka shkruar librin pasi është qetësuar llava e shpirtit ose e mendimit të tij, por kjo nuk do të thotë se ai nuk ka sjellë pjesë të kësaj llave tek lexuesit. Më pas, pasi llava që ka hedhur tek ti autori fillon e qetësohet, atëherë gjen kohë e rikthehesh tek ato që në fillim nuk i ke quajtur edhe aq të rëndësishme, deri sa e ke të qartë se edhe ata kanë rëndësinë e tyre.

Mendoj se kjo dukuri i librit, pra fakti që lexuesi fillon e bëhet autor dhe njëkohsisht redaktor i librit, sepse fillon e heq ose rilexon ato që mendon se janë më të rëndësishmet, është ndër sukseset e librit. Sepse askush nuk është i ftohtë ndaj tij. Në të vertetë, të gjithë jemi fillimisht të interesuar të dimë se kush fshihet pas ngjarjes tragjike të 17 janarit të vitit 1982 dhe vrasjes së ndodhur, mirëpo, më pas, e ndjejmë se nuk qenka kjo e vetmja gjë, dashje pa dashje , e ndjejmë se nuk është më e rëndësishme vetëm kjo ngjarje, e cila përbën vetëm një moment të romanit, por edhe "atentatet" e tjera, të cilat

ndodhin në radhët e lëvizjeve ilegale. Dhe ndodh që natyrshëm ke dëshirë të polemizosh me autorin, ta shash ose ta lavdërosh, ti thuash se e ke mirë ose se e ke gabim, se ngjarjet kanë qenë pikërisht ashtu ose nuk kanë qenë të tilla; e ndjen se ke edhe ti diçka të tillë brenda vetes, sepse ka edhe raste të tjera, kur po kështu "atentate" të vogla, i janë bërë lëvizjes ilegale, qendresës, luftës. Pra në fund të fundit bëhesh pjesë e librit. Çdo autor do të ishte i lumtur po të ndodhte kjo. Me librin e Kelmendit kjo ka ndodhur.

Shumë kohë më parë, kur u njoha me kapituj e parë të romanit "Atentatet", dhe nuk e dija nëse do të shkruante më tej ose jo, mjaft ngjarje i dija. Jeta e solli që të bëj pjesë në të njëjtën organizatë me Kelmendin, - Lëvizja Popullore e Kosovës, - dhe të jemi në strukturat drejtuese të saj. Ndodhte, që për probleme të veçanta, të cilat kishin lidhje me luftën, të bëheshin apostrofime të strukturave brenda vendit. Nuk e dija përse Kelmendi kishte gjithnjë një shpirt kundërshtimi ndaj adresimeve të tilla, sidomos kur ato, deri atëherë, nuk ishin ndjerë. Më pas disi isha më i qartë, pas librit, shumëçka më është më e qartë. Pse e sjell këtë detaj nga libri i Kelmendit? Mund të duket krejt e parëndësishme tani, mirëpo mendoj se nuk është ashtu. Duke sjellë në vemendje ngjarje që kanë shkuar, autori rikthen vemendjen tek fakti i mospërsëritjes së tyre. Edhe kjo është veti e librit.

Romani "Atentatet" është një libër që do të mbesë. Ai nuk do të bjerë në harresë. Me gjithë të metat që mbart, sidomos në disa perceptime, ai do të jetë gjithnjë një libër i ditës. Ai vonoi të vijë në letërsinë tonë plot 25 vite, erdhi megjithatë në kohën e duhur dhe ka bërë shpejt vendin e tij. Kjo do të thotë se ishte i mirëseardhur dhe i nevojshëm e ndoshta i domosdoshëm. Më shumë, mendoj, se ishte kjo e fundit. Në fund të fundit ka qenë një vonesë e mbarë.

Nëse libri do të ribotohej (meqë botimi i parë ka mbaruar), mendoj se ai duhet "krehur". Kjo duhet bërë domosdo. Rishikimi i tij, siç ndodh rëndom me ribotimet, do e bënte atë edhe më të vlershëm.

Megjithëse autori thekson se libri është shkruar me mendësitë e kohës së atëhershme, pra viteve kur edhe janë vendosur ngjarjet, nuk ka mundur ti shpëtojë përceptimeve dhe kohës së sotme. Jo rrallë, përsonazhi kryesor i librit, Mirani, të duket sikur ka qenë një herë në fundin e viteve të '90-ta dhe është rikthyer edhe një herë, më pas, për të thënë ato që i ka thënë. "Rebel", në sensin e mirë, siç është nga natyra, unë besoj se Kelmendi ka pasur përplasjet që sjell Mirani në libër, qoftë edhe përmes ngjarjeve me përfaqsuesit e shtetit shqiptar, mirëpo jo gjithmonë, është i bindshëm. Ka krahasime, në të cilat gjen të paverteta historike, siç është qëndrimi i ish mbretit Zog ndaj Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës. Ka qëndrime që i takojnë një kohë të ardhshme ndaj kombëtares dhe ideologjikes në përgjithsi.

Mirëpo këto janë deri diku rëndesa që mbarten. Mendoj se e meta më e ndjeshme e librit është në përballimin e raportit mes njerëzve që vertet bartin vlera kombëtare në rradhët e lëvizjeve ilegale dhe të atyre që janë përçarësit e mëdhenj, atentatorët, dëmtuesit, agjentët, të dyshuarit. Ndërsa të parët, më shumë se nga kushdo përcillen përmes Miranit dhe disa pak të tjerëve, si për shembull Vasilit, skota përçarëse dhe plangprishëse, është disa herë më e madhe. Sa që nganjëherë të krijohet bindja se në këto vite, kur edhe janë bërë punët më të mëdha të fillesës, shumëçka ka qenë jo e mbarë, për të mos thënë diçka tjetër. Në gjithë këtë vorbull nuk ka qenë vetëm Mirani ai që ka lëvizur, kanë qenë edhe të tjerë, të cilët, anonimë ose përciptas si janë, lënë të vetëm një njeri - përsonazh.

Bedri Islami (27.03.2007, www.pashtriku.org)

# 17. ATENTATET E ZBULUARA
## Historia - Dëshmia - Tronditja

Shkruan: Mustafë XHEMAILI
Biel-Bienne, më 12 prill 2007

(Fjala promovuese më 14 prill 2007 në Dyzeldorf (Gjermani), për romanin e Ibrahim Kelmendit ATENTATET, botoi "Fokus", Prishtinë, 2007)

### 1. Njohja

Njohja ime me Ibrahim Kelmendin është bërë në veprimtari e sipër qysh kur ai mbajti fjalimin me jehonë, por edhe dekonspirativ, në varrimin e babait tim Muharremit, ndjesë pastë, më 3 shtator 1979. (shih libri faqe 209) Madje kjo njohje ime me te u bë në mungesë. Unë shërbeja në ish-Armatën Jugosllave dhe kur erdha në Komogllavë, gjithçka kishte përfunduar. Pasojat e fjalimit të militantit të zbuluar të ilegales së Kosovës, Ibrahim Kelmendi, i cili fjalën për babain tim e kishte shkruar i ulur mbi një thes të mbushur me misër, ishte e dy anshme: përfundimisht në Komogllavë u shpall irredenta dhe, përfundimisht, Ibrahimi u detyrua ta lëshoj Kosovën. Fjalimi i tij ishte thjeshtë politik, kundër shtypësve dhe shfrytëzuesve të klasës punëtore dhe Kosovës, ishte thjeshtë kundër interesave të ish-Jugosllavisë. Ishte fjalim politik që mbahej hapur në Kosovë, një ndër të rrallët e asaj kohe, ishte aq i guximshëm sa shënonte një kthesë të madhe në jetën e njerëzve, të pranishmëve të shumtë që kishin ardhur pothuajse nga gjithë Kosova, por dhe nga Maqedonia për të ma nderuar babain tim. Ndërsa Muharrem Xhemailin, punëtorin, mjeshtrin e kategorisë së lartë të ndërtimeve, grevistin e shkëlqyeshëm në Ndërmarrjen ndërtimore Ramiz Sadiku dhe dashamirësin e madh të arsimit, lirisë dhe përparimit, e nderoi përjetësisht, Ibrahim Kelmendi e nderoi përjetësisht me një fjalim të denj atdhetar e politik. Nuk është vonë edhe sot, që, unë, djali më i madh i familjes së Xhemailëve të Komogllavës irredentiste, mikun tim IK, ta falënderoi, publikisht, për këtë nderë që iu bë babait tim në shtatorin e largët, në vjeshtën e verdhë të vitit 1979.

Vetëm kur jam arratisur nga Kosova në pranverën e vitit 1984, dhe veçanërisht në verën e atij viti, njohja me I. K., u bë aktive, në bashkëpunim të plotë dhe pothuajse krejt të natyrshme. Veprimtarinë e tij e kisha të njohur. Me rrëfimet e tij, ai vetëm më bindi nga afër se ai kishte qenë dhe ishte kapaciteti udhëheqës organizativ, i cili kishte mbetur i vetmuar, pa shokë që kishin nivelin e tij, guximin dhe këmbëngulësinë për të luftuar dhe ecur përpara, pa intelektual, dhe... me një dëshprim të madh, që ai e ndrydhte brenda vetes. Ai para meje ka qenë i hapur dhe pa ekuivok, pa makijazh dhe pa sforcim. Mbase me dhjetëra herë m'i ka përsëritur ngjarjet që më vonë do ta marrin formën e prozës së gjatë ATENTATET. E ka bërë këtë edhe në kuadrin e punës që bënim bashkë (ishim në udhëheqje të LRSSHJ-së e pastaj të LPRK-së e OMLK-së degës jashtë vendit si dhe në Redaksinë e ZiK-ut, por e ka bërë këtë edhe si para një shoku, miku, intelektuali. Unë i besoja. Ai ishte më i sinqerti, përkundër, ta zëmë Xh.Sh.-së, i cili, i kishte larguar krejtësisht intelektualët nga vendet vendimmarrëse në organizatë dhe në Redaksinë e ZiK-së, dhe ishte shumë i shkathët, orator i shkëlqyeshëm dhe specialistë i intrigave politike.

Analizat që IK i bënte për situatat, emrat e ndryshëm që vepronin në diasporë, që tash janë personazhe në ATENTATET, dhe veçanërisht ngjarjet para dhe pas

natës së 17 janarit të vitit 1982, më kanë bindur në drejtësinë e gjykimeve për njerëz dhe personalitet që tashmë janë përshkruar në roman. Këtë bindje timen shpesh ua kam thënë dhe bashkudhëheqësve në organizatat ku veproja dhe Redaksinë e ZiK. Të vetmin problem unë e kam pasur me IK.-në se ai largohej pa paralajmërim dhe jo gjithherë i jepte llogari Qendrës, ku edhe vetë bënte pjesë. Dhe, gjithmonë, unë i haja kritikat për të nga të gjithë të tjerët, sepse gjithmonë para kritikuesve e mbroja. Ndërsa kur ai vinte e takoheshim shpesh bënim shamatë të vërtetë. Ndoshta kjo e metë, e cila shpjegohet me karakterin e njeriut, për një disiplinë (apo mosdisiplinë) në jetë dhe në organizim të saj, ai vetë ia ka parë më së shumti sherrin. Sepse të gjithë më së shumti e kanë sulmuar në këtë dobësi të tij.

Shikuar në aspektin tjetër IK në atë kohë, realisht ishte lideri politik kryesor në mërgatë, gjë që për mua, thjeshtë, e bënte të kuptueshme mosrespektimin e tij të plotë të rregullave dhe disiplinës që, ne, të cilët kishim ardhur në pranverën e vitit 1984 nga Kosova (shih f. 459), përpiqeshim t'i vendosim brenda LRSSHJ-së ekzistuese, LPRK së ardhshme dhe OMLK-së Djv, ato rregulla dhe mënyra pune me disiplinë të lartë, të përditshme, milituese dhe organizative ashtu siç kishim bërë brenda në Kosovë.

Në fakt, shumë shpejt, edhe këtë disiplinë që e predikonim, pa të cilën nuk do të kishte pasur kurrë sukses LPRK nga vera e vitit 1984 e deri me 1991, Ibrahim Kelmendi i futi me sukses te bashkatdhetarët në Gjermani, Belgjikë, Suedi, Norvegji, Danimarkë, madje edhe në Amerikë.

### 2. Cili është autori

Një vërejtje: Do të ketë shkrime, letra etj., dhe mbase do të ketë edhe të tjerë, se do të thonë se IK e kanë pasur mik e shok për kokë shoku e miku, por deri më sot e kanë quajtur edhe anarkist, edhe dekonspirativ, madje edhe të rrezikshëm. Njëra anë. Ndërsa ana tjetër do të lëshoj mallkime e rrëfe mbi kokë të IK-së ashtu siç kanë lëshuar edhe dikur e lëshojnë edhe sot.

Ka edhe të tjerë, madje të njohur që, sot, IK-në e duan të gjallë vetëm për dëshmitar në ndonjë gjyq të mundshëm. Pra vetëm si një subjekt dëshmues, tregues dhe kaq. Mandej IK le të shkoj në dreq të mallkuar! Them kështu, sepse personazhet kryesore në ATENTATET i njoh mirë edhe unë, dhe veçanërisht personazhet e pas atentatit që vegjetojnë me shkathtësi edhe sot në parti politike, organizata, qeveri e mekanizma të saj, ojq-ët e shumta me buxhete të majme.

Por unë mendoj se IK ka pasur shumë shokë por edhe nuk ka pasur asnjë shok! Veçanërisht pas vrasjes së Jusuf Gërvallës! Ndërsa nga dëshmia e tij, duket kthjellët se ai vetëm Jusuf Gërvallën e ka pasur shok të vërtetë! Dhe kjo ishte e natyrshme. Në rinin e tij IK, si gjithë të tjerët, duhej ta kishte një shok të vërtetë. Dhe, ai, e gjeti pikërisht atë që i duhej për bisedë, edukim, qortim, grindje, debatim, orientim, organizim, bashkëveprim - atë më të mirin, shokun ideal! Për gjithë jetën!

Pra, të shkruash apo të mos shkruash – kjo është çështja! Të heshtësh apo të flasësh – kjo është çështja! E IK., ka vendosur që thënien e Hamletit të perifrazuar kështu në këtë rast nga unë, ta merr si njëdrejtimëshe:

Të flasësh, mos të heshtësh!
Të jetosh me historinë!
Të flasësh të vërtetën!
Ta dëshmosh aktivisht atë!
Jo në mënyrë pasive, siç mund të kërkojnë disa!

Ibrahim Kelmendi është njëri ndër emrat më të spikatur të Lëvizjes Ilegale të Kosovës të viteve 70 dhe 80-ta. Ai ishte organizatori i mirëfilltë në emigracionin politik kombëtar të viteve 1978-1984 në Gjermani dhe njëri ndër më të spikaturit në kuadrin e

organizatave që përmenda më lartë. Kontributi i tij i jashtëzakonshëm brenda tyre si dhe përvoja e tij brilante me emigracionin, ka bërë që shumë punë me rëndësi jetike për organizimet në diasporë, dhe më vonë edhe brenda në Kosovë, të marrin kahje të duhur dhe me rëndësi historike. Veçanërisht me kompetencë flasë për vitet e bashkëpunimit me IK-në 1984-1991, vit kur unë për shkaqe politike e të papajtueshme, pra edhe me IK-në, në një rast vendimtar për rrjedhat politike të organizatës, ku bënim pjesë së bashku, jam tërhequr nga politika aktive.

Por ky është një kapitull tjetër, i cili mund të hyj në romanin e ri të Ibrahim Kelmendit, ose të ndonjë autori tjetër, por pse jo edhe të prozave të mia të ardhshme. Për të shkruar një roman me ngjarje historike, me personazhe që jetojnë ende, ose që janë vrarë në rrethana të ndryshme, dhe për arsye të ndryshme, autorit i duhet guximi, të cilin I. Kelmendi e ka pasur gjithmonë. Ata që nuk e kanë njohur me herët, shprehen publikisht, madje edhe në gazeta, si të habitur, hutuar dhe të mjegulluar me guximin e I. K., për të hyrë në letërsi-histori dhe zhanret që përthekojnë të shkruarit në prozë. Kjo nuk qëndron. Sepse unë kam pasur në dorë dhe në shqyrtim, artikuj, shkrime, analiza, raporte dhe relacione politike, platforma politike, të cilat Ibrahim Kelmendi, Shoku, Martin Shtoji.., i ka shkruar me guxim të pashoq, me qartësi të jashtëzakonshme për kohën dhe rrethanat. Në fakt ndërtimi i platformës bazë për të ecur përpara dhe për të ndërtuar një organizatë masash për kohën, nuk bazohet vetëm në Tezat e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës, (teza të cilat janë pranuar edhe në ditën e 17 janarit të vitit 1982- kur ato me vendimin e përbashkët të J.G. K.Z.,I.B., dhe B.G., janë shndërruar në Program të Frontit për Republikën e Kosovës (shih faqe. 325), por edhe në platformën e guximshme dhe artikuluese mbi organizimin të shkruar në vitin 1986 me titull: "Vetëm me organizim të mirëfilltë e parimor të LPRK-së do të fitojmë statusin e Republikës"(janar1986).

IK., ishte gjithmonë i shkathtë i qartë dhe mbi të gjitha këmbëngulës. Këto cilësi të karakterit të tij i njihnim dikur, ne, që punonim sëbashku në ilegalitet e gjysmëilegalitet, ndërsa tash të gjithë po i shikojnë dhe njohin në legalitet të plotë, përmes veprës së tij ATENTATET.

**3. Historia - Dëshmia - Tronditja**

Me ATENTATET, Ibrahim Kelmendi dëshmon fuqishëm për një kohë. Për rrethana të caktuara. Ai dëshmon për një rrjedhë të historisë së caktuar që vërtetë ka ndodhur, dhe ai e tregon përmes prozës së gjatë. Mënyra e të treguarit (pra të diskursit) dhe personazhet realë ose të retushuar në mënyrë fare transparente, bënë me dije, se qëllimi i autorit nuk është letërsia, por dëshmia – pra historia. Nga kjo edhe duhet të shikohet interesimi për një libër të tillë. Historia e letrarizuar bëhet shkak më i fortë për t'u lexuar dhe komentuar. Se brenda ka një a më shumë të vërteta, një a më shumë personazhe realë. Madje në këtë rast pjesa më e madhe e tyre janë gjallë dhe vegjetojnë diku nëpër Kosovë dhe Evropë.

Historia pra ndodhi - Udhëheqësit historikë të Lëvizjes së re Kombëtare të Kosovës Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi u vranë me atentate nga armiku i popullit shqiptar. Për fat dëshmie, nuk u vra i katërti Miran Bruçaj (Ibrahim Kelmendi- Bruçaj). Apo le të themi edhe se ai u vra pa atentat për të mbetur i gjallë për historinë! Pra si në historitë tragjike, po jo si në legjenda. Se legjenda nuk është histori. Dhe legjendarizmi është mit. Dhe se miti është përrallë. Dhe se përralla nuk është e vërtetë po e shpifur. Pra personazhe reale historike u vranë për një çështje historike, për një kauzë historike, për shkak se menduan, shkruan gazeta, revista, libra e këngë, hartuan pamflete, letra e programe, organizuan demonstrime e manifestime me flamur, milituan dhe luftuan në mënyrë jo të

dhunshme për lirinë e Kosovës. Për të ndodhur kjo histori dhe tragjedi e popullit të Kosovës, u kujdesën një mori personazhesh të tjerë, politikanë e diplomatë vrasës, militantë vrasës, kriminelë profesionalë, shtabe profesionale, buxhete shtetërore, koordinime të specializuara, propagandë perfide dhe luftë speciale e strategjike. Dhe në fund plumba për ata që luftojnë kundër robërisë, për ata që luftojnë për lirinë e popullit të vet.

Por Mirani mbeti gjallë dhe ai duhet të dëshmojë e t'i zbuloj atentatet dhe atentatorët, që me sukses janë fshehur deri më sot.

Dëshmia varej në fijen e fatit brenda tragjedisë - Pra ky fat i rëndë i ra hise Miranit, pra IK-së, ku jeta nga vdekja e ndau vetëm për atë fije fati brenda tragjedisë që ndodhi mbi miqtë, shokët dhe bashkëluftëtarët e vet. Ai duhej të jetonte për të dëshmuar. Por jo vetëm të jetonte sa të merrte frymë. Por të jetonte duke luftuar. Ai e ka ditur se në atë moment që të ndalej do të ndalej dhe humbte edhe dëshmia. Pra dëshmia ishte për IK., lëvizja e pandërprerë për ta çuar idenë, programin, platformën e lirisë, flakadanin e saj, të shprehemi kështu, të 17 janarit të vitit 1982, kur ai flakadan lirie që u ndez dhe u zvenit me stuhinë dhe plojën e plumbave, por jo për t'u shuar deri në çlirim. Barra e rëndë e dëshmisë, autorit të kësaj vepre, i ka rënduar më shumë se sa t'i kishin rëndë plumbat në gjoks në natën e 17 janarit në Untergrupenbah. Autori dëshminë e mbajti brenda vetes për ta zbuluar faqe bote në moment të përshtatshëm. Ashtu siç bëri në këtë vit.

Tronditja është goditëse - Sepse ngjarja dhe goditja ishte e madhe në një kohë vendimtare për një popull që kërkonte dhe luftonte për lirinë e tij kombëtare. Por tronditja në ditët e sotme që shkakton vepra e IK., ATENTATET është poashtu e madhe dhe legjitime. Kjo ka të bëjë me befasinë që të shkakton gjetja. Kureshtja për diçka që të kujtohet, për diçka që dikush të rrëfen një të vërtetë të fshehur dhe tronditja pastaj të lëvizë duke të hedhur përballë vetvetes për ta parë të vërtetën në sy. Kjo është njëra ndër karakteristikat e njohjes së vetvetes. Zakonisht më shumë të tronditë zbulimi i diçkafes brenda vetes se te të tjetër. ATENTATET është një zbulim brenda vetvetes që kur lexuesi e lexon tekstin e librit, zbulon atë që ndoshta nuk kishte dashur ta zbuloj asnjëherë. A nuk tingëllon thënia e Jusufit para vdekjes së tij, si një lloj antidëshmie: Nëse vrasësi është shqiptar mos u zbuloftë kurrë! Sepse tronditja do të ishte e madhe për kohën kur u vranë, ndërsa dëshmia do të ishte e pakët. Ndërsa sot tronditja është e madhe se ballafaqohemi me vetveten duke parë dëshminë e bollshme historike të dëshmitarit të mbijetuar nga furtunat e plumbave dhe nga furtunat e fjalëve.
Të gjitha këto, lexuesi, tash i lexon me komoditet brenda veprës së Ibrahim Kelmendit dëshmisë së tij jetësore. Ai e sheh historinë, e përjeton dëshminë dhe tronditjen njëkohësisht.

## 4. ATENTATET - çfarë romani është dhe a është roman

(Ose një shikim ndryshe për tekstin postmodern)

Skema e famshme e Aristotelit lidhur me historinë dhe letërsinë është e qartë. Ajo nuk ka ndryshuar as sot dhe është kështu: Historia tregon atë që ka ndodhur, ndërsa letërsia (poezia) tregon atë që mund të ndodhë; historia tregon çka ngjet, letërsia tregon si mund të ngjajë; historia tregon gjëra të veçanta, letërsia tregon gjëra të përgjithshme, prandaj letërsia është më filozofike se historia. Më tutje: historiani shënjon referencat (të dhënat), shkrimtari shënjon tekstin fiktiv, të mundshmen; historiani nuk harton fabula, kurse shkrimtari harton fabula. Edhe më tej: historia mund të jetë e shkruar në vargje e të mos bëhet letërsi. Sepse e para mbështet te e vërtetdukshmja (që do të thotë e mundshme) kurse e dyta në ngjashmëri (që do të thotë e besueshme). (shih te S.Hamiti:Tematologjia, f.70).

Po pra. Secila punë i ka kriteret e veta. Edhe shkenca. Madje edhe bujqësia dhe agronomia. Pra edhe letërsia ka kriteret e veta. Ajo, një shkrim, të shkurtër apo të gjatë, në vargje, prozë apo dialog, e futë në kuadrin e kritereve të saja. Letërsia në radhë të parë merret me jetën e njeriut në formën e emitimit (memisisist), në formën e krijimit (poesisit) dhe të rikrijimit (metasisit). Dhe materien që një autor e shkruan, e nxjerrë në letër, në letërsi përcaktohen përmes zhanreve. Pra materia e autorit e letrarizuar për librin e tij duhet të përkufizohet. ATENTATET çka është: histori, letërsi, autobiografi, pra roman letraro-historik, roman memoaresh, roman i personazhit, roman i ideve, i situatave, i aksionit, roman politik apo roman kriminalistik!

Në bazë të kritereve letrare, ATENTATET, nuk është roman, madje as roman historik, as roman autobiografik e as politik e kriminalistik. Së paku nga këto llojeve letrare dhe derivime të romanit, e përjashton forcërisht platforma aristoteliane mbi artet.

Dhe, nëse nuk dëshirojmë ta përfillim as këtë platformë artistike, e domosdo duhet ta përkufizojmë brenda një lloji, atëherë duhet të flasim vetëm si për një tekst autobiografik, që automatikisht duhet lexuar dhe interpretuar ndryshe nga letërsia e mirëfilltë. Kjo do të na lehtësonte shumë. Sepse materia që sjellë autori në ATENTATET, nuk na jep të dhënat letrare për të folur për vlerat letrare artistike, por thjeshtë: biografike e, mbase, edhe historike. Madje, kur dihet autori dhe historia e tij, kur dihen historitë e personazheve të kësaj autobiografie, thjeshtë ky del edhe roman historiko-politik i një periudhe të caktuar me kulmim të mprehtë: atentatet e vërteta kundër njerëzve të shquar të Kosovës vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës.

Pra, deri sa nuk përcaktojmë më mirë se për çfarë materie po flasim, hapësira për të "manipuluar" me ngjarjet e librit të këtij autori, për të manipuluar vet autorin, përkrahësit dhe kundërshtarët e dikurshëm dhe të sotshëm të personalitetit Ibrahim Kelmendi, do të jenë sa absurde, aq edhe pa kuptim. Ndërsa definimi i zhanrit, llojit, qartëson shumë gjëra.

Këtu del vetëm një problem – linja e dashurisë në mes Miranit dhe Renatës. Kjo është linja romaneske, letrare. Por edhe kjo linjë hynë në gjithë materien e ATENTATEVE, dhe na del një përshkrim edhe më i plotë biografik.

Megjithatë brenda kornizave të njërës nga këto lloje letrare, duhet të flasim. Nëse nuk bëhet kështu dhe nëse nuk duam ta kuptojmë kështu, ne, në këtë rast, duhet të flasim domosdoshmërish për një tekst postmodern që kapërthen në vete disa zhanresh letrare: prozën e mirëfilltë (tekstin), dramën (dialogun), reportazhin (përshkrimin) idilin (dashurinë), memorialistikën (ditarin), politikën (programet, manifestet), historinë (datat, ngjarjet dhe personazhet realë), autobiografinë (kujtimet), epistolaritetin (letrat). Pra gërshetim i të gjithave këtyre elementëve përbëjnë romanin e sotëm postmodern. Kush i njeh këto probleme letrare, IK. të jep përshtypjen se i ka munguar vetëm një vidiokamerë për të xhiruar të gjithë ngjarjen dhe bashkë me librin, lexuesit t'ia jep edhe një CD (dvd) për ta shikuar konkretisht se si ka ndodhur – ndodhija!

Postmodernizmi përcakton mirë një tekst siç e ka brenda ATENTATET e Ibrahim Kelmendit. Ai është i afërt me kulturën masive dhe pop-artin, preferon të ashtuquajturin stil subversiv dhe zbaton teknikën e artit të kombinuar me referenca të shumta historike, politike, etike, estetike, etj., dhe se në planin estetik postmodernizmi e thellon procesin e zhdukjes së kufijve mes gjinive dhe llojeve letrare, kështu që në mendimin kritik e teorik gjithnjë e më shpesh përdoret nocioni neutral tekst dhe derivatet e tij të tipit: inertekst, pretekst, metatekst, hipertekst etj. (shih te A. Vinca . Panteoni i ideve letrare, f. 223-224).

**5. Cila ishte koha**

Koha që paraqitet në ATENTATET e IK., është mjaft specifike. Mund të thuhet se vitet 1978-1983, janë më të përshtatshmet për thurje të subjekteve dhe njëkohësisht për përshkrimin e saj në mesin e mërgimtarëve shqiptarë në Evropën Perëndimore. Është një kohë me thyerje të mëdha. Në këtë kapërcyllë të dhjetëvjetëshit, ndodhin ngjarjet më të madhe historike të popullit shqiptar në Kosovë, pas Luftës së Dytë Botërore – Demonstrata Gjithëpopullore historike të Kosovës të vitit 1981. Edhe ashtu mërgata shqiptare ishte e pa organizuara dhe krejt në fillimit e saja organizative. Kah të orientoheshin ata!? Kryesisht të pashkollë, gjysmanalfabetë, të ardhur nga shtresat heterogjene të shoqërisë shqiptare në ish-Jugosllavi, me një kulturë të ulët të dijeve dhe përvojave, pa familje dhe mjaft të hendikepuar; të maltretuar nga regjimi mbikëqyrjes dhe represionit të ambasadave dhe i konsullatave të ish-Jugosllavisë; duke punuar në punë të rënda dhe duke jetuar pothuajse në mjerim në mesin e Evropës industriale, vetvetiu dhe domosdo janë këto tema të madha për trajtime, qoftë në letërsi, qoftë në dramë, qoftë në dokumentarë filmikë, por edhe në analiza, libra e statistika sociopsikologjike. Vetëm demonstratat e vitit 1981, hapën rrugën dhe filloi artikulimi i kërkesave, ambicieve, synimeve dhe perspektivës së tyre për ta realizuar, lirinë e tyre, lirinë e Kosovës dhe viseve të saj në ish-federatën jugosllave.

Anarkia e organizimit dhe e drejtimeve politike ka qenë e hetueshme që nga viti 1975, kur kanë filluar të shkojnë në Gjermani dhe Zvicër, mërgimtarët shqiptarë nga Kosova dhe nga Maqedonia.Veçanërit në disa shtete dhe në SHBA, emigracioni i ri nga Kosova dhe viset e saj, hasi pothuajse në kundërshtim të plotë me emigracionin e vjetër që kryesisht kishte ardhur nga Shqipëria. Praktikisht organizimet e ndryshme, që përshkruhen në ATENTATET janë reale dhe kanë ndodhur me të vërtetë, kronologjikisht e historikisht. Gjithashtu edhe bartësit e atyre organizimeve, pjesa më e madhe e të cilëve, sot janë gjallë. Këto organizime nuk janë goditur nga ish-Jugosllavia, deri sa ka dalë organizimi që bënë IK., me Frontin e Kuq Popullor dhe sidomos me gazetën e përkohshme "Bashkimi". Goditjet janë shpeshtuar, të dirigjuara nga Beogradi, kundër emigracionit politik dhe ekonomik shqiptar në Evropën Perëndimore, vetëm atëherë kur janë parë se shqiptarët me orientime politike të qarta kombëtare, janë drejtpërdrejt kundër Beogradit pushtues e sundues të Kosovës, e veçanërisht pas vitit 1981. Dhe dihet. Ato goditje kulmuan me atentatin politik kundër Jusuf e Bardosh Gërvallës, Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit. Them edhe të IK., sepse mosvrasja e tij ka qenë vetëm një rastësi! Një rastësi dhe asgjë më shumë! Ashtu siç u përpoqa ta zbërthej më lartë: rrethanat e ruajtën për të dëshmuar sot historikisht për kohën, rrethanat dhe atentatet kundër bijve të Kosovës, kundër lirisë së Kosovës në këtë periudhë, e cila po dëshmohet se ka qenë e një rëndësie vendimtare për fazën e re të luftës për çlirim.

Marrja me tema të mëdha politike, qoftë edhe duke i përshkruar ato në formën e kujtimeve, dokumentaritetit dhe formës autobiografike si dhe sajimi për herë të parë i tyre në gjinin e prozës, nga I. Kelmendi, është një kamuflim për të shfaqur e depërtuar idetë, veprimet, dhe veçanërisht sqarimet për një kohe të caktuar historike. Kjo është bërë me qëllim dhe është krejt e lejueshme edhe në shkrimtarinë e sotme.

Në një mënyrë ose tjetër të jepet ideja se sikur në këtë vepër të Ibrahim Kelmendit është trajtuar i gjithë emigracioni në Evropë në mënyrë horizontale dhe vertikale deri në ditët e sotme. Jo njëherë e kam dëgjuar këtë koncept, i cili po shkallëzohet dhe po e merr trajtën e një gabimi, qoftë i paqëllimshëm, qoftë i qëllimshëm.

Romani përfshin dhe përmbledhë vetëm një kohë të caktuar, me personazhe të caktuar, me hapësirë të caktuar: nga viti 1978 e deri në verën e vitit 1984, pra gjashtë vjet. Madje edhe autori e shënon gabim këtë periudhë. Ai thotë se ngjarjet janë të viteve 1979-1982, gjë që në bazën e materies që sjellë në ATENTATET, ngjarjet ndodhin brenda viteve 1978-verë 1984. (Kujto ngjarjet që tregohen në retrospektivë para 1979-tës si dhe ngjarjet që tregohen pas atentateve deri në fillim të vitit 1984.)

Periudhat 1984-1990, 1991-1997 të Lëvizjes Ilegale të Kosovës jashtë vendit, (veçanërisht LRSSHJ-LPRK-LPK dhe OMLK-djv.,) janë dy periudha politike që kanë krejtësisht karakteristika të tjera ani se janë pasardhëse të periudhës 1978-verë1984. Ato periudha kanë intensitete të tjera, organizime të tjera, përvoja dhe kahe krejtësisht të qarta, me programe dhe statute të definuara, natyrisht edhe me probleme dhe specifika të veçanta të atyre problemeve, me kuadro të larta, të profilizuara e të specializuara, me organizime të qëndrueshme dhe kontinuitive, me lidhje të rregullta brenda-jashtë dhe anasjelltas, e deri te themelimi, po nga këta militantë, e organizatorë, politikanë e strategë luftarakë të këtyre organizatave - i Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Prandaj kur flitet për ATENTATET e autorit IK., domosdo duhet të sqarohet dhe theksohet periudha kohore e organizimit dhe veprimeve të mërgatës ekonomike dhe politike në periudhë të caktuar 1978- verë 1984, që mos të manipulohet me hapësirën dhe kohën ku janë vendosur ngjarjet historike, dokumentare e autobiografike në këtë vepër.

### 6. Cilët janë personazhet

Personazhet e veprës së IK., mund t'i ndajmë në katër grupime. Me që janë të gjithë personazhe historikë, pra që i përkasin një kohe dhe epoke të caktuar, disa prej tyre janë edhe të kamufluar me një shtresë të hollë konspiracioni të përkohshëm.

Grupi i parë i personazheve janë ata që u vranë. Por ata u vranë jo të gjithë për të njëjtat motive dhe arsye. Vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka janë emrat historik që e vulosin gjithë hapësirën e kohës në ATENTATET, e mbi të cilët ranë plumbat për të bërë katrahurën e madhe mbi ta, mbi familjet e tyre, dhe para së gjithash, për të bërë plojën e madhe mbi Lëvizjen Ilegale e gjysmëilegale të Kosovës brenda e jashtë Kosove.

Të tjerët (që dalin jashtë këtij grupi) e që vriten si V. Ibrahimi etj., nga motive e mistere të pasqaruara ende, janë personazhe me bagazhe jetësore të dyshimta e kontraverse.

Grupi i dytë, i militantëve të vërtetë, i naivëve militantë, diplomatëve, përkrahësve: Mirani, Vasili, Maksi, Renata, Mihaili, Hydajet Hyseni, Ajshe Gërvalla, Marta, Kryehetuesi Majer, Engjëlli K., Simoni Ç. Benedikt Shafer, Hakan Mali, Dritë Gërvalla, Dardana, Bulja (Saranda), Fatkeqja, Bardhec R., Zymer P., Demushi, Baca Nesim, Xhelë Kalishti, Rexhep Halimi, Shyqeri Gjeneva, Hasan Kadria, Abdullah Tahiri, Baca Avni, Baca Zymri, Muja, Sabrushi, Suliot e Vesmirë Nelaj, Murtez Kryebardhi, Ryshan B., Hajzer Lumi, Agroni, Naili, Osalan Isforti, Enis Mitrovica, Drilona, Ahmet Zherka, Diellza, Gjeto S., etj., në ATENTATET janë ata të cilët përpiqen të bëjnë diçka më shumë për Kosovën dhe lirinë popullit të vet dhe popullit shqiptar. Pjesa më e madhe e tyre na dalin të gatshëm që, kurdoherë, të sakrifikohen për Kosovën dhe lirinë e saj.

Grupi i tretë i përgojuesëve, lakmitarëve, intrigantëve, pseudopatriotëve, shantazuesëve, arrivistëve dhe problematikëve: Sabit Katunriu, Garipi, Rrahmani, Bedriu, Minush M., Nuri Syleviqi-Qerosi, Nazimi, Fahri Faleku, Xhahil Rambeja (Xhaviti), Proletari, Enver Hadri, Vehbi Ibrahimi, Musa Hoti, Hafif Gagaj, Fazit Melaj, Halim Berbati, Ahmad Sadeku, Rexhit Sahataj, Galan Azapi, Xhafar Dunkeli (Skenderi)., Xhabir Shatori (Bacaloku), Avdyl Prapashpina, Ambasadori A.B., Korrespondenti

A.S.,etj., në ATENTATET, janë ata të cilët bënë ashtu siç u detyruan të bëjnë, siç patën dëshirë të bëjnë, siç nuk ditën të bëjnë, apo siç i urdhëruan të tjetër të bëjnë kundër lirisë së popullit të vet.

Grupi i katërt i spiujve, vrasësve, kriminelëve, Rezil Mejtepi, Fekir Dalena, Selim Brosha, Ermir Fatahu, Josip Karaxha, Sadi Bakaj, Adashi i Jusufit, Diplomati B.H., Mysafiri nga Bllaca e Lumbardhit, etj., në ATENTATET tipizohen si informatorët e shkëlqyeshëm, frymëzuesit, nxitësit, përpiluesit, farkuesit, urdhërdhënësit e urdhërmarrësit, shkelësit, vrasësit dhe ekzekutorët deri në krim, kundër lirisë së popullit shqiptar, kundër Kosovës.

### 7. Autori - Personazhi

Shpesh flitet se personazhi është edhe romani, vepra e tij. Ose anasjelltas: romani është personazh dhe lexuesi e ndjekë atë nëpër tekstin e tij. Ky është edhe një debat në teorinë e letërsisë. Ka roman personazhi. Ka dramë personazhi. Pra ka edhe monodramë.

Te ATENTATET, na del Mirani personazhi kryesor. Ai është unik dhe i gjithkundshëm. Pa te dhe veprimin e tij, nuk lëviz as teksti në këtë libër. Ai është i gjallë, por edhe i vdekur. Ai fletë, diskuton, qeshë, feston, dashuron, qanë... Ndoshta është njëri ndër personazhet më të tejdukshëm në letërsinë shqipe të njëzet viteve të fundit. Kur një libër ka brenda vetes autorin si personazh, aq më shumë ky libër është autobiografik dhe postmodern, figura e tij bëhet më popullore, e din të gjithë lexuesit se kush është në mënyrë konkrete. Ata nuk kërkojnë shëmbëllim, sepse ai është unik. Nuk ka si të tjerë. Ai është pranë tyre dhe me ta.

Kjo është përparësia e autorit personazh dhe e personazhit autor te romani postmodern ATENTATET, te romani autobiografik i Ibrahim Kelmendit, sepse Mirani është vet ai.

### 8. Jehona – Mbyllja - Hapja

Jehona e ATENTATEVE është e pritur. Ajo është e fuqishme dhe e arsyeshme. Rrëfimi i tekstit është dramatik. Sepse historia është vetë drama e jetës. E gjithë materja realizohet me një dialog të shkathët, por që duhej përpunuar edhe pak, për t'u ngritur në nivelin e pranueshëm letrar, të shijes letrare dhe vlerës artistike. Pra, tendenca që të mbetet teksti sa më afër tekstit të historisë, ka rrezikuar drejtpërdrejt tekstin letrar dhe vlerën e tij. Në këtë rast dialogun letrar dialogun artistik. Duke munguar përshkrimet gjatë dialogjeve, ta zëmë të sjelljes së një personazhi, shprehja e fytyrës apo anët psikologjike e botës së brendshme, shpesh faqe të tëra tekstesh na dalin si një procesverbal i mbledhjeve të celulave organizative. Kjo e ka dëmtuar në një masë leximin dhe përjetimin normal, për sot, por për jetëgjatësi dhe rilexime, vështirë që mund të mbajnë peshën e kohës.

Është e kuptueshme se jehona ishte e fuqishme sepse atentatet mbi Jusufin, Kadriun, Bardhoshin dhe Ibrahimin, ishin të fuqishme. Madje jehona e atentatit ishte shumë më e madhe pas likuidimit fizik të tre prej tyre. Plojën e vetë të vërtetë, atentatet e kanë bërë duke u shndërruar e shumëzuar në grindje, përçarje, fyerje dhe hutim të plotë në mesin e mërgimtarëve, të cilët edhe ashtu kishin organizim të dobët e fillestar. Ndërsa liderin organizativ dhe politik, Ibrahim Kelmendin i cili për fatin e tyre të mirë u shpëtoi plumbave, në vend se ta marrin dhe ta vendosin në vendin ku e kishte dhe të shkonin pas tij, ata e morën nëpër këmbë, e fyen, e degraduan, e mohuan dhe dëmi ishte i pakrahasueshëm, dhe, për një kohë të gjatë i pariparueshëm.

Jehona e ATENTATEVE sot, pikërisht edhe për këtë është e madhe. Sepse tash shihet krejt qartë se sa i madh është bërë gabimi, veçanërisht PAS ANTENTATIT. Befasi të madhe shprehin edhe të tjerët për ato që kanë ndodhur në mesin e atyre organizimeve të tilla siç ishin, dhe me ata njerëz-personazhe realë që kanë vepruar për dhe kundër Kosovës.

Mbi të gjitha kjo është JEHONA e mirë, e bukur, e thellë e librit të mirë, që të jep diçka me tekstin e vet, që të jep një të vërtetë të një kohe dhe të atyre njerëzve. Dhe, këtë, mund ta quaj kohë të mirë të librit dhe të vërtetës në kohë të mira që po vijnë për Kosovën dhe librin e saj, tekstin e saj, të vërtetën e saj.

Pavarësisht kësaj, nuk duhet të harrojmë se romani krijohet nga autori, ndërsa historia shkruhet nga historianët dhe nga ata që përjetojnë në formën e memoareve apo e rrëfejnë në formën e autobiografisë apo kujtimeve. Prandaj ta theksojmë edhe një herë librin, këtu prozën e gjatë si roman apo si histori. Dhe, këtu, patjetër, funksionon fantazia e besueshmërisë te lexuesit tashmë të shumtë të këtij autori. Sepse, pëlqehet më tepër historia si e besueshme, ndërsa refuzohet romani si i shpikur, i krijuar si letërsi autoriale. (shih edhe te S.Hamiti.Tematologjia f.73).

Mbyllja e një lënde, e një teksti, mund të ndodh. Po. Edhe në ATENTATE T të Ibrahim Kelmendit ka ndodhur një mbyllje. Por kjo nuk është mbyllje e qëllimtë. Kjo është krejtësisht teksture, tregimtare. Autori ka përfunduar, ka mbyllur një rrëfim, një dëshmi. E kjo dëshmi e ka rënduar për një çerek shekulli. Nuk është pak. Në shpirtin e autorit ka gërryer koha si thartira një enë që nuk zbrazet. Teksti, rrëfimi, dëshmia më në fund shkrimi është një pastrim (katarsis) që me këtë roman ka ndodhë dhe është çliruar e vërteta e autorit dhe është çliruar vet ai. Ai ka mbyllur një cikël dialogësh, monologësh, një varg vajesh dhe një varg plumbash që kanë marrë jetërat e shokëve dhe bashkëluftëtarëve të tij. Natyrisht bashkë me të gjitha këto është rrumbullakësuar me një rrëfim të veçantë, me një tekst të veçantë, një kohë dhe periudhë e veçantë, krejt natyrshëm.

Hapja bëhet e natyrshme pas përfundimit e mbylljes së natyrshme. Ibrahim Kelmendi ka fituar përvojë me ATENTATET dhe ka marrë më shumë guxim nga lexuesi i tij si dhe jehona e mirë, shumë e mirë, e librit. Ai tashmë mund të përballoj edhe shkrimin e teksteve të tjera letrare, artistike, dokumentare a historike edhe me nivele më të larta. Mjafton që tash ka bërë një përmbyllje të qëlluar në veprën e tij të parë të këtij lloji, në kuptimin e ideve dhe ecurisë së tyre deri në një jehonë, deri në një mbyllje dhe deri në një hapje.

Tash, Ibrahim Kelmendi nuk e ka aspak të vështirë të bëjë një hapje të re për të depërtuar edhe më thellë në perandorinë e shkrimit edhe të shkrimtarisë.

(www.pashtriku.org)

## 18. BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN E HIDHUR TË KOSOVËS TË TREMBË PËRHERË

Intervistë me Ibrahim Kelmendin – Republika, nr.5/2007
Intervistoi: Salih KABASHI, Botues i revistës Republika

Ibrahim Kelmendi është personalitet i njohur politik dhe publicistik i Diasporës shqiptare në Evropë. Një ndër njohësit më të mirë të saj, një kohë të gjatë bashkëpjesëmarrës dhe bashkënismëtar i lëvizjeve kombëtare jashtë vendit, ai muaj më parë ka bërë një bum të vërtetë mediatik me librin më të ri të tij me titull “Atentatet”, ku me një stil të rrallë dhe modern prej rrëfimtari të saktë, ka shpëluar anët e errëta e të

shumëpërfolura të aktiviteteve klandestine dhe figurave të njohura e më pak të njohura në emigracionin e ri shqiptar të Kosovës, dhe jo vetëm të atij. Duke qenë se libri “Atentatet” është një arenë e gjerë ku zbulohen e demaskohen prapaskena të ngjarjeve të ndryshme brenda gjirit të mërgatës sonë, duke qenë se në atë arenë defilojnë rezilë e katilë përballë një mase shqiptarësh të vuajtur dhe të djegur për Atdhe, duke qenë se në librin e tij e shohim cipërcullak të zhveshur edhe UDB-në gjakatare, edhe mjeranët shqiptarë, të cilët pa ia ditur mirë hallin vetit, ishin futur atje ku e kanë vendin vetëm të mençurit, të ndershmit dhe trimat, duke parë, në fund, se me librin “Atenta¬tet”, pothuajse është hequr misteri i atentatit më të bujshëm të UDB-së mbi tre shqiptarë të mëdhenj, duke e nxjerrë në kokër ledine vetë vrasësin, ne, autorit të librit, z. Ibrahim Kelmendi, i jemi drejtuar për një intervistë. Ai pas pyetjeve tona ka bërë shëtitjen e tij nëpër një kohë të vrullshme, duke evokuar dhe duke dëshmuar për një pjesë të historisë, në të cilën ai padyshim e ka vendin e tij të merituar, tepër interesant dhe gjithsesi të dhimbshëm.

**Republika**: *Libri yt “Atentatet” ka zgjuar interesim të madh ndër lexues. Me të ke gëzuar dhe ke hidhëruar njerëz. Këtë e kam parë si diçka normale. Por, duke biseduar rreth librit tënd kam vënë re se disa edhe janë trembur! Si e shpjegon këtë të fundit?*

**KELMENDI**: E logjikshme se do të tremben. Nuk është i lehtë ballafaqimi me të kaluarën, sidomos për ata që dëshirojnë të real ektojnë. Edhe vetë jam trembur pasi e kam lexuar romanin, por tashmë si lexues. Sa herë i kam shtruar vetes pyetjet: Është dashur Mirani dhe bashkëveprimtarët e tij t’ia vështirësojnë e t’ia ngatërrojnë aq shumë vetes jetën e tyre, gjegjësisht veprimtarinë e tyre? A mos kanë mundur të zgjedhin një rrugëtim më të thjeshtë dhe më të suksesshëm? Përse është dashur t’i bëjnë aq shumë hile njëri-tjetrit? Përse të angazhuarit e UDB-së dhe të strukturave të ngjashme nuk kanë respektuar ligjet përkatëse të kohës, për të mos sharruar deri në krime të rënda e antiligjore, rrjedhimisht përse janë angazhuar deri në kriminalitet ekstrem – atentat ndaj personaliteteve kaq njerëzore, siç ishin Jusufi, Kadriu e Bardhi? Përse veprimtarët patriotë nuk kanë qenë më të ngritur, për të gjetur forma më demokratike të organizimit? Përse panevojshëm i kanë ngatërruar konceptet ideo-politike, kur, parë nga pozicionimi i tanishëm, duket se duhet ta kenë pasur më të lehtë t’ia qëllojnë, se si mund të bëhej më lehtë dhe më mirë ajo veprimtari patriotike, sesa si kanë menduar e vepruar? Më këso pyetjesh mund të vazhdohet edhe më. Duke iu përgjigjur pyetjeve të tilla, secili personazh i romanit do të duhej të ndjehej i ndruajtur, për të mos thënë i trembur, siç jeni shprehur ju. Po vjen koha e llogaridhënies për secilin personazh që ndjehet i ndruajtur dhe i frikësuar, para vetes dhe para të tjerëve; ai që ka bërë krime të japë llogari për krime, ai që ka bërë gabime, të japë llogari për gabime, madje edhe ndonjëri të ndjehet i penduar, përse nuk ka menduar e vepruar më mirë e më shumë. Sigurisht, edhe Mirani duhet të ndjehet i ndruajtur: Ka marrë përsipër barrë të rëndë, pa qenë i parapërgatitur, gjegjësisht pa qenë i zoti, për t’i dalë zot si duhet e sa duhet.

**Republika**: *Kjo kohë e PASLIBRIT, le ta quaj kështu, çfarë përmbushje (kënaqësie) të ka sjellë?*

**KELMENDI**: Thënë të drejtën, ndjehem sikur kam bërë një si katarsis (çlirim të shpirtit), pasi kam qenë i mbingarkuar me barrë të rëndë, kurse tani sikur po ndjehem i shkarkuar.

## Asgjë më të bukur e më të ëmbël s'ka sesa e vërteta

**Republika**: *Në librin tënd ka lloj-lloj personazhesh, disa prej të cilëve, pavarësisht kamuflazhit të hollë që u ke bërë, disa nga ne nuk e kemi aq vështirë t'i identifikojmë. Ndërkohë që edhe më lehtë do ta kenë që aty ta gjejnë veten ata që të mbuluar e gjysmëmbuluar shfaqen gjatë rrëfi mit tënd artistik-memoaristik. Cilat janë reagimet e tyre, pasi që, supozoj, nuk do ta kenë lehtë gjatë asaj cope jetë që atyre u ka mbetur?*

**KELMENDI**: Edhe Miranit mund t'i vijë keq për shumë (mos)angazhime të tij, edhe atij i duhet të merret me të kaluarën në pjesën e jetës që i ka mbetur, që do të thotë, edhe Mirani do të më japë llogari mua. Po kështu, edhe personazhet tjera do duhej të ballafaqoheshin me veprimtarinë e tyre. Uroj që t'u ketë mbetur njerëzi e mjaftueshme, që ta përpunojnë njerëzishëm të kaluarën e tyre. Edhe për Rezilin ndjej keqardhje, pasi edhe ai nuk do të ishte i tillë, sikur të mos jetonte në atë hapësirë e kohë, gjegjësisht në ato rrethana. Sigurisht, sikur Kosova të mos kishte qenë e robëruar, sikur të mos kishin qenë ato struktura e mekanizma, që i krijon çdo pushtues, edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i mvishen në roman. Sa njerëzore do të kishte qenë, sikur ai vetë ta tregonte publikisht gjithë të vërtetën. Atëherë unë do të kisha treguar mëshirë njerëzore për të, duke u nisur nga fakti, se kolektiviteti ynë (kombi ynë), nuk ka qenë në gjendje ta rrethojë secilin pjesëtar të tij, që të mos rrëshqasë në krime, siç mendoj se ka rrëshqitur Rezili. Sa u përket reagimeve të personazheve, deri tani kam pasur vetëm reagime pozitive. Në përurim të librit ishte i pranishëm edhe Vasili, me të cilin u përqafuam shumë përmallshëm, pasi nuk ishim parë prej kohësh. Letër më ka dërguar edhe bashkëshortja e Kadriut. Me lejen e saj po sjell një pjesë të letrës: "Ka kohë (vite) që nuk jemi parë, por ja që bota është e vogël dhe për të gjallët krijohen mundësi në çaste të caktuara kontakti. Në këtë rast kontakti elektronik. Këtë e bëj, pas leximit të veprës tënde historike 'Atentatet', për të cilën të përgëzoj nga zemra! Edhe njëherë urime! Me të dalë nga shtypi e lexova me një frymë. Pasi jam njëra ndër protagonistet e asaj ngjarjeje makabre që bëri UDB-ja me vrasjen e tre bijve (udhëheqësve të denjë) të Kosovës dhe në disa rrethana kam qenë edhe pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në ato ndodhi para dhe pas vrasjes, nuk u durova pa të shkruar, për të përgëzuar. Të them të drejtën, u ktheva prapa 25 vjet, duke kujtuar e përmalluar dhe plot emocione atë kohë sa të bujshme, aq edhe të dhimbshme, ku ti me spikamë ke paraqitur çdo personazh. Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë. Vërtet secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë. Kjo më bën të besoj se edhe ata të cilët nuk pata mundësi t'i njihja, i ke paraqitur tamam ashtu siç ishin në realitet, të lidhur me UDBnë jugosllave, për të shkatërruar Lëvizjen..."

Po i mirëpres edhe reagimet kundërshtuese, sulmuese e fyese, edhe për faktin se tani jetojmë në rrethana të çliruara dhe mund të diskutojmë, të debatojmë e të përplasemi publikisht e demokratikisht, rrethana këto që fatkeqësisht nuk i kishim kur na kanë ndodhur gjithë ato përplasje, hile e tragjedi, por edhe suksese, meqë, megjithatë, ia dolëm të formojmë organizatën për të cilën ishim angazhuar dhe kishim vendosur bashkë: Jusufi , Kadriu, Bardhoshi dhe unë.

Gjykimin real do ta bëjë brezi tjetër, pasi ai do jetë i liruar nga subjektivizmi ynë

**Republika**: *Jo vetëm gjatë leximit të veprës, por edhe tashti kam menduar se ti mund të kesh provokuar ortekun me rrëfi min tënd të guximshëm. A mendon se në të ardhshmen mund të kemi edhe nga të tjerë libra të ngjashme mbi veprimtaritë në emigracion?*

**KELMENDI**: Sigurisht. Sa për sqarim, kam botime të gatshme, por nuk i kam botuar, për disa arsye. Arsyeja më kryesorja ka qenë distanca e pamjaftueshme kohore, si në rastin e ngjarjeve që trajtohen në roman. Pata filluar me përgatitje të librave, në të cilët do të trajtoheshin (në pikëpamje publicistike), në mënyrë sa më të kompletuar, gjithë veprimtaria patriotike e emigracionit.

Kur z. Shaban Sinani i bëri recensionin librit për emigracionin e Belgjikës, më pati këshilluar që ta shtyj për më vonë botimin e atij libri. Pra, bëhet fjalë për librin, të cilit i është bërë edhe korrektura gjuhësore dhe është bërë faqosja dhe ai po pret i faqosur (në boca) kohën kur duhet të botohet. Po vetëkuptohet, po pret edhe mundësitë financiare për ta realizuar botimin. Në fazë të përgatitjes janë për secilin shtet të paktën nga një libër dhe të tjerë.

Shpresoj se edhe të tjerët do merren me këtë tematikë, secili nga këndvështrimi i tij, për të kompletuar gjithë tablonë, pasi të paktën një e treta e shqiptarëve janë emigrantë dhe ata kanë dhënë kontribut të gjithanshëm, i cili nuk do të duhej të injorohej. Kurse gjykimin real do ta bëjë brezi tjetër, pasi ai do jetë i liruar nga subjektivizmi ynë. Atij brezi do t'ia lehtësojmë punën vlerësuese, nëse i përgatisim sa më shumë informacion dhe analiza, qofshin këto edhe subjektive.

### Arkivi më i saktë është vetë populli

**Republika**: *Një ditë do të hapen dosjet, ku secili do të ketë mundësi, si në Slloveni, bie fjala, që të ketë qasje në dosjen që ka mundur ta ketë mbajtur për të Shërbimi i Sigurimit të Shtetit, apo ndryshe policia politike komuniste e njohur si UDB. Kur kihet parasysh se dosje të tilla janë bartur në Beograd, a mund të imagjinosh rrëmujën që do të shkaktonte kthimi i tyre në Kosovë dhe hapja e tyre për publikun?*

**KELMENDI**: Nëse Beogradi nuk do të demokratizohet, atëherë duhet pritur se dosjet do të manipulohen e do të sajohen, varësisht nga nevojat politike ditore, për t'i shërbyer politikës se tyre nacionaliste. E vetmja mundësi për t'ju kundërvënë spekulimeve hileqare është trajtimi i tyre nga ekspertët. Zhvillimi i shkencës ka shkuar deri atje, sa të konstatojë saktësisht se kur është përpiluar një shkresë, gjegjësisht një dosje. Prandaj dhe duhet të shfaqim rezerva, kur ata do t'i servirin. Kurse arkivi më i saktë është vetë populli, pasi secilit individ ai ia di veprimtarinë konkrete, që do thotë se rrethi ku jam angazhuar unë e di se cili kam qenë dhe çfarë kam bërë. Disa kujdestarë janë interesuar më herët ta bombardojnë opinionin me dezinformata, por në fund të fundit, mua asnjë dezinformatë nuk do të më irriton për atë që e kam njohur personalisht.

**Republika**: *Njëri nga personazhet e tua, në Rambuje, gjatë mbajtjes së Konferencës, me pretendimin e njohësit të historisë, për të mos thënë se propagandonte, tregonte me shembuj se ne si komb mund të kemi perspektiva vetëm nën farë perandorish. Tregonte për perandorët bizantinë e romakë me origjinë ilire-shqiptare, për pashallarë turq po ashtu të rrënjëve tona kombëtare dhe vinte te kulmi: arritja mu në krye të shtetit jugosllav të shqiptarëve nga Kosova si kuadro federative. Përfundimin nuk e kishe vështirë ta nxirrje: të rrinim ende me Serbinë sepse aty, donte të linte të kuptohej, mund të shkëlqejmë më mirë si komb!!!*

**KELMENDI**: Ai ka shpërdoruar të drejtën e lirisë së të shprehurit të mendimit, edhe pse spekulimi dhe falsifikimi, ose pozicionimi kundër lirisë së kombit tënd, nuk mund të arsyetohen me liri të mendimit.

**LPK-ja në Bruksel nuk e pranoi në gjirin e saj Enver Hadrin**

**Republika**: *Edhe në librat edhe në intervistat është vënë re një guxim i mirëfilltë që t'i çmitizosh disa fi gura të emigracionit, të cilat tanimë kanë dhe lapidarë dhe një literaturë të tërë himnizuese për ta. Me pak fjalë, edhe një herë: Kush ishte Enver Hadri?*

**KELMENDI**: Nuk di të ketë bërë ndokush lapidar për Enver Hadrin, i cili edhe do të mund ta kishte merituar para Vebi Ibrahimit (të cilit i është ngritur një në fshatin Uglar të Gjilanit dhe shkollës aty i është vënë emri i tij). Nga këndvështrimi im, i ndjeri Enver Hadri ka qenë personalitet i dyzuar, tepër kundërthënës. Nuk më kanë penguar (dez)informatat e përfoljet se ai u shërben njëkohësisht Sigurimit shqiptar dhe UDB-së jugosllave. Unë kam qenë i prirë të vlerësoj kontributin e përditshëm të secilit.

Ta zëmë, kur Sekretari i parë i ambasadës jugosllave në Bon, z. Shefqet Hashani, na përkrahte gjatë formimit të Klubit shqiptar në Düsseldorf (Dyseldorf), ne e mirëpritnim, edhe pse ai ishte një krye-udbash zyrtar, ndërsa na hidhëronte kundërvënia e korrespondentit të atëhershëm të gazetës "Rilindja".

Të kthehem edhe një herë te Enver Hadri. Gjatë viteve të fundit Lëvizja ka bashkëpunuar me të, por duke e mbajtur në distancë, pra i jepnim të dhëna për gjendjen në Kosovë që ai t'i plasonte dhe kaq. Lutjes së tij për ta pranuar në Lëvizje nuk i përgjigjeshim, sepse anëtarët e Lëvizjes në Bruksel nuk e pranonin.

Në fund gjykuam se ai e pagoi me jetë vendimin e guximin e vonuar për të dalë nga tutela e UDB-së, prandaj u angazhuam t'ia bëjmë një varrim pompoz kur atë e vranë kriminelët serbë. Kurse mitizimi, se ishte intelektual, bënte shumë veprimtari patriotike, kishte lidhje të mira me strukturat politike në Bruksel e Strasburg, është vetëm mitizim, i prodhuar dhe i fryrë kryesisht nga padronët e tij në fillim dhe më vonë nga ata që dëshiruan të përfitonin individualisht nga vrasja e tij. Sigurisht edhe nga të painformuarit. Po më lejuat, do t'i bëja një lloj vlerësimi matematikor angazhimit të tij. Guximi dhe vendimi i tij për të dalë nga tutela e shërbimeve inteligjente jugosllave, përfitimi politik nga vrasja dhe gjatë varrimit të tij (nëse mund të shprehem kaq teknikisht), i kompensojnë me mbi 50 për qind dëmet e tij të viteve të 80-a. Prandaj unë do ta klasifikoja më shumë pozitiv sesa negativ.

**Republika**: *Po Vehbi Ibrahimi?*

**KELMENDI**: Për këtë njeri, si edhe për të ndjerin Musa Hoti, në rivarrimet e të cilëve qe angazhuar edhe TMK-ja, nuk diskutoj me dëshirë, pasi në hapësirë e kohë i kam urryer për veprimtari të tyre të dendura kriminale. Vetëm kur do të më ofrohen argumente të tjera për kundër, që unë nuk i kam ditur, do të ndërroja qëndrim dhe t'u kërkoja falje publike.

**Republika**: *Një pyetje tjetër: A ka pasur dhe sa mund ta ketë pasur UDB-ja në dorën e saj politikën kadrovike në lëvizjet atdhetare të emigracionit?*

**KELMENDI**: Përgjigjja e saktë do të dalë kur do të hapen arkivat, por parë nga distanca e sotme, duke analizuar veprimtarinë e disa veprimtarëve, them se UDB-ja mund t'i ketë futur hundët në radhët patriotike të mërgatës, më shumë sesa dëshirojmë të dyshojmë. Sigurisht, do kishim bërë më shumë, sikur të kishim qenë në gjendje të minimizonim dobësitë tona, për të përballuar luftën speciale që na bënte UDB-ja, sidomos luftën që e bënte përmes të ashtuquajturit organizim të legalizuar pluralist gjatë viteve të 90-ta.

**Republika**: *Doni të thoni se LDK-ja e Diasporës kishte brenda njerëz të UDB-së?*

**KELMENDI**: Në trendin (euforinë), për mendimin tim të inskenuar në Beograd, pothuajse gjithë pjesëtarët (informatorët) e UDB-së dorëzuan librezat partiake të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës dhe u anëtarësuan në LDK-në (popullore). E njëjta eufori ndodhi edhe në Perëndim.

Sa për informim, Programin, Statutin dhe fletë-anëtarësimin në LDK i kam shtypur e shumëzuar për herë të parë unë (të përpunuar mirë grafikisht) dhe kam angazhuar që të shpërndahen në demonstratë të LPK-së në Bon në fillim të vitit 1990. Gjykoja se duhej të ndihmohej që të organizohej edhe në Perëndim, për të angazhuar bashkatdhetarët që frikësoheshin të angazhohen në LPK. Pata vepruar kështu, edhe pse kisha dyshime se riorganizimet në Kosovë nuk ishin autentike. Ai riorganizim po ndodhte në kohën kur Lidhja e Komunistëve të Kosovës, Lidhja Socialiste, Lidhja e grave, Lidhja e Rinisë, etj., deri diku i kishin dalë nga kontrolli pushtetit të centralizuar monist në Beograd. Tani, po themelohej një LDK, që duhej të përfshinte gjithë popullin dhe në mënyrë të centralizuar, të kanalizuar dhe të kontrolluar duhej të menaxhohej revolta popullore e vitin 1989. Dhe fatkeqësisht ajo ndodhi. Revolta e rrebelimi aktiv i vitit 1989 u futën në arkivolin që mbante mbishkrimin LDK.

Megjithatë, po ndihmoja LDK-në që të shtrihej edhe në Perëndim, edhe pse Programi i saj binte ndesh me këmbënguljet e deputetëve të Kosovës në Kuvendin federativ, të cilët po mundoheshin të mbronin diskualifikimin juridik e politik të Konferencës së Bujanit, të cilin e kërkonin deputet serb, në kohën kur Programi i LDK-së ishte pozicionuar kundër vendimeve të Konferencës se Bujanit, etj.

Shkurt e shqip, në LDK nuk ishin infiltruar njerëz të UDB-së, por ata ishin ndër bashkëthemeluesit kryesorë të saj dhe ata ia përcaktonin kahen ideo-politike e organizative.

Sa herë bashkëveprimtarët më kishin informuar, se e kishin parë UDB-ashin famëkeq, Selim Brosha, të vizitonte Kryetarin e LDK-së në Gjermani, z. Hafi z Gagica, në zyrat e kësaj Lidhjeje në Shtutgart. Dhe kjo nuk ndodhte fshehurazi, por me një soj fodullëku, për të dëshmuar për rrethanat e kthesat e reja që po ndodhnin në Kosovë e jashtë.

Në fillim UDB-ja shfrytëzonte edhe dobësitë e paaftësitë tona organizative

**Republika**: *Ç'ishte ajo punë: Iknin nga burgjet, apo thjesht vinin në Gjermani a Zvicër dhe hop! bëheshin liderë të organizatave me emërtime patriotikeçlirimtare!*

**KELMENDI**: Në fillim nuk kishim të dhëna dhe mundësi për t'u mbrojtur nga të tillët, sepse UDB-ja, nëpërmjet atentateve, na e kishte zënë hapin. Pastaj, ata i shfrytëzonin edhe dobësitë e paaftësitë tona organizative, fillestare. Më vonë kaluam në ekstrem tjetër. Vinin nga Kosova kuadro të sprovuar patriotikisht, na afroheshin, ne (disa drejtues të Lëvizjes) i denigronim ata duke i detyruar të bëhen anëtarë të thjeshtë në bazë, siç shpreheshim atëherë, ose nuk i afronim fare, nëse ata ishin më të kualifikuar intelektualisht.

**Republika**: *Në emigracion, pos punëve të mëdha në dobi të Kosovës, ka pasur me shumicë intrigë. Ka pasur edhe përcjellje të njerëzve të thjeshtë dhe të dëlirë duke shpifur për ta se gjoja nga një kabinë telefonike në Zürich, Düseldorf a Gjenevë ishin dëgjuar të përmendin emra të ndryshëm që intriguesit i lidhnin me personazhe konkrete në hierarkinë e policisë sekrete jugosllave. Ju udhëheqja, bie fjala e LPK-së, e keni toleruar një gjë të tillë, madje e keni praktikuar. Kështu punëtorët sezonalë shantazhoheshin jo vetëm nga UDB-ja e Jugosllavisë por edhe nga njëfarë maniri udbesk përbrenda lëvizjeve të emigracionit...*

**KELMENDI**: Sindromi i frikës ishte gjithandej, pasi UDB-së i kishte dale nami si e gjithëpranishme. Në fakt ai ka qenë shërbim i fuqishëm dhe për këtë të bindin shumë edhe vrasjet e pasluftës në Kosovë, pavarësisht pranisë së forcave ndërkombëtare dhe shumë shërbimeve inteligjente. Raste konkrete, që aludoni ju, nuk po më kujtohen. Qysh në vitin 1978 UDBja e kishte filluar atë fushatë dhe donte ta shpërbënte veprimtarinë tonë të organizuar

**Republika**: *Mund të them, për aq sa mbaj mend, se një ndër figurat më të përfolura, në përmasat e saj shpeshherë negative e diskredituese jashtë çdo logjike, ke qenë ti vetë. Ku ndizej e kush e ndizte atë zjarr aq të madh të dyshimeve?*

**KELMENDI**: Besoj, përgjigjen e dini vetë. Por, meqë po kërkoni të përgjigjem unë, atëherë ajo fushatë ishte e koordinuar nga UDBja. Qysh në vitin 1978 ajo e kishte filluar atë fushatë dhe e kishte intensifikuar në prag dhe sidomos pas atentateve, pasi qëllimi ishte që të shpërbëjë veprimtarinë tonë të organizuar, meqë duhet të ketë parashikuar se do kishte ndikim të madh, po u lejua të konsolidohej e të rritej. Koha dëshmoi se ne e përballuam atë dhe bëmë maksimumin e mundshëm. Sigurisht, do kishim bërë më shumë, sikur të kishim qenë në gjendje të minimizonim dobësitë tona, për të përballuar luftën speciale që na bënte UDB-ja, sidomos luftën që e bënte nëpërmjet të ashtuquajturit organizim të legalizuar pluralist gjatë viteve të 90-a, si e thash edhe më heret.

Evropa ka qenë mirë e informuar për gjendjen dhe padrejtësitë në Kosovë, por i ka munguar vullneti i mirë për të mbajtur qëndrim të drejtë.

**Republika**: *Edhe në librin tënd edhe në intervistat, ke vlerësuar si më të ngritur emigracionin në Zvicër në raport me atë të Gjermanisë, ndërkohë që pothuajse nuk i ke lënë farë peshe atij në Belgjikë. Pse?*

**KELMENDI**: Kjo mbase ka ndodhur edhe për shkak të madhësisë numerike të imigrantëve në këto vende. Këto dy emigracione ishin më me ndikim në Kosovë e Maqedoni, ngase kishin lidhje më të ngushta më vendlindjen. Në Belgjikë ishte emigracion më i vogël dhe më i shkëputur, parë thjeshtë edhe në relacion të ndihmave sociale, pasi nëpërmjet këtyre ndihmave emigracioni mund të ushtronte ndikim më të madh në vendlindje.

Lëvizja po përqëndrohej për të rritur angazhimin çlirimtar në Kosovë. Disa individë në Bruksel, që angazhoheshin individualisht, mendonin se rol të madh kishte angazhimi i tyre individual në takime me personalitete politike të Brukselit, informimi i tyre nga këta individë.

Unë përfaqësoja konceptin, se ato personalitete e njihnin më mirë gjendjen në Kosovë sesa individët që përpiqeshin t'i informonin ata, pasi për atë punë ata kishin të angazhuar shërbime e struktura të shumta profesionale. Prandaj, ata nuk ia mbanin anën e Kosovës, jo pse nuk e dinin të vërtetën, por sepse nuk donin. Ata ishin të prirë të përkrahnin më të fortin – Serbinë, meqë kjo do t'u kushtonte më lirë. Mendoja se vetëm aftësimi ynë, për të përballuar e për ta provokuar sa më shumë Serbinë, do t'i detyronte ndërkombëtarët që të ndërrojnë qëndrimin. Nuk besoja në konceptin, se me lobim do ta mundim Serbinë, pasi dija se ajo ishte shumë herë më përpara, me kuadro, me lidhje e me financa. Të vetmin shans kishim gjendjen në terren. Për këto shkaqe dhe të tjerat që nuk po i përmend me këtë rast, nuk i kam dhënë peshë emigracionit të Brukselit, për çka duhet t'u kërkoj që tani falje bashkëveprimtarëve atje, që ishin të organizuar në Këshillin e LPK-

së në Bruksel. Ata, brenda mundësive të tyre, kanë kontribuar shumë, por jo sa dëshironim dhe jo aq sa të kishin ndikim më të madh në atë emigracion.
Ndoshta shpjegimet në të ardhmen do të ma ndryshojnë mendimin, por jo disa propaganda të individëve, të cilët, - më fal për fjalorin, - mendojnë se sa herë kanë pordhë në Bruksel, kanë lëshuar nga një bombë atomike.

Nga përvoja personale di, personalitetet politike që kam takuar në Evropë, kanë qenë mirë të informuar për gjendjen dhe padrejtësitë në Kosovë, por u ka munguar vullneti i mirë për të mbajtur qëndrim të drejtë, pasi kishin për bazë vetëm interesat e tyre të ngushta shtetërore. Edhe sot, të tillë pushtetarë evropianë dinë se, më të fituar materialisht janë nëse përkrahin Serbinë dhe jo Kosovën, por fatmirësisht, sundimtarët e atëhershëm demokratë amerikanë (Clinton, Ollbrajt, Clark e të tjerë përkrahës të doktrinës dhe angazhimit të tyre), i imponuan Evropës dhe botës edhe drejtësinë humanitare. UÇK-ja nga toka, ata nga qielli, e nxorën Serbinë nga Kosova. Këtyre, shqiptarët që dinë të vlerësojnë lirinë e tyre elementare, gjegjësisht lirimin nga pushtimi serb, duhet t'u jenë gjithherë mirënjohës.

Përplasjet kryesore i kishim në mes vete, vetë brezi ynë

**Republika**: *Në emigracion ka pasur një ndeshje gjeneratash: Emigracioni i Kosovës (kupto ai i viseve shqiptare nën Jugosllavi) përballë atij të vjetrit nga Shqipëria. As 28 nëntori nuk i bashkonte, sepse haheshit për flamurin. Pastaj grindeshit rreth përparësive si: a më parë duhet rrëzuar Enver Hoxha apo të çlirohet Kosova. Si i shpjegon këto nga kjo distancë kohore?*

**KELMENDI**: E para, kur kanë filluar lëvizjet tona në vitet e 80-a, ai emigracion, në kuptimin patriotik e politik, pothuajse nuk ekzistonte. Në njëfarë forme ai ishte shkrirë në veten e tij, pasi brezi i dytë i tij nuk donte t'ia dinte për angazhim të baballarëve. Shikuar nga ky këndvështrim, ndonjë përplasje serioze politike e ideore nuk kemi pasur, pos ndonjë përplasjeje simbolike, pa peshë. Pra, emigracioni i vjetër politik në vitet e 80-a nuk ka qenë faktor, por vetëm fiksion. Përplasjet kryesore i kishim në mes vete, vetë brezi ynë, sepse UDB-ja dhe naiviteti ynë na imponronte luftë politike e ideore, ta zëmë se si të festohet, me flamur me yll, ose pa yll, me fotografi të Enverit ose pa të, me fotografi të Titos në klube shqiptare ose pa fotografi , me cilët flamuj të dalim në demonstrata, etj.

Fondin 3 përqindësh e pati përvetësuar e tjetërsuar gjatë dhe pas lufte pseudo-kryeministri Bukoshi

**Republika**: Emigrantët janë mjelë nga shumëkush. Mjelja më herët ka qenë siç ka qenë, pare në kapuç, ndërsa në fillim të viteve '90 ajo u bë "institucionale". Pasi që kam lexuar se do të flasësh për keqpërdorime fondesh, nisja me këtë intervistë!

**KELMENDI**: Fillimisht një sqarim: Lëvizja nuk e ka mjelë emigracionin me të holla të hedhura në kapuç e në paketa, siç na kanë përfolur strukturat afër UDB-së dhe ndonjë i painformuar. Veprimtarinë patriotike e kemi mbajtur me vetëkontributi dhe me ndihma të simpatizuesve të angazhimeve tona.

Sa u përket fondeve, nuk është tematikë që mund të sqarohet nëpërmjet intervistave. Bazuar në përcaktimin tim, të drejtë institucionale shtetërore për të kërkuar llogari, mediat mund të kërkojnë vetëm për "Fondin e Republikës së Kosovës", pasi në atë Fond emigrantët kanë qenë të detyruar të paguajnë tatim (3 për qind nga të ardhurat). Atë Fond e pati përvetësuar e tjetërsuar para, gjatë dhe pas Lufte pseudo-kryeministri Bukoshi.

Sa i përket Fondit "Vendlindja thërret", ai ka qenë Fond i Lëvizjes dhe i UÇK-së, në të cilin është derdhur vetëm ndihma vullnetare (dhe jo tatimi) dhe prandaj mediat sikur nuk kanë aq shumë të drejtë morale për të kërkuar sqarime e llogari. Vërtet, unë kam qenë krye-përgjegjës për këtë Fond në Gjermani dhe si përgjegjës i dytë, pas të ndjerit dhe të lavdishmit Jashar Salihu, për gjithë Fondin "Vendlindja thërret". Kam mëdyshje se kujt dhe kur jam i detyruar t'i jap llogari. Sigurisht, disa shpërdorues të mjeteve të këtij Fondi i kam nën ivestigim (vëzhgim), se si po sillen tani; Të dhënat për ta i kam të gatshme, por do t'i publikoj kur unë e gjykoj se është koha, ose, në ndonjë rast fatkeq, do t'i publikojnë ata që ua kam dhënë t'i ruajnë këto shënime.

LPK-ja e sotme nuk është LPK-ja e para Kuvendit të Prizrenit 1999

**Republika**: *Tash nuk je në asnjë parti politike. LPK-së i ke thënë lamtumirë qysh më 1999 në Prizren. Tash më intereson që për lexuesit e rinj dhe për ata që mund të kenë harruar, të më thuash se gjatë gjithë karrierës tënde të gjatë, me cilat figura politike ke qenë në udhëheqje, si i ke parë ata dikur, si i shihje dje, si i sheh sot?*

**KELMENDI**: Fillimisht një sqarim: LPK-së nuk ia kam dhënë unë lamtumirën, por Kuvendi legjitim i vitit 1999 në Prizren. Ai Kuvend pati vendosu që kjo Organizatë meritore të shpërbëhet dhe anëtarët e saj, kush sipas përcaktimit individual ideor e politik (meqë Lëvizja kishte përbërje pluraliste), të organizohen në parti politike. Partia e tanishme e LPK-së nuk është LPK-ja e para atij Kuvendi. Këta që e kanë formuar këtë parti, nuk kishin të drejtë morale dhe juridike, të formonin këtë parti-lëvizje me këtë emër, meqë këtë të drejtë ua ndalon vendimi i atij Kuvendi.

Sa u përket figurave politike, po ta dija për kë konkretisht e keni fjalën, do t'ju jepja përgjigje konkrete.

Meqë nuk jeni konkretizuar, atëherë edhe mua më mbetet të jap përgjigje të përgjithësuar. Nëse i keni parasysh figurat politike, të cilat unë i kisha bashkëveprimtarë, atëherë me keqardhje më duhet të përgjigjem, se ndaj disave ndjehem i zhgënjyer, sidomos ndaj disave që u angazhuan në politikë. Mendoj se të tillët nuk e përballuan tundimin e famës së papritur, në ndonjë rast edhe të pamerituar, por të imponuar mekanikisht, nuk e përballuan tundimin e pushtetit dhe të pasurimit të pamerituar.

**Republika**: *UÇK-ja ka dalë nga LPK-ja, më vonë a mund të thuhet se ajo në njëfarë mënyre udhëheqjes së lartë të LPK-së i doli nga dora?*

**KELMENDI**: Keni të drejtë, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e ka themeluar LPK-ja, është përkujdesë me përkushtim për rritjen dhe konsolidimin e saj. Përgjithësisht, LPK-ja e ka ruajtur primatin e drejtimit të UÇK-së në aspektin politik, e ka menaxhuar sektorin e saj të logjistikës. Disa segmente të fraksionizuara të UÇK-së qenë pavarësuar nga LPK, edhe pse drejtues të atyre fraksioneve vazhdonin të ishin në struktura të LPK-së. Më konkretisht, bëhet fjalë për disa individë, që u interesonte pasurimi financiar dhe krijimi i karrierës se tyre politike në llogari të UÇK-së.

**Republika**: *Komandantët e UÇK-së kanë qenë kuadro të LPK-së apo jo?*

**KELMENDI**: Për aq sa jam unë i informuar, të gjithë komandantet e zonave dhe pothuajse të gjithë komandantet e niveleve të dyta e të treta kanë qenë anëtarë të LPK-së.

**Republika**: *Nga kjo distancë kohe si e shpjegoni ju përpjekjen e asokohshme për ta vënë UÇK-në nën ombrellë të FARK-ut e të Qeverisë së Kosovës me seli në Bon?*

**KELMENDI**: Insistimi për ta vënë UÇK-në nën kontroll, gjoja në emër të institucionalizimeve, ishte vetëm një përpjekje hileçare për ta zhbërë UÇK-në. Ato pseudo-institucione, pseudo-kryeministri dhe pseudo-presidenti, ishin kundërshtarët më të rreptë të UÇK-së. Por, fatmirësisht ndodhi e kundërta. UÇK-ja krijoi marrëdhënie të mrekullueshme me Shtabin e FARK-ut nga shtatori i vitit 1998...

**Republika**: *Ju e keni njohur dhe e keni kontaktuar Ibrahim Rugovën. Pse nuk mund të merreshit vesh me të?*

**KELMENDI**: Nga ana jonë me kohë ia kemi ofruar bashkëpunimin. Atij, me gjasë i ka mjaftuar vetja e tij dhe idhullimi që i kanë bërë turmat...

**Republika**: *Hysen Gërvalla një kohë të gjatë kërkonte që ju të sqaronit rrethanat e vrasjes së vëllezërve të tij dhe të Kadri Zekës. Tash kur ju kini nxjerre argumente në disa qindra faqe, si e keni parë reagimin e tij, respektivisht lutjen që ju të ju ruajnë si dëshmitar...*

**KELMENDI**: Fillimisht dëshiroj ta falënderoj për mirëpritje të romanit nga ana e tij. Kurse thirrjen e tij për të më ruajtur mua, e kam mirëprit si tepër normale, pasi e ka bërë z. Hysen Gërvalla. Nga ai nuk mund të priten mendime e sjellje më njerëzore, pasi i mungon përgatitja dhe kultura përkatëse. Nga ata që e kanë përcjellë Kuvendin (e grushteve...) të LDK-së, e kanë parë se çfarë shamataxhiu është dhe tek tani mund të më kuptojnë, se çfarë zullumi më ka bërë ky burrrrrr gjatë viteve...

REPUBLIKA, nr. 5/2007)

## 19. ROMANI "ATENTATET" ËSHTË SHEMBULL I PASTËR KU E SHOHIM ME SY RILINDJEN E HERONJVE TË KOMBIT

Shkruan: Daut DEMAKU, shkrimtar
Prishtinë, më 26.08.2007

"Për mua, për këndin tim të vështrimit, ky veprimtar (Ibrahim Kelmendi-shën. i Xh.D.) ka qenë njëlloj nxitjeje,... ...Mezi kam pritë të ketë diçka të shkruar! Pse? Sepse njerëzit që ecin rrugëve të shtruara, trotuareve të gjera, ata nuk janë krijues, janë njerëz të rëndomtë... ...dëmtojnë bukën.

...Dhe, të rëndomtit, nga dëshira që të duken se janë më të devotshëm se ata, bëjnë sajime ndër më të ndryshmet, herë me porosi të pushtuesit e herë nga vogëlsia e tyre e mjerë,.. ...përpiqen të hanë... ...të gjitha plehrat e jetës materiale, jetojnë vetëm me trup, pa mendje e vetëdije. Ndërkaq, ata që kanë energji të madhe... ...nuk pajtohen me rëndomësinë,...

Të frymëzuar nga dëshira shumë e thellë e secilës qenie njerëzore për liri, e harrojnë veten e tyre dhe njësohen me kombin,...

...Këta njerëz mund të takohen me pengesa e vonesa, por derën për hyrje në histori e kanë të hapur...

**Për romanin "Atentatet"**

Në këtë roman janë disa vija apo më saktë: disa shtresa kuptimore që më shtyn t'i shkruaj këta rreshta.

- E para: “Atentatet” është prozë e pastër dokumentare. ...Latinët thonë: Edhe ngjyra më e zbehtë është më e qëndrueshme se memoria më e fortë në botë....

...Dhe këtë depërtim, në shtresat më të ndjeshme të lexuesit, nuk e mundëson as nuk e ndërton mjeshtëria e shkrimit, as prirja e fuqia krijuese, por këtë e bën sinqeriteti i autorit. Ky sinqeritet, që në të njëjtën kohë është veçantia dhe kushti i parë i prozës dokumentare, do të ndikojë që ky roman të këtë numër të jashtëzakonshëm të lexuesve.

- E dyta: shtresa kuptimore, do të thosha, pjesa më e suksesshme e realizuar në këtë roman dokumentar është dimensioni politik. Nuk dua të hyj në burimet, motivet, shkaqet që e mundësuan këtë pjekuri të veprimit politik,...

...Të gjitha shtetet e dinë, hegjemonistët sidomos, se kur nis e paraqitet diku një xixë, një shkëndijë e dashurisë për liri, ajo xixë mund të shndërrohet në flakë, në zjarr...

...Dimensioni politik i romanit “Atentatet” është aq i thellë dhe aq domethënës sa iu mbetet studiuesve të rinj që ta zbërthejnë në qetësi, sepse brumi është aq i vërtetë, aq konkret dhe aq i bollshëm sa mjafton për gatime të të gjitha veprave politike, juridike, kriminalistike, psikologjike...

...Romani “Atentatet” është shembull i pastër ku lexuesi e sheh me sy rilindjen e heronjve të kombit. Ata në këtë roman dalin me urtësinë, mençurinë, pjekurinë e maturinë e jashtëzakonshme të njerëzve që njëmend nuk do të vdesin kurrë. Jusuf Gërvallën e kam njohtë edhe në Prishtinë edhe në Shkup. Duke lexuar romanin e kam parë Jusufin të gjallë, por jo vetëm të gjallë, por më të bukur se kurrë ndonjëherë, më të mençur në mesin e më të mençurve, më të urtë në mesin e urtarëve, më të dashur të kombit.

Duke lexuar këtë roman disa herë jam ndal, kam marr frymë thellë dhe kam thënë: Jusuf Gërvalla me shokë, më lejoni t’ju shpreh urimet e mia të sinqerta për ditëlindjen tuaj të vërtetë. Tash e tutje do të jetoni mu në zemrat e atyre që i keni dashtë aq shumë...” (www.pashtriku.org)

## 20. KUSH I KA DENUAR HERONJTË DHE DESHMORËT...!?

Ibrahim Kelmendi: "Fatkeqësisht, qysh me atentatet ndaj Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës (më 17 Janar 1982 në Gjermani), ka dominuar destruktiviteti gjatë marrjes së vendimeve për mënyrën e varrosjes dhe për vend-varrosje të Tyre (siç ishin “pronësia” destruktive ndaj Tyre nga familjarët...). Akoma më destruktive ishte rivarrosja e Tyre në Atdhe. Vendosën kryesisht familjarët dhe ata që i përvetësuan këta heronj në mënyrën më vulgare si “të tyre”, si “të këtij e të atij krahu”..." (KUSH I KA DENUAR HERONJTË DHE DESHMORËT...!?, www.pashtriku. org,19 dhjetor 2007)

Ibrahim Kelmendi: *"Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë "**raport**" nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do te ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant."* (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.115)

## 21. SAHATI I SINANIT

Anatomi e një gjendjeje që pret rrugëdalje

Shkruan: Prof. dr. Shaban Sinani - Tiranë, 6 tetor 2008

*Autori i këtij libri, Ibrahim Kelmendi, është një emër i njohur për botën shqiptare, dikur si veprimtar i vjetër i lëvizjes klandestine dhe më pas edhe si njeri i letrave.*

*Përveç librit "Shqipëria - jashtë "Veriut" dhe Jugut"", kushtuar ngjarjeve të mistershme të vitit 1997, gjatë zhvillimit të cilave I. Kelmendi nuk mund të mos ndodhej, siç ndodh së shumti me "kryengritësit e përjetshëm" të tipit të Che Guevara-s; dhe librit letrar-jetëshkrimor "Atentatet" kushtuar fillimeve të vështira e të rrezikshme të lëvizjes së organizuar politike në mërgim për zgjidhjen e "gjysmës tjetër" të çështjes kombëtare, kam pasur rast të lexoj dhe një libër tjetër të tij, ende të pabotuar, me përjetime të protagonistëve të mërgatës së vjetër e të re shqiptare, nga shteti i vjetër dhe nga Kosova, për të cilin pata menduar se ishte ende shpejt të dilte në publik.* (www.pashtriku.org)

## 22. ZHVENDOSJA E BINARËVE TË LËVIZJES KOMBËTARE

Fatos Aliu: "Me librin paraprak, Atentatet, autori ka përshkruar katrahurën e planifikuar, për zhvendosjen e binarëve të lëvizjes kombëtare, me vrasjen e veprimtarëve të shquar për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar, të vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zeka." (www.pashtriku.org, Prishtinë, 18 tetor 2008)

## 23. TI E DI, SE PATA SHKRUAR ROMAN DHE JO LIBËR HISTORIK E DOKUMENTAR DHE AS MEMOARE

Ibrahim Kelmendi: 13 PYETJE PËR XHAFER DURMISHIN - AUTORIN E LIBRIT - "LËVIZJA E JUSUF GËRVALLËS!"

I nderuar ish Bashkëveprimtari Xhafer!

Lexova rreth 300 faqet e para të kakofonisë ("librit") Tënde, të emërtuar "Lëvizja e Jusuf Gërvallës", sa për të mos injoruar fare, meqë ishim bashkëveprimtarë. Do përpiqem t'i shoh edhe rreth 700 faqet tjera.

Fillimisht dëshiroj të të falënderoj për mundin dhe përkushtimin, sepse kishe investuar energji të madhe (nëse e ke sajuar vetëm).

E mirëkuptoj hidhërimin dhe mllefin Tënd, por të kaluarën nuk mund ta ndryshoj, për hatër e qejf të askujt, po vetëkuptohet, siç e kam kuptuar, përjetuar e mbajt mend.

Besoj, edhe Ti e di, se pata shkruar roman dhe jo libër historik e dokumentar dhe as memoare. Pata bërë njoftimin se janë nga mbamendja dhe përjetimet e kohës kur kanë ndodh dhe jo mendime e konstatime të kohës kur e kam shkruar romanin.

Në vend të komentimit të menjëhershëm të kakofonisë Tënde, do t'i bëja ca pyetje, nëse ke kohë e vullnet për t'u përgjigjur:

1. Kur, ku dhe nga kush është themeluar LNÇKVSHJ'ja?
2. Ka ndonjë pjesëtarë të gjallë që ka sqaruar, që është përgjigj ose që do të përgjigjet në pyetjet e mësipërme?
3. Kush di për strukturën organizative dhe veprimtarinë e saj në Kosovë?
4. Përmes cilës lidhje dhe kur e ka anëtarësuar Sabri Novosella Jusuf Gërvallën?
5. Kur, kush dhe si të ka anëtarësuar Ty në atë Lëvizje?
6. Çfarë veprimtarie të organizuar ke ushtruar në Kosovë dhe a ke ndonjë të bashk-organizuar që e di veprimtarinë Tënde të organizuar në Kosovë?
7. Kush e ka nxjerrë Sabri Novosellën deri në kufi të RPS të Shqipërisë në fund të vitit 1979, kur është "arratisur"?
8. Di emrat e ndonjë anëtari të Komitetit "Hasan Prishtina" në Turqi gjatë vitit 1980-81, për të dëshmuar se nuk ka qenë vetëm emër fiktiv?

9. Beson Ti se Qeveria Shqiptare i pat dhënë vetëm 10.000, - USD, aq sa ia kishte kërkuar Jusuf Gërvalla përmes letrës dërguar Enver Hoxhës në vitin 1980, të cilat i erdhën përmes Sabri Novosellës?
10. Beson se Qeveria Shqiptare nuk i ka dhënë më mjete asaj Organizate përmes Sabri Novosellës dhe nëse i ka dhënë, i ka shfrytëzuar ato Organizata, apo i ka mbajt për vete "udhëheqësi" Sabri Novosella?
11. Cila është veprimtaria e "bashkëveprimtarëve të ngushtë" të Jusuf Gërvallës në emigracion nga 17. 02. 1982 deri në vitin 1999, ta zëmë e jotja, Sabri Novosellës, Nuhi Sulejmanit, Xhavit Ramabajës, Besim Rexhës, Sadik Blakës, Misin Mavrës, Haxhi Berishës, Hafiz Gagicës, Fahredin Tafallarit, Demë Demaj (nuk po më kujtohen të tjerë që vetë - lavdërohen deri në monotoni)?
12. Kush duhet t'i ketë falsifikuar "raportet" e "letrat", kinse të dërguar nga Jusuf Gërvalla në vitin 1981 "udhëheqësit" Sabri Novosella dhe ku janë origjinalet e tyre?
13. Kush e ka tani arkivin e Jusuf Gërvallës?

Po shpresoj se do të kesh vullnet të mirë që t'u përgjigjesh këtyre pyetjeve?
Me respekt,
Ibrahim Kelmendi (Në vend të reagimit / me 22. 10. 2011, www.pashtriku.org)

## 24. Përshëndetje (Xhafer Durmishi)

Edhe për refuzimin Tënd që të përgjigje në pyetjet që të bëra, të falënderoj, meqë edhe kështu ke dhënë një pjesë të përgjigjes.

Rëndom, kur publikohen libra, bile edhe gjatë promovimit të tyre, ju jepet mundësia të interesuarve të pyesin autorët.

Besoj, analistët e vëmendshëm kanë kuptuar se sa të nevojshme janë sqarimet rreth asaj organizate, sidomos rreth themelimit të saj. Mbaj mend të ketë thënë vet Jusuf Gërvalla, se ndonjëherë edhe UDB-ja ka themeluar organizata "patriotike", për të zbuluar patriotët që dëshirojnë të angazhohen. Bile pat shtuar, se edhe atyre ua kemi parë paksa hairin, meqë edhe përmes tyre është mbajt gjallë nevoja e organizimit të vërtet.

Thënë të drejtën, në kohën që trajton romani ATENTATET, dyshoja se ajo Lëvizje është pjellë virtuale e Sabri Novosellës, për të zbuluar patriotët që kanë gatishmëri për veprimtari çlirimtare. Me keqardhje e dhimbje me duhet të pranoj, se as pas 30 viteve nuk kam mundur të informohem, se ishte organizatë e themeluar prej të vërtetëve për qëllime fisnike. E, tani pata menduar si Ti je në gjendje për të dhënë sqarime, meqë Sabri Novosella të pat plasuar në emigracion (në Evropën Perëndijore) si pasardhës politik e organizativ i Jusuf Gërvallës dhe atë pozicion e ushtrove, deri sa të skartoj "ligji" i seleksionimit (gati 2 vite), pastaj pushove veprimtarinë, meqë nuk kishe më hapësirë...

Nga ana ime, me sinqeritet (deri në naivitet), kam shpjeguar për të gjithë veprimtarët dhe veprimtarinë e asaj kohe në emigracion, po vetëkuptohet, versionin autentik, bazuar në mendimet dhe vlerësimet e mia. Edhe tani dhe kurdoherëë jam i gatshëm të jap sqarime plotësuese për të gjithë të interesuarit, për aq sa di dhe duke pas parasysh përkufizimin, se sa mund të thuhet në kohë e hapësirë të caktuar.

Sidomos në prag të 30-Vjetorit të Lëvizjes (popullore), që, - bazuar në përcaktimin tim, - është me 17 Janar 1982, e quaj të dobishme të ofrohen informata, dëshmi, dokumentacion, vlerësime, të debatohet rreth tyre, për të ndihmuar ndriçimin sa më objektiv të kaluarës sonë.

Shpresoj, kemi krijuar distancë të bollshme kohore, për të diskutuar e për të shpreh mendime e vlerësime, pa inate, pa hile, sidomos pa armiqësime.

Mirëpres angazhimin edhe të ish oficerëve të UDB-së dhe informatorëve të tyre, sidomos të atyre që me profesionalizëm kanë zbatuar ligjet përkatëse të kohës, siç i kanë zbatuar ligjet përkatëse të kohës, të miratuara nga të njëjtat struktura shtetërore, mësuesit, profesorët, nëpunësit, etj.

Uroj që debati të ketë nivel sa më të kulturuar e të kultivuar, pa fyerje e ofendime, me shpresë që secili dhe secila të jenë skajshmërisht të sinqertë.

Me respekt,

i.kelmendi@hotmail.com, (23 tetor 2011; facebook)

## 25. NUK DO TE NGURROJA TA DISKREDITOJA, EDHE PËR SË VDEKURI, PËR TË PABESË E INTRIGANT

**Bedri Islami**: *- Pas botimit të romanit "Atentatet" ju u ndodhët edhe një herë në dy kahe: në përgëzimin e shumë prej atyre që i kishin përjetuar ngjarjet bashkë me ju, si Saime Isufi apo Mustafë Xhemajli, por edhe në ciklimin e radhës së sulmit ndaj jush, nëse mund ta quaj kështu. Mes të tjerave, në një material, i cili po përhapet tashti, nuk e di nëse është i saktë, bëhet* ***fjalë për lidhjen fisnore me Ramë Nikqin ose Ibërdemaj****, i cili, siç e cilëson Xhafer Durmishi, me siguri "analisti" më i zellshëm i romanit tuaj, ishte agjent i UDB-së.*

**Ibrahim Kelmendi:** *- Pas botimit të romanit "Atentatet" ka pasur vërtet reagime të llojllojshme dhe, me thënë të drejtën, më kanë gëzuar. Ato ishin një dëshmi se nuk e kisha shkruar vetëm sa për ta shkruar. Pas dy muajve romani u shit dhe shpesh ndihem keq kur të interesuarit e tjerë e kërkojnë dhe unë nuk kam asnjë kopje. Shtëpia botuese "Toena" e Tiranës ka premtuar ta ribotojë.*

*Tani ka shkruar një reagim të gjatë Xhafer Durmishi, ish-bashkëveprimtar, njëkohësisht ish-kundërshtar i imi. Sa për shembullin që sollët ju për sqarim, unë nuk do t'i isha hidhëruar fare Xhaferit, sikur të kishin qenë shpifje të tij autentike, ngaqë ndaj tyre kam krijuar imunitet. Tani më shqetëson fakti se ato shpifje i vishen Jusufit, të cituar në bazë të një "raporti" që gjoja ai i paskësh dërguar Sabri Novosellës. Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë "raport" nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. Po ta kishte shkruar vërtet ai****, nuk do të ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant****.*

*... Mjafton të them se Jusufi e ka ditur shumë mirë kush ishte Ramë (Idriz) Ibërdemaj, prandaj nuk ka pasur nevojë të hamendesohej nëse ishte Ramë Ibërdemaj apo Ramë Nikqi.*

*...Dihet, dajën nuk e zgjedh dot. Jusufit nuk do t'i kishte shpëtuar kjo lajthitje, edhe po të kishte qenë i pabesë dhe intrigant dhe të kishte përpiluar të tillë "raport" kaq diskreditues, së pari për veten e tij. Pra, kjo lajthitje është prodhuar nga falsifikuesi, i cili ngjan të jetë vetë Xhafer Durmishi, meqë e citon rreth 100 here atë "raport" në "librin" e tij, me titull hileqar e intrigues: "Lëvizja e Jusuf Gërvallës".*

*...Po ta kishte publikuar këtë "libër" Xhafer Durmishi para se ta kisha shkruar romanin "Atentatet", sigurisht, unë do ta kisha mënjanuar Ramë Ibërdemajn si personazh te romanit, për inat të Xhaferit. Prandaj, edhe për inat të Xhaferit, me këtë rast dua t'u kërkoj falje fëmijëve të respektuar të dajës Ramë, pse e kam diskredituar atë në roman si të dyshimtë për bashkëpunëtor të UDB-së. Vetëm për Haki (Ramë) Ibërdemajn,*

*të cilin një spiun i UDB-se e vrau ne Bruksel, sigurisht qe kisha dhënë një tren me xhafera që të mos e vrisnin, sepse e kishte dëshmuar veten në demonstratat e vitit 1981 ne Prishtinë dhe gjate angazhimit të tij patriotik në Bruksel si trim e patriot i devotshëm!"* (Bedri Islami, LËVIZJA, Tetovë 2012, faqe 114-117)

=======================================

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit

01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror*." (14 janar 1981)

**Shënime për autorin**

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në

redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

======================================

**XHAFER DURMISHI-SKENDERI Maj 2013-Shkurt 2026**